FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.22 22 mars 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 105, datë 1.2.2012	Për miratimin e programit ekonomik e fiskal të Shqipërisë, 2012-2014.....	881

VENDIM
Nr. 105, datë 1.2.2012

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT EKONOMIK E FISKAL TË SHQIPËRISË, 2012-2014

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit ekonomik e fiskal të Shqipërisë, për periudhën 2012-2014 sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROGRAMI
EKONOMIK DHE FISKAL
2012-2014

HYRJE

Që nga viti 2006, vendet kandidate potenciale për anëtarësim në Bashkimin Europian, ndër të cilat edhe Shqipëria, në kuadrin e programit të bashkëpunimit ekonomik të thelluar me Bashkimin Europian prezantojnë një program ekonomik e fiskal afatmesëm pranë Komisionit Europian (DG ECFIN). Ky Program është një dokument i rëndësishëm që përfshin formulimin e politikave ekonomike, fiskale dhe reformave strukturore në terma afatmesëm dhe përgatit kapacitetet institucionale dhe analitike për pjesëmarrjen në procedurat e mbikëqyrjes ekonomike e monetare të Bashkimit Europian.

Ky dokument paraqet një informacion të qartë të politikave ekonomike dhe prioriteteve afatmesme të vendit në kuadrin e reformave strukturore që parashikohen të zbatohen gjatë periudhës 2012-2014, të cilat kanë për qëllim stabilitetin makroekonomik dhe sigurimin e një rritjeje ekonomike të lartë, si dhe ngritjen e një kuadri rregullator dhe politikave sektoriale në përputhje me standardet europiane.

Dokumenti PEF 2012-2014 paraqet prioritetet kryesore të ekonomisë shqiptare. Në kapitullin e parë paraqitet situata aktuale e zhvillimeve ekonomike, sektorit real, e atij monetar. Në kapitullin e dytë paraqitet programi afatmesëm i ekonomisë i ndarë në tre pjesë, duke trajtuar parashikimet në lidhje me sektorin real, në lidhje me nivelin e inflacionit në lidhje me sektorin monetar dhe kursin e këmbimit dhe atë të sektorit të jashtëm. Në kapitullin e tretë paraqitet i detajuar kuadri afatmesëm mbi financat publike. Ky kapitull i kushton një vëmendje të veçantë parashikimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore për periudhën afatmesme, si dhe një trajtim të strategjisë së borxhit publik. Kapitulli 4 paraqet reformat më të rëndësishme strukturore që do të ndërmarrë Qeveria e Shqipërisë në fushën e konkurrencës, reformave për thithjen e investimeve të huaja, privatizimit të sektorëve strategjikë, në sektorin financiar, në tregun e punës dhe reformat administrative.

1. PERSPEKTIVA EKONOMIKE

Rimëkëmbja e ekonomisë globale vazhdoi edhe gjatë vitit 2010 duke pësuar një rritje prej rreth 4.8% e cila ishte më lartë sesa parashikimet. Zgjerimi i aktivitetit global gjatë vitit 2011 parashikohet të jetë rreth 3.6 % duke pësuar një rënie nga viti i kaluar. Ky ngadalësim është pasojë e zhvillimeve të pritura dhe të papritura të situatës ekonomike.

Rimëkëmbja e fortë në prodhimin industrial të tregtisë gjatë vitit 2010 nuk pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2011. Përveç kësaj, borxhet sovrane dhe problemet në sektorin bankar në zonën euro kanë sjellë më shumë tension sesa pritej. Për më tepër, problemet që sollën tërmetet dhe cunami në Ishujt

Japonezë, si dhe përhapja e situatës në vendet e Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore (MENA) rezultuan në ngritje të çmimeve të karburanteve, dhe me të papritura të tjera. Rezultati neto i ndryshimeve në zhvillimet e vendeve në zhvillim e sipër sollën rritje të ulët të ekonomisë globale gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011. Ndërkohë gjatë vitit 2012 rritja reale globale parashikohet të rritet në nivelin e 4.1% sipas FMN-së (*IMF, World Economic Outlook September, 2011)*.

Luhatjet e fundit financiare kanë qenë të mëdha, si pasojë e zhvillimeve në zonën euro dhe forcimit të aktiviteti global veçanërisht në SHBA. Paqartësia në lidhje me politikat ekonomike dhe stresi financiar kanë sjellë pasoja në ekonominë reale. Zhvillimet në ekonominë e BE-së që janë partnerët kryesorë në ekonominë shqiptare kanë qenë në të njëjtën linjë me zhvillimet botërore. PBB në zonën euro u rrit me 0.2% në tremujorin e tretë të vitit 2011 krahasuar me një tremujor më parë, kjo kryesisht ka ardhur si pasojë e një bilanci pozitiv tregtar në vlerën e 1,1 miliardë euro në tetor 2011. Edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011 BE-ja dhe të gjitha vendet anëtare të saj patën rritje pozitive të parashikuara këto që në pranverë të vitit 2011.

Pavarësisht një rritjeje të përgjithshme të ekonomisë së BE-së, kjo ekonomi mbetet e brishtë dhe e tillë mbetet edhe ekonomia në rajon. Dallimet janë më të mëdha kur bëhet fjalë për vendet që janë të orientuara drejt eksportit të cilat po rikuperojnë në mënyrë të qëndrueshme në krahasim me vendet e tjera të cilat po mbeten mbrapa. Rimëkëmbja ekonomike ndërmjet vendeve të ndryshme të BE-së pritet të jetë e ndryshme në varësi të ekonomisë të secilit vend, të paktën për një periudhë afatmesme. Parashikimi i zhvillimeve ekonomike për vendet e BE-së nga Komisioni Europian për periudhën 2012–2013 mbetet në nivelin mesatar të rritjes reale të vitit 2011. Ndërkohë që eurozona pritet të ketë një rritje akoma me modeste dhe 2013, në këtë rritje një ndër faktorët është konsolidimi fiskal që shumë prej anëtarëve të BE-së po tentojnë t'i bëjnë pjesë të financave të tyre publike për sigurimin e një qëndrueshmërie.

Presionet inflacioniste në ekonominë botërore (rreth 5% në 2011 sipas FMN-së) janë prezente që prej viteve 2009-2010, por janë parashikuar që për vitet 2012 dhe 2013 të ketë një rritje në çmimet e mallrave të konsumit, e cila do të japë efekt mbi çmimin e ushqimeve në Shqipëri. Risku i lëvizjeve të kapitaleve dhe dëshirës për të investuar në vendet e Europës Juglindore është i ulët.

Zhvillimet makroekonomike në Itali dhe Greqi që janë partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë, duket se vijojnë të mbeten të zbehta. Pas një tkurrje të PBB-së me gati 2% gjatë 2009-2010, ekonomia italiane pati një rritje pozitive gjatë tremujorit të dytë të 2011-s krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010. PBB-ja italiane u rrit me 0.1% në tremujorin e parë të vitit 2011 dhe 0.3 në tremujorin e dytë. Kryesisht ekonomia italiane bazohet në pjesën më të madhe të saj nga prodhimi i mallrave të konsumit me cilësi të lartë të prodhuara nga kompani të vogla dhe të mesme. Italia raportoi një deficit tregtar prej 1.1 miliardë euro në tetor 2011. Pjesën më të madhe të eksporteve italiane e zënë ushqimet, veshmbathjet, makineritë dhe automjetet, kimikatet dhe pajisjet elektronike. Italia importon kryesisht produkte inxhinierike, kimikate, mjete transporti, produkte energjie, minerale, tekstile dhe veshmbathje, pije dhe duhan etj. Marrëdhëniet më të forta tregtare të Italisë janë me vendet e tjera të BE-së ku Gjermania dhe Franca janë partnerët më të mëdhenj për të. Në të njëjtën kohë, një ndryshim në kërkesën e brendshme gjatë periudhës janar-tetor 2011 çoi në rritje të volumit të importit të mallrave me 25.4%, gjë që ndikoi edhe në rritjen pozitive në eksportet e Shqipërisë drejt Italisë. Pritet që rritja e moderuar të vazhdojë edhe në dy vitet në vijim. Në 2012 parashikimet për rritjen reale të PBB-së Italiane mbetet të jetë në të njëjtin nivel rreth 0.3%, ndërsa në 2013 rritja pritet të jetë +0.5% nivel ky rreth 1.4 pikë përqindje poshtë mesatares së rritjes së BE-së. Në të njëjtën kohë punësimi në Itali pritet të arrijë në 0.07% në vitin 2012 krahasimisht me vitin 2011.

Masat për konsolidimin fiskal të adoptuara nga Greqia sidomos pas ndihmës së 6-të të dhënë nga BE-ja prej 8 miliardë euro, pritet të përmirësojnë ekonominë dhe kërkesën e brendshme për fundin e vitit 2011 dhe fillimin e vitit 2012. Pas një rrudhjeje prej 4.4% në 2010 dhe rreth 5% i pritshmi për vitin 2011, rritja reale e PBB-së në vitin 2012 pritet të ngadalësojë ritmin negativ në rreth 2%. Kjo kryesisht prej efekteve të mbartura nga vitet e kaluara. Megjithatë pas masave fiskale të ndërmarra pritet një rritje në pritshmërinë e përgjithshme të tregjeve dhe agjentëve ekonomikë dhe rritja reale pritet të kthehet pozitive gjatë gjysmës së dytë të vitit 2012, duke e çuar rritjen reale të PBB-së në 2013 në 1.5%. Në

harmoni me pritshmërinë e PBB-së pritet që punësimi të bjerë me 6% në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011.

1.1 ZHVILLIMET E FUNDIT EKONOMIKE

Në fillim të viteve ’90 Shqipëria ndërmori rrugën e vështirë të hapjes së ekonomisë së saj nga një ekonomi e mbyllur në një ekonomi të tregut të lirë. Gjatë kësaj kohe Shqipëria filloi t’i nënshtrohej një regjimi ristrukturimi makroekonomik. Nevoja për reforma ishte shumë e madhe duke përfshirë të gjithë sektorët e ekonomisë. Procesi i tranzicionit dhe kalimi i ekonomisë tonë nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë është shoqëruar jo vetëm me transformimin e mekanizmave dhe infrastrukturës të funksionimit të tregjeve, por mbi të gjitha me nevojën e zhvillimit dhe krijimit të instrumenteve dhe hapësirave të reja ligjore, institucionale, ekonomike dhe sociale me qëllim rritjen e efiçencës alokuese dhe përdoruese të burimeve publike dhe private.

Gjatë dekadës së fundit ekonomia shqiptare ka njohur një progres të qëndrueshëm dhe relativisht të kënaqshëm krahasuar me vendet e rajonit. Proceset e transformimit ekonomik dhe ristrukturimit, si dhe politikat makroekonomike të ndjekura në dhjetë vitet e fundit kanë rezultuar në një nga ritmet e rritjes më të larta në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL). Me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.6 për qind, PBB-ja për frymë është rritur me rreth 2.3 herë gjatë periudhës 2000 – 2010 (nga 171 mijë lekë në vitin 2000 në 385 mijë lekë për banor në vitin 2010). Ndërsa PBBj-ja për frymë e shprehur në dollarë amerikanë të indeksuar me Paritetin e Fuqisë Blerëse (USD-PPP) është rritur me rreth 2.5 herë gjatë kësaj periudhe (nga 3500 USD-PPP në vitin 2000 në 8900 USD-PPP në vitin 2010). Ulja e barrës tatimore dhe lehtësirat administrative, kanë ndihmuar biznesin për të rritur produktivitetin e tij. Zhvillimet pozitive në sektorin e biznesit, veçanërisht në atë industrial dhe në atë të orientuar drejt shërbimeve, kanë rezultuar në një rritje të punësimit dhe të të ardhurave familjare. Të ardhurat në rritje, të mbështetura edhe nga zgjerimi i kredisë në ekonomi, kanë kontribuar për një kërkesë të fortë të brendshme, e cila ka sjellë nxitjen e investimeve kapitale dhe zgjerimin e prodhimit.

Gjatë viteve të krizës dhe pas krizës ekonomike globale (2009-2011), stabiliteti makroekonomik në vend ka ndjerë presionet negative të saj, megjithatë është arritur të ruhet në parametra relativisht të kënaqshëm. Gjatë secilit prej viteve 2009-2011, u arrit të evitohej recesioni ekonomik, i cili u përjetua në pjesën dërrmuese të vendeve të rajonit dhe më gjerë, dhe ekonomia shqiptare vijoi të performojë me ritme pozitive rritjeje. Rritja mesatare ekonomike e Shqipërisë gjatë viteve 2000-2008 (periudha para krizës) ishte në nivelin 6.2%, duke qenë mbi mesataren prej 5.3% të vendeve të EQL-ja, ndërsa norma e inflacionit mesatar për këtë periudhe ishte 2.7%, ndjeshëm poshtë mesatares prej 8.5% të vendeve të EQL-ja. Gjatë viteve 2009-2011 (periudha e krizës dhe pas saj) ekonomia e Shqipërisë ka performuar me një rritje mesatare prej rreth 3.1% , dukshëm mbi rritjen mesatare prej 0% të vendeve të EQL, ndërsa inflacioni mesatar ka qenë në nivelin 3.2%, lehtësisht poshtë inflacionit mesatar prej 3.7% të vendeve të EQL-së.

Një prej faktorëve përcaktues në evitimin e recesionit përgjatë goditjes së krizës globale, veçanërisht gjatë vitit 2009, ishte stimuli i fortë dhe efektiv i injektuar në ekonomi nëpërmjet një politike fiskale ekspansioniste, e cila u materializua kryesisht në një nivel të lartë investimesh publike, duke kompensuar rënien në kërkesën e jashtme dhe ngadalësimin e kërkesës së brendshme. Në vitin 2010, politika fiskale u riorientua përsëri në një kurs të qëndrueshëm drejt konsolidimit të financave publike, ku deficiti fiskal u reduktua në 3.1% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) nga 7% e PBB-së që ishte në vitin 2009, ndërsa borxhi publik ra në nivelin 58.1% të PBB-së nga niveli 59.3% që ishte në vitin 2009. Në rrafshin relativ, mund të thuhet se politika fiskale e ndjekur gjatë viteve 2009-2011 (periudha e krizës globale dhe ajo post-krizë) ka rezultuar relativisht mjaft efektive, pasi në njërën anë vlerësohet si një prej faktorëve kyç në evitimin e një recesioni ekonomik dhe mbajtjen e ekonomisë në terren pozitiv, ndërsa nga ana tjetër zgjerimi i borxhit publik në raport me PBB për këtë periudhë trevjeçare ka rezultuar relativisht i ulët krahasuar me vendet e EQL-së.

Kredibiliteti i konsiderueshëm i investitorëve të huaj dhe tregjeve të huaja të kapitalit në ekonominë dhe financat publike të Shqipërisë u reflekua qartë në emetimin e Eurobondit të Shqipërisë, në tetor 2010. Megjithëse koha në të cilën u emetua Eurobondi sërish karakterizohej nga një volatilitet dhe pasiguri e lartë në tregjet e kapitalit, Shqipëria arriti të dalë për herë të parë në tregjet e huaja të kapitalit

duke emetuar Eurobondin me vlerë nominale prej 300 milionë euro, në terma relativisht mjaft të favorshëm, respektivisht me një afat maturimi prej pesë vjetësh dhe me një normë interesi prej 7.5%

Sektori real

Viti 2010 ishte sërish një vit relativisht i mirë për ekonominë tonë. Rritja reale ekonomike për vitin 2010 ishte 3.8%, dhe ishte në përshpejtim përgjatë gjithë vitit duke arritur 5.4% në tremujorin e fundit të 2010-s (rritje vjetore) nga 2% që ishte në tremujorin e parë të 2010-s, ose nga rritja negative prej 0.7% e regjistruar në tremujorin e fundit të 2009-s. Në ndryshim nga vitet e mëparshme, rritja ekonomike në 2010, u gjenerua nga kërkesa e jashtme e udhëhequr nga eksporti i mallrave. Në ndryshim edhe me vitin 2009, ku rritja pozitive prej 3.3% u gjenerua kryesisht nga kërkesa e brendshme, e cila reflektoi stimulin e fortë fiskal të "injektuar" nga qeveria, rritja ekonomike e 2010-s u gjenerua pothuajse plotësisht nga sektori privat, duke qenë se pozita fiskale, gjatë 2010-s krahasuar me 2009-n, ishte negative.

Rritja ekonomike vazhdoi të ishte pozitive edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 në nivelin prej 2%. Ulja e ritmit të rritjes gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, por edhe gjatë vitit 2011 në tërësi ishte reflektim i ndikimit negativ të disa variablave të ambientit të jashtëm, por veçanërisht e ndikimit negativ të zhvillimeve të brendshme kryesisht gjatë gjysmës së parë të vitit.

Produkti i brendshëm bruto ngadalësoi ritmet reale të rritjes vjetore në 3.4% në tremujorin e parë të vitit 2011 dhe në 0.5% në tremujorin e dytë, pas zgjerimit progresiv të aktivitetit ekonomik gjatë dy tremujorëve të fundit të vitit 2010. Nga ana e sektorëve të prodhimit, kontribuuesi kryesor në rritjen vjetore të PBB-së ishte sektori i industrisë, ndërkohë që edhe sektori i shërbimeve dhe degët e ndërtimit dhe të bujqësisë patën një kontribut pozitiv në rritje. Me gjithë rritjen pozitive të regjistruar gjatë të tre viteve 2009-2011 ku efektet negative të krizës ekonomike globale kanë dominuar performancën e përgjithshme të ekonomisë, zgjerimi i aktivitetit ekonomik vazhdon të qëndrojë nën nivelin potencial. Nga ana e komponentëve të shpenzimeve të kërkesës, politika stimuluese e sektorit fiskal ka dhënë kontributin kryesor në rritjen e kërkesës së brendshme, duke kompensuar ecurinë e ngadaltë të investimeve dhe konsumit privat për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2011. Ndërkohë, performanca e mirë e eksporteve ka vazhduar të mbështesë norma pozitive të zgjerimit të aktivitetit ekonomik, por në një masë më të vogël, krahasuar me një vit më parë.

Rritja ekonomike parashikohet të jetë poshtë potencialit të saj rreth nivelit prej 3%, e kushtëzuar nga rritja e ngadaltë e kërkesës së brendshme dhe të jashtme dhe zbehja e stimulit fiskal. Për periudhat e ardhshme pritet që kërkesa e brendshme të luajë rolin kryesor në rritjen e kërkesës agregate.

Grafik. Ecuria e PBB-së (ndryshime vjetore dhe tremujore, grafiku majtas); treguesi i ndjesisë ekonomike dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve (grafiku djathtas).



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Ecuria e prodhimit sipas sektorëve

Sipas të dhënave të INSTAT-it, rritja ekonomike gjatë gjysmës së parë të vitit paraqitet e balancuar në shpërndarjen e saj sektoriale. Të gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë vlerësohet të kenë shënuar rritje gjatë kësaj periudhe, por rritja ekonomike vazhdon të udhëhiqet nga sektori i industrisë dhe ai i shërbimeve. Ndërkohë, pjesërisht edhe në përgjigje të rritjes së investimeve publike, sektori i ndërtimit shënoi rritje pozitive për herë të parë pas një periudhe të gjatë kontraktimi prej 5 tremujorësh.

Grafik. Kontributet e sektorëve në ecurinë vjetore të PBB-së (në pikë përqindjeje, grafiku majtas); treguesi i ndjesisë ekonomike dhe treguesit e besimit në industri, në ndërtim dhe në shërbime (grafiku djathtas).





Burimi. INSTAT dhe Banka e Shqipërisë

Treguesi i ndjesisë ekonomike sinjalizon një përmirësim të lehtë të aktivitetit vendas në tremujorin e dytë dhe të tretë, në terma tremujorë, ndonëse mbetet rreth 8.5 pikë përqindjeje më i ulët se mesatarja historike afatgjatë.

Sektori i industrisë vijoi të ndikojë në një masë më të madhe se sektorët e tjerë të ekonomisë në rritjen e prodhimit të brendshëm bruto në tremujorin e parë të vitit 2011. Vlera e shtuar e sektorit të industrisë regjistroi një rritje me 12.4 % në terma vjetorë gjatë tremujorit të parë të 2011. Megjithatë, ngadalësimi i shfaqur në aktivitetin industrial si pasojë e frenimit të kërkesës së huaj , u reflektua në një rënie të këtij sektori gjatë tremujorit të dytë me rreth 8.5% në terma vjetorë. Tkurrja e eksporteve kryesore industriale për dy muajt e parë të tremujorit të dytë ishte një ndër faktorët kryesorë që çoi në ngadalësim të aktivitetit industrial, sidomos atij të lidhur me eksportin. Gjithashtu, rritja e çmimeve në tregjet botërore për një sërë eksportesh shqiptare, kryesisht ato të lidhura me nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve, ka pushuar dhe gjithashtu natyra e përkohshme e ekspansionit të shpejtë të eksporteve hidroenergjetike gjatë vitit 2010 është konfirmuar duke e rikthyer sektorin e energjisë elektrike sërish me një bilanc tretar negativ. Megjithatë, sektori i industrisë përfaqëson një ndër sektorët më të kredituar prej sistemit bankar, çka do të mbështesë një ecuri të mirë të këtij aktiviteti në të ardhmen afatmesme. Vlera e shtuar e sektorit të ndërtimit shënoi një rritje vjetore prej 4.8% gjatë tremujorit të parë të vitit 2011 dhe sërish një kontraktim të lehtë prej 1.7% gjatë tremujorit të dytë ose një rritje të lehtë prej 1.2% për gjysmën e parë të vitit.

Grafik. Vlera e shtuar, indeksi i shifrës së afarizmit (sha) dhe treguesi i besimit në ndërtim.





Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë

Në tremujorin e tretë, sipas treguesve të besimit, aktiviteti i gjeneruar nga sektori industrial dhe ai ndërtues shfaqet më i përmirësuar krahasuar me një tremujor më parë. Tregues të tërthortë sasiorë si - rritja vjetore e eksporteve industriale me 34% gjatë muajve korrik-gusht, rritja vjetore e të ardhurave tatimore të sektorit prodhues me 52% dhe në veçanti e të ardhurave nga TVSH-ja me 3% për 7 muajt e parë të vitit 2011 - konfirmojnë drejtimin e tendencës së të dhënave cilësore në sektorin prodhues në total.

Në gjysmën e parë të vitit 2011, vlera e shtuar e gjeneruar prej degës së bujqësisë, gjuetisë, pyjeve dhe peshkimit në prodhimin vendas ishte 3.2% më e lartë në terma vjetore. Megjithatë, zgjerimi i aktivitetit bujqësor mbetet nën ritmin e shënuar gjatë 2010-s. Kontributi i dhënë në rritjen vjetore të PBB-së vlerësohet në 0.5 pikë përqindjeje.

Grafik. Vlera e shtuar në degën e bujqësisë, gjuetisë, pyjeve dhe peshkimit



Burimi: INSTAT dhe Ministria e Bujqësisë

Vlera e shtuar nga sektori i shërbimeve shënoi një rritje vjetore me 2.3% gjatë tremujorit të parë të vitit 2011 dhe 1.8% gjatë tremujorit të dytë të tij, duke shënuar një ngadalësim të rritjes vjetore të regjistruar gjatë tre tremujorëve paraardhës. Kjo tendencë konfirmohet edhe nga rritja vjetore me normë më të ulët të shifrës së afarizmit në vëllim të këtij sektori. Kontributi i dhënë prej shërbimeve në rritjen vjetore të PBB-së rezultoi rreth 1 pikë përqindjeje, duke qenë ndjeshëm më i ulët se kontributi mesatar historik i tij.

Grafik. Vlera e shtuar, indeksi i shifrës së afarizmit (sh.a.) dhe treguesi i besimit në shërbime.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë

Treguesi i besimit në shërbime sugjeron për një përmirësim të ecurisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011.

Ecuria e komponentëve të kërkesës agregate

Nga ana e kërkesës, rritja ekonomike u mbështet kryesisht nga shpenzimet dhe investimet e sektorit publik dhe kërkesa e huaj ndërsa investimet dhe konsumi i sektorit privat mbetën të ngadaltë. Të dhëna të tërthorta që disponohen për konsumin privat sugjerojnë se ai ka vijuar të japë kontribut të ulët në rritjen e kërkesës agregate në nëntëmujorin e parë të vitit 2011. Të dhënat nga importi i mallrave për konsum përshpejtuan rritjen në 1.3% në tremujorin e tretë pas rritjes me 0.9% dhe 1.7% në tremujorin e dytë dhe të parë të vitit. Në nivel 9-mujor rritja rezultoi 1.3% në terma nominalë. Financimi i konsumit privat në tremujorët dytë dhe të tretë të vitit 2011 është mbështetur nga rritja e të ardhurave reale të disponueshme, kredia konsumatore dhe përmirësimi i besimit konsumator. Megjithatë, niveli i lartë i depozitave me afat të individëve dhe tendenca rritëse e pirjes për të kursyer sugjerojnë për vazhdimësinë e kujdesit të shtuar të individëve në drejtim të sjelljes së tyre ndaj konsumit.

Grafik. Tregues të tërthortë të konsumit dhe investimeve private



Burimi: INSTAT e Banka e Shqipërisë

Pas rikuperimit të investimeve private deri në tremujorin e parë të vitit 2011, ato vlerësohen të jenë ngadalësuar gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit. Importi i mallrave kapitale shënoi rritje vjetore dyshifrore prej 19.8% në tremujorin e parë, favorizuar nga kërkesa e jashtme dhe vijimi i rritjes së eksporteve. Shuarja e efektit të multiplikatorit fiskal, ka bërë që tremujorët e dytë dhe të tretë të jenë më të ngadaltë në krahasim me tremujorin e parë. Importi i mallrave kapitalë ngadalësoi ritmet vjetore të rritjes në 2.4 dhe 1.1% përkatësisht në tremujorin e dytë dhe të tretë. Pavarësisht rritjes së normës së shfrytëzimit të kapaciteteve, kërkesa për investime vlerësohet të jetë e ulët në kushtet kur sistemi bankar vazhdon të adoptojë një sjellje të kujdesshme në kreditim dhe kushtet e financimit paraqiten më të shtrënguara në krahasim me periudhat e mëparshme. Kredia për investime, ka ndjekur një trend rënës nga tremujori në tremujor, ndonëse ka pasur ecuri të mirë në nëntëmujorin e parë të vitit.

Sektori i jashtëm

Të dhënat më të fundit të disponueshme mbi treguesit kryesorë të sektorit të jashtëm të ekonomisë, pasqyrojnë ngushtim në terma realë të deficitit të eksporteve neto gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011 krahasuar me një vit më parë. Ngushtimi i deficitit të eksporteve neto ka ardhur si pasojë e rënies së importit të mallrave e shërbimeve në terma realë me rreth 19.0%. Zhvillimet në balancën e importit dhe eksportit të mallrave e shërbimeve reale, vlerësohen të jenë materializuar në një kontribut pozitiv të këtij komponenti në rritjen e kërkesës agregate përgjatë kësaj periudhe. Ky zhvillim përbën një ndryshim për sa i përket kahut të ndikimit, pas kontributit negativ të dhënë gjatë tremujorit të parë të vitit 2011.

Ecuria e inflacionit dhe politika monetare

Inflacioni vjetor në gjashtëmujorin e parë të viti 2011 rezultoi 4.05%, duke qëndruar mbi kufirin e sipërm të bandës së tolerancës për objektivin afatmesëm të Bankës së Shqipërisë. Periudha shkurt-maj 2011 ishte përcaktuese në vlerat e larta të inflacionit vjetor. Në muajin qershor inflacioni u kthye brenda bandës së sipërme të tolerancës (3.9%). Prirja në rënie e inflacionit vjetor, e nisur që në tremujorin e dytë, u theksua dukshëm gjatë periudhës korrik-shtator 2011. Reduktimet e pritura të kontributeve të kategorive të mallrave dhe shërbimeve me çmime të rregulluara dhe të nëngrupit "Bukë dhe drithëra" në inflacionin total, u shoqëruan nga një ndryshim i sjelljes sezonale të çmimeve të produkteve bujqësore të freskëta, kryesisht në muajt gusht e shtator[1]. Zhvillimet e mësipërme kanë vijuar të balancojnë presionet inflacioniste të gjeneruara nga nivelet relativisht të larta të çmimeve të lëndëve të para në tregjet botërore. Ndonëse ato mbetën të tilla gjatë tremujorit të tretë, evidentohet një frenim i ritmeve të rritjes së tyre. Të ndihmuara nga një qëndrueshmëri afatmesme e kursit të këmbimit, presionet inflacioniste nga inflacioni i importuar rezultuan më të moderuara se në pjesën e parë të vitit.

Grafik. Inflacioni vjetor dhe mesatarja rrëshqitëse (në %).



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Në terma mesatarë inflacioni mbeti ende mbi objektivin qendror, si pasojë e pranisë së presioneve inflacioniste relativisht të larta të shtrira në një periudhë njëvjeçare[2]. Sinjalet për frenim të presioneve inflacioniste janë përcjellë edhe nga zhvillimet në inflacionin bazë dhe atë të patregtueshëm gjatë muajve të këtij tremujori. Krahas zbutjes së presioneve më afatgjata inflacioniste, rritja e shkallës së përmbushjes së ofertës së tregut me prodhime vendase, si edhe ecuria e kursit të këmbimit kanë ndihmuar zbutjen e presioneve inflacioniste me origjinë jashtë ekonomisë dhe me veprim afatshkurtër. Presionet inflacioniste nga krahu i kërkesës së brendshme, vlerësohen të kenë qenë të moderuara gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2011. Periudha në vijim nuk vlerësohet se do të ketë presione të shtuara inflacioniste nga ana e kërkesës së brendshme.

Presionet më të forta inflacioniste vlerësohet të jenë gjeneruar nga krahu i ofertës në pjesën e parë të vitit. Kombinimi dhe mbivendosja e ndikimit të faktorëve të mësipërm çoi në evidentimin e efekteve të veprimit të dytë, duke shkaktuar rritjen e pritjeve inflacioniste të agjentëve të tregut. Në parandalim të këtij fenomeni, Banka e Shqipërisë, rriti normën bazë të interesit me 0.25 pikë përqindje në fund të muajit mars 2011. Bazuar në natyrën paraprirëse të vendimmarrjes së politikës monetare, u vlerësua që rritja e normës bazë të interesit do të ndihmonte në sheshimin e luhatjeve të çmimeve, ndërkohë që masa e kësaj lëvizjeje nuk do të cenonte rritjen e aktivitetit ekonomik në terma afatmesëm.

[1] "Frutat dhe perimet" zënë rreth 9% të shportës së IÇK-së. Ndërkohë që vitin e kaluar kjo nënkategori shënoi një inflacion mesatar vjetor dhe tremujor prej (2.7% dhe -12.8%), në tremujorin e tretë 2011 normat përkatëse të inflacionit rezultuan (-4.1% dhe 16.8%). Në vite luhatshmëria e inflacionit përkatës për tremujorin të tretë (në veçanti për muajt gusht dhe shtator) vlerësohet të jetë e lartë duke mos paraqitur një sezonalitet shumë të qartë.

[2] Mesatarja e inflacionit vjetor për periudhën janar-shtator 2011, rezultoi 3.8%. Ndërkohë që mesatarja lëvizëse si matëse që sinjalizon prirjen e një treguesi, sepse sheshon pjesërisht luhatshmërinë afatshkurtër arriti në 3.6% në tremujorin e tretë të vitit 2011, nga 3.7% në tremujorin paraardhës.

Mbështetur në analizat dhe projeksionet afatmesme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në fund të muajit shtator 2011, uli normën bazë të interesit me 0.25 pikë përqindje, duke e çuar atë në nivelin 5.0 %, me qëllim nxitjen e kërkesës dhe të aktivitetit ekonomik.

Prirjet kryesore të inflacionit

Inflacioni bazë vjetor[3] në tremujorin e tretë të vitit 2011 rezultoi 3%, vlerë kjo më e ulët se sa maksimumi historik i këtij treguesi, i kapur gjatë tremujorit paraardhës[4]. Prirja në rënie rezultoi më graduale se ajo e inflacionit total.

Sjellja e inflacionit jo bazë, i cili rezultoi 3.5% në terma vjetorë, ka luajtur rol të rëndësishëm në normalizimin e vlerave të inflacionit total gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011. Inflacioni jo bazë ndoqi një prirje në rënie më të shpejtë se sa ai bazë, duke prekur në muajin shtator të vitit 2011 një nga vlerat më të ulëta historike të serisë (2.6%). Luhatjet afatshkurtra në çmime u zbutën në mënyrë të ndjeshme, për shkak të zhvillimeve të qëndrueshme në kursin e këmbimit, të shuarjes së plotë të efektit të rritjeve të çmimeve të rregulluara dhe të sjelljes përtej profilit sezonal të çmimeve të produkteve bujqësore.

Presionet inflacioniste me origjinë brenda dhe jashtë ekonomisë së vendit gjatë vitit 2011 erdhën në rënie. Kjo sjellje u materializua në vlera më të moderuara se më parë të inflacionit vjetor të sektorit të mallrave të tregtueshëm, të patregtueshëm neto dhe të atij të çmimeve të rregulluara të shportës së IÇK-së.

Inflacioni vjetor i sektorit të tregtueshëm të shportës së IÇK-së në tremujorin e tretë rezultoi 3.7%. Inflacioni vjetor i sektorit të patregtueshëm neto[5] të shportës së IÇK-së, në tremujorin në analizë rezultoi 2.2%, vlerë e përafërt me atë të pjesës së parë të vitit dhe me mesataren e pesë viteve të fundit.

Në tremujorin e tretë kontributi vjetor i inflacionit të importuar tek ai total vlerësohet rreth 50%, duke dëshmuar për vendosjen e një balance ndërmjet presioneve inflacioniste të ushtruara nga jashtë dhe brenda ekonomisë së vendit mbi çmimet e konsumit.

Tregu i punës, pagat dhe kostot e punës

Zhvillimet në tregun e punës në tremujorin e dytë të vitit 2011 konfirmuan stabilizimin e kushteve të tij për të tretin tremujor radhazi. Rritja e punësimit në një masë më të madhe se rënia e shënuar e normës së papunësisë, u reflektua në zgjerimin e forcës së aftë për punë. Ecuria e ardhshme e punësimit vlerësohet lehtësisht më e përkeqësuar në tremujorin e tretë, për të vijuar me një përmirësim të pritur në tremujorin e katërt. Bizneset sinjalizojnë një ecuri të pagave pothuajse në të njëjtin nivel për tremujorin e dytë, krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ndërsa për pjesën e mbetur të vitit pritet një rritje e tyre.

Tregu i punës

Përmirësimi i kushteve në tregun e punës, i shfaqur që në tremujorin e katërt të vitit 2010, vijoi edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011. Sipas të dhënave më të fundit të forcave të bilancit të punës për këtë periudhë, numri mesatar i të punësuarve u rrit me 2.46% në terma vjetorë. Zgjerimi vjetor me 5.4% i punësimit në sektorin privat jobujqësor drejtoi prirjen rritëse të punësimit total në ekonomi. Nga ana tjetër, punësimi në sektorin shtetëror rezultoi lehtësisht i kontraktuar, me 0.7%, ndërsa rritja vjetore e punësimit në sektorin privat bujqësor me 2.1% i atribuohet në një masë më të madhe bazës krahasuese më të ulët. Punësimi ndoqi një tendencë rritëse edhe në terma tremujorë me kontribuues kryesor punësimin në sektorin privat jobujqësor.

Tabelë. Ecuria e punësimit (ndryshime vjetore dhe tremujore në %).

		Persona				
		Ndryshime vjetore		**Ndryshime tremujore**		
		2009	2010	2010 T4	2011 T1	2011 T2
Ekonomia në total	Pesha*	-7.7	2.0	0.1	0.4	1.0
Sektori privat jobujqësor	24.7%	-0.9	3.1	0.6	1.7	3.8

[3] Mesatarja e dy matjeve (me përjashtim të përhershëm dhe me mesatare të reduktuar).

[4] Në tremujorin e dytë, inflacioni bazë vjetor rezultoi 3.4%.

[5] Zhveshur nga ndikimi i lëvizjeve në çmimet e administruara (energji elektrike, ujë dhe shërbime spitalore).

Sektori privat bujqësor	57.3%	-12.7	2.1	0.0	0.0	0.0
Sektori shtetëror	18.0%	-0.2	-0.2	-0.4	-0.4	-0.2

*Pesha mesatare e punësimit në secilin sektor në punësimin total për periudhën 2005 T1- 2011 T2.
Burimi. INSTAT

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011, norma e papunësisë vijoi të ndjekë tendencën rënëse të shfaqur që gjatë vitit 2010. Norma e saj qëndroi në 13.35%, 0.1 p.p. Megjithëse, numri i të papunëve vijoi tkurrjen në këtë periudhë, tendenca rënëse e normës së papunësisë i atribuohet kryesisht përmirësimit të treguesit të punësimit[6] në sektorin privat jobujqësor. Për sa i takon papunësisë në tremujorin e tretë, të dhënat sasiore[7] rezultojnë të krahasueshme me tremujorin e mëparshëm, ndonëse vihet re një tendencë e zbehtë për rritje.

Grafik. Ecuria e numrit të të papunëve (ndryshime tremujore në nivel) dhe norma e papunësisë (në %) (grafiku majtas). Papunësia mujore e ndarë në papunësi afatgjatë dhe të re (si % e totalit të të papunëve, grafiku djathtas).



Burimi: INSTAT dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Lidhur me zhvillimet në tregun e punës në tremujorin e tretë të vitit 2011, bizneset sinjalizojnë një situatë punësimi lehtësisht më të përkeqësuar krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Bazuar në këto rezultate të vrojtimeve, situata e punësimit vlerësohet në rënie në aktivitetin industrial dhe atë tregtar, ndërsa në sektorin e ndërtimit dhe atë të shërbimeve shfaqet më pozitive. Megjithëse sipas kësaj analize cilësore tremujore punësimi vlerësohet si më i tkurrur, në terma vjetorë të dhënat sasiore të numrit të kontribuuesve në sigurimet shoqërore dhe shëndetësore reflektojnë një prirje rritëse të punësimit në tremujorin e tretë të vitit. Në tremujorin e katërt pritet rritje e punësimit në të gjitha degët e ekonomisë krahasuar me një tremujor më parë.

[6] Norma e papunësisë llogaritet si raport i numrit të të papunëve me forcën e aftë për punë. Kështu, rritja e forcës së aftë për punë kombinuar me rënien e numrit të të papunëve reflektohet në rënie të normës së papunësisë. Nga ana tjetër, forca e aftë për punë llogaritet si shumë e numrit të të punësuarve me numrin e të papunëve. Kështu, nëse rritja e punësimit është më e lartë se rënia e papunësisë, forca e aftë për punë rritet dhe si rrjedhojë norma e papunësisë bie.

[7] Referuar të dhënave nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB)

Grafik. Numri i kontribuuesve në sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (kontributet në p.p. sipas subjekteve në rritjen vjetore të numrit të kontribuuesve, grafiku majtas). Vlerësimet për punësimin sipas aktiviteteve ekonomike, në balancë (grafiku djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.

Pagat

Sipas INSTAT-it, paga mesatare[8] në ekonomi në tremujorin e parë të vitit 2011 regjistroi 6.9% rritje vjetore. Në krahasim me tremujorin e kaluar, paga mesatare mbeti pothuajse e pandryshuar. Paga reale, e deflatuar me indeksin e çmimit të konsumit, ka pësuar rritje me 3.1 % në terma vjetorë, duke qëndruar lehtësisht nën rritjen e shënuar në tremujorin e kaluar me 0.6 p.p. Megjithatë, rritja vjetore e këtij treguesi qëndron mbi mesataren historike. Në nivel sektorial, paga mesatare u rrit në të gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë. Kështu, në sektorin e prodhimit pagat u rriten me 5.7%, në terma nominalë dhe rreth 2% në terma realë. Në sektorin e shërbimeve pagat u rriten në vlera nominale dhe reale me përkatësisht 14% dhe 9.8%. Brenda këtij sektori rritje të ndjeshme të pagës kanë pësuar dega e postkomunikacionit dhe ajo e tregtisë. Paga mesatare mujore shtetërore përshpejtoi ritmet e rritjes vjetore në tremujorin e parë të vitit 2011. Më konkretisht, paga mesatare shtetërore u rrit me 8,3% në terma nominalë, ndërsa në terma realë rezultoi 3.8% më e lartë.

Të dhënat e fundit të disponueshme të tremujorit të dytë dëshmojnë se paga mesatare në sektorin shtetëror ka mbetur e pandryshuar, në krahasim me tremujorin e kaluar (në nivelin e 45,500 lekëve). Ajo ka shënuar rritje vjetore me 6.3%, e cila është 2 pikë përqindjeje më e ulët se rritja e regjistruar në tremujorin e kaluar. Në terma realë, rritja e pagave në sektorin shtetëror ka shënuar vlerën 2.6%, nga 3.8% që ishte në tremujorin e kaluar.

Të dhënat për tremujorin e tretë tregojnë rritje në pagën minimale të miratuar në vlerën 20,000 lekë. Ky tregues sugjeron për një rritje të mundshme në nivelin e pagave në ekonomi[9]. Për më tepër, në vrojtimet e besimit të bizneseve, ecuria e pagave u vlerësua në rritje në të gjithë sektorët e ekonomisë për tremujorin e tretë, duke konfirmuar këtë tendencë të sinjalizuar të pagave, nga tregues të tërthortë.

[8] Treguesi i pagës në ekonomi, referuar edhe nën termin "pagë mesatare", është llogaritur si raport i indeksit të fondit të pagave me indeksin e numrit të punonjësve, burimi i të cilëve është publikimi "Statistikat afatshkurtra" INSTAT, ku përjashtohet "Bujqësia". Frekuenca e të dhënave është tremujore.

[9] Duke marrë parasysh nivelin e lartë të informalitetit në deklarimin e pagave nga ana e bizneseve vlerësohet se rritja e pagës minimale do të detyrojë bizneset të rrisin nivelin e pagave, gjë që do të sjellë rritje në nivelin përgjithshëm të pagave në ekonomi.

Grafik. Ndryshimi vjetor i pagës mesatare sipas sektorëve (grafiku majtas), ecuria tremujore e pagës dhe vlerësimi i saj në ekonomi (grafiku djathtas).





Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Produktiviteti dhe kostot e punës

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2011 treguesi i produktivitetit të punës (PP) vijoi pirjen në rritje për të katërtin tremujor radhazi. Ndryshimi pozitiv vjetor i PP-së (6.5%) reflekton zhvillimet pozitive në realizimin e vlerës së shtuar për aktivitetin e biznesit (pa bujqësinë) përballë ritmeve të punësimit në këtë aktivitet. Ecuria e këtij treguesi dëshmon për përpjekje të bizneseve të aktivitetit jo bujqësor, drejt një përdorimi më efiçent të forcës së punës. Ky zhvillim vlerësohet të jetë rrjedhojë e procesit korrektues për t'u përshtatur me realitetin e ri ekonomik pas vitit 2009.

Në tremujorin e parë të vitit 2011, treguesi i kostos së punës për njësi të prodhuar (KPNJ) vijoi pirjen në rënie. Pas një dinamike vjetore të gjatë pozitive, por në frenim, u shënua një rënie prej -3.3%. Pika e kthesës në ecurinë e kostos së punës për njësi të prodhuar, ka ardhur nga ritmet pozitive vjetore të treguesit të produktivitetit të punës. Ndërkohë, në të njëjtin tremujor, paga mesatare reale vlerësohet me rritje vjetore të moderuar.

Grafik. Treguesit e produktivitetit, të kostos së punës për njësi dhe i pagës mesatare reale (majtas); ndryshime vjetore (djathtas) [10].





Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet në treguesit e mësipërm tregojnë se bizneset e aktivitetit jobujqësor kanë qenë relativisht më efiçent në përdorimin e forcës së punës. Kjo e ka ndihmuar këtë aktivitet të operojë me kosto pune më të përmbajtura, duke sheshuar pjesërisht presionet inflacioniste në kostot e prodhimit në tërësi.

Zhvillimet monetare dhe tregjet financiare

[10] Matjet u referohen treguesve të produktivitetit të punës dhe të kostos së punës për njësi të prodhuar të ekonomisë përjashtuar bujqësinë. Në llogaritje janë përdorur të dhënat nga vlera e shtuar (sezonalisht e rregulluar - INSTAT, PBB, T1'11), si edhe ato nga statistikat afatshkurtra për punësimin dhe për pagat (INSTAT, SASH, T1'11). Këta tregues nuk përfshijnë bujqësinë, ndaj vlera e shtuar është konsideruar pa bujqësinë. Indeksi i pagës mesatare reale është përftuar pas deflatimit me atë të IÇK-së së rregulluar sezonalisht. Për efekt krahasimi, treguesit janë ribazuar me vlerën e secilit tregues në tremujorin e parë të vitit 2003.

Norma e ekspansionit monetar në tremujorin e tretë të vitit 2011 është ngadalësuar në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit, në përgjigje të krijimit më të ulët të parasë në monedhën vendase. Zgjerimi vjetor i M3 është mbështetur si nga kërkesa për para e sektorit privat, ashtu edhe nga flukset e sektorit të jashtëm të ekonomisë. Rritja e portofolit të kredisë për sektorin privat mbetet e kushtëzuar si nga pasiguria ende e lartë për të ardhmen, ashtu dhe nga politikat e kujdesshme të bankave në kredidhënie. Ndërkohë, zvogëlimi i prurjeve valutore nga jashtë është reflektuar edhe në rënien e kontributit të komponentit valutor në ekspansionin monetar. Po kështu, gjatë kësaj periudhe, kërkesa për para e sektorit publik ka ardhur në rënie, në përgjigje të rishikimeve të buxhetit të shtetit në korrik 2011 për një politikë fiskale më të kujdesshme. Mungesa e sinjaleve për gjallërimin e dukshëm të kërkesës për para nga sektori privat, mbështet vlerësimet e deritanishme se presionet në inflacion nga zhvillimet monetare, mbeten të kontrolluara.

Treguesit monetarë konfirmojnë vlerësimet për presione të përmbajtura inflacioniste në ekonominë shqiptare. Zgjerimi i ofertës monetare vlerësohet të jetë në përputhje me kërkesën e ekonomisë për para reale. Rritja vjetore e M3 rezultoi 10.6% në muajt korrik-gusht, duke ruajtur ritmet mesatare të vërejtura gjatë vitit 2011. Kërkesa e sektorit privat për mjete monetare ka ndjekur tendencën rritëse të muajve të mëparshëm. Kredia për sektorin privat u rrit me 12.6% në muajt korrik dhe gusht ose rreth 1.1 pikë përqindjeje më shumë se ritmi mesatar i shënuar në tremujorin e dytë të vitit. Kjo rritje është mbështetur kryesisht nga kërkesa e bizneseve private për financim, ndërkohë që edhe kredia për individë po ndjek një prirje rritëse. Rritja vjetore e kredisë për individë qëndron në nivelin 5.7% në fund të muajit gusht, nga 1.5% që shënonte në fund të vitit të kaluar.

Analizat e Bankës së Shqipërisë sugjerojnë se rritja e moderuar e kredisë mbetet më së pari një funksion i kërkesës së reduktuar të ekonomisë për të. Ky qëndrim konfirmohet nga opinionet e bizneseve, të cilat shfaqin një tendencë të dobët për investime, por edhe nga reduktimi i numrit të aplikimeve për kredi pranë bankave të nivelit të dytë. Përkundrejt tyre, sistemi bankar paraqitet likuid dhe i mirëkapitalizuar për të zhvilluar aktivitetin e tij të ndërmjetësimit financiar. Në përgjigje të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, normat e interesit të kredisë janë në nivele historikisht të ulëta. Por, sistemi bankar ka shtuar kujdesin në kredidhënie, në formën e qëndrimeve më kritike ndaj planbizneseve dhe të kërkesave më të forta për kolateral. Kjo përqasje është një reagim ndaj pasigurisë në ekonomi apo në sektorë të veçantë duke reflektuar gjithashtu edhe një model zhvillimi më të kujdesshëm të aktivitetit kreditues dhe të biznesit bankar. Në terma afatgjatë, ajo do të prodhojë një rritje më të qëndrueshme për ekonominë shqiptare dhe do të garantojë një sistem bankar solid e të besueshëm.

Zhvillimet në tregjet financiare gjatë tremujorit të tretë tregojnë për prime të ulëta likuiditeti dhe inflacioni. Vëllimi i tregtimit në tregun ndërbankar është rritur më tej, ndërkohë që, në prani të situatës së mirë të likuiditetit, normat e interesit në këtë treg kanë ndjekur rënien e normës bazë të interesit dhe kanë shfaqur luhatshmëri të ulët. Në respektim të kohëvonesave në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, rënia e normave të interesit pritet të tejçohet edhe në tregun e depozitave dhe kredive. *Yield-et* e bonove të thesarit kanë ruajtur nivelet e tyre të tremujorit të dytë, në prani të kërkesës së moderuar të qeverisë për financim afatshkurtër.

1.2 Kuadri makroekonomik afatmesëm

Parashikimi i treguesve makroekonomik afatmesëm dhe i tërësisë së elementeve përbërës të kuadrit makroekonomik është bazuar në teknikat analitike të programimit financiar. Për këtë qëllim janë ndërtuar disa skenarë të mundshëm të ecurisë makroekonomike të vendit, rezultatet e të cilëve i janë nënshtruar një analize krahasuese të hollësishme për të arritur në skenarin bazë makroekonomik. Skenari bazë i kuadrit makroekonomik, mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomiko-strukturore qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të aktorëve ekonomikë brenda kontureve të ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik, i cili duket si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim. Në kryerjen e këtyre parashikimeve janë ngritur një set supozimesh bazë, si dhe janë përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të prodhuara prej institucioneve si, Instituti i Statistikave, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Eurostat, Banka Qendrore Europiane etj. Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore.

Kohëzgjatja e tyre e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi janë ndjekur të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, testimit, analizat krahasuese, statike, dinamike, e pasi kryhen një sërë testesh konsistence, skenari bazë i përftuar synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme e maksimalisht konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale. Objektivat themelore të miksit të politikave monetare e fiskale gjatë tre viteve në vijim me anë të të cilave synohet ruajtja dhe konsolidimi i metejshëm i stabilitetit makroekonomik, krijimi i klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimit sa më të shpejtë drejt nivelit mesatar të mirëqenies së Bashkimit Europian, janë:

- Mbajtja e normës së inflacionit rreth nivelit 3 për qind dhe brenda fashës së tolerancës 2%-4%,

- Mbajtja e borxhit publik poshtë nivelit 60%, si dhe ulja graduale e tij (në përputhje me rekomandimet e KE për përmbushjen e Kritereve ekonomike të Kopenhagenit dhe në linjë me Kriteret e Mastriktit)

- Kufizimi i huamarrjes totale neto të qeverisë në një nivel jo më të lartë se 3% të PBB-së për vitin 2012 dhe 2013 dhe në një nivel jo më të lartë se 2.5% të PBB për vitet 2014 dhe 2015.

- Zbutja e deficitit të llogarisë korente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore dhe duke ruajtur të paktën një nivel dysheme të tyre të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 4 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Këto objektiva fondamentale përbëjnë konturet bazë të këtij programi ekonomik e fiskal brenda të cilave përcaktohen projeksionet për të gjithë variablat e tjerë makroekonomik.

Projeksionet për treguesit kryesorë makroekonomik për periudhën 2012 – 2014 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Treguesit kryesorë makroekonomik

Treguesit	Njësia	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
						Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.90	2.88	2.86	2.83	2.83	2.83	2.83
Norma e inflacionit (mesatar)	%	3.4	2.3	3.6	3.5	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	4.7	2.3	3.5	3.1	1.1	1.2	1.2
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	83.9	95.0	103.9	100.9	102.0	102.5	104.0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	122.8	131.6	137.7	140.5	139.7	140.0	140.0
Rritja reale e PBB	%	7.5	3.3	3.9	3.0	4.3	5.0	4.9
PBB	Lek miliardë	1,089.3	1,151.0	1,238.1	1,314.7	1,385.0	1,471.6	1,561.5
PBB	USD miliardë	13.0	12.1	11.9	13.0	13.6	14.4	15.0
PBB	Euro miliard	8.9	8.7	9.0	9.4	9.9	10.5	11.2
PBB për banor	Lek mijë	375.2	399.8	433.6	464.3	489.1	519.7	551.4
PBB për banor	USD	4,472.8	4,208.5	4,171.9	4,601.2	4,795.0	5,070.0	5,302.1
PBB për banor	Euro	3,056.5	3,037.8	3,148.9	3,304.1	3,501.0	3,712.0	3,938.7
PBB për banor	USD-PPP	8,726.3	9,296.8	10,083.3	10,797.1	11,374.1	12,085.6	12,823.8
Norma e papunësisë	%	12.7	13.8	13.5	12.9	12.1	11.4	10.6
Të ardhurat totale	% të PBB	26.7	26.0	26.2	25.0	25.7	25.7	25.8
Shpenzimet totale	% të PBB	32.3	33.0	29.3	28.4	28.7	28.6	28.3
Bilanci i përgjithshëm fiskal	% të PBB	-5.5	-7.0	-3.1	-3.3	-3.0	-3.0	-2.5
Bilanci primar fiskal	% të PBB	-2.7	-3.9	0.3	-0.2	0.6	0.7	1.1
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	3.1	1.3	2.4	1.8	2.1	1.9	2.0
Huamarrje totale neto	% të PBB	4.9	4.6	3.1	3.4	3.0	2.9	2.4
Borxhi Publik Total	% të PBB	54.7	59.3	57.8	58.9	59.6	59.5	59.0
Borxhi publik i qeverise se pergjithshme	% të PBB	51.3	55.3	54.1	55.2	55.4	55.1	54.3
Borxhi publik jashte treguesve fiskale	% të PBB	3.4	4.0	3.7	3.7	4.2	4.4	4.7
Llogaria korente	% të PBB	-15.6	-15.1	-11.7	-12.5	-11.7	-10.9	-8.9
Bilanci i mallrave	% të PBB	-26.6	-24.3	-21.1	-21.4	-18.3	-16.7	-14.2
Bilanci i shërbimeve	% të PBB	0.8	2.0	2.0	1.4	3.2	3.1	3.5
Bilanci i Pagesave	% të PBB	2.1	-0.3	2.0	0.7	1.8	1.6	2.7

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave

Inflacion

Në terma afatmesëm, skenari bazë për projeksionin e inflacionit rezulton me vlera që luhaten rreth objektivit të Bankës së Shqipërisë. Por parashikimet paraqesin një ndjeshmëri të lartë ndaj pasigurive që lidhen me zhvillimet në ambientin e jashtëm dhe implikimet e tyre në ekonominë e vendit. Mbështetje në uljen e luhatshmërisë së çmimeve të konsumit do të jenë jo vetëm vendimmarrja në kohë e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, por edhe shkalla e efikasitetit të reformave strukturore për nxitjen e aktivitetit ekonomik në vend dhe gatishmërisë së agjentëve të tregut për të korrektuar sjelljen e tyre ekonomike.

Parashikohet që hendeku i prodhimit do të vijojë të jetë negativ, ndërsa shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese mbeti nën vlerat e larta historike edhe për tremujorin e tretë të vitit 2011. Këto zhvillime pritet të sheshojnë presionet e mundshme inflacioniste që mund të prodhohen nga rreziqe që lidhen kryesisht me disbalancat në ekonomitë e huaja, partnere kryesore tregtare të Shqipërisë dhe çmimet e lëndëve të para në tregjet e huaja. Nga ana tjetër, ecuria e kursit të këmbimit duke qenë e lidhur me shpejtësinë e korrektimit të balancave në sektorin e jashtëm, mbetet faktor me potencial rreziku për të ardhmen e presioneve inflacioniste. Vendimet për çmimet e rregulluara dhe atyre që shoqërojnë rregullimet fiskale, vlerësohen të rëndësishme për të ardhmen e inflacionit në vend. Në kushtet e vlerësimit të çdo sinjali rreziku në kohë, politika monetare do të synojë ruajtjen e qëndrueshmërisë së inflacionit në terma afatmsëm. Bazuar në përditësimin e informacionit dhe të supozimeve deri në mesin e muajit tetor 2011, pritet që viti korrent të mbyllet me një inflacion vjetor më të ulët se sa ishte parashikuar gjatë pjesës së parë të tij. Parashikimi paraqet një pamje me luhatshmëri më të ulët, rreth prirjes rënëse të verifikuar edhe gjatë raundeve paraardhëse të parashikimeve.

Sjellja e inflacionit në tremujorin e tretë të vitit aktual dhe frenimi i rritjes së çmimeve të lëndëve të para dhe bazë në tregjet e huaja gjatë periudhës korrik-shtator 2011, si edhe parashikimet e fundit të FMN-së (shtator 2011) për to, kanë ndikuar në rishikimin për poshtë të parashikimeve të inflacionit në vend. Rritja e taksës së qarkullimit (mbi konsumin e karburantit) është parashikuar të japë efekte të drejtpërdrejta në inflacion nëpërmjet nëngrupit përkatës, si edhe efekte zinxhir te kostot e shërbimeve dhe të mallrave të tjerë. Efekti i rritjes së akcizave pritet të shuhet në tremujorin e parë të vitit 2012, për ta ulur më tej inflacionin gjatë pjesës së parë të vitit të ardhshëm. Megjithatë, procesi rishikues i akcizave nga fillimi i vitit 2012, nuk përjashton një rritje mesatare historike të kontributit të çmimeve të mallrave përkatës në inflacionin total gjatë vitit 2012 e në vijim.

Muaji dhjetor pritet të mbyllet me një inflacion që luhatet në vlerat 2.7%-3.0%, ndërkohë që inflacioni mesatar për vitin 2011 parashikohet të jetë rreth 3.6%.

Në horizontin parashikues të 4 tremujorëve (T3-2012) inflacioni pritet të rezultojë pranë objektivit. Ai do të ishte akoma më i ulët akoma në mungesë të supozimeve mbi efektet e taksave shtesë të karburanteve dhe të efekteve të veprimit zinxhir të rritjes së tyre në çmimet e tjera të konsumit.

Në vitin 2012 parashikohet një inflacion mesatar vjetor prej 2.8. Gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2013 inflacioni pritet të jetë në rënie, mesatarisht në nivelin 2.4% në terma vjetorë (shih tab. 1b, aneks 2).

Pavarësisht faktit që modelet tregojnë se inflacioni pas katër tremujorëve do të ndjekë një prirje rënëse, madje pak nën objektivin 3%, vlerësohet se ai përsëri është i rrethuar nga faktorë të qenësishëm rreziku që mund të rrisin luhatshmërinë e tij:

- Parashikimet nuk janë faktorizuar nga efekti i rritjes së mundshme të çmimit të energjisë elektrike gjatë vitit 2012. Kjo për faktin se informacioni për këtë rritje mbetet ende i rezervuar, ndërsa pasiguritë më të larta lidhen me kohën, skemën dhe masën e aplikimit të kësaj rritjeje.[11]

- Luhatshmëria në çmimet në tregjet ndërkombëtare të lëndëve të para dhe bazë, do të ndikonin inflacionin e kategorisë "ushqime të përpunuara", i cili ka dëshmuar për varësi të lartë të tij nga

[11] Sipas përllogaritjeve të bëra pranë DPM-së, rezulton se skema të ndryshme aplikimi, ndonëse tarifat mund të rriten mesatarisht në mënyrë të krahasueshme me rritjen e fundit (janar 2010), japin efekte mjaft të ndryshme në inflacionin total (0.3 pp – 0.7 pp).

konjuktura botërore e çmimeve.

- Frenimi i efekteve të veprimit të dytë, do të ndihmonte në përmbajtjen e presioneve inflacioniste nga kërkesa e brendshme. Në këto kushte, rol parësor do të luante vijimi i prirjes pozitive drejt rritjes së peshës së ofertës vendase për produkte ushqimore.

- Zhvillimet në balancat e shkëmbimeve tregtare të vendit me jashtë për 9-mujorin e parë të vitit 2011, përmbajnë rrezik potencial për shtim të presioneve inflacioniste nga ana e kursit të këmbimit në terma afatmesëm.

- Prania eventuale e hendekut negativ të rritjes së PBB-së dhe e ekspansionit të ngadaltë monetar, nuk pritet të ushtrojnë presione të shtuara inflacioniste nga krahu i kërkesës së brendshme. Kjo situatë mbështetet në frenimin e rritjes së pritjeve për inflacionin e agjentëve të tregut financiar, sinjal i rëndësishëm për presione në rënie përgjatë horizontit njëvjeçar të parashikimit.

Table 1b in Annex 2 could be referred to.

	ESA Code	2009	2010	2011	2012	2013
4. National CPI change (Average annual inflation rate)		2.3	3.6	3.6*	2.8	2.4**

*Note: *Preliminary value for 2011; ** Average annual inflation rate for Q1'13 -Q3'13.*

Kuadri operacional i instrumenteve të politikës monetare për arritjen e objektivit parësor të politikës monetare që është, ruajtja e stabilitetit të çmimeve në terma afatmesëm, do të mbetet ai i shpjeguar në Dokumentin më të fundit të Politikës Monetare. Instrumenti kryesor ndërhyrës në tregun e parasë për përcjelljen e sinjaleve të politikës monetare në ekonomi, eventualisht do të mbetet norma e interesit për marrëveshjet e riblerjes dhe të riblerjes së anasjelltë me maturim një javor (REPO dhe REPO e anasjellë).

Politikat monetare dhe kursi i këmbimit

Hartimi dhe zbatimi i politikës monetare në Republikën e Shqipërisë është përgjegjësi ekskluzive e Bankës së Shqipërisë. Objektivi i politikës monetare të saj është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë e ka përcaktuar në terma sasiorë këtë objektiv, në arritjen e një ndryshimi vjetor të IÇK-së prej 3%, me një interval tolerance prej + / - 1pp, gjatë periudhës afatmesme.

Procesi vendimmarrës i politikës monetare është i udhëhequr nga devijimi i inflacionit të parashikuar nga objektivi në një periudhë afatmesme dhe vlerësimi i presioneve inflacioniste në të ardhmen. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë përdor një grup gjithëpërfshirës dhe të gjerë treguesish ekonomikë dhe monetarë. Edhe pse oferta monetare nuk shërben më si objektiv i ndërmjetëm i politikës monetare, informacioni nga zhvillimet monetare konsiderohet i vlefshëm për të sinjalizuar rreziqet për stabilitetin e çmimeve në afat të mesëm dhe të gjatë. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë përgatit programin monetar, i cili ka për qëllim të inkuadrojë në një tablo gjithëpërfshirëse zhvillimet ekonomike në vend dhe të pasqyrojë vlerësime sasiore për ecurinë e treguesve monetarë, në veçanti të parasë së gjerë dhe të kreditit të brendshëm, për 12 muajt e ardhshëm. Bazuar në këto vlerësime, Banka e Shqipërisë, në skenarin e saj bazë (qendror) për vitin 2012, vlerëson se financimi për sektorin privat do jetë më i lartë se në vitin 2011, duke kompensuar kërkesën më të ulët për financim të qeverisë, në kuadër të konsolidimit të balancave fiskale. Në total zgjerimi i kreditit të brendshëm pritet të jetë lehtësisht më i lartë se sa në vitin 2011, por pranë niveleve të mesatares historike. Ndërkohë, zhvillimet më pozitive në konsum dhe në investimet private do të mundësojnë rritjen e kërkesës për financim nga sektori privat, e cila do të shoqërohet nga një rritje e ndërmjetësimit financiar nga sistemi bankar. Në tërësi të gjitha këto zhvillime do pasqyrohen në një ekspansion monetar paksa më të lartë se në vitin 2011, por pranë nivelit potencial duke konfirmuar vlerësimet e deritanishme se presionet në inflacion nga zhvillimet monetare mbeten të përmbajtura.

Regjimi aktual i politikës monetare shoqërohet me një regjim të lirë të kursit të këmbimit, ku

vlera e lekut ndaj monedhave të huaja përcaktohet nga kërkesa dhe oferta në tregun valutor. Banka e Shqipërisë mund të ndërhyjë në tregun valutor në përputhje me rregulloret përkatëse të bëra transparente për publikun. Këto rregullore parashikojnë ndërhyrje me qëllim akumulimin e rezervave valutore, dhe shmangien e luhatshmërisë së tepërt në tregun e kursit të këmbimit. Ndërhyrjet në tregun valutor nuk ndikojnë në politikën monetare të Bankës së Shqipërisë për arritjen e objektivit të saj kryesor.

Objektivi operacional i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë është orientimi i normave afatshkurtra të interesit të tregut ndërbankar pranë normës bazë të interesit dhe kufizimi i luhatjeve të tyre. Në zbatim të politikës monetare të saj, Banka e Shqipërisë përdor instrumente të tregut të politikës monetare. Instrumenti kryesor janë operacionet e rifinancimit me maturim 7-ditor. Norma e interesit të tyre është norma bazë dhe niveli i saj vendoset nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës. Përveç ndërhyrjeve në tregun e parasë, instrumente të tjera të politikës monetare janë lehtësitë e përhershme dhe rezerva e detyruar.

Funksionimi i duhur i mekanizmit të transmisionit të politikës monetare ndikohet nga faktorë strukturorë të ekonomisë shqiptare. Niveli i lartë i euroizimit, sidomos në kredidhënie, kufizon funksionimin e duhur të kanalit të normës së interesit. Gjithashtu, edhe zhvillimi i ulët i tregut financiar dhe prania e vazhdueshme e ekonomisë informale paraqesin pengesa shtesë për efektivitetin e politikës monetare. Megjithatë, politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka qenë e suksesshme. Suksesi i saj është bazuar në kredibilitetin e Bankës së Shqipërisë dhe në një komunikim të qartë dhe transparent me publikun.

Si politikat monetare, dhe ato fiskale ndërmerren në funksion të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Koordinimi i dy politikave mbështetet në shkëmbimin e vazhdueshëm të informacionit lidhur me strategjitë e politikave të qeverisë dhe ndërmarrjen e masave fiskale me ndikim në ekonomi në përgjithësi, dhe te çmimet në veçanti. Në çdo rast, Banka e Shqipërisë gëzon pavarësi të plotë institucionale dhe vendimet e saj do të orientohen drejt plotësimit të objektivit kryesor për arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

Sektori i jashtëm

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi në zvogëlim të mjeteve valutore me rreth 1.7 milionë euro. Pozicioni neto i llogarisë korente regjistroi një deficit prej 342.1 milionë eurosh. Në terma vjetorë, deficiti korent u zgjerua me rreth 69.2 për qind duke përforcuar kështu tendencën e nisur që prej tremujorit të katërt të vitit 2010. Deficiti u vlerësua në 14.0 për qind ndaj PBB-së nominale[12] ose rreth 5.5 pikë përqindjeje më i lartë krahasuar me nivelin e këtij raporti në tremujorin e dytë të vitit 2010. Prurjet valutore neto në llogarinë kapitale dhe financiare rezultuan rreth 237.9 milionë euro, në rritje me rreth 31.7 për qind në terma vjetorë.

Tabelë. Treguesit kryesorë të bilancit të pagesave

	T1 '10	T2 '10	T3 '10	T4 '10	T1 '11	T2 '11
Llogaria korente (% ndaj PBB-së)	-12.0	-8.5	-10.4	-16.8	-11.6	-14.0
Llogaria korente (në milionë euro)	-235.3	-202.2	-245.2	-373.6	-244.4	-342.1
Bilanci tregtar	-419.0	-482.9	-595.9	-584.9	-408.5	-581.4
Eksporte, f.o.b.	254.9	340.5	270.3	305.9	370.6	330.8
Importe, f.o.b.	-673.9	-823.4	-866.2	-890.7	-779.1	-912.2
Bilanci i shërbimeve	-13.1	9.5	180.0	5.2	-36.7	-17.5
Kredi	259.3	369.5	661.0	412.5	299.2	362.7
Debi	-272.4	-360.0	-481.0	-407.2	-336.0	-380.2
Bilanci i të ardhurave	-14.1	-11.2	-19.9	-31.6	4.4	11.0
Të ardhura nga IHD-të neto	-60.7	-51.5	-73.8	-73.7	-26.1	-20.7
Transferta korente	210.9	282.5	190.6	237.7	196.4	245.9
Dërgesa nga emigrantët - neto	170.1	219.5	135.1	165.1	153.1	189.4

[12] PBB – ja nominale e përdorur për periudhën 2003 – 2009 është ajo e publikuar nga INSTAT-i. Për vitin 2010 - 2011 janë përdorur projeksione të Departamentit të Politikës Monetare.

Ll. Kapitale dhe financiare (% ndaj PBB-së)	6.0	7.6	8.2	19.5	9.4	9.7
Ll. Kapitale dhe financiare (në mil euro)	117.3	180.6	193.7	433.1	197.0	237.9
Llogaria kapitale	10.0	22.7	22.6	30.2	19.1	31.5
Llogaria financiare	107.3	157.9	171.1	402.8	177.9	206.5
IHD (neto)	165.6	170.0	251.4	250.0	54.4	241.6
Investime portofoli (neto)	-25.9	-25.0	-1.5	272.4	-20.9	5.4
Kapitale të tjera (neto)	-32.4	13.0	-78.9	-119.6	144.3	-40.5
Gabime dhe harresa	100.6	31.9	111.7	66.2	-29.7	102.5
Bilanci i përgjithshëm	-17.4	10.3	60.2	125.7	-77.1	-1.7
Mjetet e rezervës	17.4	-10.3	-60.2	-125.7	77.1	1.7

Burimi. Bilanci i pagesave, Banka e Shqipërisë.

Llogaria korente

Pozicioni neto i llogarisë korente gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011 regjistroi një deficit prej 342.1 milionë eurosh, ose rreth 14.0 për qind ndaj PBB-së nominale. Ky deficit vijoi të zgjerohet në terma vjetorë për të tretin tremujor radhazi, duke shënuar rritje me rreth 69.2 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Gjatë këtij tremujori, dinamika e llogarisë korente u ndikua gjerësisht prej ecurisë së bilancit tregtar dhe atij të llogarisë së shërbimeve. Përkeqësimi i kombinuar i pozicionit të tyre neto krahasuar me tremujorin korrespondues të vitit paraardhës, kontribuoi gjerësisht në thellimin e deficitit korent. Zgjerimi i deficitit tregtar në mallra me rreth 20.4% në terma vjetorë, si dhe thellimi i pozicionit neto negativ të llogarisë së shërbimeve, kushtëzoi zgjerimin e deficitit të eksporteve neto me rreth 26.5% në terma vjetorë nominalë.

Grafik. Kontributi sipas zërave në deficitin korent (në përqindje)



Burimi: Bilanci i pagesave dhe llogaritje të stafit, Banka e Shqipërisë.

Shënim. Vlera pozitive tregon për kontribut në zgjerimin e deficitit të llogarisë korente ndërsa vlera negative tregon për kontribut në ngushtim të deficitit të llogarisë korente.

Shkalla e hapjes ekonomike në vend për tremujorin e dytë të vitit 2011, rezultoi 81.2 për qind, në rritje me rreth 1.6 pikë përqindjeje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Gjatë dy viteve të fundit, eksportet shënuan rritje progresive duke kontribuar pozitivisht në rritjen ekonomike të vendit. Përgjatë periudhës 2006-2009, norma mesatare vjetore e rritjes së eksporteve ishte rreth 4.5%, duke përfaqësuar afërsisht rreth 10.0% ndaj PBB-së. Gjatë vitit 2010, norma mesatare e rritjes së eksporteve ishte rreth 56.1% në terma vjetorë dhe rreth 13.2% ndaj PBB-së. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011, eksportet u rritën në terma vjetorë me rreth 27.3% duke pasqyruar eksportet më të larta të kategorisë "Lëndë djegëse dhe energji" (veçanërisht naftë bruto), "mallra të përpunuar" nga metalet bazë dhe mallrat e klasifikuara në kategorinë "mallra të tjerë të përpunuar" ku përfshihen kryesisht fasonet. Kategoria e fundit, fasonet, vlerësohet se do të japë një kontribut të qëndrueshëm në

rritjen e eksporteve totale në të ardhmen. Tregjet kryesore për eksportet e vendit tonë mbeten vendet e BE-së, CEFTA-s dhe partnerë të tjerë të rëndësishëm si Kina, Turqia, Zvicra etj.

Gjatë periudhës 2005-2009, importet u rritën mesatarisht me rreth 12.6%, duke përfaqësuar rreth 36.2% të PBB-së. Gjatë vitit 2010, vihet re një ngadalësim në normën e rritjes së importeve në 6.9% në terma vjetorë. Ato përfaqësuan rreth 39.1% ndaj PBB-së. Norma vjetore e rritjes së importeve gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011 ishte rreth 8.6%, kryesisht si pasojë e rritjes së importeve të mallrave të ndërmjetëm dhe atyre për konsum. Sipas partnerëve kryesorë, importet nga vendet e BE-së, Cefta-s dhanë kontributin kryesor në rritjen e importeve të vendit tonë përgjatë viteve. Gjithashtu, në vitin e fundit vihet re një rritje e importeve nga partnerë të tjerë tregtarë.

Shërbimet, të ardhurat, transfertat korente.

Analiza e llogarisë korente sipas zërave të saj kryesorë, evidenton zgjerimin e deficitit të eksporteve neto nominale gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011. Krahas zgjerimit të deficitit tregtar, gjatë këtij tremujori, bilanci neto i llogarisë së shërbimeve vijoi të jetë negativ edhe pse në një nivel disi më të ulët krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2011. Krahasuar me një vit më parë, është regjistruar një ndryshim kahu në bilancin e llogarisë së shërbimeve, nga surplus me rreth 9.5 milionë euro në deficit me rreth 17.5 milionë euro në tremujorin e dytë të vitit 2011. Thellimi i deficitit në terma vjetorë në këtë llogari ishte pasojë kryesisht e rritjes së shpenzimeve për udhëtime personale për qëllime turizmi e biznesi të rezidentëve jashtë vendit. Në terma kumulativë, gjashtë muajt e parë të vitit 2011 u karakterizuan nga rritja me përafërsisht 13.2 për qind në terma vjetorë e balancës dalëse të shërbimeve personale të udhëtimit prej rezidentëve. Ndërkohë, prurjet valutore nga shërbimet personale të udhëtimit nga jorezidentët në vend shënuan rënie me rreth 2.7 për qind gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2011 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Zhvillimet në këtë nënzë të llogarisë së shërbimeve vlerësohet të jenë efektet e heqjes së regjimit të vizave ndaj Shqipërisë me vendet e Schengen-it. Ndërkohë, efekti i tyre në llogarinë korente pritet të jetë më i ndjeshëm në tremujorin e tretë të vitit 2011 i cili përkon dhe me stinën e verës.

Bilanci neto i llogarisë së të ardhurave rezultoi në suficit prej 11.0 milionë eurosh gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011, kryesisht si pasojë e rënies së fluksit dalës së të ardhurave nga investimet e huaja direke. Pas rreth dy vjetësh që kjo llogari shënoi në mënyrë të vazhdueshme deficit neto, në gjashtë muajt e parë të vitit balanca e saj rezultoi pozitive. Kontributin kryesor në këtë drejtim e dha rënia e flukseve dalëse të të ardhurave nga investimet e huaja direkte. Në tremujorin e dytë të vitit 2011, deficiti i të ardhurave nga IHD-të shënoi rënie me rreth 59.8 për qind në terma vjetorë.

Grafik. Ecuria e të ardhurave nga IHD-të (në vlerë).



Burimi: Bilanci i pagesave dhe llogaritje të stafit, Banka e Shqipërisë.

Nga vlerësimi i prirjes afatgjatë të këtij nënzëri, rënia e shënuar në riatdhesimin e fitimeve mund të shihet si një riinvestim i tyre në vend me qëllimin rinovimin – përmirësimin – zgjerimin e kapaciteteve prodhuese. Megjithatë, ky zë pritet të vijojë pozicionin negativ në vazhdim si pasojë e fluksit të lartë të investimeve të huaja direkte hyrëse në vend. Të ardhurat nga investimet e portofolit shënuan rritje me rreth 2.1 milionë euro krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2010. Pagesat neto të interesit të borxhit kanë ulur detyrimet e vendit me rreth 23.4 milionë euro në tremujorin e dytë të vitit 2011.

Suficiti i llogarisë së transfertave korente vijoi të ngushtohet edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011, prirje kjo e filluar që prej tremujorit të katërt të vitit 2010. Në tremujorin e dytë të vitit 2011, surplusi i kësaj llogarie u ngushtua me rreth 13.0% në terma vjetorë. Nënzëri kryesor i kësaj llogarie, transfertat prej emigrantëve, vijoi prirjen rënëse vjetore për të tretin tremujor me radhë. Në tremujorin aktual, dërgesat e emigrantëve shënuan rënie me rreth 13.2 për qind në terma vjetorë.

Grafik. Remitancat, ndryshime vjetore në %; karakteristika të dërgesave të emigrantëve.



Burimi: Bilanci i pagesave dhe llogaritje të stafit, Banka e Shqipërisë.

Ndonëse remitancat karakterizohen prej një trendi afatgjatë në rënie, ky kontraktim i tyre vlerësohet të jetë edhe efekti i dytë i liberalizimit të vizave me Shqipërinë prej vendeve anëtare të Schengen-it. Raporti i tyre kundrejt deficitit tregtar vlerësohet në nivelin 55.9% ose rreth 53.0 pikë përqindje më i ulët se raporti i financimit i regjistruar në të njëjtën periudhë një vit më parë.

Grafik. Raporti i financimit të importeve të mallrave nga shuma e eksporteve, remitancave dhe investimeve të huaja direkte.



Burimi: Bilanci i pagesave dhe llogaritje të stafit, Banka e Shqipërisë.

Llogaria kapitale dhe financiare

Flukset kapitale dhe financiare (neto) regjistruan një bilanc pozitiv prej 237.9 milionë eurosh gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011. Surplusi i kësaj llogarie rezultoi rreth 31.7 për qind më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe arrin në rreth 9.7% të PBB-së ose rreth 2.1 pikë përqindjeje më të larta se raporti i regjistruar në të njëjtin tremujor të një viti më parë. Ndër to, rreth 31.5 milionë euro kanë hyrë në vend në formën e grandeve për investime kapitale dhe rreth 206.5 milionë euro në formën e flukseve financiare. Ndonëse suficiti i llogarisë kapitale dhe financiare në terma vjetorë shënoi rritje, suficiti i regjistruar në tremujorin e dytë të vitit rezultoi i pamjaftueshëm për të financuar tërësisht deficitin e llogarisë korente. Raporti i financimit të këtij të fundit ishte 69.5 për qind; raport ky, rreth 19.8 pikë përqindjeje më i ulët krahasuar me tremujorin korrespondues të një viti më parë.

Grafik. Llogaria kapitale dhe financiare, në milionë euro (bm) dhe raporti i financimit të deficitit të llogarisë korente nga llogaria kapitale dhe financiare, në përqindje (bd).



Burimi: Bilanci i pagesave dhe llogaritje të stafit, Banka e Shqipërisë.

Transaksionet financiare gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011 regjistruan një vlerë prej 206.5 milionë eurosh, në rritje me rreth 30.7 për qind në terma vjetorë. Detyrimet financiare të rezidentëve ndaj jo rezidentëve, gjatë kësaj periudhe, ishin rreth 285.4 milionë euro, në rritje me rreth 34.9 për qind në terma vjetorë. Mjetet tona financiare të investuara jashtë, pas dy tremujorësh rënie, shënuan rritje me rreth 79.0 milionë euro në tremujorin e dytë të vitit 2011. Si pasojë e lëvizjes së flukseve valutore në zërat e mjeteve dhe të detyrimeve, treguesi i shkallës së hapjes financiare në vend për tremujorin e dytë rezultoi 14.9 për qind, në rritje me rreth 3.7 pikë përqindjeje krahasuar me vlerën e tij në periudhën korresponduese të një viti më parë.

Grafik. Përbërja e llogarisë financiare në detyrime dhe mjete (flukse në milionë euro, bm) dhe treguesi i shkallës së hapjes financiare (në përqindje, bm).



Burimi: Bilanci i pagesave dhe llogaritje të stafit, Banka e Shqipërisë.

Flukset neto (hyrëse-dalëse) të investimeve të huaja direkte, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011, rezultuan në rreth 241.6 milionë euro, në rritje me rreth 42.2 për qind në terma vjetorë. Në raport ndaj PBB-së nominale, IHD-të neto vlerësohen në rreth 9.9 për qind, raport ky rreth 2.7 pikë përqindjeje më i lartë se ai në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafik. Llogaria financiare dhe zërat kryesorë (flukse neto në milionë euro).



Burimi. Bilanci i pagesave dhe llogaritje të stafit, Banka e Shqipërisë.

Sipas drejtimit të investimit rritja e IHD-ve gjatë kësaj periudhe u shkaktua nga rritja e flukseve hyrëse të tyre me rreth 41.8 për qind në terma vjetorë. Sipas instrumentit të përdorur për investime, IHD-të hyrëse në trajtën e letrave me vlerë të pasurisë (aksione) dhe riinvestim i fitimeve përfaqësuan rreth 254.4 milionë euro, rreth 48.1 për qind më të larta krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011, në zërin kapitale të tjera[13] u regjistrua një dalje kapitalesh në formën e huave midis ndërmarrjeve të lidhura prej 11.0 milionë eurosh. Në tremujorin e parë të vitit, ky zë shënoi rreth 115.1 milionë euro.

Duke përjashtuar të ardhurat nga privatizimet gjatë këtij tremujori, investimet e huaja direkte hyrëse ishin rreth 41.8 për qind më të larta krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2010. Duke filluar që prej vitit 2010, të ardhurat nga privatizimet kanë dhënë një kontribut të ulët në rritjen e IHD-ve në vend. Shpërndarja sektoriale e IHD-ve për tremujorin e dytë të vitit 2011, tregon për një përqendrim të tyre në sektorine e hidrokarbureve, sektorin bankar, hidroenergjetik, dhe atë të telekomunikacionit. Zhvillimet në flukset dalëse të IHD-ve (IHD-të e rezidentëve në ekonomitë e huaja) shënuan rënie me 1.7 milionë euro në tremujorin e dytë të vitit 2011.

Flukset neto të investimeve të portofolit në tremujorin e dytë të vitit 2011 rritën detyrimet e residentëve me rreth 5 milionë euro. Gjatë kësaj periudhe u shënua një rritje e lehtë e investimeve të portofolit në vend, si dhe një rënie e investimeve të rezidentëve jashtë me rreth 2.3 milionë euro.

Në tremujorin e dytë të vitit 2011, llogaria e investimeve të tjera neto u mbyll më një bilanc negativ, duke kontribuar me rreth 40.5 milionë euro në rritjen e mjeteve tona financiare të investuara në ekonomitë e huaja. Kahu i flukseve financiare në këtë llogari u përcaktua kryesisht nga rritja e ndjeshme e mjeteve tona të investuara jashtë. Detyrimet e vendit tonë ndaj botës u rritën me rreth 39.1 milionë euro në tremujorin e dytë të vitit 2011, ku rolin kryesor e dha huamarrja private dhe shtetërore. Kjo e fundit rezultoi në 34.2 milionë euro, në rënie me rreth 33.6 për qind në terma vjetorë. Në tremujorin e dytë të vitit 2011, mjetet tona të investuara jashtë u vlerësuan në rreth 79.0 milionë euro, pas rënies së tyre prej dy tremujorësh. Rritja e investimeve të rezidentëve jashtë erdhi kryesisht si pasojë e përmirësimit të situatës së likuiditetit në sistemin bankar. Pas dy tremujorësh rënie të vazhdueshme, në tremujorin e dytë të vitit 2011, investimet e sistemit bankar në trajtën e monedhave dhe depozitave dhe kredive afatshkurtra u rritën respektivisht me 51.1 dhe 21.8 milionë euro.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011, mjetet e rezervës shënuan rënie me rreth 1.7 milionë euro. Stoku i rezervës valutore në fund të periudhës shënoi nivelin 1.771,4 milionë euro. Ky nivel vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 4.2 muajve importesh të mallrave dhe të shërbimeve.

[13] Instrumenti *kapitale të tjera të investimit direkt*, mbulon huamarrjen dhe huadhënien e fondeve, duke përfshirë letrat e borxhit dhe kreditë tregtare ndërmjet investitorit direkt dhe sipërmarrjes së investimit direkt, si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve të investimit direkt që ndajnë të njëjtin investitor direkt.

Për sa i përket perspektivës së zhvillimit së pozicionit të jashtëm në të ardhmen një sërë rreziqesh lidhen me ngadalësimin e ekonomive së vendeve fqinje, gjë që mund të përkeqësojë bilancin tregtar në të ardhmen. Megjithatë kërkesa e brendshme e dobët do të zvogëlojë gjithashtu importet. Përveç ndikimit në bilancin tregtar, pozicioni i llogarisë korente pritet të ndikohet nëpërmjet uljes së remitancave si rezultat i përkeqësimit të situatës së punësimit në Itali dhe Greqi. Në varësi të këtyre zhvillimeve flukset e transfertave private parashikohen të bien me 5.2% në 2011 dhe 2.7% në 2012. Pavarësisht rënies së kërkesës së huaj tregtia e jashtme pritet të rritet si në terma absolutë ashtu edhe në përqindje ndaj PBB-së me disa pikë përqindje. Bilanci i mallrave pritet të përkeqësohet në -23.6 për qind të GDP-së në 2011 (nga -23.1 në 2010) dhe të rikthehet në -23.0% në 2012. Në të njëjtën linjë deficiti i llogarisë korente parashikohet të rritet me 0.5pb në 12.2 për qind të GDP-së në 2011 dhe të ketë pak ndryshim gjatë 2012.

Më tej, në një periudhë afatmesme pritet një përmirësim i deficitit të llogarisë korente në një periudhë afatmesme (3 vitet e ardhshme) në përqindje njëshifrore ndaj GDP, bazuar në rritjen e eksporteve dhe mbajtjen në përqindje të njëjtë ndaj PBB-së të importeve. Transfertat private parashikohen të mbeten midis 7.2-7.7 për qind ndaj GDP-së, për shkak të situatës së punësimit në Itali e Greqi. Llogaria financiare pritet të mbulojë deficitin e llogarisë korente kryesisht nëpërmjet flukseve të kapitalit në formën e investimeve të huaja direkte dhe flukseve të tjera të kapitalit, duke financuar në total mesatarisht 85% të deficitit të llogarisë korente. Huamarrja e re neto pritet të reduktohet në terma negativë pas një periudhe 3-vjeçare duke qenë se amortizimi i borxhit do të tejkalojë huamarrjen e re. Banka e Shqipërisë ka dhe do të ketë një fokus të veçantë në nivelin e rezervave ndërkombëtare, me qëllim mbajtjen e një niveli të duhur të rezervave në afatin e gjatë. Përshtatshmëri e tyre do të vlerësohet në kuptimin e aftësisë së tyre për të mbuluar të paktën 4 muaj importe dhe për të mbuluar detyrimet afatshkurtra të jashtme të vendit.

Deficiti negativ i jashtëm i Shqipërisë kohët e fundit është dukshëm larg normave të vlerësuara nga një studim i ndërmarrë kohët së fundmi nga banka qendrore (Vika, I (2011) "Deficiti i llogarisë korente të Shqipërisë dhe politikat e ndërmarra" Banka e Shqipërisë. Në të ardhmen, ekonomia shqiptare mund të ndikojë vetë për të reduktuar deficitin e saj drejt niveleve të qëndrueshme pra rrezikuar rritjen ekonomike dhe punësimin. Flukset investuese nuk duket se kanë ndikuar në zhbalancimet e bilancit të jashtëm nga norma, kështu që politikat afatmesme duhet të përqendrohen në ristrukturimin e sektorit privat me qëllim rritjen e kursimeve kombëtare dhe gjithashtu duke e kthyer vendin në një destinacion tërheqës për IHD-të. Në të njëjtën kohë, politikat ekonomike afatshkurtra duhet të synojnë mbajtjen nën kontroll kërkesën. Studimi tregon se politika monetare mund të marrë rolin udhëheqës në këtë drejtim. Megjithatë, nëse konsiderohen paqartësi në lidhje me masat e ndërmarra të kujdesshme dhe administrative që synojnë rritjen e kreditimit, është e nevojshme ndërhyrja nëpërmjet politikave fiskale të kujdesshme qe do të frenojnë kërkesën. Në të vërtetë rritja e kreditimit është ngadalësuar kohët e fundit, dhe parashikimet tregojnë që nuk ka një prirje agresive për kreditim nga bankat në të ardhmen e afërt.

Këto zhvillime, së bashku më një planifikim buxhetor me konservatorë të qeverisë për vitin 2012, duhet të jenë baza për rregullimet e caktuara në bilancin e jashtëm.

Duke marrë parasysh situatën e vështirë ekonomikë të rajonit dhe veçanërisht në Greqi, flukset hyrëse të transfertave private janë parashikuar që të ulen në vitin 2011, si dhe në vitin 2012. Në dritën e një opinioni të zymtë për rritjen që do të kenë ekonomitë e rajonit, tregtia e jashtme pritet të rritet si në terma absolut dhe në ato relativ në raport me PBB-në me disa pikë përqindjeje.

Zhvlerësimi vjetor i monedhës vendase pritet të jetë mesatarisht 1.9% kundrejt euros në vitin 2011 (nga 4.3% që ishte në vitin 2010). Në vitin 2012, norma e këmbimit është parashikuar të jetë më pak se gjysmë përqindje nga mesatarja, dhe gjatë vitit 2013 pritet që kjo normë të kthehet në nivelet e arritura gjatë këtij viti. Nga ana tjetër, bazuar në ICK kursi real efektiv i këmbimit ka përjetuar zhvillime të qëndrueshme në vitin 2011. Megjithatë në dy vitet e ardhshme është parashikuar që monedha vendase të pësojë një nënçmim prej 2.8% (në vitin 2012) dhe 1.6% (në vitin 2013) krahasuar me nivelin mesatar të arritur në vitin 2011. Megjithatë zhvlerësimi i vërtet i monedhës vendase për dy vitet e ardhshme është e vështirë të besohet si pasojë kjo e fakteve që do të ketë një rritje në eksporte, si dhe rritjes së kërkesës së jashtme nga ekonomitë fqinje të Eurozonës të cilat duken që po rimëkëmben pas krizës.

Së fundmi, duke pasur parasysh që BE-ja është burimi kryesor i financues jashtëm, tensionet financiare dhe ekonomike të rritura do të japin impaktin e tyre negativ mbi investitorët e huaj që duan të investojnë në Shqipëri. Përveç këtij fakti, mbizotërimi i bankave europiane në sistemin bankar vendas mund të provojë pafavorueshmëri në të ardhmen nëse këto banka nuk janë në gjendje të përballojnë financimin e tyre për operacionet ndihmëse.

Në të vërtetë rajoni tashmë është goditur nga kriza globale. FDI-të kanë rënë ndjeshëm që nga gjysma e dytë e vitit 2008, dhe niveli i tyre në të gjashtë ekonomitë e Europës Juglindore (përfshirë edhe Shqipërinë) është rreth 60 për qind të nivelit që ato kishin para krizës, (sipas një raporti më të fundit të Bankës Botërore). Prandaj çdo thellim i krizës në Bashkimin Europian do të jetë i dëmshëm për të gjithë burime e financimit të deficitit, si në eksporte, investime të huaja dhe remitanca.

Sektori financiar

Gjatë nëntëmujorit të vitit 2011, gjendja e sistemit financiar dhe të sektorit bankar është vlerësuar si e "qëndrueshme". Brenda sistemit financiar, sektori bankar vazhdon të dominojë. Ky sistem ka zgjeruar më tej operacionet e tij duke rritur pjesën e tij në ekonominë kombëtare. Gjendja e likuiditetit duket e mirë për shkak të ritmit të kënaqshëm të rritjes së depozitave të publikut. Ato mbulojnë më shumë se një herë vlerën e kredive dhe financimi nga jorezidentët është në nivel të ulët. Ritmi i rritjes së kredisë po rritet, por cilësia e portofolit të kredisë ka vazhduar të bjerë. Sektori bankar ka ruajtur ritme të qëndrueshme të rritjes së të ardhurave nga interesi neto dhe fitimi bruto operativ. Megjithatë rritja e provigjoneve në depozita ka çuar në një rënie të rezultatit neto financiar të sektorit bankar krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Pas një trendi afatgjatë rënës, mjaftueshmëria e kapitalit (ose kapitali i ponderuar me rrezikun) është përmirësuar në tremujorin e tretë të vitit 2011, si pasojë e injektimit në sistem të kapitalit të ri nga disa banka.

Në fund të muajit qershor 2011, niveli i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, i matur si raport i aktiveve të sektorit financiar ndaj PBB-së, vlerësohet në 86.9% në gjysmën e parë të vitit 2011, nga 84.4% që ishte në fund të gjysmës se parë të vitit 2010 dhe 85.9% që ishte në fund të vitit 2010. Asetet e institucioneve financiare janë rritur me rreth 5% krahasuar me fundvitin 2010. Sektori financiar jobankar vazhdon të ketë një pjesë të vogël në totalin e aktiveve të sistemit financiar. Kështu totali i aktiveve të sektorit financiar jobankar përbëjnë rreth 5.5% të aktiveve të sistemit financiar, një pjesë në rënie në krahasim me nivelin e 5.7% që ishte në fund të vitit 2010. Si pjesë e PBB-së, aktiviteti i këtij sektori përbëjnë rreth 4.8% nga 4.9% që ishte në fund të vitit 2010. Sektori bankar mbetet segmenti më dominues i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri. Asetet e këtij sektori në fund të muajt shtator 2010 përbënte rreth 84.6% të PBB-së nga 86.9% që ishte në qershor 2011 dhe nga 80.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Rezultati financiar ishte pozitiv për sektorin bankar në vlerën prej 1.3 miliardë lekë, rreth 66.9% më i ulët se e njëjta periudhë e një viti më parë. Kthyeshmëria nga asetet në bazë vjetore, ishte 0.17 %. Ndërkohë që në të njëjtën periudhë të një viti më parë ky tregues ishte 0.6%. Kthyeshmëria nga fondet e veta në bazë vjetore ishte 1.9%, ndërkohë që një vit më parë ky tregues ishte 6%. Rënia e fitimit neto nga sektori bankar ka ardhur si rezultat i rënies në të ardhurat neto nga aktivitetet e tjera, si dhe nga kostot në rritje të provigjoneve dhe kostove operative. Rezultati financiar vazhdon të ketë një përqendrim të lartë në bankat më të mëdha (të grupit 3) dhe kjo do të ishte më mirë që të shtrihej në një numër më të madh të bankave në mënyrë që të jetë më e qëndrueshme

Në shtator 2011, asetet likuid zinin 26.3% të totalit të aktiveve të sektorit bankar nga 28% që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Raporti i "Kredisë ndaj depozitave" ishte 60%, duke qenë në të njëjtin nivel me vitin e kaluar. Gjatë periudhës janar-shtator 2011, sektori bankar ka vazhduar të përballojë përkeqësimin e cilësisë së kredisë. Kreditë me probleme ishin 18.3% të totalit të kredisë, krahasuar me nivelin e 13.8% që ishin në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Për t'i bërë ballë situatës së rrezikut të kredisë, sektori bankar ka vazhduar të rrisë depozita e saj për të përballuar çdo humbje të mundshme. Në fund të nëntëmujorit, këto depozitat u rritën në nivelin e 50.6 miliardë lekësh, rreth 10% më shume se niveli i tyre në qershor 2011 dhe 47.2% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Raporti i provigjoneve ndaj kredive me probleme (bruto) ishte 50.8% nga 52.7% që ishte në vitin e kaluar.

Asetet e sektorit bankar të shprehura në valutë arritën në 595.1 miliardë lekë (nga të cilat kreditë e shprehura në valutë ishin 373.4 miliardë lekë), duke përfaqësuar një rritje prej 2.2% në fund të qershorit dhe 7.1% nga viti në vit. Investimet e sektorit bankar në asetet e subjekteve jorezident arritën në 168.9 miliardë lekë, duke pësuar një rritje prej 30.6% në fund të muajit qershor dhe një rritje prej 39.7% nga viti në vit.

Detyrimet e shprehura në valutë të huaj arritën në 570.1 miliardë lekë duke pësuar një rritje prej 8.5% në fund të muajit qershor dhe me një rritje prej 17% nga viti në vit, detyrimet e sektorit bankar ndaj jorezidentëve, arritën në 69.3 miliardë lekë me një rritje prej 4.6% në fund të muajit qershor 2011, dhe 56.4% më shumë se një vit më parë. Shuma e linjave të kredisë të përdorura vlerësohet të jetë 18.9 miliardë lekë.

Banka e Shqipërisë ka theksuar rëndësinë e rritjes së peshës së kredive në monedhën vendase. Kjo do të zvogëlonte rrezikun për huamarrësit dhe për vetë bankat. Zhvillimet në këtë drejtim kanë qenë inkurajuese, por gjithsesi ato akoma nuk janë të rëndësishme. Trendi për huamarrje në monedhë të huaj pritet të vazhdojë me një ritëm më të ngadalshëm. Ndryshimi i këtij trendi mund të kërkojë masa të tjera rregullatore në një fazë të mëvonshme. Lidhur me pozicionin neto të sektorit bankar ndaj jorezidenëve, ky pozicion është dukshëm pozitiv rritës. Kjo tendencë është përcaktuar nga përmirësimi i gjendjes likuide në monedhë të huaj të sektorit bankar dhe hezitimi i saj për kreditim të ekonomisë. Kjo situatë pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen derisa gjendja ekonomike e individëve dhe biznesit të tregojë shenja të përmirësimit të qëndrueshëm.

Depozitat u rritën me rreth 5.4% në tremujorin e tretë të vitit 2011 dhe 14.1% krahasuar më një vit më parë. Depozitat mbeten të përqendruara në bankat e mëdha të sektorit bankar, por gjithsesi shkalla e përqendrimit të tyre ka rënë ndjeshëm

Rritjes së depozitave është rritur në rreth 5.4 për qind në tremujorin e tretë të vitit 2011 dhe 14.1 një vit më parë. Depozitave mbeten të përqendruara në bankat më të mëdha të sektorit bankar, por shkalla e përqendrimit të tyre ka rënë ndjeshëm.

Tabela 1. Rritja vjetore e depozitave në sektorin bankar, 2004-2011.

	2004	**2005**	**2006**	**2007**	**2008**	**2009**	**2010**	**9-mujori 2011**
Rritja totale e depozitave (%)	13.4	16.4	20.1	19.9	2.4	7.6	17.7	10.5

Burimi: Banka e Shqipërisë

Duke u bazuar në afatet e maturimit të tyre, vëmë re se 65% e depozitave bankare janë relativisht me maturim të shkurtër deri në 6 muaj. Rritje në depozita është vëne re për depozitat me afat maturimi nga 6-12 muaj. Gjatë këtij viti depozitat e reja u rritën me 3.1% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Në fund të muajit shtator, raporti i depozitave në monedhën vendase ndaj totalit të depozitave ishte 50.07%, duke rënë me 1.6 pikëpërqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Gjatë 9-mujorit të vitit 2011, depozitat e reja në euro dhe USD ishin respektivisht 1.7% dhe 1.6% më të larta se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Edhe pse pjesa më e madhe e këtyre depozitave të përbëra nga maturiteti i ulët deri në 3 muaj, përbërja e tyre kohët e fundit ka ndryshuar duke bërë që depozitat e reja të shkojnë drejt një afati maturimi më të gjatë.

Depozitat e reja në lekë dhe llogaritë rrjedhëse kanë reflektuar trendin e normave të interesit. Kështu, vlera më e lartë për depozitat e reja në lekë dhe llogaritë rrjedhëse përputhet me normën e interesit më të lartë për periudhën. Në të ardhmen pritet që rritja e depozitave të jetë pozitive, edhe pse ritmi i saj mund të ngadalësohet. Ne besojmë se rritja e depozitave do të mbështetet nga një rimëkëmbje graduale, por e qëndrueshme ekonomike, e cila do të mundësonte të ardhura në rritje për familjet.

Deri në shtator 2011, kredia për sektorin privat arriti në 38.6% të PBB-së, ose 2.9 pp më e lartë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Rritja vjetore e rritjes së kredisë ishte rreth 14.7% duke pësuar një rritje nga niveli prej 9.1% që ishte në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Gjatë nëntë mujorit të vitit 2011, bankat kanë rritur kapacitetin e tyre kreditues për sektorin privat dhe familjar. Kredia për biznes ende mbetet forca shtytëse për rritjen e kredisë. Në terma vjetorë kredia është rritur 19.6%. Sektori i

prodhimit dhe sektori i shërbimit janë sektorët më të financuar nga bankat, sidomos bujqësia (46%), energjia (42%) dhe tregtia (22%) që në të vërtetë janë edhe kontribuuesit kryesorë të rritjes ekonomike.

Kredia për ndërtimin (8%) dhe industrinë (8%) vazhdon të mbajë një normë mesatare vjetore rritjeje. Sipas qëllimit të kredisë për biznesin, deri në shtator të vitit 2011, kjo kredi ka përjetuar një rritje vjetore për kapital qarkullues (22%) dhe për investime në pasuri të patundshme (21%). Kredia për ekonomitë familjare ka pësuar një rritje gjatë muajit shtator 2011; megjithatë, ajo mbetet ende në nivele të ulëta në krahasim me mesataren vjetore historike për periudhën 2004-2011. Rritja e saj vjetor ishte rreth 6.3%. Sjellja individuale drejt kursimit ka ulur nevojat për likuiditet të cilat janë materializuar në kreditë "Overdraft", të cilat janë rritur me 16%. Pasiguritë e larta në tregun e pasurive të paluajtshme kanë regjistruar një ngadalësim të kredive të kategorisë kredi "për pasuri të paluajtshme", duke pësuar një rritje prej vetëm 4 për qind nga viti në vit.

Rritja vjetore e kredisë nga sektori bankar, 2004-2011.

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	9-mujori i parë 2011
Rritja totale e kredisë (%)	38	82.1	54.9	47.7	35.6	13.4	9.1	14.7
Rritja e kredisë për sektorin privat (%)	26.2	83.6	49.4	39.4	32.6	16.5	15.6	19.6
Rritja e kredisë për sektorin e ekonomive familjare (%)	75	79.4	67.4	58.9	34.9	3.1	2.3	6.34

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në shtator të vitit 2011, ashtu si një muaj më parë teprica e kredisë e shprehur në monedhë të huaj dhe në lekë mbeti e ndryshuar respektivisht 69% dhe 31%. Pavarësisht pjesës së lartë të kredisë në monedhën të huaj, zhvlerësimi i monedhës vendase gjatë vitit 2011, solli në një kërkesë më të lartë për kredi në monedhë vendase, në shtator 2011 rritja vjetore e kredisë në lekë ka qenë 18.7% krahasuar me 13.1% që ishte rritja vjetore e kredisë në valutë .

Cilësia e kredisë vazhdoi prirjen rënëse gjatë nëntëmujorit të vitit 2011, ku raporti i kredive me probleme ndaj totalit të kredive, mbi baza bruto, u rrit në 18.3% kundrejt 17% që ishte në qershor 2011 dhe 13.8% që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në të vërtetë, cilësia e kredive është përkeqësuar si për bizneset, ashtu dhe për ekonomitë familjare, si në kreditë në monedhën vendase dhe në ato të huaja. Për të përballuar këtë situatë sektori bankar ka ndërmarrë masa për të rritur dispozitat. Në shtator 2011, raporti i dispozitave ndaj kredive me probleme (raporti i mbulimit) ishte 50.8%, nga 52.7% që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Lidhur me kolateralin, të dhënat e fundit treguan se vlera e kolateralit të kredive të garantuara përbënin 76.8% të portofolit të kredisë.

Raporti i kredive të këqija për periudhën 2004-2011.

Kreditë e këqia (%)	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	9-mujori 2011
Sistemi	4.2	2.3	3.05	3.3	6.6	10.5	13.9	18.3
Sektori privat	5.4	2.6	3.5	3.6	7.6	12.3	15.5	20.5
Sektori i ekonomive familjare	1.5	1.7	2.2	3.03	5.5	8.2	11.7	15.4
Monedhë vendase	1.9	1.7	2.8	3.9	7.5	10.1	14.4	17.3
Monedhë e huaj	4.7	2.5	3.1	3.1	6.3	10.6	13.8	18.8

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë nëntëmujorit të vitit 2011, situata e likuiditetit në sistemin bankar ka qenë e kënaqshme. Baza e depozitave është zgjeruar gjatë gjithë kësaj periudhe, dhe në shtator 2011 arriti nivelin e 902.6 miliardë lekë, rreth 5.3 për qind më shumë se në qershor 2011 dhe 14 për qind më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Për sistemin bankar në tërësi, raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve ishte 26,3 për qind. Aktivet likuide përfaqësojnë rreth 31,3 për qind e detyrimeve afatshkurtra, kur niveli rregullator minimal është 20 për qind. Për të gjitha bankat ky raport qëndron mbi këtë kufi rregullator. Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2011, ky raport ka treguar luhatshmëri të vogël në kufijtë 30-32 për qind. Ky raport tregon asimetri të rëndësishme për monedhat vendase dhe të huaja. Në këtë kontekst, ky raport është vlerësuar të jetë rreth 20 për qind në euro dhe dollarë, por shkon në 41.1 për qind në lekë.

Financimi nga bankat mëma mbetet një burim shumë i rëndësishëm financimi për disa banka, sidomos bankat greke në Shqipëri, edhe pse gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, përveç një banke greke, niveli i tyre ka rënë gradualisht. Këto fonde në shtator 2011 kanë qenë rreth 38.5 miliard lekë nga 25.5 miliardë që kanë qenë në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Bankat greke ishin në gjendje të thithnin një pjesë të rëndësishme të depozitave hyrëse në sistemin bankar. Në përgjithësi, pozicioni i likuiditetit të bankave greke është përmirësuar dhe mbetet në nivele të kënaqshme. Raporti i aseteve të likuiditetit ndaj totalit të detyrimeve afatshkurtra arriti 33,7 për qind krahasuar me 27.3 për qind në shtator 2010. Që nga shtatori 2011, linjat ekreditit llogariten 23.1 për qind të depozitave të klientit, nga 16.7 për qind në shtator 2010.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar shqiptar ka treguar një tendencë rënëse, ndërsa në tremujorin e tretë të 2011, ky raport u rrit përsëri. Sa për shtatorin 2011, ky raport qëndron në 15.1 për qind, ose 0.4 pikë përqindjeje më i lartë se niveli i qershorit 2011, duke reflektuar një normë më të lartë të rritjes së kapitalit rregullator në krahasim me riskun e ponderuar të aktiveve (5.6 për qind kundrejt 2.7 për qind). Në të ardhmen e afërt pritet që ky raport mund të jetë i qëndrueshëm ose të rritet pasi bankat do të preferojnë të investojnë më pak në aktive me rrezik.

Analiza e "Testit të stresit" e kryer për periudhën 2011-2012 analizon rezistencën e sistemit bankar dhe nevojën për kapital shtesë në rast të goditjeve të forta makroekonomike të cilat përfshijnë: lëvizjet e kundërta në kursin e këmbimit, normat e interesit, ecurinë ekonomike, rritjen e kredive dhe reflektimin e tyre në vëllimin e kredive me probleme. Rezultatet e analizës tregojnë se sektori bankar mund të përballojë një rritje të mëtejshme të kredive me probleme në skenarin bazë, i cili pritet të ngadalësohet gjatë 2012. Në rastin e goditjeve negative makroekonomike, do të ketë nevojë për kapital shtesë kërkesë kjo kryesisht për shkak të shokut të fortë të rritjes së kredive dhe një rritje të ulët ekonomike. Edhe nën skenarin e kundërt, në terma të raportit të kredive me probleme dhe të mjaftueshmërisë së kapitalit, del se sektori bankar është në gjendje të përballojë goditjet e rëndësishme që rezultojnë nga lëvizjet e pafavorshme të faktorëve ekonomikë të cilat do të përkeqësojnë cilësinë e kredive. Megjithatë, ndjeshmëria e disa bankave ndaj goditjeve makroekonomike është rritur dhe kjo kërkon nevojën e rritjes së monitorimit nga afër të zhvillimit të tyre. BSH zhvilloi gjithashtu skenarë të rrezikut të përhapjes ose kontaminimit, për të vlerësuar ekspozimin e sektorit bankar ndaj bankave të tyre mëmë jashtë vendit. Rezultatet e stresit tregojnë se ekspozimi për bankën greke është më i madh në krahasim me bankat italiane që operojnë në Shqipëri.

Në kontekstin e cilësisë së portofolit të kredive, ecuria e kredisë në monedhë të huaj është e një rëndësie primare për shkak të dominimit të vazhdueshëm në strukturën e kredive totale. Edhe pse cilësia e kredive në valutë është ende relativisht mirë në krahasim me kreditë e brendshme, pritjet për ecurinë e ardhshme të këtij portofoli duhet të mbajnë parasysh faktin se më shumë se gjysma e totalit të portofolit të kredisë FX përbëhet nga kreditë e pambrojtura FX. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në pikëpamje të brishtësisë së natyrshme në ecurinë e kursit të këmbimit të monedhës vendase. Në këtë kontekst, rreziqet indirekte janë të theksuara sidomos në lidhje me euron duke qenë se kreditë në euro zënë një peshë dominuese në portofolin e kredive.

Rreziku i kredisë përbën rrezikun kryesor me të cilin përballet sektori bankar shqiptar. Në lidhje me këtë çështje, Banka e Shqipërisë, me anë të funksionit të saj mbikëqyrës, ka kërkuar nga bankat e

nivelit të dytë që të sigurojnë, në mënyrë paralele edhe identifikimin në kohë dhe siç duhet të provigjoneve për kreditë e humbura si edhe për të marrë veprimet e duhura në mënyrë që të mbulojë humbjet nga kreditë nëpërmjet ekzekutimit të kolateraleve. Këto veprime së bashku me masat e marra për të ulur shpenzimet operative, gradualisht do të krijojnë kushtet për të gjeneruar një rezultat të qëndrueshëm dhe pozitiv financiar, i cili do të mbështesë më mirë nevojat afatmesme të sektorit bankar për kapital. Banka e Shqipërisë po monitoron nga afër procesin e menaxhimit të cilësisë së kredive nga sistemi bankar dhe ndikimin e tyre mbi të ardhurat, dhe në këtë kontekst anketat dhe vlerësimet e standardave janë duke u zhvilluar lidhur me trajtimin e kolateralit, me qëllim të përmirësimit të kuadrit rregullativ përkatës.

Në vizion afatshkurtër, Banka e Shqipërisë ka vlerësuar dhe kërkuar që sektori bankar të forcojë kapitalizimin e veprimtarisë së tyre, duke rritur kapitalin nga aksionarët. Banka e Shqipërisë ka orientuar dhe monitoruar këtë proces, në mënyrë që ajo të kryhet në përputhje me strategjitë e zhvillimit të veprimtarisë bankare dhe të rreziqeve përkatëse. Procesi i forcimit të treguesve të kapitalizimit të sektorit bankar përfshin krijimin e vlerave të mjaftueshme kapitale mbi nivelin e tij minimal të kërkuar. Procesi është duke u zhvilluar në komunikim të plotë të Bankës së Shqipërisë me sektorin bankar. Si rezultat, sektori bankar do të mbetet i qëndrueshëm dhe do të krijojë kushtet për rritjen e kontributit të tij në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

Ekspozimi ndaj borxhit i ekonomive familjare edhe bizneseve

Sektori i ekonomive familjare

Huamarrja e ekonomive familjare nga bankat deri në shtator 2011 është përmirësuar duke u rritur me 5.3% në terma vjetorë, krahasuar me 1.1% gjatë të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Nga ana tjetër, depozitat vazhdojnë të rriten fuqishëm me 16.6% në terma vjetorë, edhe pse 1 pikë përqindjeje më pak në krahasim me vitin e kaluar. Si rezultat, pozita financiare e kreditorit është zgjeruar me 20% në terma vjetorë. Në terma të riskut, sektori i ekonomive familjare ka ulur ekspozimin ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit pasi raporti i kredive të pambrojtur në monedhë të huaj ndaj totalit të kredive ka arritur nivelin e 33.7% në shtator 2011, në krahasim me 42,61% vitin e kaluar. Edhe ekspozimi i tyre ndaj rrezikut të tërthortë të normës së interesit ka rënë gjithashtu, ku raporti i kredive me norma interesi të ndryshueshme ndaj kredive të përgjithshme është 25,8% krahasuar me 27.9% të vitit të kaluar.

Duke marrë parasysh mungesën e të dhënave në lidhje me gjendjen financiare të familjeve dhe biznesit, si dhe barrën e huamarrjes së tyre, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar kohët e fundit një studim në mënyrë që të sigurojë më shumë informacion. Rezultatet për sektorin e ekonomive familjare tregojnë se burimi kryesor i të ardhurave vjen nga punësimi në sektorin privat (29.8%), pensioneve (30.1%) dhe vetëpunësimit (20.9%). Vetëm 14% e familjeve deklarojnë se kanë burime të tjera të të ardhurave, kryesisht remitanca. 24.8% e familjeve deklarojnë se aktualisht kanë një borxh për të paguar. Burimi kryesor i borxhit është një person (59.3%) dhe bankat (37.4%). Borxhi është përdorur kryesisht për të blerë/riparuar pasuri të patundshme (41.6%), për konsum (28.5%) dhe për të zhvilluar një biznes (10.1%). Borxhi është marrë hua kryesisht në afat të shkurtër deri në 12 muaj (36%) dhe afat të mesëm 1-3 vjet (33%). Për shkak të të ardhurave më të ulëta dhe një rritje të nevojshme të shpenzimeve, 27% e familjeve deklarojnë se aftësia e tyre për të shlyer borxhin është përkeqësuar gjatë gjashtëmujorit të parë të 2011. Megjithatë, 50% e familjeve presin të mos kërkojnë borxh të ri gjatë pjesës tjetër të 2011.

Sektori i biznesit

Huamarrja nga sektori bankar i sektorit të biznesit është përmirësuar me një rritje vjetore prej 18.2% deri në shtator 2011, ndërsa depozitat kanë pësuar rënie në terma vjetorë me 5.2%. Si rezultat, pozita financiare e biznesit debitor është zgjeruar me 28% në krahasim me muajin shtator 2010. Zgjerimi i pozitës financiare të debitorit-biznes është më i madh në drejtim të monedhës së huaj sesa në monedhën vendase, dhe kjo e rrit ekspozimin e sektorit në tërësi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Ekspozimi më i lartë në aspektin e rrezikut të tërthortë të kredisë është reflektuar edhe në raportin e kredive të pambrojtura në monedhë të huaj ndaj totalit të kredisë, pasi ajo arriti 33.6% në shtator 2011 në krahasim me 33% vitin e kaluar. Bizneset kanë rritur edhe ekspozimin e tyre ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit,

pasi raporti i kredive me normë interesi të ndryshueshme në raport me kreditë e përgjithshme është 61,6% krahasuar me 59.2% vitin e kaluar.

Një prezantim më të detajuar të situatës financiare të bizneseve, jep sondazhi i kryer nga Banka e Shqipërisë. Rezultatet e anketës tregojnë që aktualisht 42.8% e bizneseve duhet të paguajnë një borxh. Burimi kryesor i financimit të aktivitetit gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 është ai i shitjes (26.9%), ndërsa huamarrja e përdorur vetëm apo në kombinim me burime të tjera është përdorur nga 27.3% e bizneseve (një rritje prej 3 pp krahasuar me gjysmën e dytë të 2010). Borxhi është përdorur kryesisht për investime afatgjata (30.8%) dhe për të mbuluar shpenzimet korrente (36.3%). Bizneset kanë financuar aktivitetin e tyre nga huamarrja me një afat maturimi deri në 1 vit (58,9%), ndërsa 20% e tyre kanë marrë hua në gjysmën e parë të 2011. Megjithatë, 73,8% e huamarrësve deklarojnë se niveli i tyre i huamarrjes është i përshtatshëm dhe vetëm 10,2% do të donte të merrte hua më shumë. Në lidhje me pritjet për të ardhmen, 57.6% e bizneseve deklarojnë se nuk kanë ndërmend të marrin hua përsëri për 6 muajt e ardhshëm, krahasuar me 68% të bizneseve që kanë deklaruar të njëjtën gjë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2010.

Zhvillimet e këtij viti në eurozonë dhe veçanërisht vendet fqinjë të Shqipërisë, Itali dhe Greqi, kanë qenë në fokusin e veçantë të shqetësimeve mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë për sa i përket ndikimeve të tyre potenciale në stabilitetin e sistemit bankar e më gjerë të vendit. Banka e Shqipërisë i ka ndjekur në vijimësi me vëmendje maksimale këto zhvillime, duke analizuar në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme situatën dhe vlerësuar ndikimet potenciale në sistemin bankar dhe stabilitetin financiar. Ecuria e dobët e ekonomisë europiane, e cila reflektohet në mbarë tregjet botërore, nëpërmjet ndikimit edhe në ekonominë shqiptare ka kontribuar në rritjen e vazhdueshme të treguesit të kredive të këqija në sistem, ndërkohë që tensionet në sistemet financiare europiane kushtëzojnë presione të rritura lidhur me sigurimin e likuiditetit. Në këtë kuadër, qëndrimi i Bankës së Shqipërisë ka qenë dhe mbetet proaktiv, duke synuar adresimin në kohë të rreziqeve nëpërmjet ndërmarrjes së masave paraprake rregullative dhe mbikëqyrëse për të zbutur ndikimin potencial të efekteve që burojnë nga tensionet në tregjet ndërkombëtare dhe forcuar qëndrueshmërinë e sistemit bankar të vendit.

Kështu, Banka e Shqipërisë ka iniciuar dhe realizuar një sërë ndryshimesh të rëndësishme në kuadrin rregullativ dhe mbikëqyrës si nëpërmjet përmirësimit të kuadrit rregullativ ekzistues dhe vënies në jetë të akteve të reja rregullative, ashtu edhe nëpërmjet marrjes së masave mbikëqyrëse në funksion të administrimit të kujdesshëm të situatës në sistemin bankar.

Për t'i dhënë Bankës së Shqipërisë kompetenca më të plota në administrimin e situatave që paraqesin rrezik sistemik, ligji për bankat është amenduar. Si rezultat, Banka e Shqipërisë ka tashmë hapësira më të gjera ligjore për të adresuar situata të mundshme tensioni në sistemin bankar, përfshirë trajtimin e bankave me probleme apo ndryshimin e statusit të tyre ligjor për qëllime prudenciale.

Ndërkohë, po këtë vit u rishikuan rregullat për administrimin e rrezikut të kredisë në veprimtarinë e bankave dhe degëve të bankave të huaja, me synim një monitorim më efektiv të portofoleve të kredive në bankat e sistemit duke përcaktuar kriteret për klasifikimin dhe vlerësimin e kredive dhe aktiveve të tjera me qëllim llogaritjen e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga zhvlerësimi i tyre. Rregullat e reja për administrimin e rrezikut të kredisë u mundësuan nga autoriteti mbikëqyrës në përgjigje të nevojave të bankave në kushtet aktuale të zhvillimit të tregut, si dhe vështirësive me të cilat janë përballur ato sidomos pas krizës globale financiare të viteve 2008-2009.

Po kështu, në vijim dhe në referencë të rregullave të reja për administrimin e rrezikut të kredisë u realizuan disa ndryshime edhe në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit", të cilat lidhen me vendosjen e kërkesave për ponderimin e rrezikut të kredisë në rastet e kredidhënies jashtë territorit ku bankat ushtrojnë veprimtarinë nëpërmjet filialeve, degëve ose agjencive të tyre. Autoriteti synon që të vendosë kërkesa më prudenciale nëpërmjet këtyre ndryshimeve në funksion të shëndetit të sistemit bankar.

Banka e Shqipërisë ka bërë kujdes të veçantë, në bazë të analizave të vazhdueshme dhe të thelluara, për sa lidhet me përsosjen e rregullave për administrimin e rrezikut të likuiditetit të bankave individuale dhe të sistemit në tërësi. Rregullorja e re e administrimit të rrezikut të likuiditetit ka vendosur limite rregullatore më konservatore lidhur me treguesin e likuiditetit të bankave, ndërkohë që një kujdes i

veçantë i është rezervuar edhe trajtimit të likuiditetit sipas monedhave. Në këtë kuadër, bankat tashmë duhet të respektojnë raporte minimale të likuiditetit respektivisht edhe në monedhë kombëtare dhe valutë, për të siguruar një situatë të qëndrueshme lidhur me të dy treguesit. Baza e aktiveve likuide që bankat mund të përdorin për të përmbushur kërkesat rregullatore gjithashtu është përforcuar nëpërmjet aplikimit të kritereve më rigoroze për këtë qëllim. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë, nëpërmjet paketës së re të masave për administrimin e rrezikut të likuiditetit ka forcuar edhe kërkesat raportuese të treguesve të likuiditetit duke synuar monitorimin më periodik të treguesve përkatës si nga vetë bankat ashtu edhe nga autoriteti mbikëqyrës.

Përtej këtyre masave, është aplikuar një qasje më prudenciale për bankat greke që operojnë në Shqipëri, si rezultat i rreziqeve specifike të cilat ato bartin për shkak të tensioneve që burojnë nga situata aktuale në shtetin fqinj. Konkretisht, atyre i është kërkuar të respektojnë një tregues mjaftueshmërie kapitali përtej minimumit rregullator, si dhe tregues likuiditeti edhe më konservatorë kundrejt limiteve minimale të specifikuara në kuadrin rregullator.

2. FINANCAT PUBLIKE

Reformimi i sektorit të financave publike është në thelb të strategjisë së financave publike, që mbulon periudhën 2007-2013. Kjo strategji mbështetet në katër shtylla: përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike, forcimi i menaxhimit të borxhit, zgjerimi i bazës së taksueshme dhe harmonizimi i politikës tatimore me përparësitë kombëtare; rritja e besueshmërisë dhe performancës së administratave tatimore dhe doganore.

Edhe pse shumë mbetet për të bërë, në aspektin e zgjerimit të bazës së taksueshme reforma të rëndësishme tatimore janë ndërmarrë që nga viti 2006. Strategjia e reformimit të sistemit tatimor u bazua në disa elemente thelbësore: normë shumë e ulët e tatim fitimit (më e ulëta në eurozonë dhe një nga më të ulëtat në rajon) prej 10%; taksim individual i thjeshtë dhe proporcional, me normë unike taksimi prej 10% mbi të gjitha burimet e të ardhurave; sistem TVSH-je me bazë të gjerë dhe normë standarde 20% (me një normë të reduktuar 10%), si dhe një prag përjashtimi "brenda normales" për bizneset e vogla; taksa mbi punë të ulëta (kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), me normë totale taksimi prej 28% mbi pagën bruto.

Zhvillime ka pasur dhe pjesa e administrimit të sistemit tatimor, në të dyja agjencitë e të ardhurave, tatime dhe dogana. Janë përmirësuar aspekte të rëndësishme si organizimi, dhe infrastruktura, është shtrirë përdorimi i teknologjisë së informacionit në pjesën më të madhe të sistemit, për kryerjen e procedurave "rutine" si deklarimi, pagesa e detyrimeve, zhdoganimet, analizat e riskut, etj.

2.1 Bilanci dhe borxhi i qeverisë së përgjithshme

Zhvillimet e fundit fiskale

Nga të dhënat paraprake të thesarit të Ministrisë së Financave, për vitin 2011 të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar arritën në 330.4 miliardë lekë (shih tabelën 1). Të ardhurat totale buxhetore ishin rreth 4 për qind më të ulëta se parashikimi dhe 1.7 për qind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet totale arritën në 376.1 miliardë lekë (shih tabelën 1) 3.7 për qind më të ulëta se në vitin 2010, dhe 14.7 miliardë më të ulëta se planifikimi.

Deficiti fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në 45.7 miliardë deri në fund të 2011, 1 miliardë lekë më pak se planifikimi. Deficiti është financuar në pjesën më të madhe me burime të brendshme (kryesisht huamarrje): 438 milionë lekë janë të ardhurat nga privatizimi të destinuara për financimin e deficitit; 28.2 miliardë lekë të ardhurat nga huamarrja e brendshme neto. Financimi i huaj neto i deficitit ka qenë në nivelin 18 miliardë lekë.

Treguesit kryesorë të buxhetit të konsoliduar për vitin 2011

Miliardë lekë	Janar-dhjetor '10	Janar-dhjetor '11	Buxheti 2011
Të ardhurat totale	324.7	330.4	344.0
Shpenzimet totale	362.8	375.7	390.9
Nga të cilat: shpenzimet korrente	300.8	305.8	311.5
Nga të cilat: shpenzimet kapitale	67.5	70.3	73.7
Balanca fiskale	-38.0	-45.3	-46.8
Balanca primare	+3.57	+0.03	-4.61

Të ardhurat tatimore gjatë vitit 2011, u realizuan në masën 96.3 për qind, rreth 11,6 miliardë lekë më pak se planifikimi ose 5.3 për qind më shumë se një vit më parë. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat arritën në nivelin e 235.4 miliardë lekë, duke u realizuar në masën 97 për qind të planit të periudhës. Krahasuar me një vit më parë ato janë 5.5 për qind më të larta.



Të ardhurat nga TVSH-ja për vitin ishin rreth 119.4 miliardë, 661 milionë lekë më pak se planifikimi ose 4.7 për qind më shumë se një vit më parë.

Të ardhurat nga akcizat u realizuan në masën 97.9 për qind e planit të periudhës, 4 për qind më shumë se viti 2010. Tatim-fitimi arriti në 19.7 miliardë lekë për periudhën 12-mujore, 11 për qind më shumë se një vit më parë, ose 1.4 miliardë më pak se planifikimi i periudhës. Tatimi mbi të ardhurat personale u realizua në masën 95 për qind, 3.1 për qind më shumë se një vit më parë; ndërsa taksa doganore arriti në 6.9 miliardë lekë, 5.7 për qind më pak se periudha paraardhëse.

Të ardhurat nga pushteti vendor arritën 11.8 miliardë lekë, 3.5 miliardë lekë më pak se planifikimi ose 0.9 për qind me pak se një vit më parë.

Të ardhurat nga fondet specialë ishin 5.6 për qind më shumë se viti 2010, duke u realizuar në masën 97.6 për qind e planit të periudhës.

Të ardhurat jotatimore për vitin 2011 ishin 22.7 miliardë lekë, ose 2.5 miliardë më shumë se planifikimi i periudhës 12 mujore.

Analiza e realizimit të pritshëm të shpenzimeve buxhetore për vitin 2011

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit në fund të vitit 2011, arritën në rreth 375.7 miliardë lekë, nga rreth 390.9 miliardë lekë të parashikuara me buxhetin e miratuar, duke u realizuar në rreth 96.1 për qind ose me një mosrealizim prej rreth 15.1 miliardë lekë. Për rrjedhojë këto shpenzime në fund të vitit 2011 përllogariten në rreth 28.5 për qind e produktit të brendshëm bruto, nga rreth 29.5 për qind që arritën një vit më parë.



Kundrejt vitit 2010, shpenzimet e përgjithshme buxhetore rezultojnë rreth 13 miliardë lekë më të larta, ose rreth 3.6 për qind më shumë. Ecuria e shpenzimeve buxhetore në shumë absolute dhe ritmi i rritjes së tyre në disa vite, jepet në grafikun e mëposhtëm:



Shpenzimet e kryera nëpërmjet përdorimit të fondit rezervë të Këshillit të Ministrave dhe kontigjencës, janë reflektuar në zërat e shpenzimeve ku ato janë kryer, si më poshtë:

- Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, i planifikuar në rreth 1.93 miliardë lekë, gjatë vitit 2011, është përdorur në rreth 1.76 miliardë lekë, përkatësisht rreth 206.2 milionë lekë për shpenzime personeli, rreth 845.6 milionë lekë për shpenzime të tjera korente dhe rreth 711.7 milionë lekë për investime.

- Fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit, i planifikuar në rreth 3.65 miliardë lekë, gjatë vitit 2011 është përdorur në rreth 2.32 miliardë lekë, nga e cila rreth 1.52 miliardë lekë në formën e subvencionit, për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, te njësitë e qeverisjes vendore dhe 0.8 miliardë lekë për transfertën e brendshme korente për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

- Fondi për rritjen e pensioneve, i planifikuar në rreth 1.6 miliardë lekë, është përdorur tërësisht në masën e planifikuar dhe është pasqyruar në zërin e shpenzimeve shoqërore, ndërsa nga fondi për rritjen e pagave rreth 604 milionë lekë është përdorur për rritjen e pagave dhe rreth 167.3 milionë lekë për rritjen e sigurimeve shoqërore.

Në totalin e shpenzimeve buxhetore të realizuara, gjatë vitit 2011, shpenzimet korente zënë rreth 81.4 për qind, ndërkohë që shpenzimet për investime zënë rreth 18.6 për qind.



Shpenzimet korente, kanë arritur në rreth 305.8 miliardë lekë ose rreth 97.1 për qind të planit vjetor me ndryshime (plan që merr në konsideratë vetëm rishpërndarjet e cilësuara më sipër). Shpenzimet korente arritën në rreth 23.2 për qind të PBB-së nga rreth 24.4 për qind që ishin një vit më parë. Krahasuar me vitin e kaluar, këto shpenzime rezultojnë rreth 4.9 miliardë lekë më të larta ose rreth 1.6 për qind më shumë.



Brenda shpenzimeve korente, shpenzimet e personelit, që përfaqësojnë rreth 22.1 për qind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë vitit 2011, rezultojnë me një kursim prej rreth 1.5 miliardë lekë ose rreth 2.2 për qind më pak se plani me ndryshime, rrjedhojë kjo kryesisht e kursimeve në zërin shpenzime për paga, prej rreth 1.1 milionë lekë.

Shpenzimet e personelit në fund të vitit 2011 arritën në rreth 5.1 për qind e PBB-së, nga rreth 5.3 për qind që ishte një vit më parë.



Krahasuar me një vit më parë, shpenzimet e personelit rezultojnë rreth 1.7 miliardë lekë më të larta, ose rreth 2.6 për qind më shumë, ndërkohë që shpenzimet për paga rezultojnë rreth 1.4 miliardë lekë më të larta, ose rreth 2.6 për qind më shumë dhe shpenzimet për kontribute të sigurimeve shoqërore rreth 0.2 miliardë lekë më të larta, ose rreth 2.7 për qind më shumë.



Shpenzimet për interesa, që përfaqësojnë rreth 13.4 për qind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë vitit 2011, krahasuar me planin vjetor, rezultojnë me një kursim prej rreth 5.7 miliardë lekë, kursim ky i evidentuar në interesat e brendshme me rreth 4.4 miliardë lekë dhe në interesat e jashtme, me rreth 1.3 miliardë lekë. Në këtë mënyrë shpenzimet për interesa arritën në rreth 3.1 për qind e PBB-së nga rreth 3.4 për qind që ishin një vit më parë.



Kundrejt vitit të kaluar, shpenzimet për interesa rezultojnë rreth 489 milionë lekë më të ulëta ose rreth 1.2 për qind me pak, rrjedhojë kjo e interesave të brendshme të cilat rezultojnë rreth 1.3 miliardë lekë më të ulëta se një vit më parë dhe e interesave të jashtme që janë rreth 0.8 miliardë lekë më të larta.



Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, gjatë vitit 2011 arritën në rreth 33.0 miliardë lekë duke qenë rreth 1.3 miliardë lekë më pak se një vit më parë ose rreth 3.9 për qind më të ulëta. Këto shpenzime në fund të vitit 2011 arritën në rreth 2.5 për qind të PBB-së, nga rreth 2.8 për qind që ishin një vit më parë.



Shpenzimet për subvencione, në fund të vitit 2011, arritën në rreth 3.3 miliardë lekë, duke qenë rreth 234 milionë lekë më pak ose 6.6 për qind më të ulëta krahasuar me një vit më parë. Siç është përmendur edhe më sipër, rreth 1.52 miliardë lekë janë përdorur nga fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit, për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, te njësitë e qeverisjes vendore. Subvencionet në vitin 2011 arritën në rreth 0.25 për qind të PBB-së, nga rreth 0.29 për qind që rezultuan një vit më parë.



Shpenzimet për fondet speciale gjatë vitit 2011, rezultojnë rreth 97.3 për qind të planit vjetor me ndryshime, ose rreth 7.2 për qind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet për sigurimet shoqërore, krahasuar me vitin e kaluar rezultojnë rreth 5.9 miliardë lekë më të larta ose rreth 7.5 për qind më shumë, ndërsa shpenzimet për sigurimet shëndetësore rezultojnë rreth 1.8 miliardë lekë më të larta ose rreth 7.3 për qind më të larta.



Deri në fund të vitit 2011, rreth 1.66 miliardë lekë, ose rreth 97.4 për qind e planit vjetor, janë përdorur për kompensimin në vlerë të pronarëve.

Shpenzimet për buxhetin lokal kane arritur në rreth 28.1 miliardë lekë duke rezultuar rreth 2.6 miliardë lekë më të ulëta se një vit më parë ose rreth 8.6 për qind më pak. Këto shpenzime arritën në rreth 2.1 për qind të PBB-së nga rreth 2.5 për qind që rezultuan vitin e kaluar.



Pagesa e papunësisë rezulton me një realizim prej rreth 83.4 për qind ose rreth 174 milionë lekë më pak se parashikimi vjetor, duke qenë në të njëjtën kohë rreth 106 milionë lekë më pak ose rreth 10.8 për qind më pak se një vit më parë.

Ndihma ekonomike gjatë vitit 2011 arriti në rreth 16.6 miliardë lekë, duke qenë në të njëjtën kohë rreth 147 milionë lekë më pak ose rreth 0.9 për qind më e ulët se një vit më parë.



Rreth 1.5 miliardë lekë janë përdorur për kompensimin e ish-të përndjekurve politike, me një diferencë prej rreth 300 milionë lekë kundrejt parashikimit vjetor.

Shpenzimet kapitale në fund të vitit 2011 janë realizuar në nivelin 93.9 për qind të planit vjetor me ndryshime, duke rezultuar me një mosrealizim prej rreth 4.5 miliardë lekë. Për rrjedhojë investimet në vitin 2011 arritën në rreth 5.3 për qind e PBB-së nga rreth 5.5 për qind që rezultuan një vit më parë.



Krahasuar me vitin e kaluar, investimet me financim të brendshëm rezultojnë rreth 5.5 miliardë lekë më të ulëta ose rreth 11.9 për qind më pak, ndërkohë që investimet me financim të huaj rezultojnë rreth 7.2 miliardë lekë më të larta ose rreth 34.4 për qind më të larta. Për rrjedhojë investimet në total

rezultojnë rreth 5.5 miliardë lekë më pak ose rreth 11.9 për qind më të ulëta kundrejt vitit 2010. Struktura e investimeve faktike të vitit 2011 ishte rreth 58.8 për qind investime të brendshme dhe rreth 40.1 për qind investime të huaja (diferenca prej rreth 1.1 për qind përfaqëson shpenzimet faktike për shpronësimet).



2.1.1 Strategjia e politikave dhe objektivat afatmesme

Politikat tatimore dhe parashikimi i të ardhurave tatimore për periudhën afatmesme

Projekt Kodi i Ri Doganor i cili po hartohet në përputhje të plotë me rregulloren 450/2008 të Bashkimit Europian ka si qëllim kryesor lehtësimin e biznesit, garantimin e një niveli të lartë të sigurisë dhe mbrojtjes për t'ju përgjigjur në këtë mënyrë sfidave me të cilat do të përballet Shqipëria me realitetin ekonomik të Bashkimit Europian. Projektlegjislacioni doganor synon modernizimin dhe thjeshtëzimin e rregullave doganore përmes një mjedisi doganor pa letër si për autoritetin doganor ashtu edhe për operatorin ekonomik, përdorimin e mjeteve dhe teknologjisë moderne të kompjuterizimit, të cilat të gjitha këto përbëjnë bazën për një procedurë zhdoganimi të thjeshtë dhe efiçente. Kodi i ri Doganor bazuar veçanërisht në sisteme kompjuterike të integruara ofron:

- thjeshtimin e rregullave doganore;
- përmirësimin e kontrolleve doganore, të cilat parësisht kryhen bazuar në një analizë risku si pjesë e kornizës së menaxhimit të riskut;
- lehtësimin e procedurave të zhdoganimit, të cilat do të jenë plotësisht të kompjuterizuara dhe do të ofrojnë maksimumin e thjeshtëzimeve;
- efikasitet në zbatimin e procedurave doganore të cilat janë riorganizuar në "procedura speciale" duke mundësuar një ristrukturim të transitit (kombëtar dhe të jashtëm), magazinimit (magazinimi i përkohshëm, magazinimi doganor, zonat e lira), përdorimit të veçantë (pranimi i përkohshëm dhe *end-use*) dhe përpunimit (përpunimi aktiv dhe pasiv).

Gjatë vitit 2012, Ministria e Financave është në përputhje me programin e Qeverisë Shqiptare për formalizimin e ekonomisë, luftën ndaj evazionit fiskal dhe kontrabandës, përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorit, do të fokusohet në dhënien me koncesion të dy shërbimeve të rëndësishme publike në dy sektorë strategjikë për mbledhjen e të ardhurave:

1. dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në RSH;
2. dhënien me koncesion e shërbimit të skanimit të kontejnerëve dhe automjeteve të tjera;

Dhënia me koncesion e shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në RSH synon të sigurojë dhe garantojë pagesën e taksave dhe tatimeve të parashikuara nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë për tregtimin e karburanteve në territorin shqiptar nëpërmjet kontrollit të tregut të karburanteve (akcizë, t.v.sh. taksë karboni).

Ky kontroll bëhet i mundur pikërisht me anë të sistemit të markimit të karburanteve ofruar nga shoqëria propozuese, i cili vërteton jo vetëm nëse përbërja e karburanteve ka ndryshuar pas pagesës së taksave, por edhe nëse karburanti në qarkullim është i shënjuar, pra ka paguar taksën, apo është karburant i pa shënjuar, pra i futur kontrabandë në tregun shqiptar.

Dhënia me koncesion e shërbimit të skanimit të kontejnerëve dhe automjeteve të tjera ka për objekt projektimin, financimin, zbatimin dhe administrimin e shërbimit të kontrollit të kontejnerëve të destinuar për import, eksport apo që janë në regjim transitor, në gjithë territorin e Republikës së

Shqipërisë. Ky kontroll propozohet të realizohet nëpërmjet instalimit dhe përdorimit të disa pajisjeve "skaner" të një teknologjie të lartë inspektimi, e cila bën të mundur kontrollin e automjeteve pa qenë nevoja për të ndërhyrë fizikisht.

Ky projekt ndër të tjera synon të sigurojë dhe të garantojë një mjet mbështetjeje të plotë për sistemin doganor dhe sistemin kufitar shqiptar nëpërmjet aplikimit të metodave bashkëkohore duke mundësuar: zbulimin e evazionit të të ardhurave, duke përfshirë keqdeklarimin e tarifave; zbulimin e mallrave dhe produkteve kontrabandë; zbulimin e mallrave dhe produkteve narkotike; lëvizjen e paligjshme të armëve dhe municioneve dhe në mënyrë të veçantë zbulimin e evazionit për mallrat e akcisëz (duhani, alkooli, vajrat, karburantet, etj.).

Në kuadër të asistencës së FMN-së ka përfunduar: drafti i Planit të ri Strategjik të DPT-së 2012-2015 dhe drafti i Strategjisë së Përputhshmërisë 2012-2015, të cilat priten të miratohen nga administrata tatimore. Kjo strategji përfshin 5 elemente kyçe të administrimit tatimor: borxhi tatimor, regjistri i tatimpaguesve; procedurat e riskut; rimbursimi i t.v.sh.-së dhe teprica kreditore.

Bazuar në buxhetin e miratuar për vitin 2012, si dhe kuadrin makroekonomik e fiskal të miratuar për periudhën 2013-2015 dhe politikat tatimore për tre vitet në vijim, të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar për tre vitet 2012-2014 në vlerë janë parashikuar përkatësisht në nivelet 355.7 miliardë lekë për vitin 2012; 377.4 miliardë lekë për vitin 2013 dhe 403 miliardë lekë për vitin 2014, me një rritje vjetore prej respektivisht 8%, 6.1% dhe 6.8%, ndërsa në raport me PBB-në të ardhurat do jenë respektivisht 25.7% në 2012 dhe 2013 dhe në nivelin prej 25.8% të PBB-së në vitin 2014.

Ecuria e të ardhurave nga tatimet dhe doganat si zëri kryesor i të ardhurave të buxhetit të shtetit, për periudhën 2012-2014 parashikohet që të ketë një rritje vjetore prej 6.4% në vitin 2012; 7.5% në vitin 2013 dhe një rritje prej 6.9% në vitin 2014 kundrejt një viti më parë. Në raport me PBB-në ato parashikohen të jenë në nivelin prej 18.1% të PBB-së në vitin 2012; në nivelin prej 18.3% në vitin 2013 dhe në nivelin prej 18.4% në vitin 2014. Në tabelat e mëposhtme paraqiten projeksionet e të ardhurave të buxhetit të shtetit për periudhën afatmesme në vijim.

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR
ne milion Leke

Nr.	E M E R T I M I	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
					Paraprake	Buxheti	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TE ARDHURAVE	291,238	298,981	324,721	329,271	355,759	377,473	403,046	429,984
I.	Ndihmat	4,228	4,430	4,605	2,613	9,843	10,250	11,200	11,500
II.	Te ardhura tatimore	264,421	270,830	288,564	303,926	324,739	349,104	374,311	401,975
II.1	*Nga Tatimet dhe Doganat*	205,292	208,870	223,019	235,509	250,602	269,316	287,809	308,215
1	*Tatimi mbi Vleren e Shtuar*	107,094	110,062	113,998	119,189	126,873	136,232	145,494	155,705
2	*Tatmi mbi Fitimin*	18,108	17,149	17,606	19,712	21,980	23,531	25,062	26,795
3	*Akcizat*	32,510	33,504	38,788	40,403	42,652	45,893	48,975	52,457
4	*Tatimi mbi te Ardhurat Personale*	24,498	26,820	27,058	27,967	29,754	31,883	33,926	36,442
5	*Taksa Nacionale dhe te tjera*	14,423	13,405	18,295	21,388	22,598	24,630	26,789	28,788
6	*Taksa Doganore*	8,660	7,929	7,274	6,850	6,745	7,147	7,563	8,027
II.2	*Te ardhura nga Pushteti Lokal*	11,307	12,149	11,898	11,790	14,624	17,014	19,890	22,536
1	*Taksa lokale*	7,137	8,154	7,684	7,279	9,409	11,197	13,380	15,227
2	*Tatimi mbi Pasurine(ndertesat)*	1,586	1,509	1,896	1,941	2,132	2,480	2,901	3,397
3	*Tatimi mbi Biznesin e vogel*	2,584	2,486	2,318	2,570	3,083	3,337	3,608	3,912
II.3	*Te ardhura nga fondet speciale*	47,822	49,812	53,647	56,627	59,513	62,774	66,612	71,225
1	*Sigurimi Shoqeror*	42,547	44,344	45,041	48,839	51,577	54,803	58,287	62,493
2	*Sigurimi Shendetsor*	5,275	5,467	6,432	6,152	6,436	6,871	7,325	7,832
3	*Te ardhurat per kompensimin ne vlere te pronareve*	0	0	2,174	1,636	1,500	1,100	1,000	900
III.	Te ardhura jotatimore	22,588	23,720	31,552	22,732	21,177	18,119	17,535	16,508
1	*Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise*	5,700	6,241	4,936	5,710	4,500	4,500	4,500	4,600
2	*Te ardhura nga Inst.Buxhetore*	8,919	9,338	13,994	10,333	12,977	11,919	11,635	10,508
3	*Dividenti*	6,402	374	735	1,060	700	500	300	300
4	*Tarifat sherbimeve*	0	4,183	2,977	3,513	2,500	1,000	1,000	1,000
5	*Te tjera*	1,567	3,584	8,910	2,116	500	200	100	100

Burimi: Ministria e Financave

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR
ne % te Produktit te Brendshem Bruto

Nr.	E M E R T I M I	2008	2009	2010	2011 Paraprake	2012 Buxheti	2013 PBA	2014 PBA	2015 PBA
	TOTALI TE ARDHURAVE	26.7	26.0	26.2	25.0	25.7	25.7	25.8	25.9
I.	Ndihmat	0.4	0.4	0.4	0.2	0.7	0.7	0.7	0.7
II.	Te ardhura tatimore	24.3	23.5	23.3	23.1	23.4	23.7	24.0	24.2
II.1	*Nga Tatimet dhe Doganat*	18.8	18.1	18.0	17.9	18.1	18.3	18.4	18.5
1	*Tatimi mbi Vleren e Shtuar*	9.8	9.6	9.2	9.1	9.2	9.3	9.3	9.4
2	*Tatmi mbi Fitimin*	1.7	1.5	1.4	1.5	1.6	1.6	1.6	1.6
3	*Akcizat*	3.0	2.9	3.1	3.1	3.1	3.1	3.1	3.2
4	*Tatimi mbi te Ardhurat Personale*	2.2	2.3	2.2	2.1	2.1	2.2	2.2	2.2
5	*Taksa Nacionale dhe te tjera*	1.3	1.2	1.5	1.6	1.6	1.7	1.7	1.7
6	*Taksa Doganore*	0.8	0.7	0.6	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5
II.2	*Te ardhura nga Pushteti Lokal*	1.0	1.1	1.0	0.9	1.1	1.2	1.3	1.4
1	*Taksa lokale*	0.7	0.7	0.6	0.6	0.7	0.8	0.9	0.9
2	*Tatimi mbi Pasurine(ndertesat)*	0.1	0.1	0.2	0.1	0.2	0.2	0.2	0.2
3	*Tatimi mbi Biznesin e vogel*	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
II.3	*Te ardhura nga fondet speciale*	4.4	4.3	4.3	4.3	4.3	4.3	4.3	4.3
1	*Sigurimi Shoqeror*	3.9	3.9	3.6	3.7	3.7	3.7	3.7	3.8
2	*Sigurimi Shendetsor*	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5
3	*Te ardhurat per kompensimin ne vlere te pronareve*	0.0	0.0	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
III.	Te ardhura jotatimore	2.1	2.1	2.5	1.7	1.5	1.2	1.1	1.0
1	*Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise*	0.5	0.5	0.4	0.4	0.3	0.3	0.3	0.3
2	*Te ardhura nga Inst.Buxhetore*	0.8	0.8	1.1	0.8	0.9	0.8	0.7	0.6
3	*Dividenti*	0.6	0.0	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0
4	*Tarifat sherbimeve*	0.0	0.4	0.2	0.3	0.2	0.1	0.1	0.1
5	*Te tjera*	0.1	0.3	0.7	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0
	PBB nominal	1,089,293	1,151,020	1,238,094	1,314,702	1,384,971	1,471,598	1,561,486	1,661,666

Burimi: Ministria e Financave

Parashikimi i shpenzimeve buxhetore

Planifikimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2012 është mbështetur në procedurat e buxhetimit bazuar në objektivat politikë dhe produktet gjatë përgatitjes së PBA-së 2012-2014. Bazuar në ligjin e buxhetit, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të shtetit për vitin 2012 parashikohen në nivelin e 396.9 miliardë lekë ose 28.6% të PBB-së, duke regjistruar një rritje prej rreth 6.3% të krahasuar me buxhetin e pritshëm faktik të vitit 2011. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore do të synojnë arritjen e:

- rritjes së diferencuar të pagave për sektorët prioritarë;
- rritja e nivelit të përfitimeve të pensionistëve me mesatarisht 4%, dhe
- ruajtjes së nivelit të shpenzimeve kapitale në 5% të PBB-së.

Shpenzimet për personelin

Shpenzimet e personelit për vitin 2012, u bazuan në një politikë që synon rritjen e efiçencës dhe efektivitetit të burimeve njerëzore. Këto shpenzime parashikohen të ulen në terma realë dhe të jenë rreth 5.1% e PBB-së në faktin e pritshëm 2011, si dhe në buxhetin e vitit 2012. Më konkretisht, kjo ulje ka ardhur si pasojë e reformave që parashikohen të kryhen në disa sektorë si: reduktimi i numrit të efektivëve ushtarakë të Ministrisë së Mbrojtjes, të cilat ulin në këtë mënyrë numrin e përgjithshëm të punonjësve buxhetorë për vitin 2012 në 88.640 punonjës nga 89.560 punonjës në vitin 2011. Gjithashtu, fondi i pagave është përllogaritur duke mbajtur në konsideratë rritjen e përgjithshme të pagave duke filluar nga data 15 korrik 2011, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 463, datë 16.6.2011 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në disa institucione shtetërorë" të ndryshuar", si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 472, datë 2.7.2010 "Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore" i ndryshuar". Politika e rritjes së pagave do të vazhdojë edhe për vitin 2012 dhe do të konsistojë në një politikë të kujdesshme indeksimi dhe rritjeje selektive për sektorët prioritarë. Gjithashtu, këtë vit në përllogaritjen e shpenzimeve për paga është identifikuar si një zë më vete fondi i veçantë i cili gjatë vitit 2012 do të përdoret vetëm pas miratimit të Ministrit të Financave në përputhje me performancën e të ardhurave sipas rasteve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar.

Shpenzimet për interesat

Parashikimi për shpenzimet e interesave është bazuar në fluksin e huamarrjes së brendshme dhe të huaj, si dhe në nivelin e parashikuar të normës së interesit në kushtet e një situate makroekonomike të

qëndrueshme. Për pasojë, krahasuar me buxhetin e pritshëm faktik të vitit 2011, edhe në vitin 2012 shpenzimet për këtë zë parashikohen të qëndrojnë në nivelet rreth 3.6% të PBB-së.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për vitin 2012 parashikohen të kapin nivelin 29.06 miliardë lekë. Ky fond, në vijimësi edhe të viteve të kaluara, do të vazhdojë të orientohet kryesisht në rritjen e shpenzimeve të funksionimit dhe mirëmbajtjes së sektorëve prioritarë të infrastrukturës, arsimit, shëndetësisë dhe bujqësisë, duke aplikuar një normë të diferencuar rritjeje në favor të këtyre sektorëve prioritarë. Duke synuar rritjen e efiçencës dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve publike, që prej vitit 2009 zëri i shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes, reflekton edhe ndryshimet e rëndësishme strukturore të buxhetit qendror lidhur me zbatimin e reformave respektive në sektorët prioritarë të Arsimit dhe Shëndetësisë, përkatësisht në arsimin universitar dhe shërbimet e kujdesit dytësor (spitalor).

Shpenzimet për subvencionet

Shpenzimet për subvencione janë parashikuar duke u bazuar në politikën ekzistuese të subvencioneve dhe në politikat për reduktimin e tyre të mëtejshëm. Në përputhje dhe me rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare për një ulje të subvencioneve, të gjitha institucioneve iu është kërkuar të ndërmarrin reforma në menaxhimin më të mirë të sektorit dhe përmirësimin e performancës financiare të tyre. Ato parashikohen që edhe për vitin 2012 të ruajnë nivelin 0.1% të PBB-së.

Shpenzimet për buxhetin lokal

Shpenzimet për buxhetin lokal të vitit 2012 parashikohen të jenë në nivelin e 29.5 miliardë lekë ose 2.1% të PBB-së ose 4.9% më të lartë se buxheti i pritshëm faktik i vitit 2011.

Shpenzimet për pagesën e papunësisë dhe ndihmën ekonomike

Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë parashikohen të rriten nga 17.2 miliardë lekë në buxhetin e pritshëm faktik të vitit 2011 në 18.05 miliardë lekë në 2012. Këtu do të mbahet parasysh politika për një rritje të diferencuar midis zërave përbërës të këtyre shpenzimeve. Ndërkohë që ndihma ekonomike, si rezultat i përmirësimeve ligjore dhe administrative do të vijë duke u ulur (në terma relative), pjesa më e madhe e rritjes do të shkojë për pagesën e paaftësisë, si rezultat i indeksimit të saj, rritjes së numrit të përfituesve dhe përmirësimit të procedurave të përfitimit të një statusi të tillë.

Fondi rezervë dhe kontingjencës

Niveli i fondit rezervë të Këshillit të Ministrave dhe kontigjencës për ruajtjen e deficitit për vitin 2012 parashikohet të jetë në masën 4.7 miliardë lekë, përkatësisht 2 miliardë fond rezervë i Këshillit të Ministrave dhe 2.7 miliardë lekë fond kontigjencë për ruajtjen e deficitit. Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave ka pësuar një reduktim në masën 914 milionë lekë krahasuar me buxhetin e rishikuar 2011.

Shpenzimet kapitale

Shpenzimet kapitale për vitin 2012 parashikohen në masën 69.8 miliardë lekë, pra rrjedhimisht, ato parashikohen të arrijnë nivelin 5% të PBB-së. Në prioritizimin e listës së investimeve do të vazhdojnë të përzgjidhen ato të cilat janë vazhdim i projekteve të mëparshme, si edhe investimet që cilësohen strategjike për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, në përputhje edhe me programin e qeverisë. Njëkohësisht, shpenzimet kapitale si me financim të brendshëm ashtu edhe të huaj do të vazhdojnë të përqendrohen në sektorët prioritarë të qeverisë si: infrastruktura, arsimi, shëndetësia, mbrojtja, bujqësia e zhvillimi rural. Me konkretisht, investimet me burime të brendshme parashikohet të jenë 2% të PBB-së. Ndërsa, investimet me burime të huaja parashikohen në nivelin e 3% të PBB-së, nga 1.9% e PBB-së në buxhetin e pritshëm faktik të vitit 2011.

Vlerësimi i deficitit buxhetor

Për vitin 2012, deficiti buxhetor do të mbahet në nivelin prej 3% të PBB-së. Financimi i tij i brendshëm është parashikuar në nivelin 1.4% të PBB-së, ndërsa financimi i huaj do të arrijë nivelin prej 1.6% të PBB-së.

Parashikimi afatmesëm (2013-2015)

Në fund të vitit 2015, shpenzimet e përgjithshme buxhetore parashikohen të arrijnë mesatarisht 28.3% të PBB-së. Burimet do të përdoren kryesisht për:

- uljen e deficitit buxhetor deri në 2.5% të PBB-së;
- rritjen e pagave dhe pensioneve; dhe
- ruajtjen e një niveli investimesh publike në një nivel mesatar prej 4.6% të PBB-së.

Shpenzimet për personelin

Shpenzimet për personelin për periudhën 2013-2015 parashikohen të jenë në përputhje me politikat e rritjes së diferencuar të pagave në sektorët prioritarë. Kështu, në vitin 2013 ato parashikohen të jenë 5% e PBB-së, në vitin 2014 parashikohen të jenë në nivelin 4.9% të PBB-së dhe në vitin 2015 në nivelin 4.8% të PBB-së.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për periudhën 2013–2015 parashikohen të mbahen në nivelin rreth 2% të PBB-së, duke reflektuar politikën e qeverisë në këtë aspekt. Ato do të orientohen drejt rritjes së shpenzimeve për funksionimin dhe mirëmbajtjen, duke synuar uljen në maksimum të shpenzimeve të pastra administrative, në përputhje me rekomandimet.

Shpenzimet për subvencionet

Shpenzimet për subvencionet janë parashikuar bazuar në politikën ekzistuese të subvencioneve dhe mbi politikat e uljes së tyre të mëtejshme. Në mbështetje të rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare për një ulje të subvencioneve, të gjitha institucioneve u është kërkuar të ndërmarrin reforma për një menaxhim më të mirë të sektorëve përkatës dhe të përmirësimit të performancës së tyre financiare. Në periudhën 2013-2015, ato parashikohen të jenë në nivelin 0.1% të PBB-së.

Shpenzimet për pagesën e papunësisë dhe ndihmën ekonomike

Për periudhën 2013–2015, shpenzimet për pagesën e papunësisë dhe ndihmën ekonomike parashikohen të jenë rreth 1.25% të PBB-së çdo vit. Ndërkohë, për shkak të përmirësimeve ligjore dhe administrative, ndihma ekonomike do të ulet (në terma relativë). Madhësia e rritjes do të shkojë drejt pagesës së paaftësisë, si pasojë e indeksimit, rritjes së numrit të përfituesve dhe përmirësimit të procedurave të marrjes së këtij statusi.

Fondi i rezervës dhe kontigjencës

Niveli i fondit rezerve të Këshillit të Ministrave dhe kontigjencës për ruajtjen e deficitit për vitin 2013 parashikohet të jetë në masën 8 miliardë lekë, duke u rritur më tej në 12.5 miliardë lekë në vitin 2014 dhe 16 miliardë lekë në vitin 2015, ku pjesën më të madhe e zë kontigjenca për ruajtjen e deficitit.

Shpenzimet për interesat

Parashikimi i shpenzimeve të interesave është bazuar në strategjinë e borxhit të Ministrisë së Financave dhe nivelet e parashikuara për financimin e brendshëm dhe të huaj për të. Për vitin 2013-2015, këto shpenzime parashikohen të jenë në masën 3.6% të PBB-së.

Shpenzimet për buxhetin lokal

Shpenzimet për buxhetin lokal për periudhën 2013-2015 do të rriten nga 2.2% e PBB-së në vitin 2013 në nivelin prej 2.4% të PBB-së në vitin 2015.

Shpenzimet kapitale

Shpenzimet kapitale për vitin 2013 parashikohen të jenë në nivelin 4.9% të PBB-së. Në prioritizimin e listës së investimeve do të vazhdojnë të përzgjidhen ato të cilat janë vazhdim i projekteve të mëparshme, si edhe investimet që cilësohen strategjike për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, në përputhje edhe me programin e qeverisë. Në vitin 2015 këto shpenzime parashikohen të arrijnë nivelin 4.6% të PBB-së.

2.1.2 Niveli i borxhit dhe zhvillimet e tij

Strategjia e borxhit publik dhe menaxhimi i tij 2012-2014

1. Menaxhimi i borxhit dhe parashikimi i treguesve të pritshëm gjatë vitit 2011

Borxhi publik i Qeverisë qendrore në fund të vitit 2011 vlerësohet të jetë 774,547 milionë ALL ose 58.9% e PBB-së. Ky borxh përbëhet nga borxhi i brendshëm i cili vlerësohet të jetë 33.36% e PBB-së dhe nga borxhi i jashtëm 25.54 % e PBB-së.

Borxhi i brendshëm në raport me PBB është rritur me 27 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2010 ndërsa borxhi i jashtëm rezulton të ketë një rritje prej 52 pikë përqindje në raport me PBB. Në total stoku i borxhit është rritur me 79 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2010, nga 58.11 % në 58.90% të PBB.

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Borxhit publik është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikës së emetimit të letrave me vlerë dhe financimin e huaj, si dhe për menaxhimin e borxhit të Qeverisjes Qendrore në Shqipëri.

Strategjia e borxhit publik për periudhën 2012-2014 synon të japë një orientim në lidhje me politikën e Ministrisë së Financave për menaxhimin e borxhit publik për këtë hark kohor.

Bazuar në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", objektivi kryesor i menaxhimit të borxhit është sigurimi i fondeve të nevojshme të huamarrjes, duke vlerësuar riskun dhe koston e tij, në këndvështrimin afatmesëm e afatgjatë, si dhe zhvillimin e tregut të titujve të shtetit, nëpërmjet shtimit të instrumenteve të tij dhe zgjerimit të bazës së investitorëve.

Politika e emetimeve është pjesë e programit afatmesëm buxhetor 2012-2015. Kjo strategji synon mbajtjen e shpenzimeve për interesa në nivel sa më ulët në përputhje me kushtet e tregjeve financiare, si dhe synon të mbajë në kontroll risqet e portofolit të borxhit publik. Në kushtet e situatës së trazuar në Eurozonë si pasojë e krizës së borxheve sovrane, menaxhimi i borxhit publik, si dhe mbajtja e tij në limite do të jetë një sfidë madhore për vitin 2012.

2. Historiku dhe zhvillimi i borxhit të qeverisjes qendrore gjatë vitit 2011.

*në milionë lekë	2008	2009	2010	9/m 2011	P 2011
Stoku i borxhit, gjithsej	595,786	682,404	715,328	767,876	774,548
Stoku i borxhit të brendshëm	400,456	415,028	407,372	437,652	438,727
Stoku i borxhit të jashtëm	195,330	267,376	307,956	330,224	335,821
GDP	1,089,293	1,151,020	1,238,094	1,314,702	1,314,702
Stoku i borxhit gjithsej/GDP	54.69%	59.29%	58.11%	58.20%	58.90%
Stoku i borxhit të brendshëm/GDP	36.76%	36.06%	33.09%	33.17%	33.36%
Stoku i borxhit të jashtëm/GDP	17.93%	23.23%	25.02%	25.03%	25.54%

Në fund të vitit 2011 raporti i stokut të borxhit ndaj PBB-së vlerësohet të jetë rreth 58.9% nga i cili 33.36% është stoku i borxhit të brendshëm dhe 25.54% është stoku i borxhit të jashtëm. Raporti i stokut të borxhit të brendshëm dhe të jashtëm ndaj PBB-së kanë pësuar të dy rritjet respektive me 0,27% ndaj PBB-së dhe 0,52% ndaj PBB-së dhe këto të dhëna përfaqësojnë stokun e borxhit shtetëror se bashku me garancitë.

Faktorët që ndikojnë në shtesën e borxhit do të analizohen më në detajim në seksionin e mposhtëm. Theksojmë se vlerësimet më poshtë i përkasin borxhit shtetëror dhe është nxjerrë më vete borxhi i garantuar.

Ndërkohë vlen të theksohet mbajtja e kontrolluar e nivelit të borxhit gjatë vitit 2011, duke ruajtur kufijtë e financimit të deficitit në përputhje me kuadrin makroekonomik dhe synimet e tij.

i) Faktorët që ndikojnë në shtesën e borxhit

Në këtë paragraf janë ilustruar faktorët që ndikojnë në shtesën e borxhit.

Përbërja e stokut të borxhit publik	2008		2009		2010		2011	
Borxh i brendshëm gjithsej, nga i cili:	395,504	36.31%	409,501	35.58%	401,821	32.45%	429,927	32.70%
B brendshëm instrumente	371,964	34.15%	390,631	33.94%	401,821	32.45%	429,927	32.70%
Rivlerësim i valutës	23,540	2.16%	18,870	1.64%	0	0.00%	0	0.00%
Borxh i jashtëm	163,735	15.03%	227,128	19.73%	268,081	21.65%	296,059	22.52%
Nga i cili riskedulime	8,759	0.80%	12,270	1.07%	11,549	0.93%	11,665	0.89%
Ndikimi i disbursimeve	161,065	14.79%	203,804	17.71%	266,517	21.53%	295,718	22.21%
Ndikimi i kursit të këmbimit	2,670	0.25%	23,324	2.03%	1,565	0.13%	4069	0.31%
Garanci	36,547	3.36%	45,774	3.98%	45,425	3.67%	48,561	3.69%
Stoku gjithsej	595,786	54.69%	682,403	59.29%	715,327	57.78%	774,547	58.91%

Në tabelën e mësipërme është paraqitur kompozimi i portofolit të borxhit, fillimisht i ndarë në tre grupet kryesore: borxh i brendshëm, borxh i jashtëm dhe borxhi i garantuar. Më tej është vijuar me ndarjen e secilit portofol sipas përbërësve.

Borxhi i brendshëm ndahet në borxhin me instrumente dhe zërin e rivlerësimit të valutës. Vërejmë që duke filluar nga viti 2010, zëri i rivlerësimit të valutës është bërë zero për arsye të zhvlerësimit të kursit të ALL kundrejt valutave të huaja. Borxhi i brendshëm shtetëror ka një tendencë rënëse gjatë viteve 2010-2011 duke mbetur në nivelet rreth 32.7% e PBB-së gjatë kësaj periudhe.

Stoku i borxhit të jashtëm paraqet një trend në rritje duke filluar që nga viti 2009. Në fund të 2011-s vlerësohet të jetë 22.52% e PBB-së.

Faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në portofolin e borxhit të jashtëm janë disbursimet, riskedulimet, si dhe shtesa që vjen nga efekti i kursit të këmbimit të ALL kundrejt monedhave përbërëse të portofolit. Zëri i disbursimeve paraqet një trend të përshpejtuar në rritje duke filluar që nga viti 2008. Nga 14.79% e PBB që ky zë përfaqëson në fund të 2008 kemi mbërritur në nivelin rreth 22.49 % e PBB në fund të 2011.

Efekti i kursit të këmbimit është një zë tjetër shumë i rëndësishëm në përbërjen e portofolit të stokut të borxhit të jashtëm. Ky fakt vërtetohet dhe në tabelë, ku evidentojmë që në vitin 2009 ky efekt ka qenë rreth 2.03% e PBB-së. Në vitet në vijim është stabilizuar në 0.13% në 2010 dhe rreth 0.31% e PBB-së për 2011.

	2008		2009		2010		2011	
Borxh i brendshëm total	25,968	2.38%	13,997	1.22%	-7,680	-0.62%	28,106	2.14%
Borxh i brendshëm instrumente	17,933	1.65%	18,667	1.62%	11,190	0.91%	28,106	2.14%
Rivlerësim i valutës	8,035	0.74%	-4,670	-0.41%	-18,870	-1.53%	0	0.00%
Borxh i jashtëm, nga i cili:	43,751	4.02%	63,393	5.51%	40,953	3.33%	27,978	2.13%
Riskedulime	-488	-0.04%	3,511	0.31%	-721	-0.06%	116	-0.01%
Faktori disbursime	41,081	3.77%	40,069	3.48%	39,389	3.20%	27,638	1.82%
Fakt kurs këmbimi	2,670	0.25%	23,324	2.03%	1,565	0.13%	4069	0.31%
Garanci total	9,145	0.84%	9,227	0.80%	-349	-0.03%	3,136	0.24%
Shtesa gjithsej	78,864	7.24%	86,617	7.53%	32,924	2.67%	59,220	4.50%
GDP	1,089,293		1,151,020		1,238,094		1,314,702	
Ndikimi i shtesës së borxhit		7.24%		7.53%		2.66%		4.50%
Ndikimi GDP		5.96%		2.93%		4.17%		3.37%
Ndikimi i të dy faktorëve		1.28%		4.59%		-1.51%		1.13%

Në tabelën e dytë është ilustruar shtesa e faktorëve të analizuar më sipër duke filluar që nga viti 2008. Gjithashtu është analizuar efekti që vjen nga shtesa e borxhit në stok, si dhe efekti që rrjedh nga rritja ekonomike.

Shtesa në stokun e borxhit të brendshëm për fundin e 2011-s përllogaritet në 2.14% e PBB-së i cili është i përbërë vetëm nga borxhi me instrumente, ndërkohë që është eliminuar zëri i rivlerësimit të valutës.

Shtesa në stokun e borxhit të jashtëm vjen në pjesën më të madhe nga ecuria e disbursimeve. Në fund të këtij viti shtesa që vjen nga disbursimet vlerësohet të jetë rreth 1.82% e PBB-së.

Shtesa që vjen nga riskedulimet në përgjithësi përveç vitit 2009, ka qenë në nivele të ulëta, si dhe ka pasur dhe vlera negative gjatë 2008-s dhe 2010-s. Efekti më i lartë i tyre ka qenë në vitin 2009 ku shtesa ishte në vlerën 0.31% e PBB-së.

Shtesa në stokun e borxhit përllogaritet të jetë rreth 4.50% e PBB për fundin e këtij viti. Ndërkohë që rritja ekonomike luan efekt në drejtim të uljes së shtesës neto totale me 3,37%. Ndikimi total i dy faktorëve rezulton në shtesën vjetore në stokun e borxhit publik të raportuara në tabelat historike të stokut të borxhit ndaj PBB-së dhe në fund të vitit 2011 vlerësohet të jetë rreth 1.13% e PBB-së.

ii) Situata makroekonomike

Duke filluar në vitet 2010 e në vijim, në Europë po asistojmë në krizën e borxheve sovrane. Situata komplikohet edhe me tej kur vendet fqinje, si Italia dhe Greqia ndodhen mes vendeve që po vuajnë krizën e qëndrueshmërisë së borxheve. Ekonomia e vendit është e lidhur ngushtësisht me to jo vetëm nga pikëpamja ekonomike por edhe sociale. Efektet e kësaj krize mbeten ende për t'u vlerësuar,

por gjithsesi mbetet fakt që ato do të influencojnë ekonominë shqiptare në drejtim të eksporteve, rritjes ekonomike, si dhe ecurisë së remitancave.

Efekte do të ketë në ecurinë e të ardhurave, si dhe në politiken shtrënguese të shpenzimeve nga ana e Qeverisë. Buxheti i vitit 2012 është konservativ dhe ka marrë parasysh një sërë risqesh që mund të godasin ekonominë. Limitet e deficitit janë vendosur në përputhje me këtë situatë, si dhe është pozitiv fakti që buxheti është parashikuar të realizojë suficit primar.

Faktorë të rëndësishëm që mund të ndikojnë në politikën dhe ecurinë e huamarrjes do të jenë situata e likuiditetit në tregun e brendshëm dhe sjellja e bankave në këtë drejtim. Roli i Bankës së Shqipërisë në modifikimin e kuadrit rregullator në drejtim të mbikëqyrjes së sistemit bankar është i rëndësishëm pasi modifikon sjelljen e bankave në lidhje me investimet në letra me vlerë të Qeverisë.

Faktorët e mësipërm do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në ecurinë e huamarrjes në tregun vendas, ecurinë e normave të interesit, si dhe në drejtim të realizimit të planit të financimit të deficitit për vitin 2012.

iii) Analiza e borxhit të brendshëm

Stoku i borxhit të brendshëm zë një përqindje të konsiderueshme në totalin e portofolit të borxhit. Instrumentet afatshkurtra në fund të shtatorit 2011 përbëjnë rreth 55.40 % të totalit të portofolit të borxhit të brendshëm. Instrumentet afatgjata rezultojnë në 43.31% të portofolit.

	31.12.2008		31.12.2009		30.12.2010		30.09.2011	
	Çmim blerje	%	Çmim blerje	%	Çmim blerje	%	Çmim blerje	%
Stoku i borxhit	400,456		415,028		407,372		437,653	
I. Borxhi shtetëror	395,504	98.76%	409,501	98.67%	401,821	98.64%	432,015	98.71%
1. Instrumente afatshkurtra	224,224	55.99%	237,469	57.22%	231,436	56.81%	242,451	55.40%
Bono 3/M	25,774	6.44%	22,870	5.51%	11,495	2.82%	11,834	2.70%
Bono 6/M	54,631	13.64%	47,647	11.48%	44,188	10.85%	43,135	9.86%
Bono 9/M		0.00%		0.00%	3,317	0.81%	2,353	0.54%
Bono 12/M	143,819	35.91%	166,952	40.23%	172,436	42.33%	185,129	42.30%
2. Instrumente afatgjata	144,740	36.14%	153,162	36.90%	170,385	41.83%	189,564	43.31%
Oblig.2/Vj	65,730	16.41%	65,247	15.72%	70,957	17.42%	76,300	17.43%
Oblig.3/Vj	21,100	5.27%	15,600	3.76%	15,613	3.83%	19,387	4.43%
Oblig.5/Vj	45,910	11.46%	60,315	14.53%	71,815	17.63%	81,877	18.71%
Oblig.7/Vj	12,000	3.00%	12,000	2.89%	12,000	2.95%	12,000	2.74%
3. Kredi direkte	3,000	0.75%		0.00%		0.00%		0.00%
4. Rivlerësimi i valutës	23,540	5.88%	18,870	4.55%	0	0.00%	0	0.00%
II. Borxhi i garantuar	4,952	1.24%	5,527	1.33%	5,551	1.36%	5,638	1.29%
1. Garanci treg. brend.	4,952	1.24%	5,527	1.33%	5,551	1.36%	5,638	1.29%

Sikurse vërejmë nga tabela, pjesën dërrmuese të instrumenteve afatgjata vazhdojnë ta zënë obligacionet 2 dhe 5-vjeçare. Rritje në përqindje vërehet tek obligacionet 3 dhe 5-vjeçare, përkatësisht me 60 dhe 108 pikë përqindje. Për obligacionet 7-vjeçare nuk ka pasur as maturime dhe as emetime të reja gjatë vitit 2011. Ashtu si viti 2010, pjesa më e madhe e huamarrjes së re gjatë vitit 2011 vazhdon të rezultojë nga obligacionet 2, 3 dhe 5-vjeçare, si dhe në bonot e thesarit 12-mujore.

Nga tabela e mësipërme deri në fund të shtatorit 2011, vërejmë që instrumentet afatshkurtra janë ulur me 1,41% në krahasim me vitin e kaluar, ndërsa afatgjatat kanë pasur një rritje vetëm 1,48% ndaj totalit. Garancitë në tregun e brendshëm kanë mbetur thuajse në të njëjtat nivele. Kjo përbërje tregon përpjekjet për të akomoduar kërkesat për huamarrje në segmente të instrumenteve afatgjata, si dhe punën e kujdesshme në procesin e emetimit të borxhit të ri.

Në stokun e borxhit është eliminuar tërësisht zëri i rivlerësimit të valutës në totalin e borxhit të brendshëm. Kjo për shkak të zhvlerësimit të monedhës vendase ndaj eurosh dhe dollarit, gjë që e bën të panevojshme emetimin e ri për të mbuluar humbjet në rezervën valutore. Deri në fund të shatorit 2011, nuk ka qenë e nevojshme përdorimi i instrumentit të kredisë direkte.

Gjithsesi ka pasur vështirësi në rikompozimin e portofolit të borxhit, si dhe në realizimin e objektivave për uljen e instrumenteve afatshkurtra në drejtim të rritjes së instrumenteve afatgjata. Gjendja e likuiditetit të brendshëm dhe sidomos ndikimi i situatës së trazuar të tregjeve ndërkombëtare financiare, të cilët karakterizohen nga luhatshmëri kritike gjejnë reflektim në strategjinë e bankave të nivelit të dytë drejt investimeve afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe risk të ulët. Dallohet se bankat, si pasojë e

politikave të tyre të brendshme për riskun, kanë kufizuar disi pjesëmarrjen e tyre, veçanërisht në ankandet e obligacioneve.

iv) Mbajtësit e borxhit

Edhe gjatë këtij viti ka vazhduar tendenca pozitive e rritjes së numrit të pjesëmarrësve në tregun primar të letrave me vlerë të Qeverisë, duke sjellë një thellim të diversifikimit të portofolit nga pikëpamja e mbajtësve të tij. Konkretisht, vihet re një tendencë në rritje e peshës së institucioneve jo banka dhe veçanërisht e individëve. Portofoli i Bankës së Shqipërisë ka pësuar ulje duke lënë mundësi investimi në ankandet e bonove të aktorëve të tjerë të tregut. Bankat e nivelit të dytë dhe Banka Raiffeisen kanë një rritje modeste të portofolave të tyre në përbërjen e stokut të borxhit të brendshëm.

	31.12.2009	31.12.2010	30.9.2011
BOA	17.66%	15.40%	14.35%
Banka Raiffeisen	34.57%	33.94%	34.21%
Bankat e tjera	34.33%	35.37%	35.67%
Jo banka	2.68%	3.21%	3.51%
Individët	10.76%	12.08%	12.26%

v) Pjesëmarrja në ankandet primare

Pjesëmarrja në ankande gjatë vitit 2011 ka qenë e kënaqshme dhe pjesa më e madhe ka plotësuar nevojat e qeverisë për bono dhe obligacione.

Ecuria e treguesit të raportit shumë e kërkuar/shumë e ofruar paraqitet e kënaqshme, përveç disa rasteve të ankandeve të paplotësuara të cilat ilustrohen si më poshtë:

* Ankandet e bonove 3-mujore të marsit dhe majit të cilat kanë pasur përkatësisht *cover ratio* 0.83 dhe 0.89 nuk janë plotësuar si pasojë e rritjes së konsiderueshme të emetimit në krahasim me maturimin e instrumentit. Gjithashtu një ankand nuk është plotësuar gjatë muajit qershor, përkatësisht me *cover ratio* 0.87.

* Në janar dhe në mars kemi mosplotësim të dy ankandeve të bonove 6-mujore përkatësisht me *cover ratio* 0.80 dhe 0.73. Ankandi i bonove 6-mujore të janarit ishte emetim i ri, dhe bankat nuk kanë pasur mundësi të riinvestojnë një instrument të maturuar, dhe kjo mund të ketë qenë një arsye e cila krijoi mosplotësimin e ankandit.

* Në shtator kemi mosplotësimin e një ankandi bonosh 12-mujore me një *cover ratio* relativisht të papërfillshëm 0.99.

Për sa i përket obligacioneve, gjatë vitit 2011 nuk janë plotësuar 4 ankande. Përkatësisht 2 ankande të obligacioneve 2-vjeçare, 1 ankand i obligacioneve 3-vjeçare dhe ankandi i rihapur i obligacioneve 5-vjeçare.

* Ankandet e obligacioneve 2-vjeçare të shkurtit dhe të marsit nuk janë plotësuar me *cover ratio* 0.98 dhe 0.85. Ankandi i obligacioneve 3-vjeçare i muajit prill nuk është plotësuar me *cover ratio* 0.76. Ankandi i rihapur i obligacioneve 5-vjeçare i muajit korrik nuk është plotësuar me *cover ratio* 0.68. Kjo ndodhi për shkak të realizimit brenda së njëjtës datë edhe i ankandit 3-vjeçar. Si rrjedhojë shuma e ofruar nga qeveria për të dyja ankandet së bashku ishte relativisht më e lartë nga shuma të cilën tregu ishte i predispozuar të ofronte për blerjen e obligacioneve në të njëjtën datë.

Duke përjashtuar rihapjen e ankandit 5-vjeçar, kërkesa për instrumentet 5-vjeçare ka tejkaluar ofertën e Qeverisë në të gjitha ankandet e zhvilluara gjatë vitit 2011.

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	9/M 2011
Bono thesari	1.05	1.11	1.11	1.11	1.26	1.06	1.05	1.23	1.12	1.11
Oblig.2/Vj	1.39	0.98	0.85	1.01	1.17	1.12	1.06	1.04	1.22	1.05
Oblig.3/Vj	1.57	-	-	0.76	-	-	1.20	-	-	1.31
Oblig.5/Vj	-	1.16	-	-	1.10	-	0.68	-	-	1.03
Oblig.7/Vj	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali	1.12	1.10	1.09	1.07	1.23	1.07	1.03	1.20	1.09	1.10

Lidhur me pjesëmarrjen në ankandet e Qeverisë, vihet re një profilizim i bankave në llojin e instrumentit në të cilin do të investojnë, kjo duke u bazuar në politikat e tyre të investimit. Si rrjedhojë edhe e krizës financiare, bankat janë më të kujdesshme dhe konservatore në lidhje me politikat e riskut, dhe për këtë arsye ato preferojnë më shumë titujt afatshkurtër me një risk më të ulët, kundrejt titujve afatgjatë.

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në treg investojnë fondet e tyre në bono thesari. Edhe ato banka të cilat pjesën më të madhe të investimeve të tyre i kanë në obligacione, pesha e fondeve të investuara nga këto të fundit është shumë e vogël për të pasur ndikim në portofolin e titujve afatgjatë.

Gjithsesi gjatë 9-mujorit vihen re norma të ulëta të treguesit të *Cover ratio* për obligacionet afatgjata, si dhe për bonot e thesarit. Në asnjë rast ky tregues nuk ka qenë mbi 2, nivel ky që pranohet në shumicën e tregjeve të kapitalit si përcaktues për suksesin e një ankandi. Norma e ulët e këtij treguesi është shoqëruar me rritje të *yieldit* të titujve qeveritarë.

vi) Efektiviteti i ankandeve

Efektiviteti i ankandeve është një tregues i rëndësishëm sepse evidenton sjelljen e pjesëmarrësve në ankandet e letrave me vlerë, nivelin e likuiditetit të tregut dhe rrjedhimisht edhe shanset e suksesit të ankandeve. Për të matur efektivitetin e ankandeve kemi përdorur *Auction Tail*, i cili është një parametër teknik i matur si diferencë midis yield-it maksimal dhe atij mesatar. Nëse është nën 1 pikë bazë tregon një treg me likuiditet dhe efektivitet të lartë, dhe nëse është mbi 1 pikë bazë tregon të kundërtën.

Gjate 9-mujorit të parë "*Auction Tail*" ka qenë në mënyrë të konsiderueshme mbi 1 pikë bazë duke reflektuar një likuiditet dhe efektivitetit të ulët të ankandeve (grafiku 5). Vlerat e larta të këtij treguesi vijnë si rrjedhojë e diferencave të mëdha ndërmjet *yield*-it minimal dhe atij maksimal të pranuar në ankand (të cilat reflektohen në nivelin e yieldit mesatar të ponderuar). Kjo vjen si pasojë e një kërkesë jo shumë të lartë për tituj qeveritarë, dhe të kushtëzuara nga vendime sporadike të bankave që në shumicën e rasteve reflektojnë menaxhim afatshkurtër të depozitave shtesë, sesa një strategji të mirëfilltë të menaxhimit të portofolit, duke çuar në një konkurrence të paparashikueshme ndërmjet bankave për titujt e qeverisë.

Ecuria e treguesit "*Auction Tail*" për titujt qeveritarë- shtator 2011



*Shënim: Burimi MoF. Të dhënat deri në 30.9.2011

Gjatë 9-mujorit "*Auction Tail*" ka qenë mbi 1 pikë bazë si për titujt afatshkurtër të borxhit, ashtu edhe për ata afatgjatë (shih grafikun 5). Vihet re rritje e këtij treguesi për bonot 3-mujore nga 4 pikë bazë në shkurt në 11 pikë bazë në shtator dhe një rënie në ecurinë e këtij treguesi për bonot e thesarit 6-mujore, obligacionet 3-vjeçare dhe obligacionet 5-vjeçare. Bonot e thesarit 12-mujore kanë pësuar në shkurt një rritje të lartë të treguesit "*Auction Tail*", por që më pas tendenca ka qenë rënëse. Obligacionet 2-vjeçare kanë pasur rritje të treguesit në periudhën janar-qershor (12 pikë bazë në qershor) për të pasuar me rënie të konsiderueshme në korrik në 5 pikë bazë dhe ka vijuar përsëri rritjen deri në shtator në 9 pikë bazë.

vii) Analiza e normave të interesit

Gjatë vitit 2011 ka pasur një tendencë në rënien e *yieldit* mesatar të ponderuar. Kështu në fund të vitit 2010 ky tregues ishte 8,432% ndërsa në fund të shtatorit 2011 arriti në 8,071% për totalin e portofolit të huamarrjes së brendshme.

Ndërkohë zhvillimet e vitit 2011 tregojnë se normat e interesit në fund të qershorit 2011 krahasuar me fundin e vitit 2010, janë rritur për bonot 3-mujore mesatarisht me 33 pikë përqindje ndërsa bonot 6-mujore janë rritur mesatarisht me 36 pikë përqindje duke arritur përkatësisht 5,62% dhe 6,77%. Gjithashtu edhe në segmentin e bonove 12-mujore normat e interesit janë rritur me 59 pikë përqindje duke arritur në nivelin 7.68% nga 7.09% (dhjetor 2010).

Obligacionet 2-vjeçare kanë pasur rritjen më të lartë të normave të interesit ndër të gjitha instrumentet financiare krahasuar me fundin e vitit 2010, nga 7.65% në 8.84% me rreth 119 pikë përqindje. Normat e interesit për obligacionet 3-vjeçare janë në nivelin e fundit të vitit 2010. Për sa i përket obligacioneve 5-vjeçare ato kanë pasur një rritje prej 19 pikë përqindje, përkatësisht nga 8.48% në 8.67%. Normat e interesit për instrumentet shtetërore kanë pasur tendenca rritëse për vetë faktin sepse ka pasur një rritje në kërkesën e qeverisë për huamarrje e cila për më tepër ka ushtruar presion sepse ka qenë e përqendruar gjysmën e parë të vitit.

Viti 2011	BTH 3m	BTH 6m	BTH 12m	OB 2	OB 3	OB 5	OB 7
Janar		6.32	6.83	7.38	8.90		
Shkurt	5.21	6.38	6.96	7.60		8.15	
Mars	5.35	6.67	7.27	7.85			
Prill		6.84	7.41	8.15	9.19		
Maj	5.47	6.82	7.36	8.15		8.67	
Qershor	5.55	6.80	7.54	8.40			
Korrik		6.82	7.69	8.55	9.21	8.67 (rihapje ankandi)	
Gusht	5.61	6.78	7.68	8.67			
Shtator	5.62	6.77	7.68	8.84			

Por gjithsesi, në pjesën tjetër të vitit 2011 vihet re tendencë në rënie e normave të interesit, duke menaxhuar me kujdes financimin e deficitit dhe situatën e likuiditetit në treg, të cilën e tregon edhe grafiku si më poshtë:



viii) Analizë e treguesve të riskut

Në fund të tremujorit të tretë të vitit vërejmë këto rezultate:

- Treguesi i duration në fund të shtatorit është pothuajse në të njëjtat nivele me fundin e tremujorit të dytë të vitit, ky tregues është në nivelin e mesatares së tij për vitin 2011. Treguesi i kohës mesatare në rifiksim gjatë vitit 2011 ka pësuar luhatje, por gjithmonë duke qëndruar brenda intervaleve të vlerave [1-1.4] dhe duke ruajtur trendin e tij ciklik. Portofoli vazhdon të jetë sensibël ndaj luhatjeve të normave të interesit, megjithëse tremujori i tretë të vitit ka paraqitur një qëndrueshmëri në normat e interesit.

- Ditët mesatare në maturim kanë pësuar një rënie krahasuar me tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2011, për shkak të emetimit të instrumenteve afatshkurtra duke mos shënuar përmirësim në drejtim të rritjes së këtij treguesi.

- *Yieldi* mesatar i ponderuar mbetet në të njëjtin nivel gjate 3-mujorit të tretë të vitit, duke vijuar trendin në rënie i cili ka filluar që në fillim të vitit 2011. Arsyeja e rënies së këtij treguesi qëndron në emetimet e konsiderueshme të instrumenteve afatshkurtra gjatë këtij viti.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet ecuria e treguesve të riskut për nëntë muajt e parë të vitit 2011.

	Macaulay Duration	YMP	DMM	DMM*	KMR	DMM (pa BOA)
Jan-10	0.74	8.96%	403	1.12	1.13	465
Shk-10	0.77	8.97%	416	1.16	1.20	484
Mar-10	0.74	8.97%	404	1.12	1.25	472
Pri-10	0.72	8.93%	394	1.09	1.32	460
Maj-10	0.72	8.88%	389	1.08	1.43	456
Qer-10	0.70	8.79%	382	1.06	0.99	445
Kor-10	0.76	8.70%	395	1.10	1.08	456
Gush-10	0.73	8.70%	391	1.09	1.16	455
Shta-10	0.74	8.56%	395	1.10	1.24	460
Tet-10	0.71	8.53%	383	1.06	1.29	448
Nen-10	0.71	8.48%	375	1.04	1.34	442
Dhj-10	0.73	8.43%	384	1.07	0.99	438
Jan-11	0.72	8.33%	377	1.05	1.07	425
Shk-11	0.76	8.22%	393	1.09	1.17	442
Mar-11	0.75	8.13%	391	1.09	1.25	438
Prill-11	0.72	8.10%	378	1.05	1.29	424
Maj-11	0.73	8.08%	378	1.05	1.39	425
Qer-11	0.74	8.05%	383	1.06	0.99	429
Kor-11	0.74	8.07%	387	1.08	1.07	432
Gush-11	0.73	8.07%	372	1.03	1.11	416
Shta-11	0.73	8.07%	372	1.03	1.22	417

DMM* - ditët mesatare në maturim (në vite), YMP - *yieldi* mesatar i ponderuar, KMR - koha mesatare në rifiksim (në vite), Duration - ndjeshmëria ndaj luhatjes së normave të interesit (në vite).

Në grafikun i mëposhtëm ilustrohet ecuria e treguesve referuar rezultateve të mësipërme.



ix) Kompozimi i portofolit sipas llojit të interesit

Duke iu referuar tabelës së mëposhtme, vihet re se gjatë vitit 2011 instrumentet me interesa të ndryshueshme kanë fituar terren në raport me instrumentet fikse. Kjo vjen për shkak se emetimet e obligacioneve 5-vjeçare gjatë vitit 2011 kanë qenë kryesisht me interes variabël.

Trendi i rritjes së stokut të instrumenteve me interes të ndryshueshëm ndikon në ekspozimin kundrejt riskut të rifinancimit dhe luhatjeve të normave të interesit.

Muajt	Fix/total stoku	Floating/total stoku
Janar 2011	85.58%	14.42%
Shkurt 2011	84.69%	15.31%
Mars 2011	84.87%	15.13%
Prill 2011	84.89%	15.11%
Maj 2011	84.31%	15.69%
Qershor 2011	84.57%	15.43%
Korrik 2011	84.19%	15.81%
Gusht 2011	84.20%	15.80%
Shtator 2011	84.22%	15.78%



x) Profili i maturimeve

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet profili i maturimeve të portofolit të borxhit të brendshëm, referuar përkatësisht tremujorit të parë, të dytë dhe të tretë të vitit 2011.



	Mars	Qershor	Shtator
ne Vitin I	69.68%	69.47%	69.72%
ne Vitin II	13.91%	14.46%	15.15%
ne Vitin III	6.67%	7.05%	6.42%
ne Vitin IV	6.66%	5.80%	5.92%
ne Vitin V	3.08%	3.22%	2.79%
ne Vitin VI	0.00%	0.00%	0.00%

Profili i maturimeve gjatë gjithë vitit paraqet pjesën më të madhe të instrumenteve (rreth 70%) të cilat maturohen brenda një viti. Ky profil paraqet ecurinë e tij në grafik, përkatësisht sipas tremujoreve të vitit 2011. Situata mbetet pothuajse konstante për të tre rastet, duke treguar një risk të lartë rifinancimi. Portofoli i borxhit paraqet rreth 70% të instrumenteve të cilat duhet të rifinancohen në harkun kohor prej 1 viti duke qenë i ekspozuar ndaj riskut të luhatjeve të normave të interesit. Instrumentet që do të rifinancohen gjatë vitit të dytë rriten nga 13.91% në fund të marsit në 15.15% në fund të shtatorit duke e ulur shtrirjen në kohe të maturimit të borxhit të brendshëm, si dhe duke rritur përqendrimin e

maturimeve brenda harkut kohor prej dy vjetësh. Kjo vihet re qartë pasi nga viti i tretë deri në vitin e gjashtë përqindjet e maturimeve ulen.

Ky tregues sinjalizon një risk të lartë rifinancimi, i cili do të ulet në momentin që ky profil do të bëhet më i zbutur.

xi) Financimi i deficitit të brendshëm

Huamarrja e re është realizuar në masën 36.37% me bono thesari dhe 63.63% me obligacione afatgjata. Për më tepër 36% e obligacioneve afatgjata ose 15% e portofolit të borxhit të brendshëm janë obligacione të emetuara me interes të ndryshueshëm dhe nga pikëpamja e ekspozimit ndaj riskut të normave të interesit konsiderohen njëlloj si bonot me afat maturimi 1-vjeçar. 73% i instrumenteve të borxhit të brendshëm janë me interes të ndryshueshëm dhe afat maturimi deri në një vit, duke qenë lehtësisht të ekspozuara ndaj luhatjeve të normave të interesit.

Janar – Shtator 2011 (*në milion lekë)	
Bono Thesari 3-mujore	338
Bono Thesari 6-mujore	-1,056
Bono Thesari 9-mujore	-1,011
Bono Thesari 12-mujore	12,384
Total Bono	10,960
Obligacione 2-vjeçare	5,343
Obligacione 3-vjeçare	3,774
Obligacione 5-vjeçare	10,202
Obligacione 7-vjeçare	0
Total obligacione	19,179
Total huamarrja	30,139

Duke marrë në konsideratë këto karakteristika të portofolit të borxhit të brendshëm, si dhe situatën e trazuar të tregjeve financiare ndërkombëtare arrijmë në konkluzion që emetimet e vitit 2011 kanë qenë të ekspozuara ndaj luhatjeve të normave të interesit dhe riskut të rifinancimit, pasi tregu është i pasigurt dhe investimet me afat më të gjatë maturimi shihen me shume risk nga ana e investitorëve. Vështirësi do të hasen dhe në realizimin e suksesshëm të ankandeve gjatë vitit 2012.

Për këtë qëllim financimi i huaj duhet vlerësuar si një mundësi e mirë për të siguruar shumën e kërkuar dhe përmirësimin e treguesve të riskut të instrumenteve të borxhit.

xii) Analiza e borxhit të jashtëm

Duke iu referuar grafikut, vëmë re se pjesën më të madhe të stokut të borxhit të jashtëm është në euro (rreth 58.68%), tendencë e trashëguar nga vitet paraardhëse. Kjo përbën një avantazh për ne sepse tregon për një përputhshmëri me një nga objektivat kryesore të paraqitur në strategjinë afatmesme për të fokusuar huamarrjen e jashtme drejt kësaj monedhe. Stoku i borxhit në SDR dhe ACU është gjithashtu në nivele të larta, rreth 31.76%.

Nëse vijojmë më tej duke ndarë këto dy monedha në monedhat e tyre përbërëse, thellohen më tej përqindjet dominuese të euros duke rezultuar në 70.56%. Krahasuar me një vit më parë kemi rritje të peshës specifike të stokut të borxhit në euro dhe rënie e peshës specifike për monedhën USD.





Stoku i borxhit të jashtëm i kontraktuar me terma jokoncesionalë vazhdon të rritet në raport me borxhin me interesa koncesionale. Me kategorizimin e Shqipërisë jo më si një vend me të ardhura të ulëta, shpjegohet dhe kontraktimi me financim të huaj gjithmonë e më tepër me interesa tregtare. Për nëntëmujorin e vitit 2011 borxhi koncensional është vetëm 1.20% më i lartë se borxhi tregtar duke sinjalizuar për trendin e financimit të huaj me terma tregtarë gjithmonë e më tepër. Kjo do të shoqërohet me rritjen e shërbimit të borxhit për këtë zë.

Për gjatë tremujorit të tretë të 2011-s, si dhe në vitin 2010 vihet re gjithashtu dominimi i kredive të nënshkruara me interes fiks. Pjesa e financimit të huaj me interesa fikse raportohet në 75 %, ndërsa borxhi me interesa variabël që është në masën 25%.



xiii) Ecuria e shërbimit të borxhit

* Në milion lekë	2008	2009	2010	Q3 2011
Shërbimi i borxhit gjithsej (I+II)	35,555	42,061	48,116	33,377
Interesat e borxhit gjithsej (I)	31,307	36,301	41,604	28,838
Interesat e b. brendshëm	28,386	31,408	35,583	26,316
Interesat e b. jashtëm	2,921	4,893	6,021	2,522
Principali b.jashtëm (II)	4,248	5,760	6,512	4,539
GDP	1,089,293	1,151,020	1,231,055	1,319,277
Shërbimi borxhit gjithsej/ GDP	3.26%	3.65%	3.91%	2.53%
Interesat e borxhit gjithsej/GDP	2.87%	3.15%	3.38%	2.19%
Interesat e borxhit brendshëm/GDP	2.61%	2.73%	2.89%	1.99%
Interesat e borxhit jashtëm/GDP	0.27%	0.43%	0.49%	0.19%
Principali b.jashtëm/ GDP	0.39%	0.50%	0.53%	0.34%

Interesat e borxhit për fundin e nëntëmujorit të 2011-s rezultojnë në 28,838 milionë lekë nga të cilat 91% (26,316 milionë ALL) i përkasin interesave të borxhit të brendshëm dhe pjesa tjetër i përket interesave të borxhit të jashtëm. Pjesën më të madhe të totalit të interesave për borxhin e brendshëm e zënë interesat për borxhin afatshkurtër me rreth 55%.

Instrumentet	**2008**	**2009**	**2010**	**2011**
Bono thesari	16,981,458,997	17,697,926,717	20,112,625,667	17,800,005,589
Obligacione 2-vjeçare	3,737,815,000	5,589,316,100	6,045,339,700	6,351,803,600
Obligacione 3-vjeçare	2,082,065,000	1,710,005,000	1,390,730,000	1,574,480,000
Obligacione 5-vjeçare	447,152,500	4,960,437,844	6,695,076,454	7,231,279,373
Obligacione 7-vjeçare	990,000,000	1,320,000,000	1,320,000,000	1,320,000,000
Kredia direkte	0	130,395,511	19,282,610	0
Total	**24,238,491,497**	**31,408,081,172**	**35,583,054,431**	**34,277,568,561**

Në total kemi një rënie të interesave totalë për vitin 2011 me 1,305 milionë lekë. Instrumentet e bonove të thesarit kanë rënë në shumën 2,313 milionë lekë, e cila shpjegohet nga normat më të ulëta të interesit për vitin 2011 dhe ato të mbartura nga 2010 krahasuar me normat e interesit të 2009.

Obligacionet 2, 3 dhe 5-vjeçare kanë rritje të shpenzimeve të interesave për t'u paguar pasi gjithmonë politika e huamarrjes po fokusohet në instrumente afatgjata. Obligacionet 7-vjeçare nuk kanë ndryshime në interesa, kjo pasi s'kemi as maturime, dhe as emetime të reja për këtë titull.

3. Realizimi i objektivave të strategjisë paraardhëse të borxhit

Strategjia ekzistuese 2011-2013 e menaxhimit të borxhit publik përmban targetet operative të mëposhtme:

1. Përqindja e pjesës së borxhit në lekë me atë në monedhë të huaj do të jetë në raportet 55% me 45%.

2. Shtesa e huamarrjes së re në tregun e brendshëm do të realizohet vetëm me instrumente afatgjata dhe huamarrjet e jashtme kur është e mundur të zgjidhet monedha të bëhen në euro.

3. Duration i portofolit të borxhit të brendshëm do të luhatet në 0.68 deri në 1.29 dhe ditët mesatare në maturim rreth 380 ditë për instrumentet në tregun e brendshëm dhe 460-466 ditë me përfshirjen e Eurobondit.

Vlerësimet më të fundit tregojnë realizimin e objektivave si më poshtë:

Raporti mes borxhit në monedhe vendase kundrejt atij në valutë qëndron në vlerat 56% me 44%, duke qenë në përputhje me objektivin e vendosur në strategjinë e mëparshme.

Huamarrja e jashtme e nënshkruar gjatë 2011-s është bërë për pjesën më të madhe të kredive në euro.

Shtesa e huamarrjes në tregun e brendshëm ka qenë në pjesën më të madhe me obligacione afatgjata 2, 3 dhe 5-vjeçare (18 miliardë lekë, ose 65%), por ndërkohë është përdorur edhe instrumenti i bonove të thesarit 12-mujore (10 miliardë lekë apo rreth 35%).

Duration përllogaritet të jetë 0.67 në fund të vitit 2011 duke qëndruar pranë kufirit minimal të vendosur nga strategjia. Ditët mesatare në maturim ulen ndjeshëm nga objektivi në 361 ditë dhe janë 449 ditë me Eurobond.

Si më poshtë paraqitet ecuria e treguesve me tremujorë dhe vlerësimi për fundin e 2011.

	DMM	YMP	KMR	Duration
T I	391	8.126	1.26	0.75
T II	383	8.048	0.99	0.75
TIII	372	8.071	1.22	0.73
P T IV	361	8.036	0.93	0.68

* DMM ditët mesatare në maturim (në ditë), YMP *yieldi* mesatar i ponderuar, KMR koha mesatare në rifiksim (në vite), Duration ndjeshmëria ndaj luhatjes së normave të interesit (në vite).

4. Zhvillimi dhe perspektiva e huamarrjes në tregun e brendshëm dhe të jashtëm

i) Parashikim mbi situatën në tregun e brendshëm për 2012

Parashikimet mbi situatën në tregun vendas për vitin 2012 janë mbështetur në supozimin që kriza e borxheve sovrane në vendet fqinje dhe në eurozonë do të vazhdojë dhe do të ndikojë ndjeshëm në strategjitë e investimit në portofolin e letrave me vlerë nga pikëpamja e bankave të nivelit të dytë që operojnë në Shqipëri. Këta faktorë do të influencojnë ndjeshëm financimin e deficitit për vitin 2012, si dhe ecurinë e ankandeve të bonove dhe obligacioneve.

Faktorët kryesorë që do të ndikojnë tregun janë renditur si më poshtë:

- Edhe pse janë shtrënguar kushtet për dhënien e kredive nga ana e bankave, faktor ky që do të ndikonte pozitivisht në rritjen e kërkesës për tituj qeveritarë, bankat parashikojnë që për vitin 2012 rritja e depozitave të jetë zero ose shumë e ulët. Kjo bën që të ketë më pak fonde të lira për investim dhe për rrjedhojë ulen mundësitë për pjesëmarrje në ankandet e qeverisë.

- Për shkak të krizës ndërkombëtare të borxhit, Banka e Shqipërisë nëpërmjet një rregulloreje të re ka rritur raportin e likuiditetit nga 20% në 25%, faktor ky që do të ndikojë drejtpërdrejtë në portofolin e investimeve të bankave në tituj qeveritarë. Për të siguruar nivelin 25% të likuiditetit të gjitha bankat do të priren drejt investimit në tituj afatshkurtër (bono thesari) dhe do të ulin kërkesën e tyre për tituj afatgjatë. Për këtë arsye do të ketë vështirësi në emetimet e obligacioneve afatgjata. Kjo situatë do të ndikojë në përkeqësimin e treguesve të riskut, duke përfshirë këtu ndjeshmërinë ndaj luhatjeve të normave të interesit, ditët mesatare në maturim, përkeqësimin e profilit të maturimeve, ku pjesa më e madhe do përqendrohen në maturimin brenda harkut kohor të një viti, si dhe përkeqësimin e treguesit të kohës mesatare në rifiksim.

- Viti 2012 do të sjellë maturime të obligacioneve 5-vjeçare. Për efekte të strategjisë do të ketë vështirësi për të siguruar huamarrje të re në këtë segment, si dhe ngrihen pikëpyetje edhe në lidhje me riinvestim të maturimeve në këto segmente. Kryesisht riinvestimi me maturime, si dhe shtesa në huadhënie nga ana e bankave do të bëhet në segmentin e instrumenteve me afat maturimi deri në një vit.

- Për shkak të "Krizës greke", bankat greke që operojnë në vend pritet të mos jenë aktive në investimet në tituj qeveritarë (ose pjesëmarrja e tyre të jetë me shuma shumë të vogla) pasi kanë vështirësi në strategjitë e investimit. Ato janë në një mbikëqyrje të veçantë nga Banka e Shqipërisë dhe për momentin nuk kanë plane të qarta investimi për vitin që vjen. Arsyet e pasigurisë së situatës në shtetin fqinj dhe ecurisë së tregjeve dhe krizës globale i bëjnë të vështira projeksionet për vitin e ardhshëm. Vështirësi ndoshta do të hasen dhe riinvestim të maturimeve të portofolave të bankave greke. Nëse do të shtohet portofoli i tyre në letra me vlerë të Qeverisë ai kryesisht do të përqendrohet në instrumentet me afat maturimi deri në një vit.

- Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë mbi "Raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit" titujt e qeverisë në lekë konsiderohen me risk 0% ndërsa titujt e qeverisë në monedhë të huaj konsiderohen me

risk 100%. Kjo rregullore detyron bankat të mos marrin pjesë në ankandet e qeverisë në valutë edhe pse kanë tepricë të konsiderueshme likuiditeti në valutë (kryesisht në euro). Këto teprica të likuiditetit investohen jashtë vendit me norma shumë të ulëta interesi.

Si përfundim edhe pse huamarrja e brendshme është ulur për vitin 2012 krahasuar me vitin 2011, tregu është tepër i pasigurt dhe kërkohet një monitorim i vazhdueshëm i tij për të shmangur problemet në financimin e deficitit buxhetor, sigurimin e likuiditetit të nevojshëm për thesarin dhe arritjen e objektivave të strategjisë.

Në përfundim, gjykojmë që në një skenar të financimit të deficitit vetëm në tregun e brendshëm (të ngjashëm me vitin 2011) vështirësitë për të arritur objektivat e strategjisë në pikëpamje të rritjes së maturitetit të përgjithshëm të portofolit të borxhit, dhe uljes së kostos së borxhit përmes uljes së *yield*-it do të jenë të konsiderueshme. Faktorët kryesorë që e komplikojnë realizimin e këtyre objektivave janë:

- Tërheqja e Raiffeisen Bank nga emetimit e letrave me vlerë të qeverisë në një masë të konsiderueshme e cila lidhet jo vetëm me përsëritjen e borxhit por edhe me maturimet e portofolit.
- Bankat preferojnë të investojnë në tituj afatshkurtër me një risk më të ulët, sesa në tituj afatgjatë.
- Mungesa e pjesëmarrjes aktive të një numri të madh të bankave në ankandet e obligacioneve.
- Disa prej bankave më të mëdha janë shumë afër arritjes së limiteve të lejuara të investimit në titujt qeveritarë.
- Kërkesat e përmuajshme të Thesarit për likuiditet shkaktojnë përqendrimin e huamarrjes në fillim të muajit, dhe si rrjedhojë presion mbi *yieldin* e bonove 12-mujore, dhe shpërndarje të pabarabartë të shumave të ankandeve.

ii) Marrëdhëniet me kreditorët e huaj dhe potencialet e tyre mbështetëse në investimet afatgjata

Marrëdhëniet me kreditorët ndërkombëtarë kanë qenë mjaft dinamike në vitin 2011 dhe e njëjta pritshmëri aplikohet edhe për vitin 2012. Përpjekjet e Ministrisë së Financave për të maksimizuar financimin e projekteve prioritare me kredi zhvillimi afatgjata kanë ruajtur të pandryshuar intensitetin e investimeve të bankave të zhvillimit në vendin tonë. Financimi i projekteve me kredi afatgjata siguron jo vetëm terma më të butë financimi por edhe reduktim të rrezikut të rifinancimit si rezultat i maturitetit më të gjatë.

Një përfitim tjetër konsiston në faktin që arrihet edhe një përputhshmëri më e mirë e kohëzgjatjes së projektit me maturitetin e kredisë, çka nuk mund të arrihet me financimet afatshkurtra të mobilizuara në tregun e brendshëm.

Për vitin 2012 parashikojmë që potenciali mbështetës i kreditorëve të huaj të vijojë dhe të shtohet më tej si rezultat i projekteve në fushën e transportit. Sektorët, dhe brenda tyre projektet prioritare të përcaktuara në strategjinë afatmesme të qeverisë do të vazhdojnë të shërbejnë si orientim për aktivitetin e huamarrjes së jashtme. Edhe për vitin 2012 fokusi do të mbetet në sigurimin e mbështetjes për investimet afatgjata për ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës. Bankat ndërkombëtare të zhvillimit vazhdojnë të shfaqin interes të lartë për të financuar projektet e qeverisë shqiptare. Përveç institucioneve me histori të gjatë në vendin tonë si Banka Botërore, KFW, Kooperacioni Italian, BERZH, BEI, dhe CEB, interes të lartë kanë shfaqur edhe institucionet financiare arabe, qeveria austriake, japoneze etj.

Ndërkohë mbeten të mirëpritura kreditë e financimit me Bankën Botërore për huat e politikave të zhvillimit të cilat do ndihmojnë në zbutjen e kërkesës për maturim të instrumenteve në tregun e brendshëm.

Për sa i përket aktivitetit në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, duhet theksuar se në stadin aktual në përputhje edhe me strategjinë e re të borxhit nuk ka plane specifike për t'iu drejtuar sërish tregjeve të borxhit sovran në vitin 2012.

5. Strategjia e menaxhimit të borxhit dhe supozimet afatmesme

Ndërsa ne shikojmë përpara në vitin 2012, vlerësojmë se ka ende shumë probleme të pazgjidhura të cilat vështirësojnë pritshmëritë në muajt që vijnë. Në këtë mënyrë duhet të merret parasysh fleksibiliteti në parashikimet e këtij viti duke marrë në konsideratë që pikëvështrimet dhe zgjidhjet tona mund të ndryshojnë si funksion i zhvillimeve të ndryshme makroekonomike dhe strukturore.

Thelbi kryesor i strategjisë sonë bazohet në politikat e bankave për uljen e borxhit në pjesën e detyrimeve në respekt të planeve për kapitalizimin e tyre, zhvillimet e ekonomisë europiane dhe të krizës së borxheve dhe ndikimet e tyre në sistemin tonë bankar dhe financiar, si dhe në pritshmëritë e negociatave me bankën botërore për sigurimin e huave të politikave të zhvillimit. Institucionet financiare kanë njoftuar planet e tyre për të siguruar raportet e aftësisë paguese si pjesë e procesit Basel III, nëpërmjet tërheqjes së aseteve me risk përkundrejt rritjes së bazës së tyre të kapitalit. Në fakt ne mendojmë që në një të ardhme të afërt kjo politikë është e paevitueshme me qëllim që bankat të sjellin në një nivel të menaxhueshëm raportet e kërkuara dhe kjo do realizohet shumë thjesht nëpërmjet maturimit të portofolit të tyre në instrumentet e borxhit qeveritar. Por ndërkohë theksojmë se kjo strategji e bankave do të jetë problematike për huamarrës të vegjël si ne për arsye të fleksibilitetit të kufizuar për sa i përket alternativave të rifinancimit. Në një vështrim më të gjerë implikimet janë negative për ekonominë sepse do të detyrojë që të rriten nivelet e interesave të kërkuara për instrumentet financiare dhe do të kërkojë masa të shpejta për të siguruar nevojat e rifinancimit.

Strategjia e menaxhimit të borxhit bazohet në vlerësimin e kostove të pritshme dhe karakteristikat e riskut të strategjive të ndryshme të huamarrjes. Për secilën nga strategjitë e huamarrjes janë llogaritur kostot e pritura (pagesat e interesave dhe rivlerësimet e kurseve të këmbimit) dhe risku (devijimet nga pagesat e pritura).

Katër strategjitë kryesore të huamarrjes janë zhvilluar duke siguruar opsione të qarta dhe të ndara midis skenarëve bazë dhe skenarëve të riskut. Këto strategji janë:

1. Strategjia me huamarrje në tregun e brendshëm (referuar instrumenteve afatshkurtra dhe afatgjata) duke e plotësuar me sigurimin e financimit nga jashtë, si dhe financimet e pritshme të projekteve të huaja. Kjo është një strategji me risk të ulët ku përmirësohen ndjeshëm treguesit e ditëve mesatare në maturim por edhe me kosto relativisht më të ulët krahasuar me strategjitë e tjera në vitin e parë.

2. Strategjia e fokusuar në huamarrje afatshkurtër në tregun e brendshëm e plotësuar me financimin e projekteve të huaja. Kjo është një strategji me risk të lartë rifinancimi dhe me duration të ulët krahasuar me strategjitë e tjera.

3. Strategjia e fokusuar në instrumentet afatgjata për huamarrjen e re e kombinuar me vijueshmërinë e instrumenteve afatshkurtra të cilat ulen përtej masës së maturimit të tyre. Ndërsa huamarrja e huaj mbështetet në financimet nga institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe projektet që vijojnë në këtë fushë. Kjo është një strategji me duration të lartë por jo realiste. Kjo strategji është e nevojshme të vlerësohet sepse nga pikëpamja e objektivave dhe mundësive jep informacion se ku duhet arritur në të ardhmen, si dhe ndihmon duke dhënë informacionin e nevojshëm për kërkesat e zhvillimit të tregut të brendshëm të letrave me vlerë të Qeverisë.

4. Strategjia e realizuar nëpërmjet sigurimit të huamarrjes së re në tregun e jashtëm e plotësuar nëpërmjet financimit të pritshëm të projekteve të huaja. Kjo është një strategji me duration relativisht në nivelet e strategjisë së parë. Krahasuar me strategjinë 3 është pozitive në terma të kostos dhe gjithashtu afrohet edhe për sa i përket termave të riskut.

i) Supozimet makroekonomike për nivelin e borxhit ndaj PBB

Niveli i stokut të borxhit dhe parashikimi i tij mbështetur në parashikimet makroekonomike dhe fiskale të prezantuara në kuadrin makro 2013-2015, të miratuar në 18 janar 2012, paraqitet si më poshtë:

Skenari makro bazë



	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Stoku i borxhit qendror/GDP	54.69%	59.29%	57.78%	58.91%	59.68%	59.52%	58.96%	57.94%
Stoku i borxhit shtetëror /GDP	51.34%	55.31%	54.11%	55.22%	56.30%	56.19%	56.04%	55.40%

Sipas këtij skenari vlerësohet një gjendje e stokut të borxhit nën kufirin 60% të GDP-së por duhet theksuar risku i nivelit të lartë të tij në vitin 2012 dhe 2013. Gjithashtu në kushtet e pasigurive dhe risqeve që shoqërojnë këtë periudhë është e domosdoshme parashikimi dhe mbajtja parasysh e rezervave të domosdoshme në vitin 2013, si rezultat i të cilave duhet të parashikohet ulje e mëtejshme e deficitit buxhetor.

Skenar makro stresi

Në skenarin stres që kemi zhvilluar, kemi supozuar që rritja nominale e PBB-së do të jetë 4% për 2012 dhe 5% për 2013 e në vijim, kursi i këmbimit euro/All do të jetë kursi mesatar 2011 plus një devijim standard për 2012 dhe plus dy devijimin standard për 2013 e në vijim. Normat e interesit në tregun e brendshëm dhe të jashtëm janë subjekt i një shoku prej 100 pikë përqindje.



	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Stoku i borxhit qendror/GDP	54.69%	59.29%	57.78%	58.91%	60.46%	61.38%	61.45%	61.17%
Stoku i borxhit shtetëror /GDP	51.34%	55.31%	54.11%	55.22%	57.03%	57.92%	58.39%	58.48%

ii) Strategjitë e borxhit

Strategjia 1 (bazë)

Kjo strategji fokusohet në huamarrjen e brendshme afatshkurtër dhe afatgjatë plotësuar me financimin e huaj si kredi mbështetëse strukturore dhe projektet e zhvillimit të cilat zënë një peshë të rëndësishme në huamarrjen e re.

Si rezultat i kësaj strategjie risku i rifinancimit të brendshëm do të përmirësohet së tepërmi, të cilën e tregon edhe grafiku më poshtë.



	në 2013	në 2014	në 2015	në 2016	në 2017
Str. Vetëm B. brendshëm	322,538,970,000	67,507,100,580	16,050,000,000	16,561,932,517	18,250,000,000
St. bazë	303,129,970,000	63,107,100,580	16,050,000,000	16,561,932,517	14,500,000,000

Vihet re një profil më i ulët i maturimit të instrumenteve në vitin 2012 dhe në vijim ndërkohë që edhe treguesit e tjerë të riskut paraqiten të përmirësuar.

Ditët mesatare në maturim vlerësohet të arrijnë nivelin 472 ditë me përfshirjen e kredisë së Bankës Botërore krahasuar me 335 ditë, nëse vlerësojmë vetëm tregun e brendshëm. *Yieldi* mesatar i ponderuar ulet në 8.39% si rezultat i emetimeve të instrumenteve afatshkurtra.

	Strategjia 1	
	31.12.2012	31.12.2012+BB
YMP	8.67%	8.39%
DMM	335	472
Macaulay Duration	0.58	0.58
KMR	0.84	0.82

*DMM - ditët mesatare në maturim (në vite), YMP - *yieldi* mesatar i ponderuar, KMR - koha mesatare në rifiksim (në vite), Duration - ndjeshmëria ndaj luhatjes së normave të interesit (në vite).

Kostoja e pritshme për këtë strategji është rezultat i supozimit të një norme interesi të brendshëm prej 8,6% (kosto mesatare për të gjitha instrumentet) me një rritje prej rreth 60 pikë bazë krahasuar me një vit më parë duke pasur rezervat e nevojshme edhe për rritje të normave të interesit si rezultat i tërheqjes së Raiffeisen Bank. Ndërkohë që kreditë e bankës botërore kanë norma interesi më të ulëta se në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Kjo ndikon në një total kosto më të ulët se strategjitë e tjera. Në një skenar stresi rritja e normave të interesit është rreth 6,9 miliardë lekë në periudhën afatmesme dhe rreth 600 milionë lekë për vitin 2012, duke shprehur një risk i cili mund të menaxhohet në totalin e portofolit të borxhit dhe një skenar real për t'u zbatuar për sa i përket huamarrjes.

Kostot dhe risqet për periudhën 2012-2015

	Në miliardë lekë	% rritje
Skenari bazë		
Pagesat e interesit	197,5	
Skenari i stresit		
Rritja në pagesat e interesave	6,9	3,53
Efektet nga kursi i këmbimit	3,13	

ii) Strategjia 2

Kjo është një strategji me huamarrje të brendshme afatshkurtër e cila analizohet për të parë treguesit e riskut në kushtet e vështirësive të mëdha në tregun e brendshëm dhe pamundësive për emetim të instrumenteve afatgjata me afat maturimi përtej 1 vit.

Në këto kushte treguesit e riskut përkeqësohen krahasuar me strategjitë e tjera dhe në veçanti numri i ditëve mesatare në maturim arrin në 303 ditë. Për sa i përket yieldit mesatar të ponderuar si rezultat i instrumenteve afatshkurtra ai është relativisht më i ulët rreth 8,62%, por risku që shoqëron profilin e maturimeve është i dukshëm dhe shprehet qartë në grafikun e mëposhtëm për këtë strategji.

	Strategjia 2	
	31.12.2012	31.12.2012+BB
YMP	8.62%	8.34%
DMM	303	442
Macaulay Duration	0.56	0.55
KMR	0.82	0.8

*DMM - ditët mesatare në maturim (në vite), YMP - *yieldi* mesatar i ponderuar, KMR - koha mesatare në rifiksim (në vite), Duration - ndjeshmëria ndaj luhatjes së normave të interesit (në vite).



Kostot e pritshme për këtë strategji janë në nivel të ulët në vitin e parë, për arsye të instrumenteve afatshkurtra. Ndërsa në aspektin afatgjatë kostot në shumë absolute rriten krahasuar me strategjinë e parë dhe të tretë duke e konsideruar një strategji jo të favorshme për t'u zbatuar.

Kostot dhe risqet

	Në miliard lekë	% rritje
Skenari bazë		
Pagesat e interesit	205,8	
Skenari i stresit		
Rritja në pagesat e interesave	3,98	1,94
Efektet nga kursi i këmbimit	3,13	

iii) Strategjia 3

Në këtë strategji vijon fokusi në huamarrjen e brendshme e cila është burimi kryesor i sigurimit të financimit shtesë, nëpërmjet emetimit të instrumenteve afatgjata për këtë qëllim. Në këtë strategji ka një fokusim në huamarrjen e brendshme nëpërmjet obligacioneve afatgjata. Kjo është një strategji me duration i cili qëndron rreth niveleve të një viti më parë dhe kjo tregon se kërkohen zhvillime të mëdha në strukturën e instrumenteve të borxhit të brendshëm për të mbajtur të paktën treguesit ekzistues të riskut, përndryshe këta tregues do të përkeqësohen. Kjo gjithashtu tregon se është edhe një sfidë e madhe

për aq kohë sa tregu i brendshëm është në një stad të tillë zhvillimi ku nuk e lejon futjen e instrumenteve afatgjata në një masë të konsiderueshme. Krahasuar me opsionin e huamarrjes afatshkurtër kjo strategji siguron uljen e riskut të rifinancimit dhe reduktimit të ekspozimit ndaj tij. Në profilin e maturimeve të zhvilluar në grafikun më poshtë del qartë se kjo është strategjia me nivelim më të mirë dhe të zbutur të maturimeve.

Krahasuar me strategjinë e parë kjo strategji siguron uljen e riskut të rifinancimit, por nuk është realiste.

	Strategjia 3	
	31.12.2012	31.12.2011+BB
YMP	8.71%	8.43%
DMM	374	510
Macaulay Duration	0.62	0.61
KMR	0.88	0.86

*DMM - ditët mesatare në maturim (në vite), YMP - yieldi mesatar i ponderuar, KMR - koha mesatare në rifiksim (në vite), Duration - ndjeshmëria ndaj luhatjes së normave të interesit (në vite).



Kostot e pritshme për këtë strategji janë më të ulëta gjithmonë pas strategjisë së parë dhe gjithashtu edhe rritja e tyre është e moderuar.

Kostot dhe risqet

	Në miliardë lekë	% rritje
Skenari bazë		
Pagesat e interesit	202,3	
Skenari i stresit		
Rritja në pagesat e interesave	4,5	2,23
Efektet nga kursi i këmbimit	3,13	

iv) Strategjia 4

Sipas kësaj strategjia kërkesa e re e huamarrjes sigurohet nëpërmjet huamarrjes nga jashtë plotësuar me huamarrjen e brendshme për nevojat e riinvestimit (përveç Raiffeisen Bank) dhe financimin e pritshëm të projekteve. Theksi i kësaj strategjie është huamarrja e huaj kryesisht nëpërmjet financimit të projekteve të zhvillimit. Kjo strategji ka një duration total relativisht të njëjtë me strategjinë e parë dhe një ekspozim më të vogël ndaj riskut të rifinancimit të borxhit të brendshëm. Nga pikëpamja e raporteve borxh në lekë dhe valutë pjesa e borxhit të brendshëm vazhdon të ulet por për shkak të rritjes së borxhit të jashtëm shtohet rreziku i ekspozimit të tij ndaj kursit të këmbimit dhe risku i shtesës së gjithë stokut të borxhit.

	Strategjia 4	
	31.12.2012	31.12.2011+BB
YMP	8.66%	8.37%
DMM	346	486
Macaulay Duration	0.59	0.58
KMR	0.85	0.83

*DMM - ditët mesatare në maturim (në vite), YMP - yieldi mesatar i ponderuar, KMR - koha mesatare në rifiksim (në vite), Duration - ndjeshmëria ndaj luhatjes së normave të interesit (në vite)



Kostot e pritshme për këtë strategji janë në nivele të ulëta, pak a shumë si në strategjinë e tretë, për shkak të normës së interesit në tregun e huaj. Por në aspektin afatgjatë, skenari risk rezulton me një kosto shtesë prej 8,7 miliardë ose 4,36%. Ndërkohë risku i kursit të këmbimit është prezent edhe në shërbimin e borxhit dhe rezulton me një kosto shtesë prej 3.8 miliard lekë.

Kostot dhe risqet

	Në miliard lekë	% rritje
Skenari bazë		
Pagesat e interesit	199,7	
Skenari i stresit		
Rritja në pagesat e interesave	8,7	4,36
Efektet nga kursi këmbimit	3,88	

6. Objektivat kryesorë të strategjisë

Nga analiza e portofolit të borxhit vihet re se ky portofol ka një risk të lartë. Kjo për arsye se huamarrja e brendshme afatshkurtër vazhdon të përbëjë një pjesë të konsiderueshme të portofolit, e cila kërkon rifinancim në një kohë relativisht të shkurtër dhe nga ana tjetër huamarrja në monedhë të huaj e cila është rritur, karakterizohet nga risku i kursit të këmbimit. Simulimet kosto/risk tregojnë rëndësinë e reduktimit të borxhit, përndryshe efektet negative financiare do të jenë të mëdha duke shkaktuar pagesa të larta të shërbimit të borxhit.

Të dhënat kryesore të përmbledhura për katër strategjitë paraqiten si më poshtë:

	Strategjia 1 (bazë)		Strategjia 2		Strategjia 3		Strategjia 4	
	Dec-12	Dec-12 +BB	Dec-12	Dec-12 +BB	Dec-12	Dec-12 +BB	Dec-12	Dec-12 +BB
YMP	8.67%	8.39%	8.62%	8.34%	8.71%	8.43%	8.66%	8.37%
DMM	335	472	303	442	374	510	346	486
Macaulay Duration	0.58	0.58	0.56	0.55	0.62	0.61	0.59	0.58
KMR	0.84	0.82	0.82	0.8	0.88	0.86	0.85	0.83



Opsioni i huamarrjes që tregon risk më të ulët është strategjia e tretë nëpërmjet huamarrjes së brendshme afatgjatë. Por analiza e tregut tregon qartë që ky nuk është një opsion i zbatueshëm. Tregu i brendshëm nuk është aktualisht i përgatitur për blerjen e instrumenteve afatgjata, aq më tepër në shuma të mëdha për financimin e deficitit dhe përmirësimin e portofolit të instrumenteve të borxhit.

Opsioni i dytë më i mirë në terma të kostos dhe uljes së riskut është strategjia e parë (strategjia bazë) e cila ka kosto të ulët në aspektin afatgjatë dhe risk më të ulët të kursit të këmbimit, duke u krahasuar kjo e fundit me strategjinë e katërt.

Bazuar në sa më sipër, pikërisht kjo është strategjia që rekomandohet për sigurimin e huamarrjes dhe menaxhimin e borxhit gjatë vitit 2012 e cila do të realizohet nëpërmjet objektivave operative si më poshtë:

1.Përqindja e pjesës së borxhit në lekë me atë në monedhë të huaj do të jetë në raportet 53% me 47%.

2.Shtesa e huamarrjes përveç financimit të projekteve do të realizohet në tregun e brendshëm dhe nga huaja e politikave të zhvillimit me Bankën Botërore.

3.Duration i portofolit të borxhit të brendshëm do të luhatet 0,57-0,59 dhe ditët mesatare në maturim rreth 346 ditë për instrumentet në tregun e brendshëm dhe 470-480 ditë me përfshirjen e financimit të huaj nga Banka Botërore.

2.1.3 Implikimet buxhetore të "reformave strukturore kryesore"

Siç përmendet në seksionin 3.1 më sipër ashtu edhe në Programin Ekonomik dhe Fiskal 2011-2013, Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike, pas daljes se vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 474, datë 16.6.2011 "Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike", janë angazhuar me rishikimin e të gjitha strukturave organizative të ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore. Qëllimi i kësaj reforme është për ta bërë administratën publike më efiçente dhe efektive duke ridimensionuar çdo element të hierarkisë organizative dhe duke eliminuar postet dhe funksionet që dalin të tepërta. Një nga rezultatet e pritshme të kësaj reforme të ndërmarrë, është edhe ulja e numrit të

përgjithshëm të punonjësve buxhetorë referuar seksionit 3.1.2 me lart. Në vazhdimësi, parashikohet që me përfundimin e këtij procesi, të kursehet rreth 100-150 milionë lekë në zërin "Shpenzime personeli".

Siç përmendet në seksionin 3.1.2 më sipër ndihma ekonomike, si rezultat i përmirësimeve ligjore dhe administrative do të vijë duke u ulur (në terma relativë), ku pjesa më e madhe e rritjes do të shkojë për pagesën e paaftësisë, si rezultat i indeksimit të saj, rritjes së numrit të përfituesve dhe përmirësimit të procedurave të përfitimit të statusit të PAK. Reforma në fushën e mbrojtjes sociale synon të përmirësojë barazinë, efikasitetin, transparencën dhe efektivitetin e përdorimit të burimeve për uljen e varfërisë. Këto reforma për ndihmën ekonomike gjithashtu mbështesin politikat që forcojnë mekanizmat për shpërndarjen e fondeve dhe përzgjedhjen e përfituesve në programin kryesor të asistencës sociale; shtojnë stimuj për investimin në kapitalin njerëzor përmes ofrimit të një pagese sociale shtesë të lidhur me regjistrimin dhe frekuentimin në shkollë për familjet që kanë fëmijë në moshë shkollore; hapin procesin për krijimin e një regjistri të unifikuar të përfituesve të programeve të asistencës sociale; dhe ndryshojnë formulat e indeksimit të programit të pagesave të invaliditetit.

Për më tepër, ligji nr. 10 399, datë 17.3.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"", të ndryshuar, parashikon aplikimin e një forme të re vlerësimi që garanton përfshirjen në skemë të çdo familjeje që jeton në varfëri. Pilotimi i skemës së re do të fillojë gjatë vitit 2012, nëpërmjet digjitalizimit të plotë të saj dhe ngritjes së regjistrit elektronik në nivel kombëtar. Implikimet në shpenzimet buxhetore parashikohen të jenë neutrale, pasi objektivi i Qeverisë është që çdo kursim që rezulton nga rritja e efiçencës së përdorimit të fondeve nga targetimi më i mirë i familjeve në nevojë, do të shkojë për rritjen e masës së pagesës së këtyre të fundit.

Duke filluar nga viti 2010, me synim inkurajimin e zhvillimit lokal dhe rajonal, politikat e buxhetit të brendshëm harmonizohen me politikat e buxhetit lokal. Është gjerësisht e kuptuar që zhvillimi ekonomik i komunave, bashkive dhe rajoneve nuk është një problem i izoluar ose vetëm një problem i pushtetit lokal, por është një problem që është i lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik të mbarë vendit. Në dritën e kësaj filozofie, u bë e domosdoshme të integrohen politikat sektoriale të qeverisë qendrore në nivelin rajonal. Për këtë qëllim, politikat buxhetore orientohen drejt politikës së "Zhvillimit rajonal". Kjo politikë është një parapërgatitje për rajonet me qëllim që të forcojnë aftësitë e tyre për të aplikuar për fonde strukturore dhe investimesh nga Bashkimi Europian.

2.2 Cilësia e financave publike

Thellimi i institucionalizimit të Programit buxhetor afatmesëm

Në lidhje me shpenzimet buxhetore, Qeveria Shqiptare, që në vitin 2001, ka paraqitur Programin buxhetor afatmesëm (PBA), duke synuar fuqizimin e lidhjes ndërmjet politikave qeveritare dhe alokimit të fondeve buxhetore, duke marrë vlerën e parasë. Të gjitha ministritë e linjës ishin pjesë e programit buxhetor afatmesëm që në vitin 2006, ndërsa institucionet buxhetore qendrore u përfshinë për herë të parë në vitin 2009. PBA-ja synon në kalimin gradual nga buxheti i bazuar tek inputet, te buxhetimi bazuar në programe dhe performancë.

Mbështetur në ligjin "Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", njësive të qeverisjes vendore u kërkohet të përgatisin dhe aprovojnë buxhetet e tyre afatmesme (për tre vjet). Në këtë kontekst njësitë e qeverisjes vendore duhet të kenë një komunikim intensiv me qeverinë qendrore (veçanërisht me Ministrinë e Financave), për të shkëmbyer të dhënat dhe informacionin në lidhje me ndërtimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore janë pjesë e programit buxhetor afatmesëm, që në vitin 2009. Përpjekjet dhe puna e kryer në një kohë relativisht të shkurtër ka pasur efekte pozitive në proces. Për vitin 2011, këto efekte kanë konsistuar në rritjen e përgjegjësive dhe përgjegjshmërisë së organeve të pushtetit vendor për të kryer këtë detyrë, në rritjen e kapacitetit lokal për të përgatitur buxhete cilësore afatmesme, dhe në konsolidimin e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe lokal, me synim shtimin e fondeve publike që do të sillte rritjen e shërbimeve dhe investimeve publike në favor të komuniteteve.

Viti 2011 ishte viti i tretë i përgatitjes së projektbuxhetit afatmesëm nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore.

Procesi i parashikimit afatmesëm ka bërë që vizioni për të ardhmen e njësive vendore të jetë më i qartë dhe njëkohësisht të kenë prioritete, projekte dhe plane investimesh. Për vitin 2012, hartimi i

projektbuxhetit nga njësitë e qeverisjes vendore duhet të koordinohet dhe të integrohet ngushtë me politikat rajonale dhe kombëtare, si dhe me proceset e planifikimit, veçanërisht në kuadrin e zhvillimit lokal dhe rajonal të bazuar në potencialet dhe mundësitë.

Forcimi dhe institucionalizimi i marrëdhënieve ndërqeveritare fiskale

Në kontekstin e decentralizimit dhe forcimit të autonomisë financiare të pushtetit vendor, tashmë administrimi i tatimit të biznesit të vogël është transferuar ne strukturat tatimore të pushtetit vendor. Duke bërë këtë, veçanërisht në zonat rurale tatimpaguesit janë më afër autoriteteve për mbledhjen dhe administrimin e tatimeve. Gjithashtu, janë transferuar në nivel vendor, taksa të rëndësishme të cilët kanë ndikuar jo vetëm në rritjen e të ardhurave vendore por kanë shërbyer dhe shërbejnë si instrumente efikase për të bërë politika fiskale vendore, që njëherësh janë politika zhvilluese lokale. Për vitin 2012 taksa vendore për regjistrimin e përvitshëm të automjeteve u zëvendësua me taksën për qarkullimin e automjeteve baza e së cilës është e lidhur me efektet që qarkullimi i automjeteve ka në mjedis. Gjithashtu, në favor të buxheteve vendore është shtuar si taksë e re taksa e rentës minerare, e cila do ketë efekte pozitive në rritjen e buxheteve vendore.

Objektivi i Qeverisë për vitin 2012 është vazhdimi i përshpejtimit të procesit të reformës së decentralizimit në disa sektorë të rëndësishëm. Konsolidimi dhe shtimi i të ardhurave lokale përbën jo vetëm një nga objektivat e sigurimit të qëndrueshmërisë së reformës së decentralizimit. Ky objektiv do të arrihet duke rritur efektivitetin në mbledhjen e tatimeve vendore, kryesisht taksës mbi biznesin e vogël, taksës së ndërtimeve dhe taksës së tokës bujqësore dhe duke fuqizuar gjithashtu efektivitetin në menaxhimin e aseteve lokale, si një instrument i rëndësishëm për të rritur të ardhurat lokale dhe investimet për infrastrukturën lokale. Transferimi i aseteve në pronësi të njësive të pushtetit vendor është një proces i cili do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2012. Ky proces krijon mundësi për rritjen e të ardhurave financiare nëpërmjet përdorimit të tyre vetë ose nga palë të treta ose nëpërmjet shtimit të kolateralit garantues në huamarrje që do të përdoren për financimin e investimeve publike. Reforma e decentralizimit fiskal do të përqendrohet në saktësinë e marrëdhënieve fiskale ndërmjet pushtetit lokal dhe qendror.

Procesi i buxhetimit lokal deri tani është kryer mbi një bazë rastësore. Mekanizmi i përcaktimit të transfertave të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara nuk është akoma i parashikueshëm dhe jo tërësisht transparent, ku shumë shpesh bëhet objekt diskutimi dhe negocimi (burokratik dhe politik) ndërmjet organeve të pushtetit vendor dhe ministrive përkatëse të linjës. Për këtë qëllim, barazimi horizontal do të përmirësohet më tej, me qëllim që të reflektohet më mirë dinamika demografike dhe ekonomike e rajoneve të ndryshme të vendit, si dhe pabarazitë ndërmjet tyre. Në fushën e zhvillimit lokal dhe rajonal, qysh nga buxheti i vitit 2010, skema e grandeve konkurruese u shndërrua në një skemë të re të quajtur "Fondi i zhvillimit të rajoneve". Krijimi i fondit ka rritur shkallën e decentralizmit, duke inkurajuar komunitetet lokale, institucionet dhe politikën për kryerjen e një reforme administrative me synim, zmadhimin e njësive vendore, duke i shndërruar ato në njësi më të afta absorbuese të fondeve.

Në kontekstin e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", përpjekjet do të përqendrohen në përcaktimin e aftësive lokale dhe konsolidimit të marrëdhënieve ndërmjet Qeverisë qendrore (Ministria e Financave) dhe pushtetit lokal në formulimin e politikave fiskale dhe reformave të propozuara në lidhje me decentralizimin, në kontekstin e PBA-së.

Përmirësimi dhe sqarimi i kuadrit legjislativ për procesin e zbatimit të buxhetit lokal. Fushat kryesore të ndërhyrjes nga Ministria e Financave janë: i) procedurat e thesarit, kryesisht ato që janë në lidhje me diferencat e mëdha që kanë lidhje ndërmjet sasisë së parashikuar të grandit të kushtëzuar nga njësitë e qeverisjes vendore dhe sasisë faktike; ii) lëshimin në kohë dhe qartësinë e udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe hollësitë në lidhje me procesin e buxhetit; iii) rregullat për zbatimin e buxhetit në pajtim me sistemin e llogarinë e thesarit të vetëm; iv) raportimin financiar dhe sistemin e llogarive, si dhe çështjet sqaruese në lidhje me "ndjekjen" e pajisjeve të buxheteve lokale dhe përdorimin e tyre në pajtim me buxhetin e aprovuar.

Përmirësimi i kuadrit legjislativ të tatimeve vendore, duke marrë parasysh mundësinë e rishikimit të shkallës bazë të taksës mbi pasurinë dhe taksës mbi biznesin e vogël dhe mundësinë e miratimit të një dispozite që të lejojë pushtetin vendor të ndryshojë nivelet e taksave bazuar mbi inflacionin. Reforma e decentralizimit fiskal ka efekt pozitiv në rritjen e të ardhurave lokale nga taksat dhe tarifat kundrejt transfertës së kushtuar të buxhetit të shtetit. Autonomia fiskale e pushtetit lokal është rritur nga viti në vit. Për vitin 2012 struktura e burimeve të të ardhurave për pushtetin lokal është 54 për qind nga tatimet dhe tarifat dhe 46 për qind nga buxheti i shtetit (transferta e pakushtëzuar). Për vitin 2012 janë bërë përmirësime në kriteret e shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar. Gjithashtu, transferta e pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore për vitin 2012 është rritur 4% krahasuar me vitin 2011.

Me qëllim zhvillimin ekonomik vendor dhe krijimin e kushteve sa më të mira për bizneset vendore, transfertën e pakushtëzuar të njësive të qeverisjes vendore duhet ta përdorin me prioritet për mbjelljen dhe shtimin e pemëve drufrutore, si dhe shtimin e hapësirave të gjelbra. Për këtë arsye në ligjin e buxhetit të vitit 2012 është përcaktuar, se komunat dhe bashkitë do të përdorin jo më pak se 10 për qind të transfertës së pakushtëzuar për mbështetjen e pemëtarisë dhe gjelbërimit.

Me qëllim rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike në nivel vendor me ligjin e buxhetit të vitit 2012, njësive të qeverisjes vendore u janë vënë kushte standarde për përdorimin e fondeve për shpenzimet e personelit duke inkurajuar përdorimin e sa më shumë fondeve vendore për investime dhe shërbime publike.

Zbatimi i kuadrit fiskal në huamarrjen lokale. Bazuar në ligjin nr. 9869, datë 4.2.2008 “Mbi huamarrjen vendore”, njësitë e qeverisjes vendore kanë filluar të aplikojnë dhe të marrin hua. Sipas këtij ligji, qeveria është e përkushtuar në: i) bashkërendimin e politikave për borxhin kombëtar dhe lokal (në një mënyrë të tillë që pushteti qendror të mbajë nën kontroll natyrën dhe zgjerimin e detyrimeve fiskale të pushtetit vendor); ii) sigurimin e një huamarrjeje të kujdesshme lokale (në lidhje me menaxhimin e riskut në kontekstin e financave publike); iii) sistemin e garancive lokale për huamarrjen; iv) mekanizmat e monitorimit dhe kontrollit.

Financimi lokal. Me qëllim që të konsolidohen financat vendore gjatë vitit 2012 dhe në vazhdim, përpjekjet e qeverisë do të përqendrohen mbi identifikimin e problemeve që i përkasin nevojës së një kuadri rregullator për financat vendore, të cilat do të synojnë të përcaktojnë procedurën për hartimin dhe zbatimin e buxhetit vendor, skemën e financimit të transfertës së pakushtëzuar për pushtetin vendor, problemet e llogarive dhe auditimin e jashtëm dhe të brendshëm, asistimi i njësive vendore që kërkojnë të marrin hua, transparencën etj. Ky proces do t’i nënshtrohet diskutimeve me grupe të ndryshme të interesit dhe në përfundim të këtij procesi do të hartohet një ligj i veçantë për “Financat vendore”.

Objektivat e investimeve në sektorin publik

Për periudhën 2013-2015, qeveria do të vazhdojë të caktojë prioritetet për alokimet për investimet në sektorë, të tillë si: arsimi, shëndetësia, infrastruktura dhe siguria, për qëllimet e mëposhtme:

Arsimi

Shpenzimet kapitale në këtë sektor, në periudhën 2013–2015, do të përqendrohen kryesisht në financimin e arsimit parauniversitar për:

- ndërtimin e shkollave të reja;
- rindërtimin e shkollave ekzistuese;
- sigurimi i laboratorëve të pajisur;
- sigurimi i internetit në shkollë.

E vlen të përmendet që shuma e caktuar për ndërtimet dhe rindërtimet e shkollave të arsimit parauniversitar janë pjesë e fondit të zhvillimit rajonal, ku njësitë e pushtetit lokal konkurrojnë dhe përzgjidhen mbi bazën e propozimeve të projekteve të tyre sipas kritereve të pushtetit qendror.

Shëndetësia

Investimet në këtë sektor prioritar për periudhën 2013-2015 përqendrohen kryesisht në:

- ndërtimin dhe rindërtimin e ambienteve spitalore;
- ndërtimin dhe rindërtimin e ambienteve të kujdesit parësor;

- blerjen e pajisjeve dhe aparateve mjekësore.

Infrastruktura

Fillimisht, duhet theksuar se fakti që shpenzimet kapitale në këtë sektor kanë pjesën më të madhe të shpenzimeve totale kapitale për periudhën 2013-2015. Drejtimet kryesore të investimeve në këtë sektor përfshijnë:

- Investimet në sektorin e rrugëve kombëtare, ndërtimi dhe rehabilitimi i rrjeteve kryesore, si dhe sistemimi dhe asfaltimi i rrjeteve kombëtare. Prioritetet e këtyre investimeve janë ndërtimi i korridoreve rrugore kryesore, si: përfundimi i rrugës dhe i tunelit Tiranë-Elbasan, përfundimi i unazës së re të Tiranës, ndërtimi i dy seksioneve rrugore të boshtit qendror jugor Berat-Lushnjë dhe Elbasan-Berat, aksi veri-jug, vazhdimi i ndërtimit të Rrugës së Arbrit si degë e Korridorit të Tetë, *By Pass*-et e Fierit, Tepelenës, Gjirokastrës, etj.
- Investimet në zgjerimin dhe përmirësimin e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimeve;
- Investimet në ndërtimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës së porteve të Durrësit dhe Vlorës.

Bujqësia

Planifikimi për shpenzimet kapitale në këtë sektor për periudhën 2013-2015 do të shënojë një rritje të konsiderueshme si sektor prioritar i ekonomisë.

Drejtimet kryesore të investimeve në këtë sektor përfshijnë:

- përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, në fushën e sigurisë rrugore, monitorimi dhe kontrolli i produkteve ushqimore sipas standardeve të BE-së;
- rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes në Ultësirën Perëndimore dhe në gjithë vendin, duke rritur qëndrueshmërinë e burimeve ujore dhe sigurinë e digave;
- rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet (duke përfshirë: kanalet kryesore të drenazhimit, kolektorët kryesorë të drenazhimit, kulturat dhe derdhjet e tyre në det), kryesisht në Ultësirën Perëndimore në Shkodër, Lezhë, Kurbin, Durrës, Kavajë, Lushnjë , Fier, Vlora, Saranda dhe Elbasan, Berat dhe Korçë;
- ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e mbrojtjes së nivelit te pjesët më të cenueshme, kryesisht në lumenjtë e Bunës, Kirit, Drinit të Zi, Mat, Shkumbin, Seman, Vjosa, Osumi, Drinos, Bistrica, rrymat malore, kanalet e digave me nivel të lartë me mbrojtje të siguruar.

Zhvillimi rural

Një ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin rajonal në zonat rurale dhe integrimin e politikave sektoriale të pushtetit qendror në nivel rajonal do të ketë caktimi i fondeve sipas Fondeve të Zhvillimit Rajonal. Shpërndarja e këtij fondi për investime publike është e lidhur ngushtë me mbështetjen që i është dhënë strategjisë së Qeverisë për reformën dhe zhvillimin ekonomik në nivelin qendror dhe lokal. Ky fond përdoret për të financuar projektet që janë brenda pushtetit lokal dhe i zbatojnë ato si sektorë prioritarë të përmendur më sipër.

2.3 Menaxhimi institucional i financave publike

Që nga viti 2008, Ministria e Financave po zbaton ligjin e ri për buxhetin "Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", që ka ndryshuar rrënjësisht qëndrimet e kaluara në planifikimin e financave publike, proceset e monitorimit dhe zbatimit. Ai ka identifikuar ose ripërkufizuar rolet e aktorëve kryesorë në të gjithë procesin buxhetor, nëpërmjet prezantimit të koncepteve të reja si punonjës i parë i autorizuar, punonjës autorizues, punonjës ekzekutiv etj., që janë zbatuar te struktura e secilit institucion buxhetor.

Karakteristikat kryesore të këtij ligji mbeten:

- Institucionalizimi i procesit të PBA-së për njësitë qeverisëse lokale dhe qendrore, si dhe njësitë e fondeve speciale, me qëllim vendosjen e një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet politikave të qeverisë dhe caktimit të fondeve buxhetore;
- Përcaktimi i një zinxhiri të qartë të përgjegjësive që përcaktojnë një listë të qartë të përgjegjësive për të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e menaxhimit të financave publike;
- Përmirësimi i marrëdhënieve fiskale ndërmjet organeve të pushtetit lokal dhe qendror;

- Zbatimi i standardeve statistikore dhe ato të llogarive publike në pajtim me standardet ndërkombëtare si GFS dhe SNA 93;

- Zbatimi i sanksioneve në rastin e mospërputhjes me procedurat e duhura të përcaktuara në këtë ligj.

Në fushën e kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP), legjislacioni parësor është miratuar dhe ka hyrë në fuqi duke filluar nga viti 2010. Ligji nr. 10 296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" (MFK) ka hyrë në fuqi në janar 2011; ligji nr. 10 294 "Për inspektimin financiar publik" ka hyrë në fuqi në korrik 2010 dhe ligjin "Për auditim të brendshëm", të ndryshuar ka hyrë në fuqi më tetor 2010. Sa i përket legjislacionit dytësor, manualet e "Menaxhimit financiar dhe kontrollit" dhe "Auditimit të brendshëm" janë miratuar nga Ministri i Financave dhe kanë hyrë në fuqi në të njëjtën kohë me ligjet përkatëse dhe aktet e tjera nënligjore do të miratohen brenda 2011-s.

Disa aktivitete të zbatimit kanë filluar në vitin 2010, gjatë fazës së miratimit të bazës ligjore dhe konsistojnë në:

- mbajtjen e seminareve në nivel rajonal për ndërgjegjësimin dhe informimin (tremujorin e fundit të 2010) me pjesëmarrjen e nëpunësve autorizues dhe ekzekutues të njësive të qeverisjes vendore;

- regjistri i riskut për Ministrinë e Financave është projektuar për herë të parë në shtator 2010.

- pyetësorët e vetëvlerësimit për sistemet e MFK-së janë dërguar në institucionet publike qendrore dhe vendore. Të dhënat e mbledhura shërbyen si burim informacioni për përgatitjen e raportit të konsoliduar të KBFP.

- raportin e konsoliduar të KBFP-së për vitin buxhetor 2010, u përgatit dhe u dorëzua nga Ministri i Financave për KLSH-në dhe Këshillin e Ministrave (maj 2011).

Në fakt, sfida e Qeverisë Shqiptare është implementimi i një sistemi modern të KBFP-së dhe futjen e MFK-së në mënyrë që të sjellë përmirësime jo vetëm në "kontroll", por edhe në menaxhimin financiar dhe nga kjo një "vlerë për para" më të mirë në shpenzimet publike. Zbatimi i suksesshëm i bazës ligjore kërkon një ndryshim të rëndësishëm në marrëveshjet e menaxhimit dhe përmirësimin e përgjegjshmërisë menaxheriale. Në këtë kuadër:

1. "Plani strategjik për një zbatimi modern të sistemit të MFK-së (2011-2016)" është përgatitur nga NjQH/MFK, në bashkëpunim me ekspertët e SIGMA-s dhe miratimin e Ministrit të Financave me urdhrin nr.11 841, datë 2011/6/10.

2. Shkresa zyrtare për hapat që duhen ndjekur për një zbatim korrekt të kuadrit ligjor të MFK-së, i është dorëzuar të gjitha subjekteve publike të qeverisë qendrore dhe lokale, në mars 2011.

3. Udhëzimi i Ministrit të Financave për përgjegjësitë e titullarëve të njësive dhe nëpunësit autorizues përkatës.

4. Seminare dhe tryeza të rrumbullakëta mbi çështjet e MFK (sidomos të menaxhimit të riskut) janë organizuara me disa institucione qendrore si KLSH, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Transportit, Zyra e Administratës Gjyqësore etj.

5. Aktet nënligjore në përputhje me ligjin MFK, në fushat e mëposhtme, janë në proces për t'u miratuar brenda vitit 2011:

a) Formati, përmbajtja dhe afatet për dorëzimin e deklaratës së cilësisë në sistemet MFK;

b) Standardi mbi gjurmët e auditit që kanë të bëjnë me procedurat e unifikuara në të gjithë subjektet e sektorit publik;

c) Menaxhimi i dokumentacionit, qarkullimin dhe asgjësimin e aseteve të subjekteve publike.

6. Aktet nënligjore në fushën e financave publike të inspektimit, janë miratuar nga Ministri i Financave, si më poshtë:

a) Nr. 11, datë 2011.5.16 "Për kriteret e kryerjes së inspektimit financiar publik".

b) Udhëzim i Ministrit të Financave nr. 36, datë 2011.5.16 "Për kriteret e përzgjedhjes për inspektorët e inspektimit financiar publik".

c) Udhëzim i Ministrit të Financave "Për kontrollin e cilësisë dhe kryerjen e aktiviteteve publike të inspektimit financiar", të miratuar në korrik 2011.

d) Lista e inspektorëve të zgjedhur është miratuar në shtator 2011.

7. Forumi i MFK-së në faqen e Ministrisë së Financave, do të jetë gati së shpejti dhe do të krijojë një rrjet të nëpunësve të autorizuar dhe zbatues të enteve publike.

8. Institucioni pilot për zbatimin e fazës së parë të planit strategjik për zbatimin e sistemit modern të MFK-së (2011-2016), është zgjedhur Ministria e Transportit dhe Punëve Publike dhe raporti i vlerësimit është hartuar dhe diskutuar me palët e interesuara

9. Në lidhje me zhvillimin e metodologjisë së kontabilitetit për miratimin e IPSAS, gjatë majit 2011 u mbajt në Ministrinë e Financave një seminar për prezantimin e IPSAS nr. 6 dhe nr. 24. Aktualisht Ministria e Financave ka aplikuar për ndihmë ndërkombëtare në këtë fushë për të siguruar zbatimin e reformës së kontabilitetit.

Zhvillimi i sistemit institucional në lidhje me cilësinë e financave publike konsiston në menaxhimin efektiv të procesit të ekzekutimit të buxhetit të qeverisë së përgjithshme; menaxhimit financiar optimal të burimeve qeveritare, të ofruara këto nëpërmjet një programimi dhe monitorimi të hyrjeve dhe daljeve në llogaritë e njësive shpenzuese të qeverisë që do të furnizohen në kohë me burimet e nevojshme për një funksionim normal të shërbimeve publike; regjistrim të përditësuar të të gjitha fazave të përgjegjësisë-shpenzimeve buxhetore për hartimin e bilancit të trashëgimisë së qeverisjes qendrore; administrimin e llogarisë së vetme të thesarit në Bankën Qendrore, rritjen e transparencës fiskale të qeverisë duke përmirësuar procedurat e kontrollit *ex-ante* dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar; Përmirësimit të vazhdueshëm të thesarit duke përdorur përvojën më të mirë ndërkombëtare dhe propozimit të ndryshimeve të mundshme për ta modernizuar atë, duke krijuar mundësinë e kalimit gradual nga një sistem me "bazë të kontabilitetit të parasë *cash*" në sistemin me "bazë *accrual* të kontabilitetit"; zhvillimin e AMoFTS (*Oracle E-Business Suite*), të një sistemi modern për përpunimin e transaksioneve të qeverisë së përgjithshme në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe praktikat e raportimit financiar, përdorimi i likuiditeteve dhe pasurisë së përgjithshme të qeverisë në mënyrë më ekonomike, më efiçente dhe më transparente. Këto janë mbështetur nga projekti IPA 2008 "Mbështetjen dhe zgjerimin e sistemit të thesarit shqiptar" i zbatuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim nëpërmjet menaxhimit indirekt të centralizuar.

Projekti ka filluar më 15 prill 2011 dhe është planifikuar të vazhdojë për 36 muaj deri në prill 2014. Është planifikuar që nëpërmjet projektit, 50 institucione buxhetore do të kenë akses në sistemin e-AMoFTS për ekzekutimin e tyre buxhetorë (50-30 BI-së). Vëllimi total i projektit është 1.525.000 euro prej të cilave 1,5 milionë euro është dhënë nga Komisioni Europian dhe 25,000 nga Qeveria e Shqipërisë.

Pritshmëri të tjera lidhur me këtë projekt janë:

- Forcimi i procesit të parashikimeve dhe menaxhimit të likuiditeteve.
- Përmirësimi i përgjithshëm i disponibilitetit, cilësisë, integritetit dhe besueshmërisë së informacionit që kanë të bëjnë me arkëtimin e të ardhurave dhe llogaritë e pagueshme, të nevojshme për parashikim të *cash-it* dhe analizës së trendeve që janë pjesë përbërëse e procesit modern të parashikimit të *cash-it*.
- Përmirësimi i përgjithshëm i transparencës, rëndësisë, cilësisë dhe afateve kohore të ekzekutimit të buxhetit të konsoliduar duke kapur transaksionet në burim.
- Nxitja e një pjesëmarrjeje më të lartë për të siguruar kontrolle të brendshme më të mira për sa i përket të ardhurave dhe shpenzimeve publike në ministritë e linjës, njësitë shpenzuese dhe bashkive e komunave, si dhe njësive të tjera shpenzuese qeveritare.
- Konsolidimi i gjithë të ardhurave në Bankën Qendrore.

Avantazhet nga perspektiva e PFM:

- Mundësi për të forcuar procedurat.
- Lejim të qeverisë për optimizimin e mëtejshëm të administrimit të të ardhurave dhe procesin e mbledhjes së tyre.
- Ripërcaktimin e rolit të thesarit, nga mbajtja manuale e deri te procesi i ekzekutimit të buxhetit të konsoliduar.

3. OBJEKTIVAT E REFORMAVE STRUKTURORE

3.1 Pengesat e rritjes ekonomike dhe agjenda e reformave strukturore

Në vitin 2012, rritja ekonomike pritet të nxitet nga konsumi privat vendas dhe investimet, ndërkohë që kërkesa e jashtme është parashikuar të ketë një kontribut më të vogël se në vitin e tanishëm. Përveç kësaj, kushtet aktuale financiare dhe niveli i besimit të konsumatorit dhe biznesit do të mbështesin kërkesën e sektorit privat vendas. Këto zhvillime që nxisin rritjen e PBB-së, do të çojnë në një zgjerim të deficitit të llogarisë korente deri në fund të vitit që nuk mendohet të gjenerojë presione inflacioniste të rëndësishme nëpërmjet kursit të këmbimit.

Në të kaluarën, rritja e PBB-së reale ishte përkrahur nga sektori fiskal dhe kërkesa e huaj, ndërsa konsumi privat dhe investimet e brendshme vazhduan të tregojnë një ecuri të ngadaltë. Pasiguria ende e lartë në lidhje me zhvillimet e ardhshme ekonomike dhe norma e ulët e shfrytëzimit të kapaciteteve pengojnë rritjen e kërkesës së brendshme private. Nga ana tjetër, moderacioni në ritmin e shpenzimeve qeveritare dhe kërkesës globale do të thotë kontribut më të ulët të këtyre dy komponentëve në rritjen reale të PBB-së deri në fund të 2011. Kjo pamje pritet të vazhdojë në vitin e ardhshëm. Për 2012, kërkesa e brendshme private pritet të nxitet nga përmirësimi i kushteve të brendshme financiare. Në përgjithësi, rritja e PBB-së reale në 2012 do të mbetet nën kapacitetin e mundshëm.

Një faktor tjetër i marrë në analizë është ndjeshmëria e ekonomisë shqiptare ndaj aktivitetit global në terma sektorialë dhe gjeografikë. Ekonomia shqiptare pritet të ndikohet nga përkeqësimi i kushteve ekonomike në vendet fqinje europiane, edhe pse jo në një shkallë serioze. Deri tani, vendi ka shënuar norma pozitive rritjeje, të cilat kanë qenë megjithatë, nën mesataren historike. Ndërsa sektori i jashtëm ka qenë një nxitës i rëndësishëm i rritjes ekonomike në 2 vitet e fundit, një ngadalësim në kërkesën e jashtme (kryesisht europiane) pritet të ndikojë në këtë sektor në të ardhmen e afërt.

Përhapja dhe intensiteti me të cilin vendet evropiane do të goditen nga kriza e borxhit do të përcaktojë ndikimin mbi ekonominë tonë. Parashikimi ynë bazë supozon se krizës së borxhit do t'i jepet një zgjidhje e qëndrueshme dhe efikase. Në këtë drejtim, efekti në ekonominë tonë është afatshkurtër. Treguesit makroekonomikë sugjerojnë se ekonomia shqiptare mund të përballojë këtë situatë të përkohshme dhe të jetë në gjendje për të ruajtur ekuilibrat afatgjatë të saj. Në një rast të keq, që të dyja çështjet e borxhit të Greqisë dhe Italisë të mbeten të pazgjidhura ose të përhapen në vende të tjera me dëme të konsiderueshme për Eurozonën, goditja për rritjen ekonomike do të jetë shumë më e rëndësishme dhe me efekte afatmesme. Më poshtë, jepen disa nga kanalet përmes së cilëve kushtet ekonomike dhe financiare në Greqi dhe Itali ndikojnë në aktivitetin tonë ekonomik.

Kriza e borxhit sovran në Greqi ka treguar pak ndikim në ekonominë shqiptare për shkak të përpjesës së kufizuar të këtij vendi në importet ose eksportet tona dhe fleksibilitetin e kohëve të fundit të treguar nga firmat eksportuese për të diversifikuar gjeografikisht. Ekspozimi në Greqi është i vogël. Investimet e huaja direkt nga Greqia kanë qenë në rënie gjatë viteve të fundit, edhe pse investimet e përgjithshme të huaja direkte janë rritur. Bankat e huaja me kapital grek që operojnë në Shqipëri janë të kapitalizuara mirë. Pesha e aktiveve të tyre ndaj totalit të aktiveve bankare ka qenë në rënie gjatë viteve të fundit. Portofoli i tyre i kredive është pakësuar dhe bankat e tjera kanë rritur pjesën e tyre në treg. Nga ky aspekt, efekti i krizës së borxhit në Greqi në ekonominë tonë reale pritet të jetë i kufizuar.

Ekspozimi i Shqipërisë në ekonominë italiane është më i madh. Pjesa e eksporteve tona në Itali është e konsiderueshme (50%). Deri tani, problemet financiare në Itali kanë pasur pak ndikim në tregti, ndoshta për shkak të faktit se ky vend nuk është gjithmonë destinacioni i fundit i eksporteve tona. Megjithatë, një përkeqësim i mëtejshëm në Itali do të ketë një ndikim të madh në ekonominë tonë. Remitancat, të cilat përdoren kryesisht për të financuar konsumin e familjeve pritet të bien në mënyrë të konsiderueshme (edhe në kombinim me ato nga Greqia). Ndikimi nëpërmjet investimeve të huaja direkte pritet të jetë më i vogël, duke qenë se IHD nga Italia kanë rënë gjithashtu dhe pjesa e tyre në PBB-në tonë është relativisht e vogël.

Shqetësimi ynë kryesor do të jetë ruajtja e një sistemi të shëndoshë financiar dhe për të adresuar këtë risk do të merren të gjitha masat e nevojshme për të trajtuar çdo çështje në lidhje me stabilitetin e sistemit financiar. Sot konstatohet se bankat kanë pasur mjaft vështirësi në ekzekutimin e kolateraleve të lëna peng nga kredimarrësit për kreditë e marra në rast të mosshlyerjes së detyrimeve përkatëse. Është

vërejtur se këto pengesa kanë qenë të natyrës ligjore ose burokratike. Në jo pak raste ka dalë në pah sjellja burokratike e institucioneve të përfshira, gjë që e ka shtyrë në mënyrë të panevojshme procesin. Ky fenomen - ekzekutimi i kolateraleve të lëna peng - ka qenë shqetësim për industrinë bankare dhe madje ka shtyrë edhe Bankën e Shqipërisë të jetë e përfshirë në diskutime dhe propozime konkrete në këtë drejtim. Banka e Shqipërisë, në rolin e institucionit mbikëqyrës të sistemit bankar, ka ndërmarrë një sërë hapash në evidentimin, impaktin dhe adresimin e problematikave të procesit të ekzekutimit të kolateraleve dhe hallkave të caktuara të tij me qëllim ngritjen e tyre në një nivel më të lartë ndërinstitucional. Angazhimi institucional i të gjitha palëve për ndjekjen në vazhdimësi të problematikave të vlerësuara në procesin e ekzekutimit të kolateralit, krijon pritshmëri pozitive lidhur me ndryshime konstruktive në këtë drejtim. Ndërkohë, ecuria dhe zhvillimet në praktikat e ekzekutimit të kolateraleve si pasuri e paluajtshme do të ndiqen në vazhdimësi me vëmendje të veçantë. Njëkohësisht do të punohet dhe në drejtim të koordinimit apo bashkëpunimit nëpërmjet grupeve të punës *ad-hoc* edhe me institucionet e tjera që do të përfshihen në përmirësimin e procedurave që lidhen me ekzekutimin e kolateralit.

3.2 Fushat kryesore te reformave strukturore

3.2.1 Sektori i ndërmarrjeve

Zhvillimi i ndërmarrjeve të sektorit privat

Pavarësisht implikimeve të krizës globale, ekonomia ka demonstruar dinamizëm dhe Shqipëria ka mundur të realizojë një rritje ekonomike pozitive të kënaqshme dhe të mbajë nën kontroll inflacionin. Kjo i atribuohet kryesisht politikave të ndërmarra në vitet e kaluara lidhur me përmirësimin e klimës së biznesit, nxitjes së politikave të partneritetit publik–privat dhe mbajtjes së një normë të lartë të investimeve në ekonomi.

Gjatë vitit 2010 është siguruar një rritje pozitive e lehtë ekonomike prej 3.9% kundrejt GDP-së krahasuar me rritjen prej rreth 8% gjatë vitit 2008. Sektori privat siguron mbi 80% të produktit të brendshëm bruto dhe rreth 82% të punësimit, dhe përbën aktualisht faktorin dhe kontribuesin kryesor të rritjes ekonomike dhe punësimit dhe sidomos të zbutjes së varfërisë. Sistemi bankar është tërësisht privat, gjë që ka mundësuar jo vetëm zhvillimin e këtij sektori, por edhe përmirësimin e shërbimeve financiare në treg.

Referuar të dhënave të INSTAT-it, numri i subjekteve aktive deri në fund të vitit 2010 arriti në 100,687 gjë që tregon një ulje të lehtë krahasuar me vitin 2009.

Për sa i takon strukturës së ndërmarrjeve, në fund të vitit 2010 ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (sipas përkufizimit të BE-së për NVM-të) me deri në 250 punonjës, përbënin 99,9% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve aktive. Për vitin 2010, pranë QKR-së janë regjistruar 16,433 biznese te reja ose 24% më shumë se viti paraardhës.

Shpërndarja gjeografike e bizneseve në Shqipëri nuk paraqet ndryshim kundrejt vitit paraardhës. Rreth 50% e ndërmarrjeve aktive janë përqendruar në qarqet e Tiranës dhe të Durrësit. Shpërndarja e ndërmarrjeve aktive sipas sektorit ekonomik është: Tregtia 44.4%, hotele, kafe, restorante 15.6%, shërbime të tjera 13.9%, transporti dhe komunikacioni 10.3%, industria 9.9%, ndërtimi 4.2%, bujqësia dhe peshkimi 1.7%. Krahasuar me vitin 2009 rënie më të madhe ka pësuar sektori i tregtisë me rreth 2.9 %, ndërsa rritjen më të madhe sektori i transportit me 0.7%.

Shifra e afarizmit sipas INSTAT-it për vitin 2009 është rritur me 6.2% krahasuar me vitin 2008. Rreth 38% e shifrës se afarizmit vjen nga sektori i prodhimit dhe 62% nga sektori i shërbimeve.

Vlera e shtuar sipas INSTAT-it për vitin 2009 ka pasur një ulje prej 2% krahasuar me vitin 2008. 43% e vlerës së shtuar vjen nga sektori i prodhimit dhe 57% sektori i shërbimeve.

Fluksi i investimeve të huaja direkte gjatë vitit 2010 e vlerësuar nga Banka e Shqipërisë ishte rreth 827 milionë euro që përbën një rritje me rreth 17.1 për qind kundrejt vitit 2009. Për 6-mujorin e parë të vitit 2011, fluksi i IHD ishte 302 milionë euro, ose 15% më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Vlerësohet që pjesa më e madhe e fluksit hyrës të investimeve të huaja për vitin 2010 ka ardhur kryesisht nga investimet në sektorin energjetik, investimet në operacionet hidrokarbure në blloqet e kërkimit e të shfrytëzimit, në sektorin bankar, si dhe koncesionet ne sektorin minerar etj. Fluksi i IHD

gjatë vitit 2010 ka ardhur në mungesë të plotë të privatizimeve.

Sipas vendit të origjinës së investimeve të huaja direkte, pjesa më e madhe e kapitalit të huaj të investuar në Shqipëri vjen nga vendet e Bashkimit Europian, që përbën rreth 66% të totalit të investimeve të huaja të realizuara në Shqipëri. Investitori më i madh është Greqia me rreth 41% të investimeve gjithsej, ndërkohë që vendin e dytë e zë Turqia me 14%, vendin e tretë e zënë Shtetet e Bashkuara të Amerikës me 12%. Në vijim, sipas kontributit, janë Austria me 9%, Italia me 8% dhe Gjermania 3%.

Shpërndarja e stokut të IHD sipas sektorëve të ekonomisë është: 33.4% e stokut të IHD është në sektorin financiar, 23.5% në sektorin e transportit dhe komunikacionit, 16.1% në industrinë përpunuese dhe 15.4% në ndërtim.

Numri i ndërmarrjeve aktive të huaja dhe të përbashkëta sipas të dhënave të INSTAT në fund të vitit 2010 arriti në 2924 njësi, nga 2336 në vitin 2009, me një rritje prej 21%. Sipas aktivitetit ekonomik, 31% e ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta i përkasin sektorit të tregtisë, 25% sektorit të përpunimit industrial, 24% në shërbime, 10% në ndërtim, 6% në transport dhe telekomunikacion, 3% në bujqësi dhe peshkim. Për sa i takon shpërndarjes gjeografike të vitit 2009, rreth 68% e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta janë përqendruar në rajonin e Tiranës, e ndjekur nga rajoni i Durrësit me 12%, Vlorës me 4% Korçës me 3%, Shkodra 3%, Elbasani 3%, etj.

Referuar strukturës se ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta sipas madhësisë apo numrit të të punësuarve për vitin 2010, mikrondërmarrjet me 1 deri në 9 të punësuar përbëjnë 79% të numrit total të ndërmarrjeve, ndërmarrjet e vogla me 10 deri në 49 të punësuar zënë 14%, ndjekur nga ndërmarrjet e mesme me 50 deri në 249 punonjës që zënë 6% dhe vetëm 2% të numrit total të tyre e zënë ndërmarrjet e mëdha me mbi 250 të punësuar.

Liria ekonomike për vitin 2011 në Shqipëri vlerësohet mbi mesataren e përgjithshme botërore sipas indeksit për lirinë ekonominë. Shqipëria renditet në vendin e 70 nga 179 vende dhe rezulton me 64 pikë, 2 pikë më pak se viti i kaluar. Nga 10 treguesit kryesor që masin lirinë ekonomike të një vendi, Shqipëria në 9 prej tyre ka një rënie të lehtë.

Volumi tregtar i Shqipërisë për vitin 2010 kapte vlerën 4648.7 mln/€ me një rritje në masën 14.6% krahasuar me vitin 2009. Për vitin 2010 volumi i përgjithshëm tregtar është në raportet 74.9% importe dhe 25.1% eksporte dhe krahasuar me një vit me parë në vitin 2009 raportet e volumit të përgjithshëm tregtar ishin importe 80.7% dhe eksporte 19.3%.

Eksportet për vitin 2010 arritën në vlerën 1167.1 mln/€ , me një rritje prej 49% kundrejt vitit 2009. Eksportet nga prodhimi i brendshëm kanë vlerën 548.1 mln/€ , ose 47% të totalit të eksporteve dhe me një rritje të konsiderueshme prej 91.1% krahasuar me vitin 2009. Eksporti me regjim të përpunimit aktiv (material porositësi për rieksport) për vitin 2010 arriti në 619 mln/€, (824mln/$), ose 53% të totalit të eksportit me një rritje prej 24.7% kundrejt vitit 2009.

Raporti i eksportit ndaj prodhimit të brendshëm bruto (PBB) ose prirja e ekonomisë shqiptare për të eksportuar në vitin 2010 arriti në masën rreth 12.3%, kundrejt vitit 2009 ku ky tregues ka qenë 9.1%. Grupi i produkteve ushqimore (1-24 kapitujt e parë të HS) ka zënë 5.8% ndaj totalit të eksportit duke arritur një vlerë prej 67.5 mln/€ (ose 89.7 mln/$) me një rritje ndaj vitit 2009 me 18.8%. Grupi i produkteve joushqimore (industriale 25-97 kap. HS) ka zënë 94.2% të totalit të eksporteve, me një vlerë prej 1099.5 mln/€ (ose 1459.3 mln/$). Ky është grupimi me peshën më të madhe në eksport.

Eksportet sipas destinacionit për vitin 2010 paraqiten si më poshtë:

- në pjesën më të madhe të tyre, eksportet e mallrave kanë shkuar drejt vendeve të BE-së, duke arritur në 819 mln/€ ose 70.2% të totalit të eksporteve dhe me një rritje prej 32% kundrejt vitit 2009. Eksportet drejt BE-së shkojnë kryesisht drejt Italisë, Greqisë, Gjermanisë etj.
- Më pas renditen vendet e CEFTA-s me 119 mln/€ ose 10.2% të totalit të eksportit, me një rritje prej 27% ndaj vitit 2009
- Me vendet e EFTA-s, gjatë vitit 2010 ka pasur një rritje rreth 4 herë, duke arritur në vlerën 49.6 mln/€ (ose 4.2% të totalit të eksportit).

Për sa i përket shteteve kryesore drejt të cilave kanë shkuar eksportet shqiptare për vitin 2010 ato renditen si më poshtë: Italia 50.9%, Kosova 6.1%, Turqia 6%, Kina 5.5%, Greqia 5.4%.

Grup-mallrat më peshën më të madhe për vitin 2010 janë grupi i tekstil-konfeksioneve dhe këpucarisë (34.6%), produktet minerale, lëndët djegëse dhe energjia elektrike (27.8%), materiale ndërtimi (20.4 %) dhe produktet bujqësore dhe blegtorale (5.8%).

Për 9-mujorin e vitit 2011 eksportet kapën vlerën 1045.8 mln/€, me një rritje prej 21.2%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010. Rritja më e madhe është regjistruar në grup-mallrat materiale ndërtimi dhe metale; minerale, lëndë djegëse, energji elektrike, lëkurë dhe artikujt prej tyre etj.

Importet për vitin 2010 kanë arritur vlerën prej 3481.5 mln/€, në CIF, me një rritje prej 6.4% krahasuar me vitin 2009. Për vitin 2010 importet përbejnë rreth 75% të volumit të përgjithshëm tregtar. Për periudhën e 9-mujorit të vitit 2011, vlera e importeve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010 është rritur me 16.4%, duke arritur në vlerën prej 2794.6 mln/€.

Politikat e ndërmarra për zhvillimin e sektorit privat

Objektivi kryesor i politikës së Qeverisë për zhvillimin e sektorit privat ka konsistuar në reformimin tërësor të kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e biznesit duke synuar me përparësi përmirësimin e klimës së biznesit, reduktimin e barrierave administrative, si dhe për implementimin e Small Business Act, SBA. Politikat kryesore të ndërmarra për zhvillimin e sektorit privat, kanë konsistuar në sa më poshtë:

1. Zbatimi i strategjisë së inovacionit të biznesit dhe teknologjisë. Strategjia është hartuar me mbështetjen e projektit IPA 2007 dhe është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 104, datë 9.2.2011. Në zbatim të kësaj strategjie është miratuar "Programi strategjik për zhvillimin e inovacionit dhe teknologjisë së SME-ve për periudhën 2011-2016", që orientohet në zhvillimin e 4 programeve të rëndësishme si: fondi i inovacionit; shërbimet e inovacionit për biznesin; programi për inkubatorët e biznesit dhe programi për zhvillimin e klasterave. Për implementimin e strategjisë dhe programeve të saj, pranë AIDA-s është ngritur qendra e ndërmjetësimit të biznesit dhe inovacionit (BRIC).

BRIC do të funksionojë si ndërmjetësi kryesor dhe lehtësuesi për promovimin e inovacionit dhe zhvillimit të teknologjisë në biznese duke siguruar lidhjet e këtij të fundit me institucionet e tjera si AKTI-n, AKSHI-n, universitetet, qendrat e ekselencës, AIDA –n etj.

2. Reduktimi i kostos dhe kohës së regjistrimit të një biznesi të ri. Sipas *Doing Business* 2011-2012, në lehtësirat për të bërë biznes, Shqipëria renditet në vendin e 82-të (nga 183 vende të analizuara). Koha për regjistrimin e një biznesi është reduktuar në 1 ditë në raport me 28 ditë që nevojiteshin më parë në Gjykatë. Për vitin 2010, pranë QKR-së janë regjistruar 16,433 biznese të reja ose 24% më shumë se viti paraardhës. Gjate 9-mujorit të parë 2011 janë regjistruar 10,017 biznese të reja.

3. Reduktimi i kohës dhe hapave për fillimin e një biznesi. Tashmë nevojiten vetëm 5 hapa për hapjen e një biznesi të ri nga 10 hapa që nevojiteshin një vit më parë dhe vetëm 5 ditë nga 36 ditë që nevojiteshin një vit më parë. Aktualisht kompanitë përdorin një numër identifikimi të vetëm i cili jepet nga QKR-ja kur bëjnë regjistrimin dhe njëkohësisht gjenerohet në zyrën e taksave, në zyrën e sigurimeve shoqërore dhe në zyrën e punës. Kjo praktikë ka sjellë reduktimin me katër hapa të procedurës për fillimin e biznesit.

4. Thjeshtimi i procedurave të licencimit. Në 9 qershor 2009 është ngritur dhe ka hyrë në funksionim të plotë qendra kombëtare e licencave si një "*one stop shop*". QKL-ja punon sipas parimit të miratimit në heshtje. Licencat e grupit I dhe të II jepen nga vetë QKL brenda 2-4 ditëve. Licencat e grupit të III, të cilat përcillen pranë ministrive të linjës, koha e dhënies së licencës është 10-30 ditë.

Me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 385, datë 19.5.2010 "Për një shtesë në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta"", të ndryshuar, u krijua dhe filloi funksionimin qendra me një ndalesë për aktivitetet në sektorin energjetik. Kjo qendër funksionon si një njësi brenda QKL-së.

Për të asistuar sa më shumë bizneset që operojnë në tregun shqiptar, përveç 8 sporteleve që operojnë në Tiranë, me firmosjen e marrëveshjes mes QKL-së dhe QKR-së, gjatë vitit 2010 sportelet e QKR-së në njësitë e qeverisjes vendore filluan të pranojnë aplikime për pajisjen me licenca/leje të subjekteve tregtare që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Tashmë, QKL-ja operon edhe në

Korçë, Vlorë, Durrës, Elbasan, Peshkopi, Fier, Berat, Gjirokastër dhe Shkodër.

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2010, procesi i licencimit si në sportelet e Tiranës, ashtu dhe në sportelet në rrethe, ka ecur normalisht. Numri i aplikimeve gjatë kësaj periudhe ka qenë më i lartë krahasuar me vitin 2009. Deri në fund të dhjetorit 2010 në QKL janë kryer 4,801 aplikime nga ku janë aprovuar 3,190 dhe janë refuzuar 1,529 të tilla. Numri i aplikimeve në proces ishte 75. Numri i aplikimeve të pranuara në heshtje është 67. Gjatë periudhës janar-9 dhjetor 2011 kanë kërkuar për t'u pajisur me licenca 4944 subjekte dhe janë miratuar e janë aktive 2930 prej tyre, dhe janë miratuar në heshtje 16 licenca.

5. Përmirësimi i skemave të financimit të biznesit. Sipas raportit *Doing Business* 2011-2012 të Bankës Botërore, Shqipëria renditet e 24-ta në botë për lehtësinë për të marrë kredi. Sipas Bankës së Shqipërisë, portofoli i kredisë deri në shtator 2011 ka arritur në 39.8% të GDP-së. Kreditimi i ekonomisë deri në shtator 2011 zë 45.8% të totalit të aktiveve të sistemit bankar.

Për të përmirësuar klimën e financimit të SME-ve gjatë viteve të fundit janë ndërmarrë një numër masash, të cilat lidhen kryesisht me futjen e skemave të garantimit të kredive për SME-të, nga të cilat do të veçonim:

- Implementimi i skemës së kreditimit të SME-ve nga Programi Italian. Në kuadër të projektit italian për mbështetjen e SME-ve, deri më tetor 2011 janë kredituar 58 kompani me një vlerë prej 13,4 milionë euro.

- Miratimi i skemës dhe implementimi i Fondit të Garantimit të Kredive për SME-të. Është përgatitur skema e fondit të garantimit të kredive për SME-të, e cila në veçanti mundëson bizneset fillestare, *start up* në shumat nga 15,000–50,000 euro, me normë interesi në euro prej 5,5% (më të ulët se normat e tregut).

- Fondit Europian për Europën Juglindore (EFSE). EFSE është një nga kredidhënësit më të mëdhenj në Shqipëri për sektorin financiar. Ajo u ka siguruar institucioneve vendase financiare një fond prej 40 milionë euro, që prej ardhjes së saj në Shqipëri në vitin 2007. Këto institucione kreditimi partnere kanë dhënë më tepër se 8.500 kredi me fondet e marra nga EFSE në formën e kredisë për biznes.

Disa nga masat e përmendura më lart, kanë pasur një ndikim të dukshëm në përmirësimin e performancës së SME-ve.

6. Rritja e konkurrueshmërisë së SME-ve nëpërmjet zbatimit të programit për fondin e konkurrueshmërisë. Sipas indeksit të konkurrueshmërisë për vitin 2011, Shqipëria renditet në vendin e 78 nga 142 vende të analizuara, që flet për një përmirësim të ndjeshëm kundrejt vitit 2010, duke u ngjitur me 10 vende krahasuar me indeksin e vitit 2010 ku Shqipëria renditej e 88 nga 139 vende.

Në strategjinë për zhvillim e biznesit dhe investimeve për periudhën 2007-2013, një vëmendje e veçantë i kushtohet programeve për rritjen e konkurrueshmërisë së SME-ve, hartimit të një programi strategjik dhe një plani veprimesh për transferimin e teknologjisë dhe inovacionit. Për mbështetjen e SME-ve është ngritur dhe funksionon fondi shqiptar i konkurrueshmërisë i miratuar për një periudhë 6-vjeçare për periudhën 2007-2013, që implementohet nga AIDA. Që nga fillimi i skemës janë mbështetur 98 kompani.

7. Programi i konkurrueshmërisë dhe novacionit (CIP) për SME-të. Pjesëmarrja e Shqipërisë në programin komunitar për konkurrueshmërinë dhe novacionet (Competitiveness and Innovation Programme - CIP), për periudhën 2007–2013, është miratuar me vendim të Parlamentit Europian nr. 1639/2006/EC. Brenda programit të CIP-it, ka 3 nënprograme kryesore të cilat janë të fokusuar për SME-të dhe për ato lloj teknologjish që mbrojnë mjedisin: i) *Enterpreneurship and Inovation Program* (EIP), ii) ICT policy support programme, dhe iii) *Intelligent energy-europe programme* (IEE).

Pjesëmarrja e Shqipërisë në programin CIP është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 713, datë 24.10.2007, për miratimin në parim, të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin komunitar "Programi kuadër për konkurrueshmëri dhe novacion". Marrëveshja e mirëkuptimit (MoU) është ratifikuar me ligjin nr. 9984, datë 11.9.2008 "Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e komunitetit "Programi i veçantë për sipërmarrjen dhe novacionin (EIP) të programit kuadër të konkurrueshmërisë dhe novacionit, 2007-2013"", i botuan në Fletoren Zyrtare nr. 143, datë 22 shtator

2008 dhe ka hyrë në fuqi më datë 7 tetor 2008.

Aktivitete për projektin komunitar CIP-EIP: Shqipëria merr pjesë në Programin e rrjetit të grave europiane ambasadore dhe në programin e *European Network of Mentors for Women Entrepreneurs*. *Java Europiane* e SME-ve. Shqipëria merr pjesë për herë të dytë në Javën Europiane të SME-ve. Në 3-9 tetor 2011 janë zhvilluar një numër aktivitetesh kushtuar të mësuarit për sipërmarrjen, është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi tripalësh për hartimin e një plani veprimi për të mësuarit për sipërmarrjen, si dhe futjen e tij në kurrikulën e arsimit 9-vjeçar, aktivitete informuese për projektin "Rrjeti europian i mentorëve të grave sipërmarrëse", "Rrjetin europian të grave sipërmarrëse ambasadore", etj.

8. Ekonomia informale. Plani i veprimit "Për reduktimin e ekonomisë informale për periudhën 2006-2009" është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave. Nga 33 masa totale të planit të veprimit janë realizuar 31 masa, ndërsa 2 masa nuk janë realizuar. Ekonomia informale në Shqipëri është reduktuar vazhdimisht në këto 3 vjet. Bazuar në të dhënat e INSTAT, Ekonomia e Pavrojtuar (NOE) vlerësohet të ketë një reduktim kundrejt GVA, nga 28.7% në vitin 2006, 28.5% në vitin 2007 dhe 27.2% në vitin 2008.

Për vlerësimin e ekonomisë jo të vrojtuar, INSTAT vazhdon të kryejë mbledhjen e informacionit (vjetore dhe tremujore) dhe analizën e të gjitha burimeve të të dhënave në mënyrë që të përmirësojë metodologjinë e vlerësimit të ekonomisë jo të vrojtuar në linjë me kërkesat e Sistemit Europian të llogarive (ESA 95), vlerësimet e GDP-së dhe komponentët e saj, bazuar në metodën e "përqasjes me Eurostat" dhe manualin e OECD-së për përfshirjen e llogarive kombëtare.

Lidhur me masat për reduktimin e ekonomisë informale, janë ndërmarrë veprime të vazhdueshme nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Inspektorati Shtetëror i Punës. Gjatë vitit 2011 është miratuar ligjin nr. 10 415, datë 7.4.2011 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"", në të cilin parashikohen masa që kanë të bëjnë me vendosjen e gjobave për pagesat e paregjistruara, mosvendosjen e pajisjeve fiskale, punonjësit e paregjistruar dhe për kompanitë e regjistruara dhe të paregjistruara të autorizuara për të shitur dhe/mbajtur pajisje fiskale, të cilat synojnë luftimin e evazionit fiskal dhe reduktimin e ekonomisë informale në përgjithësi.

Gjithashtu është rritur numri i kontrolleve dhe efikasiteti i tyre nga Drejtoria e Hetimeve Tatimore. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektoratit Shtetëror të Punës (ISHP) janë ndërmarrë kontrolle mbi subjektet që veprojnë në bujqësi, peshkim, turizëm (në ndërtimin dhe operimin e hoteleve), me qellim identifikimin e të punësuarve të padeklaruar. Është në funksionim gjithashtu një numër telefoni jeshil, pa pagesë për të denoncuar rastet e ndryshme të shkeljes së të drejtave të punës. Në zbatim të këtyre masave janë zbatuar sanksione të ndryshme për shkeljet e konstatuara të këtyre marrëdhënieve.

Drejtimet kryesore për zhvillimin e sektorit privat për periudhën 2012–2014

1. Zbatimi i strategjisë së biznesit dhe investimeve për periudhën 2007–2013.

2. Zbatimi i strategjisë së inovacionit dhe teknologjisë së biznesit dhe planit të veprimit 2011-2016.

3. Zbatimi i principeve Europiane *Small Business Act*.

4. Forcimi i kapaciteteve dhe përmirësimi i shërbimeve nga AIDA për investitorët e huaj dhe vendas.

5. Forcimi i kapaciteteve të dhe njësisë BRIC/AIDA dhe pjesëmarrja në rrjetin europian të ndërmarrjeve, EEN.

6. Ngritja dhe vënia në funksionim të zonave ekonomike (parqe industriale, zona të lira).

7. Implementimi i Programit 3-vjeçar Italian për mbështetjen e SME-ve nëpërmjet linjës së butë të kredisë dhe fondit të garantimit të kredive.

8. Adoptimi i direktivës 2005/56/EC "On cross-border mergers".

9. Zbatimi i programeve financiare të Fondit të Konkurrueshmërisë dhe Fondit të Garantimit të Kredive për eksport (FK-së dhe FGKE-së).

10. Krijimi dhe implementimi i Fondit të Novacionit dhe Fondit të Ekonomisë Kreative.

11. Vlerësimi i politikave për SME-të sipas SBA-së e sipas metodologjisë së OECD-së

12. Forcimi i dialogut biznes-privat dhe rritja e rolit të këshillit konsultativ të biznesit

Në mbështetje të implementimit të masave të përmendura me sipër, në kuadër të Programit Afatmesëm Buxhetor 2012–2014 janë planifikuar 2 289 milionë lekë, nga të cilat 1 089 milionë lekë financohet nga buxheti dhe pjesa tjetër financohet nga donatorët.

Privatizimi dhe politikat e partneritetit publik-privat

Energjia

Privatizimi i shoqërisë "KESH" sh.a.: Gjatë viteve 2006-2008, është bërë ristrukturimi i KESH sh.a. dhe ndarja e tij në kompani të veçanta. Po kështu gjatë kësaj periudhe është bërë ristrukturimi dhe riorganizimi i sektorit të transmetimit (OST-ja), dhe në vitin 2009 është realizuar privatizimi i sektorit të shpërndarjes (OSSH). Kontrata për shitjen e 76 për qind të aksioneve të shoqërisë "Operatori i sistemit të shpërndarjes" pranë shoqërisë çeke "CEZ" për vlerën 102 milionë euro është nënshkruar në datën 11 mars 2009. Kontrata është miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 10 116, datë 23.4.2009.

Gjatë vitit 2010-2011 është punuar për përgatitjen e strategjisë së privatizimit të sektorit të prodhimit të energjisë elektrike. Gjatë vitit 2011 është iniciuar procesi për përgatitjen e procedurave të privatizimit të sektorit të gjenerimit të energjisë elektrike.

Është miratuar ligji për privatizimin e 4 hidrocentraleve, që kanë qenë në pronësi të KESH-it dhe konkretisht për hidrocentralet Ulëz-Shkopet dhe Bistrica 1-Bistrica 2. Si hap i parë ka qenë krijimi i shoqërive të veçanta "HEC Ulëz-Shkopet" dhe "HEC Bistrica 1- Bistrica 2". Po vazhdon puna për hartimin e dokumentacionit të nevojshëm për hapjen e tenderit për privatizimin e tyre.

Liberalizimi i tregut të energjisë, futja e operatorëve privatë. Gjate tre viteve të fundit ka pasur një progres të konsiderueshëm në futjen e operatorëve privatë ne sektorin e gjenerimit të energjisë elektrike dhe liberalizimin e tregut te energjisë. Deri tani janë nënshkruar rreth 115 kontrata koncesioni për ndërtimin e rreth 300 hidrocentraleve me fuqi të instaluar në rreth 1 330 MW. Me vënien në shfrytëzim të këtyre objekteve parashikohet të garantohet siguria e furnizimit me energji elektrike të tregut të brendshëm dhe një pjesë e energjisë se prodhuar të shitet në tregun rajonal.

Gjatë vitit 2010–2011 janë lidhur kontrata për 11 HEC-e të vegjël, me vlerë të përgjithshme të investimit të parashikuar në rreth 19 milionë euro, dhe një vlerë të përgjithshme të prodhimit të pritshëm prej 143,7 Gwh, të cilat parashikohen të mbyllen brenda vitit 2014. Rreth gjysma e këtyre objekteve janë kontraktuar gjatë vitit 2011. Gjatë vitit 2011 kanë përfunduar edhe punimet për ndërtimin e linjës së interkonjeksionit me Malin e Zi dhe është nënshkruar marrëveshja e interkonjeksionit mes dy vendeve.

Privatizimi i shoqërive publike të sektorit hidrokarbur shënon një hap të rëndësishëm në përmirësimin e performancës së sektorit të energjisë elektrike.

Ristrukturimi dhe privatizimi i shoqërisë "Armo" sh.a.: Privatizimi i 85% të aksioneve të shoqërisë "ARMO", me destinacion përpunimin e produkteve hidrokarbure, ka përfunduar në vitin 2008. Kontrata për shitjen e 85 për qind të aksioneve të shoqërisë "ARMO" është miratuar dhe nënshkruar në datë 22.8.2008, dhe është dekretuar nga Presidenti i Republikës. 85% e aksioneve të shoqërisë "ARMO" sh.a. i kanë kaluar shoqërisë "AMRA OIL" sh.a dhe konsorciumit "Refinery Associates of Texas, Anika Enterprises & Mercuria Energy group".

Synimi kryesor i privatizimit të shoqërisë ARMO sh.a. ka qenë përmirësimi i cilësisë së rafinimit të naftës bruto dhe, nëpërmjet investimeve në teknologji, të tentohej arritja e standardeve ndërkombëtare në cilësinë e nënprodukteve të naftës që dalin nga ky proces teknologjik dhe rehabilitimi i mjedisit në zonën përreth rafinerive dhe më pas në ndërprerjen e ndotjes së mëtejshme të mjedisit.

Gjatë periudhës 2010–nëntor 2011 kanë filluar procedurat për privatizimin e paketës prej 15% të aksioneve të ARMO sh.a. të zotëruara nga shteti. Me urdhër të Ministrit ka filluar llogaritja e paketave të aksioneve për punonjësit dhe ish-pronarët e truallit të objekteve të ARMO sh.a. (urdhri nr. 438, datë 8.6.2010 i Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës "Për fillimin e procedurave për llogaritjen e paketës së aksioneve për punonjësit e shoqërisë ARMO sh.a.", si dhe urdhri nr. 439, datë 8.6.2010 i Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës "Për fillimin e procedurave për llogaritjen e paketës së aksioneve për ish pronarët e truallit të shoqërisë ARMO sh.a.")

Ristrukturimi dhe privatizimi i shoqërisë "Albpetrol" sh.a.: Privatizimi i shoqërisë publike "Albpetrol" sh.a., që operon në sektorin e prodhimit të naftës dhe gazit është realizuar deri më sot përmes dhënies të një pjese të të drejtave, të titullimit dhe interesit, për vendburimet ekzistuese, kompanive të tjera që operojnë në fushën e kërkimit dhe prodhimit mbi bazën e lidhjes së marrëveshjeve hidrokarbure sipas ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet". Ky proces është në vazhdimësi sipas përcaktimeve të çdo marrëveshjeje të veçantë që shoqëria "Albpetrol" sh.a., ka realizuar me kompanitë që veprojnë sot në sektorin hidrokarbur.

Në zbatim të politikave të Qeverisë Shqiptare për privatizimin e plotë të shoqërisë "Albpetrol" sh.a. gjatë periudhës 2010–nëntor 2011, nga strukturat e METE, duke u mbështetur edhe në rekomandimet e deritanishme të konsulentit "Patton Boggs", i përzgjedhur me procedurë tenderi, është punuar për përcaktimin e praktikave dhe procedurave për realizimin e privatizimit të shoqërisë "Albpetrol" sh.a. Mbi këtë bazë është përgatitur edhe projektligji "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë "Albpetrol" sh.a., Patos", i cili është shqyrtuar dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe është përcjellë për procedurë shqyrtimi dhe miratimi në Kuvendin e Shqipërisë. (Vendimi nr. 713, datë 26.10.2011 i Këshillit të Ministrave "Për propozimin e projektligjit "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë "Albpetrol" sh.a., Patos"".

Në dhjetor 2011 projektligji është shqyrtuar dhe miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe është dekretuar nga Presidenti i Republikës.

Privatizimi i "AlbTelekom": Për privatizimin e "AlbTelekom" është proceduar në përputhje me formulën e privatizimit të përcaktuar në ligjin nr. 8810, datë 17.5.2011. Aktualisht është bërë transferimi i 76% të aksioneve pranë investitorit strategjik (Calik Enerji Telekomubikasyon), si dhe pjesa e aksioneve e parashikuar në favor të punonjësve dhe ish-pronareve të truallit të shoqërisë "AlbTelekom" sh.a. Deri në fund të vitit 2011 pjesa e mbetur e aksioneve për t'u privatizuar është rreth 16,77 për qind.

Aktualisht procesi i privatizimit të pjesës së mbetur është në fazën e procedurave të ankandit. Për pjesën e mbetur kanë paraqitur interes 2 kompani, një kompani kroate dhe "AlbTelekom" sh.a., zotëruese e një pjese prej 76 për qind. Në zbatim të procedurave të ankandit, kompanitë e interesuara kanë firmosur Marrëveshjet e Konfidencialitetit, me qëllim marrjen e informacionit të nevojshëm për shoqërinë "AlbTelekom" sh.a. dhe për procesin e ankandit. Afati i fundit për paraqitjen e ofertave ka qenë data 28.10.2011. Në kushtet kur njëra nga kompanitë e interesuara ka paraqitur kërkesë për disa sqarime lidhur me procesin, si dhe ka konsideruar si të pamjaftueshme kohën për të paraqitur ofertën, në bazë të ligjit nr. 9874, datë, 14.2.2008 "Për ankandin publik", të ndryshuar, si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", është vendosur zgjatja e afatit për dorëzimin e ofertave. Hapja e ofertave ka qenë parashikuar në datën 30.11.2011. Për të garantuar suksesin e procesit data e hapjes së ofertave është shtyrë në datën 15 mars 2012.

Zonat ekonomike

Zhvillimi i zonave ekonomike është një ndër instrumentet e aplikuara për tërheqjen e investimeve të huaja dhe vendase dhe futjen e teknologjive të avancuara me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë dhe zhvillimin e industrive të orientuara nga eksportet. Përmes krijimit dhe zhvillimit të zonave ekonomike synohet gjithashtu të gjenerohet punësim në rajonet ku ato janë instaluar. Në referencë të ligjit, zonat ekonomike përfshijnë parqet industriale dhe zonat e lira ekonomike.

Zhvillimi i zonave ekonomike (parqet industriale dhe zonat e lira) është ndërtuar mbi bazën e partneritetit publik-privat, dhe të koncesionit të formës BOT (ndërtim, operim, transferim), për një periudhë deri në 35 vjet dhe nën regjimin e tarifës prej 1 euro. Baza ligjore është ligji nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", i ndryshuar, dhe ligji nr. 9789, datë 19.7.2007 "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike".

Deri në fund të vitit 2011 janë shpallur dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave 10 zona ekonomike, nga të cilat njëra ka statusin e zonës së lirë. Gjatë vitit 2011 është punuar për negocimin dhe nënshkrimin e kontratave, pjesa me e madhe e të cilave parashikohet të përfundojë brenda vitit 2011, dhe pjesërisht brenda tremujorit të parë 2012. Parqet për të cilët interesi ka qenë i ulët ose kanë paraqitur

problematika në drejtim të lidhjes së kontratave, do të merren në shqyrtim me qëllim anulimin e tyre. Në vitin 2012 parashikohet të fillojë zbatimi i të gjitha planeve të investimit për të cilat është lidhur kontrata dhe është bërë dorëzimi i sipërfaqeve.

Investimet e pritshme në parqet industriale parashikohet të arrijnë në rreth 100 milionë euro, ndërkohë që investimet për zhvillimin e zonës së lirë ekonomike janë parashikuar në rreth 1,5 miliardë euro. Efektet e pritshme në punësim konform parashikimeve pritet të jenë në nivelin e 35,000 vendeve të reja të punës, pa përfshirë këtu rreth 25,000 vende të reja të punës që parashikohen të gjenerohen në kuadër të zhvillimit të zonës së lirë ekonomike në Vlorë. Të gjitha investimet janë të formës "*greenfield*" me përjashtim të parkut industrial Elbasan që do të jetë i tipit "*brownfield*".

Për sa i takon statusit të zbatimit, deri në nëntor 2011, janë miratuar nga Këshilli i Ministrave 10 zona ekonomike, nga të cilat njëra është zonë e lirë. Ecuria e zhvillimit të tyre paraqitet si më poshtë:

1. Zona ekonomike me statusin "Park Industrial" Koplik, Shkodër, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 12, datë 4.1.2008, me sipërfaqe 61 ha, në pronësi shtetërore.

Është nënshkruar kontrata koncesionare në datë 29.9.2008.

Kontrata është ne proces rinegocimi, me qëllim reflektimin e vërejtjeve të paraqitura nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë lidhur me disa aspekte teknike të kontratës së koncesionit. Rinegocimi i kontratës parashikohet të përfundojë brenda vitit 2011.

Investimi i parashikuar në kontratë nga ana e zhvilluesit të parkut industrial Koplik është 18 519 539 euro dhe parashikon krijimin e 16 374 vende të reja pune.

2.Zona ekonomike me statusin "Park Industrial" Shëngjin, Lezhë, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 11, datë 4.1.2008, me sipërfaqe 3.2 ha, në pronësi shtetërore. Në datë 29.9.2008 është nënshkruar kontrata koncesionare me Shoqërinë ATX–International Tirana sh.p.k. Kontrata është rilidhur me zhvilluesin në datë 23.7.2010, në datë 3.12.2010 është nënshkruar kontrata e uzufruktit dhe në datë 3 nëntor 2010 është bërë dorëzimi i sipërfaqes së parkut te zhvilluesi, duke i hapur rrugë procedurave për marrjen e lejeve të ndërtimit dhe fillimit të zbatimit të planit të investimeve sipas projektit të miratuar.

Investimet e pritshme parashikohen në rreth 17 milionë euro, ndërsa efektet në punësim lidhen me hapjen e rreth 3,000 vendeve të reja të punës.

3. Zona ekonomike me statusin "Park Industrial" në Vlorë, është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 774, datë 4.6.2008, me sipërfaqe 125 ha, pronësi shtetërore dhe private. Është nënshkruar kontrata koncesionare me shoqërinë "Idea Vlora", e cila është miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Gjatë vitit 2011 ka përfunduar draftmarrëveshja e uzufruktit, e cila parashikohet të nënshkruhet brenda vitit 2011. Brenda vitit 2011 parashikohet të bëhet edhe dorëzimi i sipërfaqes te zhvilluesi, duke i hapur rrugë fillimit të procedurave për marrjen e lejeve të ndërtimit dhe fillimit të investimeve të ndërtimit.

Investimi i pritshëm është 20 819 797 euro dhe parashikohet të krijohen rreth 18 500 vende pune.

4. Zona ekonomike me statusin "Park industrial", Spitallë, Durrës, është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 21.2.2008. Zona ka një sipërfaqe 850 ha, dhe shtrihet në pronësi shtetërore dhe private.

Gjatë vitit 2011 janë paraqitur dy kërkesa për zhvillimin e parkut, por në sipërfaqe më të vogla. Aktualisht po punohet për përgatitjen e procedurave për hapjen e një gare të re. Procesi i vlerësimit të kërkesave pritet të fillojë brenda vitit 2011 dhe të përfundoje brenda tremujorit të parë 2012. Shpallja e garës parashikohet të realizohet brenda 6-mujorit të parë 2012.

5.Zona ekonomike me statusin "Park industrial" në Elbasan, me sipërfaqe 254.7 ha, në pronësi shtetërore dhe pronësi private është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 776, datë 4.6.2008. Nuk është hapur gara për përzgjedhjen e zhvilluesit të parkut industrial, pasi ka vazhduar procesi i privatizimit edhe pas shpalljes së zonës ekonomike duke reduktuar sipërfaqen shtetërore brenda parkut industrial. Aktualisht METE po shqyrton mundësinë e anulimit të vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e këtij parku.

6. Zona ekonomike me statusin "Park industrial" Shkodër, është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 4.6.2008, ka sipërfaqe 137 ha, në pronësi shtetërore dhe pronësi private. Në garën e hapur në vitin 2009 nuk është paraqitur asnjë ofertë. Meqenëse procesi i privatizimit ka vazhduar edhe pas shpalljes së kësaj zone ekonomike duke reduktuar sipërfaqen e miratuar, gjatë vitit 2012 do të shikohet mundësia e anulimit të vendimit të Këshillit të Ministrave.

7. Zona e lirë në Vlorë, me sipërfaqe 478.14 ha, është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 11.6.2009. Pritet që së shpejti të fillojë negocimi i kontratës koncesionare midis METE-s dhe zhvilluesit. Aktivitetet që do të zhvillohen në këtë zonë janë aktivitete portuale, industriale dhe të përpunimit, veprimtari tregtare dhe depozitim mallrash, me përjashtim të veprimtarive që lidhen me prodhimin e çelikut.

Gjatë vitit 2011 është proceduar me negocimin e kontratës. Lidhja e kontratës është ndalur deri në përmbushjen e detyrime kontraktuale nga ana e zhvilluesit për detyrimet e garancisë. Parashikohet të mbyllet brenda tremujorit të parë 2012. Investimi i pritshëm nga shoqëria është rreth 1.5 miliardë euro, efektet në punësim vlerësohen në krijimin e rreth 25,000 vendeve të reja pune.

8. Zona ekonomike me status "Park industrial" në Laknas, Tiranë me sipërfaqe 9.48 ha, në pronësi private është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 790, datë 22.7.2009. Shoqëria nuk ka paraqitur ende projektin teknik, studimin e fizibilitetit dhe studimin mjedisor, për t'i hapur rrugën procedurave të vlerësimit dhe më pas të hapjes së garës. Sipas planbiznesit të paraqitur nga shoqëria, investimet e pritshme parashikohen në rreth 25,3 milionë euro.

9. Zona ekonomike me status "Park industrial" Lezhë, me sipërfaqe 54.3 ha, me autoritet kontraktues bashkinë e Lezhës është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 81, datë 27.1.2009. Në vitin 2011 bashkia e Lezhës ka filluar procedurat për hapjen e garës, të cilat mendohen të mbyllen brenda vitit 2011.

10. Zona ekonomike me status "Park industrial" në Rrashbull, Durrës. Është miratuar në vitin 2011 me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 105, datë 9.2.2011, me sipërfaqe 16.2 ha. Projekti është identifikuar nga shoqëria italiane "MAIO".

Gjatë vitit 2011 kanë përfunduar procedurat e vlerësimit të projektpropozimit të pakërkuar, si dhe është bërë miratimi i autoritetit kontraktues dhe bonusit me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 525, datë 20.7.2011. Është shpallur gara e cila është parashikuar të zhvillohet në datë 21.11.2011. Procesi i vlerësimit parashikohet të mbyllet brenda vitit 2011. Përgatitja e kontratës së koncesionit parashikohet të mbyllet brenda tremujorit të parë të vitit 2012.

Referuar projektpropozimit, investimi i parashikuar në këtë zonë është rreth 30 milionë euro, punësimi i pritshëm konsiston në hapjen e rreth 100 vendeve të reja pune.

Sektori minerar dhe industria

Politikat e sektorit minerar

Gjate tri viteve të fundit zhvillimi i sektorit është bazuar në zbatimin e programit qeverisës në dy drejtime kryesore:

1. Përditësimi i strategjisë minerare, hartimi i një pakete të re ligjore për sektorin minerar që të jetë tërheqës për investimet, të përmirësojë klimën e biznesit, të lehtësojë procedurat e lejedhënies, të garantojë një shfrytëzim racional dhe efektiv të pasurive minerare nëpërmjet rritjes së transparencës dhe konkurrueshmërisë.

2. Rritjen e të ardhurave nga ky sektor nëpërmjet stimulimit të prodhimeve për eksport dhe plotësimit gjithnjë e më mirë të tregut vendas me minerale.

Për drejtimin e parë është hartuar strategjia minerare me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 479, datë 29.6.2011 "Për miratimin e strategjisë minerare të Republikës së Shqipërisë", ku zhvillimi i qëndrueshëm ka përcaktuar katër synimet për zhvillimin e sektorit: prosperitetin ekonomik, mbrojtjen e mjedisit, mbështetjen sociale, barazinë për brezat e sotëm dhe mundësi të barabarta për brezat e ardhshëm. Paketa e re ligjore për sektorin minerar e përbërë nga ligji nr. 10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë"; 11 vendime të Këshillit të Ministrave dhe 21 urdhra të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ka futur disa koncepte të reja në politikat minerare që

lidhen me konceptin e planifikimit minerar të koordinuar dhe harmonizuar me planifikimin e territorit, programimin e veprimtarive minerare nëpërmjet zonimit minerar, transparencë dhe lehtësim të procedurave në procesin e lejedhënies, aplikimin e parimit të konkurrencës për dhënien e të drejtave minerare, rehabilitimin e mjedisit, garancive financiare për realizimin e investimit dhe rehabilitimin e mjedisit, trajtimin e mbetjeve dhe riciklimin e tyre që kanë si qëllim të garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm e të harmonizuar dhe fitim maksimal të shtetasve shqiptarë.

Për drejtimin e dytë janë përcaktuar prioritetet e zhvillimit, që përfshijnë:

1. Krijimin e një klime të përshtatshme biznesi për tërheqjen e investimeve vendase e të huaja në sektorin minerar;

2. Nxitjen e veprimtarisë se kërkim-zbulimit për shtimin e rezervave të reja minerare;

3. Teknologji të reja, automatizimi dhe optimizimi për të përballuar me zbulimin, shfrytëzimin e trupave minerare që shkojnë më në thellësi dhe kanë një përmbajtje më të ulët të mineralit të dobishëm, si dhe kërkesave gjithnjë në rritje në drejtim të përdorimit të tokës dhe kërkesave në rritje për marrjen e të drejtave minerare;

4. Aktivitet minerar me ndikim minimal në panoramën e relievin;

5. Përdorim efektiv i mineraleve, energjisë dhe ujit gjatë veprimtarive minerare;

6. Minimizimi i shkarkimeve të dëmshme në mjedis nga veprimtaritë minerare dhe mbylljen efektive të minierave, rehabilitimin ambiental;

7. Promovimin e riciklimit dhe përdorimin e produkteve sekondare;

8. Përpunim i thellë i produkteve minerare (fizik, metalurgjik, kimik, biologjik) për marrjen e të gjithë elementeve në një xeheror (figura 6);

9. Realizimi i një GIS të dhënash dhe modelimi multidimensional;

10. Nxitjen e pjesëmarrjes se ekspertëve të rinj në sektor dhe kualifikimin e atyre ekzistues.

11. Menaxhim efektiv të impaktit në ambient dhe marrja e masave parandaluese;

12. Transparenca me komunitetin e zonave minerare;

13. Ulje të risqeve mjedisore dhe sociale;

14. Rehabilitimi i pikave të nxehta të ndotjes historike të minierave;

15. Partnership publik-privat, me konceptin që minierat janë të nevojshme për të siguruar zhvillim të infrastrukturës rajonale.

Këto koncepte të reja për strategjinë dhe legjislacionin minerar kanë shkuar në përputhje me strategjinë që aktualisht Bashkimi Europian po ndërton për lëndët e para të bazuar në tri shtylla:

a) Sigurimi i aksesit për shfrytëzimin e lëndëve të para në mënyrë që të nxisë burime të qëndrueshme të furnizimit me burime minerale;

b) Rritja e shfrytëzimit racional dhe efektiv të burimeve minerare;

c) Promovimin e riciklimit për të reduktuar konsumin e BE-së ndaj lëndëve të para të papërpunuara dhe uljen e varësisë relative prej importit.

Është e rëndësishme që politika jonë minerare të jetë koherente me politikat europiane për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit minerar, lidhur kjo me objektivin e vendit tonë, për t'u integruar në Bashkimin Europian.

Në sektorin minerar, nuk aplikohet asnjë lloj ndihme shtetërore, apo politika që ndikojnë në konkurrueshmërinë midis subjekteve minerare.

Gjendja e sektorit minerar

Prodhimi minerar në tërësi ka pasur një rritje të konsiderueshme. Prodhimet minerare kanë qenë destinuar kryesisht për eksport, si kromi, bakri, hekur-nikeli, gurë dekorativë. Ndërkohë, prodhimet jo metalore kanë pasur si destinacion kryesor prodhimin e materialeve të ndërtimit, argjilave të përdorura si lëndë e parë për prodhimin e çimentos, gurët dekorativë, pllakore, bazalte, etj., kryesisht me destinacion plotësimin e kërkesave të tregut të brendshëm. Prodhimi është rritur vit pas viti, duke shpënë në 44 gamën e mineraleve të shfrytëzueshme me mbi 6.5 milionë ton minerale prodhim në vit (viti 2010). Aktualisht në industrinë minerare janë aktive 754 leje minerare.

Gjatë viteve 2007-2009 në sektorin minerar janë realizuar rreth 260 milionë euro investime, përkatësisht 71,9 milionë euro për vitin 2007, rreth 109,8 milionë euro për vitin 2008, 78,7 milionë euro

për vitin 2009 dhe 34,1 milionë euro. Karakteristike ka qenë se investimet gjatë kësaj periudhe përfshijnë jo vetëm makineri e pajisje për shfrytëzim minerar, por edhe investime në teknologji për përpunim të mëtejshëm të mineraleve, siç vërehet në industrinë e çimentos, kromit, gurëve dekorativë, që përbëjnë pjesën e sektorit me zhvillimin më të madh në vitet e fundit. Përmes lejeve minerare të dhëna në vitet e kaluara dhe lejeve të reja që do të jepen në tre vitet e ardhshme pritet të realizohet një nivel investimesh prej rreth 50-70 milionë euro në vit.

Për tre vitet e ardhshme, investimet më të mëdha do të vazhdojnë në industrinë e prodhimit të çimentos, në nxjerrjen dhe pasurimin e mineralit të kromit, në përpunimin e gurëve dekorativë, rritjen e prodhimit dhe përpunimit të bakrit, rritjen e prodhimit të mineralit të nikelit silikat, etj. Gjatë vitit 2010 është nënshkruar marrëveshja e koncesionit me kompaninë "Illyria Minerals Industry" sh.a., i formës BOT për shfrytëzimin e minierave të kromit në Kalimash dhe Vlahne. Në bazë të marrëveshjes, në katër vitet e ardhshme parashikohet që të investohen rreth 20 milionë euro dhe të nxirren dhe përpunohen rreth 210 mijë ton mineral në vit. Ndërkohë, në industrinë e çimentos do të vazhdojnë investimet e filluara, të cilat parashikohen në total të shkojnë deri në 1,5 miliardë euro. Me realizimin e këtij investimi Shqipëria plotëson përfundimisht nevojat e tregut të brendshëm ndërkohë që një pjesë e madhe e prodhimit do të destinohet për eksport.

Sot numërohen rreth 7100 punonjës në këtë industri dhe mundësitë janë për shifra shumë më të larta, duke evituar kështu mundësitë e migrimit të brendshëm të popullatës dhe problemeve sociale dhe të infrastrukturës që e shoqërojnë këtë migrim, duke garantuar zhvillimin e këtyre zonave dhe një shpërndarje e zhvillim të biznesit dhe në zonat rurale. Përgatitja e burimeve njerëzore të afta për menaxhimin e industrisë minerare është e një rëndësie të veçantë, ndaj rëndësi duhet t'i kushtohet përgatitjes së specialistit inxhinier-ekonomist-menaxher të ardhshëm për të ndërmarrë analiza teknike, ekonomike, vlerësimin e ndikimit mjedisor, social etj. Programet e universitetit duhet të përqendrohen jo vetëm në kontekstin teknik por edhe në atë të menaxhim-biznesit dhe të kombinuara me praktikat e dobishme të studimit, projektimit dhe zbatimit të njësive përkatëse. Zhvillimi i paketave të simulimit kompjuterik për parashikimin e proceseve teknike dhe ekonomike. Studimi dhe projektimi i sistemeve të reja shfrytëzimi dhe përpunimi efektiv për burimet minerale ekzistuese, si edhe ato alternative.

Disa të dhëna vlerësuese për ecurinë e sektorit minerar jepen në grafikët e mëposhtëm (1, 2, 3, 4, dhe 5).

Grafiku 1: Prodhimi i mineraleve në tonë



Grafiku 2: Vlerat e investimeve në industrinë minerare



Grafiku 3: Sasia e produkteve të eksportuara



Grafiku 4: Numri i punonjësve të industrisë minerare



Grafiku 5: Sipërfaqja e zonave minerare të mbuluara me leje minerare



Privatizimi i sektorit minerar

Privatizimi i sektorit minerar ka përfunduar dhe tashmë 100% të prodhimit të këtij sektori jepet nga sektori privat. Ish-ndërmarrjet minerare shtetërore të paprivatizuara janë në procesin e mbylljes dhe likuidimit. Në këtë sektor nuk ka asnjë subjekt shtetëror në prodhim.

Mbyllja e minierave të shfrytëzuara të industrisë minerare (krom, bakër, FeNi, qymyr dhe metale të tjera) dhe privatizimi i aseteve të tyre është proces në vazhdim, që nga fillimi i viteve '90-të.

Në degën e kromit, kanë kaluar në procesin e mbylljes dhe privatizimit gjithsej 178 objekte minerare, ku bëjnë pjesë, miniera, fabrika pasurimi, impiante seleksionimi, etj., së bashku me asetet e tyre

- janë mbyllur 31 miniera dhe objekte përkatëse;
- janë privatizuar 110 objekte (ndërtesa, pajisje-makineri, mjete transporti);
- në koncesion janë dhëne 7 objekte (Darfo spa) dhe 4 objekte (IMI sh.a.), prej të cilave 5 miniera, 3 fabrika pasurimi, 1 impiant seleksionimi dhe 2 uzina ferrokromi;
- janë pajisur me leje minerare shfrytëzimi 237 subjekte private (janë aktive);
- janë dhënë me qira rreth 70 galeri miniere së bashku me asetet e tyre (rreth 278 objekte ndërtesa, p/makineri etj.);
- janë bërë transferime kapitali ndaj 10 objekte.

Në degën e bakrit, i janë nënshtruar procesit të privatizimit objekte minerare, ku bëjnë pjesë miniera, fabrika pasurimi, uzina bakri, parqe transporti etj., së bashku me asetet përkatëse.

Janë mbyllur objektet minerare (Thirre, Laje, Karme1, Hurdha e Tolles, Kanisqel), janë demoluar fabrikat e pasurimit Golaj, Reps, Rrëshen, Mjedë, Rehovë, Kurbnesh, si dhe UB Rubik (Shkrirja). Është në proces demolimi Uzina e Rafinimit të Bakrit Rubik.

Gjithashtu është përfunduar demolimi dhe kapsulimi i mbetjeve të rrezikshme në uzinën e vjetër të bakrit në Rubik, në uzinën e plehrave azotike Fier dhe në uzinën e sodë-pvc Vlorë.

Gjendja e objekteve të industrisë së bakrit në fund të vitit 2010 është si më poshtë:

- Janë mbyllur rreth 60 objekte.
- U privatizuan 22 objekte.
- Janë dhënë në koncesion 4 objekte, minierat e bakrit Munellë dhe Lak Rroshi, fabrika e pasurimit Fushë-Arrëz dhe impianti i seleksionimit të skorieve Shëngjin.
- Janë demoluar 9 objekte (UB Laç, UB Rubik, Fabrika e Pasurimit Kurbnesh, etj.).
- Është bërë kalim kapital për 9 objekte.

Janë në proces privatizimi asetet e 31 objekteve, ndërkohë që mjaft asete kanë përfunduar ciklin e privatizimit pa u shitur dhe i janë kthyer "Albbakër" sh.a., i cili vazhdon shitjen e tyre.

Në këtë degë janë dhënë gjithsej 14 leje minerare (sot aktive). Në degën e hekur-nikelit dhe nikel-silikatit i janë nënshtruar procesit të mbylljes dhe privatizimit të aseteve, gjithsej 25 objekte minerare. Në këtë degë janë dhënë gjithsej 38 leje minerare (aktive sot).

Në degën e qymyreve i janë nënshtruar procesit të mbylljes dhe privatizimit gjithsej 35 objekte minerare (miniera, fabrika pasurimi, etj.). Në degën e qymyreve janë dhënë gjithsej 11 leje minerare shfrytëzimi (sot aktive), si dhe janë dhënë me qira asetet e objekteve të tyre.

Deri në fund të vitit 2010 (për periudhën 1995-2010), kanë kaluar në proces mbylljeje, likuidimi dhe privatizimi të aseteve, gjithsej mbi 148 objekte minerare.

Përmirësimi i klimës së biznesit dhe forcimi institucional

Qeveria Shqiptare ka përcaktuar përmirësimin e ambientit rregullator dhe institucional për biznesin, si një ndër reformat e saj prioritare, duke vlerësuar se zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe social i vendit lidhet ngushtë me kuadrin rregullator në tërësi dhe për biznesin në veçanti. Kjo politikë ka vazhduar edhe për vitin 2011 në drejtim të përmbylljes së reformave në proces dhe të rritjes së performancës së funksionimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve nga institucionet e krijuara si rezultat i reformave.

Zbatimi dhe monitorimi i reformës rregullatore bëhet nga një Task-Forcë, ngritur me urdhër të Kryeministrit, nr. 170, datë 31.10.2005. Task-Forca për reformën rregullatore drejtohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje të saj 5 ministra të Ministrive më kryesore që lidhen me çështjet e biznesit. Plani i Veprimit për reformën rregullatore është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 157, datë 15.3.2006 (të ndryshuar).

Gjatë vitit 2011 reformat kanë vazhduar në dy fusha të tjera po aq të rëndësishme, si:

1. Reforma për garantimin e cilësisë së kuadrit rregullator, dhe ngritjen e sistemit të vlerësimit të ndikimit rregullator VNR (Regulatory Impact Assessment – RIA).

2. Reforma në sistemin e inspektimit në Shqipëri.

3. Në kuadër të transparencës, lehtësimit dhe informimit të biznesit, që nga janari i vitit 2011 është në funksionim të plotë regjistri elektronik për legjislacionin e biznesit (Web-Site për legjislacionin e biznesit).

Përmirësimi i cilësisë së kuadrit të ri rregullator

Ngritja e sistemit të vlerësimit të ndikimit rregullator VNR/RIA është pjesë e platformës së Qeverisë Shqiptare dhe Planit të Veprimit të Reformës Rregullatore për garantimin e cilësisë së kuadrit rregullator dhe përmirësimin e klimës se biznesit.

Cilësia e dobët e ligjeve dhe rregulloreve është konsideruar si një faktor që pengon seriozisht rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Kostot rregullatore dhe mungesa e sigurisë përbënin barriera domethënëse për investimet në sektorin privat dhe rritjen ekonomike. Vlerësimi i ndikimit rregullator (VNR/RIA) është një mjet kyç për përmirësimin e efiçencës dhe efektivitetit të vendimmarrjes rregullatore. Duke i vlerësuar efektet e mundshme të një propozimi të ri rregullator, VNR/RIA u jep vendimmarrësve evidenca për sa u përket ndikimeve pozitive dhe negative të një rregulloreje të re. Sistemi i VNR/RIA gjithashtu përmirëson transparencën dhe shpjegueshmërinë e çdo akti rregullator.

Zhvillimi i sistemit të vlerësimit të ndikimit rregullator (VNR/RIA), si një instrument që do të garantojë cilësinë e kuadrit të ri ligjor, është asistuar nga projekti BERIS "Lehtësimi i hyrjes dhe operacioneve në biznes", si dhe konsulenca ndërkombëtare, në bashkëpunim me të cilët është përcaktuar paketa për "Vlerësimin e ndikimit rregullator" (VNR/RIA). Në kuadër të kësaj pakete, pas një pune dyvjeçare, u përgatit strategjia për krijimin e sistemit të VNR/RIA dhe u përcaktuan opsionet për institucionalizimin e sistemit më të përshtatshëm për RIA-n në Shqipëri.

Në 26 tetor 2010, pasi u analizuan të gjitha opsionet e mundshme, Task-Forcë për reformën rregullatore miratoi ngritjen e sistemit të thjeshtë të vlerësimi të ndikimit rregullator (VNR/RIA light), si një mundësi zbatimi që i përgjigjej më mirë realitetit të vendit, dhe që merr parasysh më mirë stadin aktual të zhvillimit të Shqipërisë, mundësitë e saj buxhetore, institucionale dhe njerëzore. Kjo do të thotë adoptimin e një sistemi të VNR/RIA-s që integrohet në procesin ekzistues të politikëbërjes, duke e ndërtuar kështu mbi strukturat dhe procedurat aktuale institucionale.

Në këtë kuadër është kërkuar amendimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 28 gusht 2003 "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", me qëllim rishikimin e procedurave të draftimit të akteve dhe reformimin e relacionit shpjegues aktual dhe të vlerësimit buxhetor. Nga ana e METE-s është përgatitur projektvendimi dhe është dërguar për shqyrtim pranë Këshillit të Ministrave.

Sistemi i thjeshtë i VNR/RIA, mundëson një performancë më të mirë të procesit të draftimit dhe një relacion shpjegues me më shumë informacion për vendimmarrësit. Në relacionin shpjegues të ri do të ketë më shumë informacion mbi problematikën, objektivin e draft-aktit, kostot dhe impaktet pozitive dhe negative sipas opsioneve, impaktin te biznesi, familjet në nevoje, zonat dhe degët e ndryshme të ekonomisë, impaktin në mjedis, periudhën dhe institucionin e monitorimit pas zbatimit të aktit të ri etj.

Gjatë vitit 2011, METE me strukturat përkatëse të saj, bazuar në Programin Analitik Legjislativ të Këshillit të Ministrave për vitin 2011 ka përzgjedhur projektaktet, të cilat do të jenë objekt monitorimi për zbatimin e sistemit të thjeshtë të VNR/RIA.

Gjatë këtij viti është synuar që draftimi i akteve dhe përpilimi i relacionit shpjegues për projektaktet me përmbajtje ekonomike dhe ndikim te biznesi të bëhet sipas parimeve dhe përcaktimeve që kërkon sistemi i thjeshtë i VNR/RIA, duke dhënë më shumë informacion mbi problematikën, objektivat që kërkohen të arrihen me aktin e ri, opsionet e mundshme, kostot dhe impaktet pozitive dhe negative sipas opsioneve, impaktin te biznesi, familjet në nevojë, zonat dhe degët e ndryshme të ekonomisë, respektimin e procesit të konsultimit, përcaktimi i strukturave monitoruese të zbatimit, periudha e matjes së efektshmërisë dhe rishikimit të aktit të ri etj.

Gjatë viteve 2011-2012 METE do të sigurojë trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët e lartë të administratës publike dhe për zyrtarët, të cilët do të jenë përgjegjës për hartimin e legjislacionit, rregulloreve dhe relacionin shpjegues që i shoqëron këto. Në këtë kuadër, për avancimin e procesit është parashikuar ngritja e një rrjeti për RIA-n, të përbërë nga zyrtarë të Ministrive të linjës, si mënyrë për t'i përmirësuar njohuritë, përvojat dhe kapacitetet lidhur me RIA-n.

Monitorimi i zbatimit të sistemit të thjeshtë të VNR/RIA për periudhën 2011-2012, për aktet që kanë një domethënie ekonomike, do të bëhet nga METE. Në fund të kësaj periudhe është planifikuar të bëhet një rishikim i pavarur i sistemit të thjeshtë të VNR/RIA, me synimin për të përcaktuar nëse Shqipëria zotëron kapacitetet e nevojshme për të lançuar një sistem të plotë të VNR/RIA në vitin 2013.

Nëse ky rishikim do të konstatojë mundësinë për lançimin e një sistemi të plotë të RIA-s, Qeveria Shqiptare do të procedojë me zbatimin e një sistemi të plotë të RIA-s, duke përfshirë këtu një ligj mbi RIA-n, një Njësi Kombëtare për Koordinimin e RIA-s, ngritjen e njësive për RIA-n brenda Ministrive të linjës, etj.

Reforma në sistemin e inspektimit

Reforma në sistemin e inspektimeve është pjesë e reformës rregullatore të Qeverisë dhe është një ndër reformat më komplekse të ndërmarra deri tani. Për realizimin e reformës në inspektim ishin parashikuar një sërë masash në Planin e Veprimit për reformën rregullatore në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit.

Reforma është udhëhequr nga Task-Forca për Reformën Rregullatore dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes, duke u mbështetur nga projekti BERIS, i financuar nga Banka Botërore. Me urdhër të Kryeministrit nr. 79, datë 3.6.2009 është ngritur grupi-teknik ndërinstitucional për drejtimin dhe monitorimin e reformës në fushën e Inspektimit, i cili udhëhiqet nga Zëvendësministri i METE-s.

Reforma në fushën e inspektimit lidhet me:

- Zgjedhjen e modelit më të mire dhe më të duhurin për Shqipërinë.
- Përgatitja e kuadrit ligjor dhe institucional në përputhje me modelin e përzgjedhur.

Pas një pune 2-vjeçare analizuese dhe të detajuar të problematikës së funksionimit të inspektimit, të analizimit të informacionit të grumbulluar për të gjitha inspektimet që realizohen aktualisht në vend, u konkludua në variantin më të mirë të mundshëm për Shqipërinë.

Bazuar në këto analiza, gjatë vitit 2010 Task-Forca miratoi dokumentin e politikës për drejtimet kryesore të reformës së inspektimeve, u shqyrtuan projektpropozimet në aspektin teknik, dhe u përzgjodh

opsioni më i përshtatshëm mes tre opsioneve të vlefshme. Si sistem me i përshtatshëm u vlerësua sistemi që parashikon krijimin e një strukture qendrore (Inspektorati Qendror), e cila do të merret me të gjithë problematikën e inspektimit, duke promovuar metodologjinë më të mirë, parimet dhe praktikat kryesore më të mira që zbatohen në vendet e zhvilluara të BE-së dhe OECD.

Në vijim është përgatitur draftligji për inspektimin, i cili është konsultuar me komunitetin e biznesit, palët e tjera të interesuara dhe institucionet (Inspektoratet) që operojnë aktualisht në sistemin e Inspektimit. Projektligji përcakton parimet më të përgjithshme të inspektimit dhe mundëson krijimin e një strukture qendrore për inspektimin dhe ndarjen e roleve midis institucioneve. Në të bëjnë pjesë parimet e pavarësisë së inspektimit, të proporcionalitetit në veprimtarinë e inspektimit, të prezumimit të pafajësisë dhe barrës së provës, këshillimit dhe informimit, i informimit publik, i paanësisë etj.

Projektligji "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 16.6.2011, ligji nr. 10 433 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 90, datë 5.7.2011. Në zbatim të ligjit "Për ngritjen dhe funksionimin e Inspektoratit Qendror", janë nxjerrë aktet nënligjore si: vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 630, datë 14.9.2011 "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Qendror", si dhe urdhri i Kryeministrit më 30.8.2011 "Për emërimin e Kryeinspektorit".

Aktualisht po punohet për lidhjen e kontratave me firmat konsulente për realizimin e fazës së dytë të reformës në sistemin e inspektimit. Kjo fazë mjaft e rëndësishme parashikohet që të mbyllet brenda muajit prill 2012.

Faza e dytë e reformës në sistemin e inspektimit konsiston në riorganizimin dhe ristrukturimin e të gjitha inspektorateve dhe trupave inspektues me synim reduktimin e tyre (kalimin nga 33-Inspektorate në 11-12 Inspektorate), adoptimin e të gjithë legjislacionit përkatës qe bazohet në ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe aplikimin e praktikave më të mira dhe orientimet më të fundit të EU-së në drejtim të inspektimit, sigurisë, ambientit etj.

Regjistri elektronik për legjislacionin e biznesit

Ngritja e regjistrit elektronik për legjislacionin e biznesit është parashikuar si pjesë e reformës rregullatore, me synimin për të rritur shkallën e transparencës, konsultimit, lehtësimit të biznesit, informimit të tij, si dhe për minimizimin e mundësive korruptive.

Regjistri është në formatin e një *Web-Site* ku i gjithë legjislacioni (çdo akt legjislativ) gjendet në format (*file*) elektronik. Regjistri elektronik është konceptuar dhe dizenjuar, si një instrument për të ndihmuar kryesisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM/SME) dhe publikun në përgjithësi, për të gjetur të gjithë informacionin rregullator të nevojshëm për të gjitha fushat e veprimtarisë së të bërit biznes, si në momentin e nisjes, funksionimit dhe zhvillimit të biznesit.

Regjistri elektronik i legjislacionit të biznesit përmban:

a) të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen direkt apo indirekt me biznesin;

b) të gjitha ligjet dhe vendimet e Këshillit të Ministrave që kanë të bëjnë me biznesin;

c) të gjitha udhëzimet, urdhrat e veçanta dhe të përbashkëta të çdo ministrie, të Këshillit të Ministrave, dhe çdo institucioni të pavarur;

d) të gjitha procedurat, format e aplikimit, manualet, skemat e ndryshme që nxjerrin Ministritë dhe çdo institucion i pavarur në zbatim të ligjeve dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave;

e) të gjitha projektaktet rregullatore që iniciohen nga ministritë dhe institucionet e pavarura.

Regjistri elektronik i legjislacionit të biznesit ofron shërbimet:

a) të gjitha shërbimet janë *free* dhe aksesi i hapur për të gjithë publikun;

b) një *soft* i specializuar për kërkimin e akteve ligjore e nënligjore, udhëzimet, format e aplikimeve, manualet që lidhen direkt apo indirekt me biznesin, duke përdorur mënyrat me kërkim ose me përcaktim direkt të akteve, ose sipas fushës aktivitetit, institucionit etj.;

c) informacion për statusin e akteve (akti është në fuqi, i amenduar, i shfuqizuar, projektaktet);

d) në këtë *web-site* mund të jepen dhe tërhiqen komente të ndryshme nga përdoruesit për projektaktet por edhe ato që janë aktualisht në fuqi.

Portali elektronik është bërë funksional që nga janari i vitit 2011 dhe është hostuar në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), i cili gjendet me adresë zyrtare:

http//www.rlb.gov.al; Në hedhjen e akteve të ndryshme rregullatore në këtë portal janë përfshirë mbi 30-Institucione.

Me qëllim që ky "*Web-Site*" të mbetej i disponueshëm në mënyrë të përhershme, i përditësuar e administruar sa më mirë në dobi të komunitetit të biznesit, gjatë vitit 2011 ka dalë një urdhër i Kryeministrit, nr. 74, datë 3.8.2011 "Për krijimin, funksionimin, administrimin dhe monitorimin e regjistrit elektronik për legjislacionin e biznesit", i cili përcakton detyrat dhe përgjegjësitë për çdo Institucion për funksionimin e këtij portali.

Për periudhën në vijim, Struktura për Reformën Rregullatore në METE, do të punojë për përfshirjen në këtë portal edhe të shumë Institucioneve dhe Enteve të tjera të Pavarura, të cilat nxjerrin akte rregulluese, dhe që lidhen direkt apo indirekt me të bërit biznes në çdo fushë të aktivitetit ekonomik dhe të shërbimeve.

Politikat e ndihmës shtetërore në sektorin e ndërmarrjeve

Kuadri ligjor për ndihmën shtetërore përfshin ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar me ligjin nr. 10 183, datë 29.10.2009 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", tri rregulloret në zbatim të tij, të miratuara me vendime të Këshillit të Ministrave, si dhe një numër udhëzimesh mbi aspekte apo kategori të caktuara të ndihmës shtetërore, të miratuara me vendime të Komisionit të ndihmës shtetërore.

Ligji zbatohet për veprimtaritë që ushtrohen në të gjithë sektorët e prodhimit dhe të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të sektorëve të bujqësisë e të peshkimit. Ligji bazohet në parimet, rregullat dhe procedurat e parashikuara në legjislacionin europian për ndihmën shtetërore. Ai përcakton format e dhënies së ndihmës shtetërore, kategoritë e ndihmës shtetërore, procedurat e dhënies së ndihmës dhe mbikëqyrjes së saj, si dhe strukturat përgjegjëse kontrolluese dhe vendimmarrëse.

Strukturat përgjegjëse për kontrollin e ndihmave shtetërore në Shqipëri, janë: Komisioni i ndihmës shtetërore, si strukturë vendimmarrëse dhe Drejtoria e Mekanizmave të Tregut dhe Ndihmës Shtetërore si strukturë tekniko-organizative në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Komisioni i Ndihmës Shtetërore përbëhet nga 5 anëtarë, të emëruar nga Këshilli i Ministrave me një mandat 4 vjeçar. Kryetar i Komisionit të Ndihmës Shtetërore është ministri që mbulon çështjet e ekonomisë.

Referuar raportit për ndihmat shtetërore të vitit 2010, për periudhën 2007-2010 ndihma shtetërore në Republikën e Shqipërisë është vlerësuar në rreth 45.348,68 milionë lekë (358 milionë €). Ndihma shtetërore për vitin 2010, duke përfshirë të gjithë sektorët, arrin në vlerën 9.918,92 milionë lekë (72,16 milionë €), që përfaqësojnë 0.81 për qind të PBB-së të Republikës së Shqipërisë.

Instrumentet kryesore të përdorura për dhënien e ndihmës shtetërore, për periudhën e trajtuar kanë qenë grandet, përjashtimi dhe ulja e taksave.

Gjatë vitit 2010, strukturat e kontrollit të ndihmës shtetërore e kanë trajtuar mbështetjen e ndërmarrjeve me burime shtetërore si një politikë të rëndësishme për të inkurajuar ndërmarrjet publike/private dhe duke mos krijuar shtrembërime të konkurrencës. Në bazë të ligjit "Për ndihmën shtetërore" dhe detyrimeve të MSA-së, për sigurimin e transparencës në përdorimin e fondeve publike, janë përgatitur këto dokumente kryesore:

- Raporti për inventarin e skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore në Shqipëri, pas shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve përkatëse për secilën nga skemat ekzistuese të regjistruara. Ky raport është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 45, datë 16.1.2008.
- Raportet vjetore për ndihmat shtetërore të dhëna në Shqipëri për vitin 2007, 2008, 2009 dhe 2010, të miratuara, përkatësisht, me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1023, datë 9.7.2008, vendim të Këshillit të Ministrave nr. 630, 11.6.2009, vendim të Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 23.7.2010, vendim të Këshillit të Ministrave nr. 668, datë 28.9.2011, të cilat më pas janë dërguar pranë strukturave të Komisionit Europian.

Deri tani KNSH-ja ka marrë 41 vendime, nga të cilat 15 vendime për skemat ekzistuese, 13 për ndihmat e reja, dhe të tjerat për udhëzimet për kategori të veçanta të ndihmës shtetërore, hartën rajonale,

rregulloren e funksionimit etj. Të gjitha vendimet e KNSH-së janë botuar në Fletoren Zyrtare, si dhe janë pasqyruar në *web-site-n* e METE-s.

Në dy vitet e fundit, një prioritet i ndihmës shtetërore ka qenë mbështetja për ndërmarrjet inovative me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së tyre. Ndihma për ndërmarrjet e reja inovative lejohet nëse plotësohen disa kushte, ndër të cilat: i) përfituesi duhet të jetë një ndërmarrje e vogël, e krijuar jo më parë se 6 vjet nga koha kur është dhënë ndihma; ii) kostot për kërkim dhe zhvillim, që duhet të përballojë përfituesi, duhet të zënë të paktën 15% të kostove totale operacionale të ndërmarrjes, në të paktën një nga tre vitet përpara vitit në të cilin jepet ndihma; iii) shuma e ndihmës nuk duhet të kalojë vlerën 100,000 euro; iv) përfituesi mund të përfitojë ndihmë vetëm një herë gjatë periudhës në të cilën ai cilësohet si një ndërmarrje e re inovatore.

Mbështetja e ndërmarrjeve inovative do të vazhdojë të konsiderohet me prioritet edhe për tre vitet e ardhshme. Skema e garantimit të kredive afatshkurtra për kolateral për kreditë tregtare për mjete xhiroje ka vlerë maksimale deri në 10.000.000 lekë. Skema ka një kohëzgjatje 6 vjet. Vlerësimi i kësaj skeme është bërë sipas Komunikatës së Komisionit Europian 97/C281/03 "Për sigurimin afatshkurtër të kredive të eksportit".

3.2.2 Sektori financiar

Kuadri rregullator lidhur me aktivitetin bankar i është nënshtruar një procesi përsosjeje të mëtejshme mbështetur në standardet më të mira ndërkombëtare. Ky proces vijon, dhe gjatë vitit 2012 pritet të shoqërohet edhe me hyrjen në fuqi të rregullores së re të mjaftueshmërisë së kapitalit, e cila është duke u hartuar në kuadrin e përafrimit të legjislacionit dhe bazës rregullatore me standardet e Bashkimit Europian. Edhe trajtimi rregullator i aspekteve të tjera relevante të mbikëqyrjes do të rishikohet me qëllim forcimin e tij, përfshirë këtu qeverisjen e përgjegjshme të bankave mbështetur në parimet dhe standardet e Komitetit të Baselit dhe udhëzimet e BE-së në këtë fushë.

Aktivitetet në industrinë financiare si edhe mbikëqyrja e tij duhet të jenë në përmirësim të vazhdueshëm, si rezultat i mjedisit sfidues dhe të ndryshueshëm të tregut. Si rrjedhim, edhe politikat e ardhshme të autoriteteve publike duhet të fokusohen në:

a) zhvillimin e sistemit financiar dhe segmenteve të tij, si tregu ndërbankar;

b) përmirësimi i mbikëqyrjes së tregut financiar ndërmjet:

a) mbulimit të plotë të institucioneve financiare si edhe i aktiviteteve financiare të cilat mund të lindin në të ardhmen;

b) bashkëpunimit më të mirë ndërmjet autoriteteve publike të cilat kanë për detyrë rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit dhe tregut financiar. Ky bashkëpunim më i mirë do të sjellë përgatitje më të mirë të identifikimit dhe menaxhimit të riskut, shtrirje më të mirë të praktikave rregullative, si edhe praktika mbikëqyrjeje më të mirëharmonizuara me standarde ndërkombëtare.

Për sa i përket mbikëqyrjes bankare, Banka e Shqipërisë do të fokusohet në:

- shtimin e mbikëqyrjes së riskut, duke u siguruar mbi ekzistencën e një sërë rregullash të mirëpërcaktuara, të cilat sigurojnë thjeshtësinë, transparencën dhe janë në pajtim të plotë me industrinë bankare;

- fokus më të fortë mbikëqyrës dhe kërkesa më të forta rregullatore nga bankat kryesore, sipas madhësisë së tyre, bashkëveprimit në treg, si edhe ekspozimit të tyre;

- prezantimin e masave rregullative të cilat kanë për qëllim reduktimin e prociklimit në aktivitetin bankar;

- përmirësimin e rregullave dhe praktikave të manaxhimit të krizës;

- sigurimin e mbrojtjes më të mirë të konsumatorëve të mallrave dhe shërbimeve financiare.

Sistemi i pagesave

Banka e Shqipërisë në kuadër të fuqizimit të mbikëqyrjes së sistemit të pagesave, në bashkëpunim të ngushtë me FMN-në, gjatë periudhës 2009–2011 ka qenë në proces hartimi dhe reflektimi të opinioneve të ministrive të linjës për projektligjin "Për sistemin e pagesave". Ky projektligj është në linjë dhe me tendencat ndërkombëtare për ridimensionimin e rolit të mbikëqyrjes në sistemin e

pagesave pas krizës financiare ndërkombëtare, nga një përqasje e "butë" drejt një përqasjeje "të fortë"[14]. Gjithashtu ky projektligj përbën edhe një hap të mëtejshëm në procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së në fushën bankare dhe financiare. Qëllimi i këtij ligji është të nxisë sigurinë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri, nëpërmjet: 1) përcaktimit të standardeve që kanë të bëjnë me licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e elementeve të rëndësishëm të sistemit kombëtar të pagesave, si dhe me mbrojtjen e sistemeve, si dhe 2) mbrojtjes së marrëveshjeve të kolateraleve financiare, të rëndësishme për mirëfunksionimin e sistemit të pagesave, por me një synim akoma më të gjerë: atë të mbrojtjes së stabilitetit financiar të vendit.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë me qëllim rritjen e efiçencës dhe mirëfunksionimin e sistemit të pagesave, dhe në veçanti për të nxitur zhvendosjen e pagesave në ekonomi nga *cash* me anë të sistemit bankar të cilat mund të jenë ndikuar edhe nga niveli i lartë i komisioneve të aplikuara në muajin mars të vitit 2011, ndërmori një paketë masash të cilat konsistojnë në:

- Përcaktimin e çmimeve tavan të cilin bankat mund t'ua aplikojnë klientëve të tyre për pagesat/transfertat që procesohen nëpërmjet sistemeve "AIPS" (Sistemi i pagesave ndërbankare me vlera të mëdha) dhe "AECH", (Sistemi i klerimit të pagesave me vlera të vogla).
- Rritjen e vlerës limit të pagesave me vlerë të vogël të cilat shlyhen nga bankat nëpërmjet sistemit të klerimit të pagesave me vlera të vogla.
- Shtimin e seancave të klerimit të pagesave në sistemin e pagesave ndërbankare me vlera të mëdha, duke iu ofruar mundësinë bankave të shlyejnë pagesat e klientëve pothuajse në kohë reale, me një komision të reduktuar.
- Rishikimin e tarifave të pjesëmarrjes së bankave në sistemin e pagesave ndërbankare me vlera të mëdha dhe sistemin e klerimit të pagesave me vlera të vogla, kundrejt kërkesës për ulje të komisioneve bankare për shërbimet e pagesave.

Përgjatë vitit 2011, Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për fuqizimin e rolit mbikëqyrës së Sistemit të pagesave nëpërmjet:

a)Rishikimit të Dokumentit të Politikave të Mbikëqyrjes të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 38 në datë 18.6.2008. Qëllimi kryesor i këtij rishikimi, është ridimensionimi i politikave të mbikëqyrjes sipas projektligjit "Për sistemin e pagesave" duke zgjeruar kështu objektivat dhe qëllimin e funksionit mbikëqyrës për të gjithë komponentët e sistemeve të pagesave duke përfshirë këtu edhe instrumentet e pagesave. (prioritet afatshkurtër)

b)Krijimit të një skeme rregullative për infrastrukturën e tregjeve financiare, me qëllim krijimin e metodave dhe instrumenteve për të siguruar përputhshmërinë e funksionimit të sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes me standardet më të mira ndërkombëtare, duke vendosur kështu parimet dhe standardet më të mira ndërkombëtare të mbikëqyrjes (prioritet afatshkurtër) .

c)Hartimin e një manuali të brendshëm për zbatimin e mbikëqyrjes të sistemeve të pagesave, i cili synon konkretizimin e hapave të ndjekura nga DSP-ja në kuadër të mbikëqyrjes së sistemeve dhe shërbimeve të pagesave në përgjithësi (prioritet afatshkurtër) .

Në kuadër të reduktimit të mëtejshëm të përdorimit të parasë fizike në ekonomi, ndër të tjera, Banka e Shqipërisë ka fokusuar punën e saj në marrjen e masave në lidhje me transpozimin e disa direktivave shumë të rëndësishme në fushën e pagesave, siç është direktiva 2007/64/EC "Mbi shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm" dhe direktiva 2009/110/EC "Mbi ngritjen, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronike" dhe/ose me praktikat më të mira ndërkombëtare". Implementimi i këtyre direktivave synon krijimin e institucioneve të reja në treg me fokus shërbimet e pagesave dhe emetimin e parasë elektronike, çka mendohet të sjellë rritjen e konkurrencës në treg. Gjithashtu, këto direktiva synojnë fuqizimin e transparencës në lidhje me shërbimet e pagesave dhe paranë elektronike, si dhe vendosin një set rregullash moderne në lidhje me të drejta dhe detyrimet e përdoruesve dhe ofruesve të këtyre shërbimeve duke rritur kështu sigurinë dhe efiçencën, si dhe duke fuqizuar rolin e autoritetit mbikëqyrës në këto fusha. Për arritjen e qëllimeve të lartpërmendura, Banka e Shqipërisë ka ngritur një grup pune ndërdepartamental.

[14] Të fortë nënkupton rregulla të forta mbikëqyrëse dhe rol akoma më aktiv të bankës qendrore.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë në kuadër të implementimit të direktivave të lartpërmendura, në amendimet e bëra rishtazi në ligjin nr. 9662 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" ka përafruar përkufizimin e shërbimeve të pagesave dhe të parasë elektronike përkatësisht sipas direktivave 2007/64/EC dhe 2009/110/EC, si dhe ka prezantuar konceptin e institucioneve të pagesave dhe atyre të emetimit të parasë elektronike, duke përkufizuar veprimtari të tilla veprimtari jo më si veprimtari bankare por si veprimtari financiare, të cilat mund të kryhen edhe nga institucione financiare jo banka.

Me qëllim rritjen e efiçencës dhe reduktimin e rrezikut operacional në proceset e pagesave, BOA po punon për një projekt i cili do të sigurojë administrimin automatik të kolateralit. Projekti do të jetë pjesë integrale e zhvillimit të procedurës DVP (delivery vs payment) i cili do të materializohet me krijimin nga ana e Bankës së Shqipërisë të një CSD-je (Central Securities Depository) për titujt e qeverisë.

Përmirësimi i infrastrukturës nëpërmjet masave të lartpërmendura i mbështetur edhe nga reformat në kuadrin rregullativ të sistemit të pagesave, siç është transpozimi i direktivës 98/26/EEC "Mbi finalitetin e shlyerjeve" dhe direktiva 2002/47/EC "Mbi kolateralin financiar", si dhe krijimi i një skeme rregullative për infrastrukturën e tregjeve financiare sipas parimeve të BIS[1] vlerësohet të krijojë baza të shëndosha për zhvillimin e një infrastrukture tregu të sigurt dhe efektiv.

3.2.3 Tregu i punës

Zhvillimi i tregut të punës dhe nxitja e punësimit përbëjnë një ndër komponentët kryesorë të politikave shtetërore për rritjen e nivelit të punësimit dhe si pasojë reduktimin e varfërisë. Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Formimit Profesional 2007-2013 ka programuar objektiva konkrete dhe të arritshme për zhvillimin e tregut të punës, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të punësimit, zbatimin e standardeve bashkëkohore për orientimin dhe përfshirjen e punëkërkuesve në tregun e punës, bashkëpunimin dhe mbështetjen e biznesit dhe operatorëve të tjerë ekonomikë dhe socialë.

Objektivi strategjik do të vazhdojë të jetë, për periudhën 2011-2013 në fushën e shërbimeve të punësimit, modernizimi i shërbimeve, duke e transformuar në mënyrë të vazhdueshme Shërbimin Kombëtar të Punësimit, nga një institucion që ofron shërbime administrative, në institucion që ofron shërbime ndaj dy klientëve kryesorë të saj, punëkërkuesve të papunëve dhe biznesit.

Për realizimin e këtij objektivi duhet të vazhdojë puna: i) të forcohet dhe zhvillohet institucionalisht sistemi i shërbimeve të punësimit; ii) të krijohet një sistem modern dhe unik i shërbimeve të punësimit në të gjithë vendin nëpërmjet përmirësimit dhe zhvillimit të metodës së punës dhe të kapaciteteve menaxheriale të stafit; iii) të rritet punësueshmëria dhe ulet papunësia nëpërmjet aplikimit të politikave aktive të punësimit; iv) të ndërtohen dhe zhvillohen marrëdhënie të fuqishme të partneritetit me aktorë të tjerë që operojnë në tregun e punës e sidomos me partnerët socialë.

Politikat shtetërore të punësimit do të vazhdojnë të përfshijnë si masa për nxitjen e punësimit (politikat aktive), ashtu dhe sigurimin e mbështetjes me të ardhura (politikat pasive).

Politikat aktive të tregut të punës

Politikat aktive të tregut të punës përfshijnë:

- shërbimet e punësimit;
- programet e krijimit të vendeve të reja të punës;
- programet e formimit profesional.

Niveli zyrtar i papunësisë të regjistruar për 11-mujorin 2011 figuron në shifrën 143.013 persona, e shprehur në përqindje në raport me forcat e punës 13.43%.

Nga këta të papunë 73.750 janë femra, 89.643 persona janë të papunë afatgjatë, 82692 përfitojnë ndihmë ekonomike, 9.290 përfitojnë pagesë papunësie, 7637 romë dhe egjiptianë, 2566 me aftësi të kufizuar dhe pjesa tjetër jetim dhe emigrantë të kthyer.

- Gjatë 11 mujorit 2011 janë realizuar rreth 22.000 punësime, nga të cilat rreth 50% janë femra.

Punësimet janë:

- 0.761 punësime janë me ndërmjetësimin e Zyrave të Punësimit;
- nga programet e nxitjes së punësimit janë punësuar/trajnuar 1170 persona;
- nga të papunët afatgjatë 2226 persona;
- nga personat e trajtuar me ndihmë ekonomike 821 persona;

- pas përfundimit të një kursi formimi janë punësuar 678 persona;
- nga personat e trajtuar me pagesë papunësie janë punësuar 436 persona;
- romë 128 persona;
- pak 3 persona;
- pjesa tjetër janë punësuar me plan aksion ose e kanë gjetur vetë punën.

Programet e nxitjes së punësimit

Programet e nxitjes së punësimit janë zbatuar edhe në 2011 dhe do të jenë prezente në Shqipëri në vitet në vazhdim.

Për vitin 2011 fondi për programet e nxitjes së punësimit është 100 milionë lekë dhe janë zbatuar programet ekzistuese me anë të së cilave janë punësuar dhe trajnuar 1170 punëkërkues të papunë.

Projektvendime të tjera që pritet të miratohen

Përveç projektvendimeve të parashikuara në strategji Drejtoria e Politikave të Punësimit nëpërmjet grupit të punës së përmendur më sipër ka përgatitur dhe dy projektvendime të tjera dhe konkretisht:

1. Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta", neneve 4 e 8 të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar. Programi për nxitjen e punësimit të punëkërkuesve të papunë femra është përgatitur në kuadrin e objektivit të Qeverisë për zhvillimin e politikave sociale aktive, nëpërmjet nxitjes së punësimit. Programi synon të nxisë drejtuesit dhe menaxherët shqiptarë të bëjnë përpjekje për të punësuar punëkërkuese të papuna femra nga grupet e veçanta. Programi synon punësimin e femrave nga grupet e veçanta të punëkërkuesve të cilat kanë vështirësi për të hyrë në tregun e punës. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta i ka trajtuar me prioritet gratë në programet e nxitjes së punësimit. Me gjithë pjesëmarrjen e gjerë të tyre në programet e nxitjes së punësimit duke konsideruar nivelin e lartë të papunësisë te grupet e veçanta të femrave, ministria po merr masa konkrete për zbatimin e politikave aktive për punësimin e tyre. Me anë të këtij programi synohet mbështetja e punëdhënësve që marrin në punëkërkues të papunë femra nga grupet e veçanta. Kjo mbështetje konsiston në financimin e masës së detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe katër paga minimale në shkallë vendi.

2. Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë që hyjnë për herë të parë në punë" pikës 5 të nenit 9 të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar. Ky projektvendim hartohet në zbatim të programit të qeverisë 2009–2013 dhe në zbatim të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit". Programi ka për qëllim të mbështesë kategorinë e të rinjve që hyjnë për herë të parë në tregun e punës dhe nuk kanë eksperienca të mëparshme pune. Të rinjtë deri në 24 vjeç përbëjnë rreth 20% të punëkërkuesve të papunë dhe kryesisht janë të rinj të cilët nuk janë përfshirë ende në tregun e punës dhe duke mos pasur eksperiencë në punë është shumë e vështirë të përfshihen në procese pune. Për këtë qëllim shteti mbështet punëdhënësit të cilët punësojnë këtë kategori punëkërkuesish me masën e sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore kontributi i punëdhënësit. Mbështetja bëhet për një periudhë deri në një vit me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër së 6 muaj. Punëdhënësit të cilët punësojnë të rinjtë punëkërkues mund të përfitojnë deri në 100 për qind të numrit mesatar të të siguruarve të 3 muajve të fundit përpara aplikimit për mikrondërmarrjet dhe deri në 50% për ndërmarrjet e tjera.

Këto programe do të zbatohen në vitin 2012 dhe nëpërmjet këtyre synohet përfshirja në tregun e punës e grupeve në nevojë, por fondet që do të vihen në dispozicion për vitin 2012 do të jenë 90 milionë lekë.

Formimi profesional

Rritja e autonomisë së DRFPP-ve dhe sidomos mbështetja me investime dhe fonde, është trajtuar nga ana jonë si masë për rritjen e bashkëpunimit me zyrat rajonale të punësimit dhe mundësitë e tyre për të hapur kurse të reja sipas kërkesës së tregut të punës.

Fuqizimi i Drejtorive Rajonale të Formimit Profesional Publik (DRFPP), shtrirja e tyre në territorin e vendit dhe zgjerimi i atyre ekzistuese vazhdon të jetë në fokusin e ministrisë dhe si rezultat fillimi dhe

realizimi i punimeve rehabilituese në ambientet përkatëse në Kukës dhe Bajram Curri për Drejtorinë Rajonale të Qendrës së Lëvizshme për zonën Verilindore.

Gjithashtu rëndësi po i kushtohet hapjes së kurseve të reja të profesioneve në DRFPP-të, që kërkohen nga tregu i punës dhe hartimi i kurrikulave të reja në përputhje me hapjen e kurseve të reja në DRFPP, kjo në bashkëpunim me SHKP-në dhe AKAFP-në. Gjatë kësaj periudhe janë hartuar 5 kurrikula të reja.

Gjatë periudhës 9-mujore janë regjistruar në DRFPP-të 8.087 persona, 6.491 persona kanë qenë pjesëmarrës në kurse të përfunduar nga të cilët janë certifikuar 6.282 persona. Nga këta kanë qenë 3.427 femra, 2.961 të papunë nga të cilët 1.705 të papunë të regjistruar pranë zyrave të punësimit, 840 të burgosur (janë persona qe vazhdojnë dënimin dhe trajnohen në ambientet ku kryejnë dënimin me heqje lirie), 1446 të rinj nga mosha 16-19 vjeç, 2345 persona nga mosha 20-24 vjeç, 1489 persona nga mosha 25-34 vjeç dhe 1211 persona mbi 34 vjeç.

Duke filluar nga viti 2009 e në vazhdim, vihet re një rritje e bashkëpunimit me partnerë dhe aktorë të tjerë të tregut të punës. Mund të përmendim zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të realizuara pothuajse në të gjitha rajonet si takime dhe korrespondenca ndërinstitucionale me Inspektoratin e Punës, tatim-taksat, bashkitë, komunat, dhomat e tregtisë dhe industrisë, drejtoritë e arsimit dhe shëndetësisë , INSTAT etj. në lidhje me:

- shkëmbimin e informacionit;
- prezantimin e programeve aktive të tregut të punës;
- pjesëmarrjen aktive në grupet rajonale të punës të ngritura në lidhje me problematikat e tregut të punës, si dhe për zbatimin e strategjive sektoriale.

Në vazhdim të këtij bashkëpunimi dhe në kuadër të "Javës Europiane të SME për vitin 2011 gjatë periudhës 7-9 tetor 2011 në ambientet e Pallatit të Kongreseve u organizua panairi me temë "WORK & STUDY", Edicioni i Dytë (Edicioni i Parë në vitin 2010), i cili shërbeu për promovimin e sipërmarrjes në Shqipëri.

Ky aktivitet u organizua nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Dhomën e Tregtisë e Industrisë së Tiranës.

Pas ceremonisë së hapjes së Panairit u nënshkrua edhe marrëveshja e bashkëpunimit midis katër institucioneve për hartimin e strategjisë së të mësuarit për sipërmarrjen, si një detyrë e rëndësishme që përputhen me rekomandimet e Komisionit Europian.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta i ka kushtuar vëmendje të veçantë sipërmarrjes dhe të mësuarit për sipërmarrjen. Konkretisht në Strategjinë Sektoriale të Punësimit dhe Formimit Profesional 2007-2013, në "Përmirësimi i klimës së biznesit dhe aksionet për SME-të", është trajtuar edhe nxitja e kulturës për sipërmarrjet, nëpërmjet përfshirjes në kurrikulin e shkollave të mesme profesionale dhe qendrave të formimit publik, nëpërmjet moduleve të veçanta.

Në bashkëpunim me ekspertët e kontraktuar nga SIDA, Agjencia e Zhvillimit Ndërkombëtar Suedi, u krye një vlerësim i sistemit aktual dhe u ndërtuan termat e referencës në lidhje me shtrirjen e procesit të informatizimit në të gjitha Drejtoritë Rajonale të Punësimit, proces i cili do të vazhdojë dhe në vitet 2011-2012. Paralelisht një grup tjetër ekspertësh të kontraktuar nga SIDA bëri vlerësimin e kapaciteteve të Shërbimit Kombëtar të Punësimit për menaxhimin e këtij procesi.

Faza e dytë e projektit ka nisur pas miratimit të marrëveshjes nga Këshilli i Ministrave në qershor 2011. Projekti ka si qëllim:

- shtrirjen e informatizimit në të gjitha drejtoritë rajonale të punësimit;
- zhvillimin dhe implementimin e procesit të vetëshërbimit në internet për punëkërkuesit e papunë pranë zyrave të punësimit;
- zhvillimin dhe implementimin e një sistemi IT për regjistrimin e punëkërkuesve të papunë dhe vendeve të lira të punës.

Në bashkëpunim me projektin "AlbVET" po punohet për rritjen e numrit të kurseve të profesioneve të qendrës së lëvizshme të formimit profesional për zonën verilindore. Në këtë kuadër është bërë organizimi i punës për ofrimin e tre kurseve profesionesh (në profesionin rrobaqepësi, hidraulik dhe elektricist) në zonën ku ushtron aktivitetin e saj.

Rëndësi i është dhënë bashkëpunimeve dypalëshe në fushën e formimit profesional me vende të rajonit. Në këtë kuadër janë hartuar dhe nënshkruar Marrëveshje të Bashkëpunimit me Republikën e Turqisë dhe të Kosovës.

Kujdes i veçantë i është kushtuar ndjekjes së ecurisë së punësimit të punëkërkuesve të papunë që përfundojnë kurset e formimit profesional pranë DRFPP-ve. Për këtë qëllim është organizuar në bashkëpunim me SHKP-në i anketimit të 3.000 punëkërkuesve të papunë pas përfundimit të trajnimit.

Programet pasive

Pagesa e papunësisë

Programi i pagesës së papunësisë është pjesë e politikave të tregut të punës, dhe siguron mbështetjen me të ardhura të të papunëve në kohën e daljes së tyre si të tillë. Objektivat e tij kryesore janë: i) të kompensojë të ardhurat për të papunët; ii) t'u japë mbështetje aktive përfituesve të pagesës së papunësisë, në mënyrë që të rikthehen në punë.

Të drejtën për të përfituar, e kanë të gjithë personat, të cilët janë të siguruar në sigurimet shoqërore dhe për ta është kontribuar sigurim për papunësi jo me pak se 12 muaj, janë të vërtetuar nga zyrat e punës se janë të papunë dhe pranojnë të kualifikohen dhe rikualifikohen nuk marrin përfitime të tjera nga ligji i sigurimeve shoqërore, me përjashtim të pensionit të pjesshëm të invaliditetit.

Për nëntëmujorin e vitit 2011 ka qenë në 9.290 numri i punëkërkuesve të papunë të trajtuar me pagesë papunësie me një fond rreth 800 milionë lekë dhe niveli bazë i pagesës së papunësisë është 6850 lekë në muaj, kurse masa e pagesës së papunësisë mesatarisht duke shtuar kompensimet për energji elektrike, ngarkesën për fëmijët në ngarkim, kompensime për bukë dhe ushqime shkon mesatarisht 8500 lekë në muaj. Nga 2010 në 2011 niveli bazë i pagesës së papunësisë u rrit në masën 4%. Gjatë periudhës 11-mujore të vitit 2011 nga punëkërkues të papunë në pagesë papunësie janë punësuar 436 persona.

Objektivat strategjikë të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në fushën e punësimit dhe të formimit profesional për periudhën në vitin 2012 do të jenë:

Në fushën e punësimit

1. Krijimi i një sistemi modern dhe unik i shërbimeve të punësimit në të gjithë vendin.

Kjo do të arrihet: i) duke rritur performancën e shërbimeve të punësimit dhe sidomos ndërmjetësimit për punësim duke përshtatur sa më mirë kërkesat dhe ofertat për punë; ii) rishikimi i strukturës së zyrave të punësimit duke i dhënë përparësi specialistëve që merren me shërbimet e punësimit; iii) bashkëpunimi në nivel rajonal e lokal në organizimin e punës së zyrave të punësimit; iv) zhvillimi i atyre politikave aktive që kanë në fokus të rinjtë dhe personat nga grupet e veçanta me probleme për t'u futur në tregun e punës; v) fokusimi në programet e reja në tregun e punës sidomos për grupet e veçanta si PAK, të papunë afatgjatë, emigrantëve të kthyer me probleme ekonomike, etj.; vi) unifikimi i shërbimeve të punësimit dhe ngritja e nivelit të punës së specialistëve në punën me klientët; vii) kualifikimi i mëtejshëm i specialistëve që kryejnë shërbime me klientët; viii) përmirësimi i mëtejshëm i monitorimit dhe vlerësimit të punës së shërbimeve të punësimit; ix) rritja cilësore e studimit afatshkurtër të tregut të punës, i cili bëhet çdo vit; x) zhvillimi i panaireve të punësimit në të gjitha qytetet e vendit; xi) numri i ndërmjetësimeve do të jetë në 12500 në vitin 2012.

2. Ndërtimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve të partneritetit me aktorë të tjerë të tregut të punës.

Kjo do të arrihet nëpërmjet: i) bashkëpunimit me universitetet, INSTAT, partnerët socialë dhe institucionet studimore dhe donatorë të ndryshëm; ii) bashkëpunimi me agjencitë private të punësimit; iii) panaire të përbashkëta shërbime punësimi – biznes, çdo vit nga zyrat rajonale të punësimit dhe shërbimi kombëtar i punësimit.

3. Zhvillimi i teknologjisë së informacionit (IT) në shërbimet e punësimit si një faktor kyç për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Krijimi i një sistemi informatik informacioni të tregut të punës për: i) zhvillimin e një mënyre të

re të menaxhimit të sistemit të informacionit të tregut të punës në SHKP si bazë për të lançuar menaxhimin me objektiva dhe rezultate; ii) zhvillimin dhe implementimin e procesit të vetëshërbimit në internet për punëkërkuesit e papunë pranë zyrave të punësimit; iii) zhvillimin dhe implementimin e një sistemi IT për regjistrimin e punëkërkuesve të papunë dhe vendeve të lira të punës; iv) krijimi i bankës së vendeve të lira të punës në të gjitha zyrat e punësimit për futjen e një niveli të lartë të vetëshërbimit në zyrat e punësimit. Mbas informatizimit të dy zyrave të punësimit, Tiranës dhe Korçës, në vitet e ardhshme do të vazhdojë informatizimi i 10 zyrave të tjera rajonale dhe 24 vendore.

4. Përmirësimi i kontakteve me ndërmarrjet.

Intensifikimi, strukturimi dhe dokumentimi më i mirë i vizitave në ndërmarrje dhe intervistat e bëra, për të marrë informacionin e nevojshëm dhe për të rritur kapacitetin ndërmjetësues.

5. Nxitja e punësimit nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit.

Kjo do të arrihet nëpërmjet: i) vazhdimit të zbatimit të programeve ekzistuese të nxitjes së punësimit dhe aplikimi i programeve të reja duke nxitur punësimin e atyre kategori personash që kanë vështirësi për t'u integruar në tregun e punës; ii) shtrirja e tyre dhe në zonat rurale; iii) përfshirja i 2500-3000 punëkërkues të papunë për vitin 2012.

Gjithashtu do të bëhet:

Vazhdimi i procesit të vendosjes së prioriteteve nga Ministri të lidhura këto me situatën e tregut të punës dhe drejtimet e zhvillimit; Monitorimi dhe vlerësimi i politikave aktive me angazhimin e partnerëve social; Informimi mbi politikat ekzistuese si një element i rëndësishëm i këtyre programeve.

Nxitja e punësimit të personave me aftësi të kufizuar.

- Vazhdimi i zbatimit të programit për punësimin e punëkërkueseve të papuna femra.
- Pjesëmarrje aktive e grave për formulimin e politikave, garantimin e përgjegjësive dhe nevojave për grupet shoqërore me të diskriminuara.
- Politika të veçanta për grupet e grave në nevojë.
- Formim profesional falas për gratë kryefamiljare, viktimat e trafikut dhe për gratë e komunitetit rom.
- Hapja dhe ofrimi i kurseve të formimit profesional për aktivitete të ndryshme jobujqësore për gratë në zonat rurale.

Nxitja e punësimit dhe formimit profesional të komunitetit rom.

Nxitja e punësimit të të rinjve.

Punësimi dhe formimi profesional për të miturit që punojnë në mënyrë informale.

Masa për nxitjen e punësimit dhe formimit profesional për emigrantët potencialë dhe ata që kthehen.

6. Programet pasive.

Rritja e nivelit të pagesës së papunësisë në masën 10-20% çdo vit, për të arritur standardet e Konventës së ILO-s nr. 168 "Nxitja e punësimit dhe mbrojtja nga papunësia" për të arritur nivelin 50% të pagës minimale në shkallë vendi. Ulja e numrit të përfituesve të pagesës së papunësisë si rezultat i punësimit të tyre nga pjesëmarrja në programet aktive në masën 10-15% mesatarisht në vit.

7. Përmirësimi i situatës në tregun informal të punës.

Bashkëpunimi midis institucioneve, Inspektorati i Punës, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve e Shërbimit Kombëtar të Punësimit për të gjitha problemet e lidhura me funksionimin e tregut të punës.

Në fushën e formimit profesional

8. Modernizimi i modelit kurrikular të AFP, për ta afruar me kërkesat e botës së punës dhe për të rritur shkallën e fleksibilitetit.

Institucionalizimi i strukturës dyshkallëshe të kurrikulit të AFP-së dhe modularizimi gradual i tij. Hartimi i akteve nënligjore që mbështesin strukturën dyshkallëshe dhe modulare të kurrikulit të AFP-së.

Hartimi i akteve nënligjore që mbështesin strukturën dyshkallëshe dhe modulare të kurrikulit të AFP-së.

9. Zhvillimi i mekanizmave institucionalë për kryerjen e funksioneve të reja dhe mbështetjen e funksioneve aktuale në AFP.

Kjo do të arrihet duke fuqizuar rolin e Këshillit Kombëtar të AFP-së (komisionet e specializuara dhe sekretariati) dhe institucionalizimi i bashkëpunimit midis AFP-së dhe biznesit lokal.

10. Zhvillimi i kompetencave mësimdhënëse dhe menaxhuese të personelit të AFP-së

Fuqizimi i mekanizmave institucionalë aktualë për trajnimin e vazhduar (*in-service*), të mësuesve e instruktorëve të AFP-së.

Hartimi i programeve për trajnimin e vazhduar të mësuesve specialistë dhe instruktorëve të AFP-së, në përputhje me nevojat.

Kryerja nga të gjithë mësuesit specialistë dhe instruktorë e 5-7 ditë trajnime në vit.

Fuqizimi i mekanizmave institucionale për trajnimin e drejtuesve të shkollave/qendrave mbi veçoritë e menaxhimit në sektorin e AFP-së.

Hartimi i programeve për trajnimin e vazhduar të drejtuesve të shkollave/qendrave të AFP-së në përputhje me nevojat.

11. Zhvillimi sasior dhe cilësor i objekteve, mjediseve dhe mjeteve mësimore në mbështetje të rritjes së parashikuar cilësore dhe sasiore të ofertës së AFP-së.

Kjo do të arrihet nëpërmjet:

Ristrukturimit të ndërtesave dhe mjediseve ekzistuese për mësimin teorik e praktik në shkollat profesionale dhe qendrat.

Pajisja me bazën e nevojshme materiale/didaktike për mësimin teorik e praktik.

Krijimi i qendrave të reja në ato rajone ku kërkesa është më e ndjeshme dhe krijimi i qendrave të trajnimit ambulant.

12. Rritja e numrit të kualifikuarve në kurset e profesioneve dhe e të punësuarve pas trajnimit.

Në vitin 2012, do të kemi 7000 të kualifikuar dhe 3800 të punësuar pas trajnimit

Reforma në sistemin e sigurimeve shoqërore

Pensionet mbështesin me të ardhura rreth 17% të popullsisë, tregues ky me prirje të qarta drejt rritjes sidomos pas vitit 2012 kur përfundon edhe reforma e rritjes graduale të moshës së daljes në pension. Aktualisht trajtohen me pensione pleqërie, invaliditeti dhe familjare rreth 548 mijë përfitues dhe nisur nga numri i përfituesve dhe nga volumi i transfertave në buxhetet familjare ato përbejnë një element të rëndësishëm të mbrojtjes sociale dhe reduktimit të varfërisë.

Sistemi aktual i pensioneve është vendosur me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Mbi sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj sanksionon këto parime kryesore:

Përfitimet nga pensionet publike përballohen nga Fondi i Sigurimeve Shoqërore (FSSH) që është strukturë financiare e pavarur nga Buxheti i Shtetit.

Menaxhimi i FSSH-së i është ngarkuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH-së) që është institucion i pavarur publik në vartësi dhe nën kontrollin e Ministrisë së Financave. Ai drejtohet nga një Këshill Administrativ tripalësh (përfaqësues të Qeverise, të punëdhënësve dhe të punëmarrësve)

Fondi i sigurimeve shoqërore administrohet në pesë degë kryesore sigurimi që janë:

1. sëmundje,
2. barrëlindje,
3. pensione,
4. aksidente dhe sëmundje profesionale; dhe
5. papunësi.

FSSH financohet përmes 4 burimeve kryesore të të ardhurave që janë:

1. Kontributet e personave juridikë e fizikë;

2. Kontributet e Buxhetit të Shtetit për njohjen e periudhave të sigurimit për kategori të veçanta personash dhe subvencione për lehtësi kontributive për të vetëpunësuarit në bujqësi;

3. Transfertat nga Buxheti i Shtetit për rritjen e përfitimeve dhe subvencione për mbulimin e shpenzimeve;

4. Të ardhura nga investimi i fondeve përkohësisht të lira dhe të ardhura të tjera.

- Kontributet paguhen nga: punëmarrësit e siguruar dhe nga punëdhënësit e tyre, nga të vetëpunësuarit dhe për disa kategori të veçanta edhe nga Buxheti i Shtetit.

- Kontributet e shtetit jepen për sigurimin e personave që kryejnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak, për ata që trajtohen me pagesë papunësie si rezultat i shkurtimit të vendeve të punës, si dhe për kategoritë që trajtohen me pensione të parakohshme apo me pagesa kalimtare.

- Transfertat shtetërore për FSSH-në jepen nga Buxheti i Shtetit për indeksimin e pensioneve kur këto e tejkalojnë indeksin e çmimeve të mallrave, si dhe për subvencionet për mbulimin e shpenzimeve kur nuk mjaftojnë të ardhurat. Në formën e transfertës shtetërore vijnë edhe financimet buxhetore të kompensimit me të ardhura të personave që marrin pensione minimale, si një masë për reduktimin e varfërisë.

- Të ardhura nga burime të tjera, përfshijnë të ardhurat nga investimet e fondeve përkohësisht të lira, të ardhurat nga gjobat, kamatëvonesat, komisionet për shërbimet që ISSH u kryen të tretëve dhe donacionet.

Ligji "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i lejon ISSH-së që me kontributet e arkëtuara të financojë vetëm dy lloje shpenzimesh:

- përfitimet që jepen sipas 5 skemave të ndryshme të sigurimit;

- shpenzimet administrative që mbulojnë kostot e operacioneve dhe të zhvillimit të ISSH-së, maksimumi i të cilave nuk mund të tejkalojë 5% të buxhetit të ISSH-së.

Duke qenë një institucion i organizuar me përvojë dhe shtrirje territoriale në gjithë vendin, Instituti i Sigurimeve Shoqërore është ngarkuar nga Këshilli i Ministrave të administrojë edhe disa skema të pensioneve shtetërore suplementare, skema të trajtimeve financiare të veçanta, si dhe kompensuese të të ardhurave apo të rimbursimit të shpenzimeve të familjeve të pensionisteve si pasojë e rritjes së çmimeve.

Zhvillimi i sistemit dhe reformat e ndërmarra

Struktura aktuale financiare dhe administrative e sistemit të sigurimeve shoqërore filloi nga puna në 1993 duke reformuar tërësisht legjislacionin e mëparshëm. Gjatë një veprimtarie disavjeçare nga zbatimi i ligjit, në harmoni me zhvillimet e përgjithshme ekonomike dhe ato të fushës së sigurimeve shoqërore në veçanti, kanë sjellë kohë pas kohe domosdoshmërinë e ndërmarrjes së reformave me synimin që sistemi i sigurimeve shoqërore t'u përshtatet zhvillimeve ekonomike të kohës. Në këtë kuadër, në mënyrë të vazhdueshme në legjislacionin e sigurimeve shoqërore janë projektuar e miratuar ndryshime, të cilat kanë prekur të gjitha fushat, si në përmirësimin e procedurave në mbledhjen e kontributeve, ashtu edhe ndryshime thelbësore në fushën e përfitimeve:

- Reforma për pensionet e fshatit në vitin 1998, e cila u fokusua në ndryshimin e formulës së llogaritjes së pensioneve të fshatit duke synuar një lidhje më të drejtpërdrejtë midis kontributeve të derdhura me shumën mujore të pensionit, si dhe ndërtimin e një strategjie të barazimit gradual të pensioneve të reja të fshatit me ato të qytetit.

- Reformat e vitit 2002 që ndryshuan parametrat e sistemit, në të cilat përshihen:

- rritja graduale e moshës së daljes në pension në 65 për burrat dhe 60 për gratë;

- e drejta për përfitimin e pensionit të reduktuar, 3 vjet para mbushjes së moshës për pension por me kushtin që të jetë plotësuar periudha maksimale e sigurimit;

- reduktimi me 4% i normës së kontributit të sigurimeve shoqërore;

- rritja e pagës kontributive maksimale nga 1:3 në 1:5;

- transferimi i mbledhjes së kontributeve nga ISSH-ja në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

- Reformat e viteve 2005 – 2009 në të cilat përfshihen:

- përqasja e legjislacionit shqiptar të sigurimeve shoqërore me standardet e Kodit Europian dhe me Konventën e ILO-s për sigurimet shoqërore në vitin 2005

- shkurtimi i periudhës minimale të sigurimit për përftimin e pensionit të pjesshëm të pleqërisë, nga 20 në 15 vjet;dhe

- reduktimi i normës së kontributit në shtator të vitit 2006, e cila vazhdonte të mbetej e lartë (reduktimi me 9% nga 38.5% në 29.5%) dhe në maj të vitit 2009 (reduktimi me 5% nga 29.5% në 38.5%);

- Vendosja e një kompensimi shtesë mbi pension për të gjithë pensionistët që nëpërmjet kontributeve kanë arritur të kenë pensione mujore minimale.

Ecuria e disa treguesve te sistemit

- Të ardhurat nga kontributet dhe numri i kontribuesve paraqiten me rritje nga viti në vit. Në 2010 të ardhurat ishin 20% më shume në krahasim me 2007 megjithëse në krahasim me atë vit norma e kontributit u reduktua me 5 pikë ose rreth 17%. Numri i kontribuesve është rritur me rreth 29 000 persona ose rreth 4% ndërkohë që vit pas viti krahas indeksimit të pensioneve është indeksuar edhe paga minimale e përcaktuar për efekt të pagimit të kontributeve. Në situatën aktuale, me gjithë përmirësimet e shënuara vlerësohet se pjesëmarrja e popullsisë aktive në skemën e sigurimeve shoqërore vazhdon të jetë relativisht e ulët; më e theksuar paraqitet kjo dukuri në zonën rurale. Mbi këtë dukuri negative ka ndikuar sidomos:

i) Mangësia e informacionit të detajuar e në kohë reale mbi subjektet dhe veprimtarinë e tyre.

ii) Mangësia e evidentimit të lëvizjeve të popullsisë, sidomos e lëvizjeve hapësinore dhe për pasojë njohje e pjesshme e dinamikës së tregut të punës duke sjellë si pasojë moskonstatim të shmangieve nga pagesat.

- Numri i përfituesve, pas një rritjeje drastike në tre vitet e para të tranzicionit, fillon e normalizohet në vitet e mëvonshme në një rritje graduale. Në vitin 2010 numri i përfituesve është rreth 541 700 persona nga të cilët 428 000 janë persona që marrin pension pleqërie. Krahasuar me vitin 2007 numri i përfituesve në vitin 2010 është rritur me rreth 3% dhe ndër to, për shkak se vijon zbatimi i reformës së rritjes graduale të moshës së daljes në pension, me 6 muaj për çdo vit, numri i përfituesve të pensioneve të pleqërisë është rritur me 1.1%. Presionet nga grupe të caktuara punonjësish për pensione të parakohshme, ndonëse kanë ardhur duke u ulur, përsëri janë prezente, por jo për t'u konsideruar.

- Shpenzimet e skemës së sigurimeve shoqërore evidentojnë një rritje graduale e normale në vite. Ne vitin 2010 transfertat në buxhetet familjare nga sistemi i pensioneve arritën mbi 63.7 miliardë lekë ose 33% më shumë se në vitin 2007 ose rreth 5.3% e PBB. Ndër to, rritjen më të ndjeshme në përqindje e zënë transfertat nga sistemi i pensioneve për fshatin të cilat krahasuar me vitin 2007 rriten me rreth 55%. Politikat e pensioneve kanë vazhduar të synojnë rritjen e pensioneve dhe sidomos atyre të fshatit, me synim barazimin e tyre për nivelin minimal. Qeveria ka synim që kjo të arrihet në vitin 2012. Ndërsa në vitin 2007 të ardhurat vjetore minimale nga pensioni për pensionet urbane, për një përfitues, ishin rreth 103800 lekë, në vitin 2010 ato arritën në rreth 128 300 lekë me një rritje prej 23.6%. Ndërsa për pensionet e fshatit të ardhurat minimale vjetore nga pensionet, në vitin 2010 arrijnë 83764 lekë me një rritje prej 54.4% më shumë se në vitin 2007. Për të dyja skemat në periudhën 2007-2010 qeveria ka aplikuar politikën e një të ardhure shtesë për pensionistët që marrin pensione minimale, e cila financohet totalisht me fondet e buxhetit të shtetit. Për shkak të kompensimit me të ardhura të pensioneve minimale, në fund të vitit 2010 të ardhurat minimale vjetore arritën në 154 080 lekë.

- Së bashku me sistemin e sigurimeve shoqërore, ISSH administron edhe skema të sigurimeve suplementare, trajtimeve të veçanta financiare, si dhe skemat kompensuese. Sa më sipër, buxheti i përgjithshëm i ISSH-së për vitin 2010 rezulton 79.3 miliardë lekë kundrejt 60.8 miliard lekë që ishte në vitin 2007, me një rritje prej 30.4% ose rreth 6.5% e PBB. Ndërkohë, pjesa e shpenzimeve administrative ka qenë për çdo vit nën 2% të buxhetit të përgjithshëm të ISSH-së dhe në vitin 2010 ajo konstatohet në masën 1.9% e shpenzimeve totale.

- Për vitin 2011, të ardhurat nga kontributet pritet të realizohen rreth 48 miliardë lekë ose 6,2% më shumë se në vitin 2010, transfertat në buxhetet familjare nga sigurimi i detyrueshëm pritet të realizohen 70.2 miliardë lekë ose rreth 6.9 % më shumë se në vitin 2010. Brenda skemës së detyrueshme shpenzimet për pensione parashikohen 68 miliard lekë me një rritje ndaj vitit 2010 me 6.6%. Në total shpenzimet për sigurimet shoqërore parashikohen 86.7 miliardë lekë dhe mbeten në nivelin 6.5% e PPB, ashtu sikurse edhe në vitin 2010.

- Sa trajtuam më sipër në 3 vitet e fundit:

i) Evidentohen dukuritë pozitive të rritjes së transfertave në buxhetet familjare nga pensionet publike të cilat njëherësh kanë ndikim të rëndësishëm në rritjen e konsumit dhe në reduktimin e varfërisë sidomos në fshat.

ii) Zbatimi i reformës së rritjes graduale të moshës së daljes në pension ka reduktuar shtesën e numrit të përfituesve por ndërkohë evidentohet një rritje e numrit të personave që aplikojnë dhe marrin pensione invaliditeti.

iii) Megjithëse evidentohet një rritje e ndjeshme e të ardhurave përsëri ato nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar nevojat për fonde të sistemit të pensioneve publike. Qeveria në periudhën 2006-2010 ka ulur me rreth 40% barrën kontributive të bizneseve, norma e kontributit nga 38.5% ka arritur në 24.5% por megjithatë evidentohen dukuritë e evazionit të kontributeve sidomos evidentohet fenomeni i punës në "të zezë". Në disa biznese evidentohet edhe dukuria e "fshehjes" së pagës reale.

iv) Megjithëse qeveria financon rreth 65% të kontributeve të fermerëve përsëri pjesëmarrja e tyre në skemën e pensioneve nëpërmjet pagesës së kontributeve është mjaft e ulët duke evidentuar një numër njerëzish që nuk do të kenë mundësinë e përfitimit të një pensioni në të ardhmen.

v) Skema e pensioneve publike rezulton mjaft deficitare dhe deficiti i saj po kalon 1% të PBB-së duke u bërë një barrë e rëndë për Buxhetin e Shtetit.

vi) Brenda skemës së detyrueshme evidentohen elemente që kanë dobësuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis kontributeve dhe përfitimeve aktuale dhe të ardhme. Kështu personat që kontribuojnë me paga të larta, në nivelet e 4-5 fish të pagës minimale, mund të marrin të ardhura nga pensione në nivelin e 30-35% të pagës gjë që demotivon pagesat dhe rrezikon fshehjen e të ardhurave reale.

Objektivat tërësore dhe ato specifike të buxhetit afatmesëm 2012-2014

Objektivat tërësore dhe specifike të buxhetit afatmesëm kanë përmirësimin e sistemit të sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe të sistemit të pensioneve publike në veçanti por edhe modernizimin e ISSH-së dhe përmirësimin e efiçencës së saj në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, suplementare dhe programore. Për këtë është e nevojshme:

- Problemet që u konstatuan më lart kanë evidentuar nevojën e ndërmarrjes së një reforme tërësore parametrike e sistemike për sistemin e përgjithshëm të sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe veçanërisht të sistemit të pensioneve publike.
- Vazhdimi me ritme të shpejta të reformave administrative dhe përfundimi i projekteve të nisura për modernizimin e sistemit të sigurimeve shoqërore.
- Hartimi dhe zbatimi i politikave buxhetore afatmesme në funksion të përmirësimit të qëndrueshmërisë financiare të sistemit sidomos përmirësimi i rregullave të indeksimit të pensioneve dhe reduktimi i lehtësive kontributive për fshatin.
- Rritja e pagës mbi të cilën paguhen kontributet jo më pak se indeksi i pensioneve, si dhe përmirësimi i procedurave administrative në funksion të uljes së evazionit të kontributeve dhe rritjes së të ardhurave.

Në themel të programimit afatmesëm të ISSH-së, në funksion të strategjisë së modernizimit të ISSH-së, qëndrojnë këto objektiva kryesorë:

- Krijimi një institucioni të konsoliduar dhe të aftë për t'u integruar dhe zbatuar standardet dhe praktikat e BE-së në fushën e pensioneve.
- Vendosja e personave të siguruar dhe e përmirësimit të shërbimit ndaj tyre, në qendër të veprimtarisë së tij. Plotësimi i kërkesave të aplikantëve brenda 45 ditëve nga data e aplikimit.
- Grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe sigurimet vullnetare, administrimi efiçent i fondeve përkohësisht të lira dhe i fondit rezervë.
- Përmirësimi i infrastrukturës, vazhdimi i punës për arkivimin e përqendruar të dokumentacionit të periudhave të sigurimit dhe digjitalizimin e tyre, modernizimin e sistemit financiar, të bazës së të dhënave dhe llogaritjes së pensioneve, të administrimit të kontributeve dhe shkëmbimit të informacionit të tyre me zyrat e tatim-taksave dhe individët.

Për plotësimin e objektivave të mësipërme tërësore, nga ISSH-ja janë përcaktuar edhe këto objektiva specifike:

- Përmirësimi i administrimit të fondit të sigurimeve shoqërore dhe i shërbimit ndaj përfituesve. Kjo do të arrihet nëpërmjet:
- përfundimit të bazës së të dhënave për pensionet deri në fund të vitit 2012;

- plotësimit të bazës së të dhënave të kontributeve të të vetëpunësuarve në bujqësi dhe vullnetare dhe përditësimin e saj deri në 30.6.2012;

- vazhdimi i punës për përqendrimin e dokumentacionit të vjetërsisë në punë në arkivën e përqendruar. Vazhdimi i punës për digjitalizimin e dokumentacionit arkivor të periudhave të sigurimit, në vazhdim gjatë tre viteve;

- informatizimi i sistemit financiar dhe shërbimeve të kontabilitetit për gjithë sistemin. Gjatë vitit 2012;

- informatizimi i sistemit të administrimit të kontributeve, krijimi i rekordeve individuale të periudhës së sigurimit dhe ndërfaqësimi i këtyre sistemeve me programin e administrimit të derdhjes së kontributeve, të zyrës së tatim-taksave.

- Administrimi i fondeve të alokuara nga Buxheti i Shtetit për programe të veçanta të qeverisë nëpërmjet përditësimit të informacionit dhe koordinimin e punës me Shërbimin Social Shtetëror dhe organet e pushtetit vendor.

- Administrimi i fondeve të alokuara nga Buxheti i Shtetit për përfitime suplementare për punonjësit e shtetit, për SHISH dhe Gardën, për Policinë e Shtetit, për minatorët, për statusin "Dëshmor i Atdheut", punonjësit e ndërmarrjeve ushtarake.

- Administrimi i fondeve të alokuara nga Buxheti i Shtetit për përfitime suplementare, për ushtaraket e MM, për pilotët fluturues në pension dhe ushtarakët e nëndetëseve në pension. Implementimi i programit të krijimit të llogarive personale të kontribuesve.

- Përmirësimi i menaxhimit të sistemit të sigurimeve shoqërore dhe fillimi i procesit të digjitalizimit të dokumentacionit arkivor.

- Rritja e nivelit të përfitimeve të pensionistëve me 4% dhe shmangia e presioneve për pensione të parakohshme nëpërmjet:

- përmirësimit të metodës së indeksimit të pensioneve dhe nxitjes së formimit të kolonës së dytë e të tretë të sistemit të përgjithshëm;

- vazhdimit të procesit të nisur për ngushtimin e diferencave në pensionet e fshatit me qytetin dhe harmonizimi i këtij procesi me masën e kontributit dhe pjesëmarrjen në skemën e sigurimeve;

- Përfshirja më e gjerë e të vetëpunësuarve në zonat rurale në skemën e sigurimeve shoqërore të detyrueshme.

- Zhvillimi dhe fuqizimi i kapaciteteve institucionale të ISSH-së për të garantuar një menaxhim sa më efikas të skemës së sigurimeve shoqërore e një administrim korrekt e ligjor të shpenzimeve.

- Përmirësimi i raporteve kontribues përfitues dhe pagë/pension minimal me pagë/pension maksimal.

Për vitin 2012 dhe për periudhën afatmesme 2012- 2014 parashikohet:

- Të ardhurat në fondin e sigurimeve shoqërore në vitin 2012 rriten me rreth 4% ndaj të pritshmit 2011 ndërsa në vitin 2014, 14.8% më shumë se viti 2011.

- Shpenzimet në buxhetin e ISSH-së (për sistemin e detyrueshëm, suplementar dhe trajtimet), në vitin 2012 rriten me 3.5% ndaj vitit 2011 ndërsa në vitin 2014 rritja parashikohet 18.4%.

- Shpenzimet për fondin e pensioneve publike në vitin 2012 parashikohen 4.2% më të larta se në vitin 2011 ndërsa në vitin 2014 rreth 19% më të larta.

- Masa e pensioneve parashikohet të rritet për çdo vit me një indeks që së paku të mbulojë rritjen e indeksit të çmimeve të mallrave të shportës, ose rreth 4%.

- Në harkun e tre viteve parashikohet të suprimohen lehtësitë kontributive për kontributet e sigurimeve shoqërore të fermerëve duke i barazuar ato me kontributet që paguhen nga personat e vetëpunësuar në aktivitete jobujqësore.

- Duke përfshirë rritjen e pensioneve dhe efektet mbetëse të rritjeve nga një vit në tjetrin, përsëri parashikohet që transfertat në buxhetet familjare nëpërmjet ISSH-së, të cilat rrjedhin nga sistemi i pensioneve dhe trajtimet e veçanta të jenë në nivelet e 6.5% të PBB-së.

- Të vazhdojë me ritme të shpejta puna për modernizimin e sistemit të sigurimeve shoqërore.

Sigurimet shëndetësore.

Sigurimi shëndetësor në Republikën e Shqipërisë është institucionalizuar në bazë të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë". Ky ligj ka pësuar disa ndryshime deri në ditët e sotme, në përshtatje me reformat e ndërmarra nga qeveria veçanërisht në vitin 2006 dhe 2008, ku në skemën e sigurimeve shëndetësore u përfshinë kujdesi parësor dhe kujdesi spitalor publik. Sigurimi shëndetësor është i ndarë nga sigurimi shoqëror. Ai është i tipit Bismarkian. Skema e sigurimeve shëndetësore ka hyrë në zbatim më 1 mars 1995 si një mekanizëm i rëndësishëm në reformimin e sistemit shëndetësor, si në drejtim të mënyrës së financimit dhe rritjes së burimeve për kujdesin shëndetësor, ashtu dhe të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve. Ky mekanizëm u vlerësua si një moderator që, i bazuar mbi parimin e solidaritetit, të zbuste efektet financiare të kalimit të sistemit shëndetësor në ekonominë e tregut dhe të përballimit të shtetasve shqiptarë me koston reale të shërbimit shëndetësor.

Sistemi aktual i sigurimeve shëndetësore ka karakter të detyrueshëm dhe bazohet në kontributet e paguara nga personat ekonomikisht aktivë dhe buxheti i shtetit për pjesën tjetër të popullatës që, në bazë të ligjit, nuk paguan kontribute.

Masa e kontributit për sigurimin shëndetësor është e ndryshme për kategori të ndryshme të popullsisë. Ajo llogaritet me përqindje mbi pagën mujore për të punësuarit (1.7% paguhet nga punëmarrësi) dhe me përqindje mbi pagën minimale të miratuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave, për të vetëpunësuarit në qytet (7%) dhe fshat (3-5%).

Punëdhënësi, qoftë ky shtetëror apo privat, duhet të paguajë për llogari të sigurimit të të punësuarve korrespondues, shumën e barabartë me 1.7% të pagës mujore të tyre. Pra në total për punonjësit e punësuar masa e kontributit është 3.4% (e ndarë 1.7% punëdhënësi dhe 1.7% punëmarrësi) e pagës mujore. Ekziston një pagë minimale e detyrueshme për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shëndetësore e cila caktohet çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Shuma që paguhet llogaritet mbi këtë pagë deri në pesëfishin e saj.

Gjithashtu, është parashikuar sigurimi vullnetar në nivelin 3.4% të pagës minimale mujore, për atë grup popullsie që nuk përfshihet në grupimet e mësipërme.

Sigurimet shëndetësore organizohen e drejtohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH), i cili është një institucion publik i pavarur, me qëllim jofitimprurës.

Hapat e ndërmarra në funksion të përmirësimit të menaxhimit të fondeve:

Vitet në vazhdim kanë qenë vitet e përpjekjeve për shtrirjen e skemës së sigurimit shëndetësor në shërbime të reja, krijimin e bazës ligjore, ristrukturimet e nevojshme për këtë shtrirje, si dhe konsolidimin e arritjeve.

Është synuar rritja e mundësisë së kontrollit mbi dhënësit e shërbimit shëndetësor, rritja e gamës së informacioneve dhe përpunimi i tyre, për rrjedhojë rritja e mundësisë së mbajtjes nën kontroll të shpenzimeve.

Pjesë shumë e rëndësishme e punës ka qenë dhe informatizimi i aktiviteteve të ISKSH-së dhe strukturave vartëse me instalimin e programeve të reja, me një bazë të fuqishme të dhënash. Me kodin e dhënësit të shërbimit, kodin e të sëmurit, kodin e diagnozës dhe elementeve të tjera të bazës merren të dhëna për shpenzimet për çdo recetë të rimbursuar, për çdo person, për çdo mjek të qendrave shëndetësore kontraktuar me ISKSH-në, merret konsumi i çdo bari të rimbursuar etj.

Falë programeve të reja të informatizimit është mundësuar gjenerimi i një game të madhe raportesh të vlefshme në trajtimin e problemeve më të rëndësishme aktuale dhe të perspektivës për monitorimin, identifikimin e të sëmurëve, dhënësve të shërbimit, gjendjes epidemiologjike, shpenzimeve dhe planifikimit.

Duke filluar nga janari 2007, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 857, datë 20.12.2006 "Për financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor", ISKSH-ja u bë përgjegjës për kontraktimin e financimin e të gjitha shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor. ISKSH-ja ka kontrata me të gjithë dhënësit publikë të kujdesit shëndetësor parësor. Ne financimin e këtij shërbimi janë futur mekanizma të matjes së performancës dhe të cilësisë së shërbimit. Duke filluar nga muaji janar 2011, financimi i kujdesit parësor

bëhet në raportet e mëposhtme:

- 80% e buxhetit të qendrave shëndetësore financohet bazuar në numrin e banorëve të regjistruar në çdo qendër shëndetësore.

- 10% e buxhetit financohet bazuar në numrin e vizitave të kryera nga mjekët e qendrës shëndetësore.

- 10% e buxhetit të çdo qendre shëndetësore financohet bazuar në realizimin e treguesve të cilësisë së shërbimit që ofron çdo qendër.

Këto raporte krahasuar me vitet e mëparshme, u përmirësuan në favor të rritjes së përqindjes së buxhetit që përfitohet kundrejt realizimit të treguesve të cilësisë (nga 5% në 10%) që ofron qendra shëndetësore dhe pakësimit të buxhetit fiks (pra të numrit të banorëve të regjistruar nga 85% në 80%).

QSH për të marrë financimin e fundit duhet të realizojë tregues të kënaqshëm për persona të vizituar për herë të parë, trajtimin me kosto-efektivitet të diagnozave të ndryshme, ndjekja e të sëmurëve kronikë, ndjekja e gruas shtatzënë, vaksinimi i fëmijëve, edukimi i vazhdueshëm i stafit të qendrës.

Qendrat shëndetësore janë vetë përgjegjëse për administrimin e burimeve të tyre financiare.

Qarqet kanë një rol të rëndësishëm në funksionimin e QSH nëpërmjet pjesëmarrjes në Bordin e tyre.

Duke filluar nga viti 2009, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1661, datë 29.12.2008 "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor", të ndryshuar, ISKSH është bërë financuesi kryesor edhe për shërbimin spitalor publik.

Kjo reformë është zbatuar edhe në vitin 2010 dhe do të vazhdojë edhe në vitet në vazhdim. ISKSH në bashkëpunim me spitalet është duke përllogaritur kostot e shërbimeve dhe synohet në financimin e spitaleve bazuar në këto kosto.

Synohet gjithashtu që spitalet të kontraktohen e financohen bazuar në rezultatet e veprimtarisë së tyre.

Theksojmë se po punohet që dhënësit publik të shërbimit shëndetësor të rrisin autonominë dhe aftësinë për të menaxhuar një skemë të tillë.

Me miratimin e ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" u realizua baza ligjore për financimin e kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me politikat dhe strategjinë e qeverisë shqiptare për reformimin dhe modernizimin e sistemit të kujdesit shëndetësor. Ky ligj u përgatit nga Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, përfaqësues të grupeve të interesit në bashkëpunim me ekspertë të Bankës Botërore.

Ligji i ri është parashikuar të hyjë në fuqi 2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare, pra në muajin mars të vitit 2013. Kjo periudhë është parashikuar si e domosdoshme për të përgatitur aktet nënligjore të autorizuara nga ligji, të nevojshme për zbatimin e tij. Gjithashtu kjo periudhë do të shërbejë për organizimin dhe ngritjen e strukturave të Fondit, si dhe vendosjen e marrëdhënieve me institucionet e tjera të identifikuara si aktorë në realizimin e përgjithshëm të sigurimit të detyrueshëm.

Parimi kryesor mbi të cilën është ndërtuar skema e sigurimeve shëndetësore, si skemë që bazohet mbi kontribute është parimi i solidaritetit. Skema synon në mbulimin e popullsisë për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor të financuara nga sektori publik dhe privat.

Duke synuar në realizimin e një mbulimi universal të popullatës, bëhet ndarja e të siguruarve në dy kategori të mëdha:

- persona ekonomikisht aktivë;

- persona ekonomikisht joaktivë;

Të dyja kategoritë janë të siguruara në skemën e sigurimeve shëndetësore, me ndryshimin e vetëm që kategoria e parë paguan vetë kontribute, ndërsa për kategorinë e dytë do të paguajë buxheti i shtetit.

Masa e kontributeve për popullsinë aktive do të vazhdojë të mbetet 3,4%, e ndarë në mënyrë të barabartë midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Baza për llogaritjen e kontributeve do të jetë:

- Paga bruto minimale e personit të siguruar deri në pesëfishin e kësaj page minimale që përcaktohet për efekt të llogaritjes së kontributeve në shkallë vendi.
- Mesatarja ndërmjet pagës bruto, minimale dhe maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve për punonjësit e vetëpunësuar.
- Mesatarja ndërmjet pagës bruto minimale dhe maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve për të siguruarit në mënyrë vullnetare.

Për popullsinë joaktive shteti do të paguajë në bazë të konsumit për frymë për shërbimin shëndetësor, indeksuar me koeficientin e inflacionit. Konsumi për frymë përcaktohet nga Fondi dhe miratohet nga Kuvendi së bashku me miratimin e buxhetit vjetor. Një përcaktim i tillë ndërton një sistem raportimi që identifikon numrin e popullsisë ekonomikisht joaktive dhe përcakton saktësisht masën e kontributit që shteti duhet të paguajë për ta.

Një nga risitë që parashikohet të sjellin ndryshimet ligjore, është prezantimi i paketave të shërbimit. Paketat e shërbimit janë një listim i atyre shërbimeve shëndetësore sipas niveleve përkatëse, parësor apo spitalor, i barnave dhe produkteve mjekësore, të cilat do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor. E veçanta konsiston në faktin se krijohet fleksibilitet në procesin e hartimit të paketave të shoqëruara me çmimet përkatëse, duke u nisur nga aftësitë paguese të buxhetit të fondit. Kjo nënkupton se jo të gjitha shërbimet mund të përfshihen në paketën e financuar nga fondi. Nga ana tjetër jepen kriteret mjekësore, ekonomike dhe sociale mbi të cilat do të hartohen paketat e shërbimeve, siç mund të përmendim shkallën në të cilën shërbimi ndikon në zgjatjen e jetës, efektiviteti i kostos së shërbimit, aftësia paguese e popullatës. Hartimi i paketave të shërbimit bëhet nga komisione teknike, ekspertët e të cilëve përfaqësojnë në mënyrë të barabartë, kriteret mjekësore, ekonomike e sociale. Tashmë do të jetë Fondi ai i cili do të hartojë këto paketa nëpërmjet ekspertëve që cakton, paketa të cilat do të miratohen nga Këshilli i Ministrave. Paketat e propozuara do të shoqërohen me një raport financiar të Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit mbi mundësinë e mbulimit nga Fondi të shërbimeve që përmbajnë paketat e propozuara. Paketat e shërbimeve do të përmbajnë edhe çmimet për secilin shërbim, të cilat gjithashtu miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Një element shumë i rëndësishëm që parashikohet me ndryshimet e fundit ligjore, është elementi i bashkëpagesës. Në këtë mënyrë konfirmohet parimi i bashkëpjesëmarrjes në mbulimin e çmimit të shërbimeve nga personat e siguruar. Mekanizmi i bashkëpagesës në një skemë sigurimesh shëndetësore, synon të realizojë disa qëllime:

- së pari, rikujton konsumatorët se shërbimet shëndetësore kushtojnë, pra e kanë një çmim për të cilin edhe qytetari duhet të paguaj;
- së dyti, ndihmon në menaxhimin e skemës duke formalizuar pagesat informale;
- së treti, është mjet për të ndaluar apo kufizuar kërkesat abuzive për akses në skemën e sigurimeve shëndetësore.

Megjithatë në zgjerim të parimit të solidaritetit, parashikohen edhe përjashtime nga bashkëpagesa për kategori personash për shkak të veçorive sociale e shëndetësore (p.sh. veteranë) të cilat përcaktohen me vendim qeverie.

Parashikohet edhe rasti kur Fondi nuk financon shërbime shëndetësore, ndaj personave që nuk janë të siguruar në përputhje me dispozitat ligjore, me përjashtim të rasteve të urgjencës mjekësore. Në ketë mënyrë duke përjashtuar rastet e urgjencës, që personat të përfitojnë nga skema e sigurimeve shëndetësore duhet të ndjekin procedurat dhe rregullat e duhura që të vërtetojnë sigurimin e tyre sipas kategorive në të cilën bëjnë pjesë.

Sipas ndryshimeve ligjore, Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, shndërrohet në Fond të Sigurimeve Shëndetësore. Ky ndryshim nuk ka të bëjë thjeshte me ndryshimin e emrit, të blerësit të vetëm të shërbimeve shëndetësore, por me krijimin e një fondi që do të sigurojë fleksibilitet në financimin e shërbimeve shëndetësore, transparencë në administrimin e fondeve dhe besueshmëri maksimale të të siguruarit që kanë derdhur kontribute pranë tij. Pavarësisht se fondi është i detyruar të ndjekë strategjinë e hartuar në këtë fushë, ai është i detyruar të hartojë plane menaxhuese në fushën e sigurimeve shëndetësore dhe të raportojë në organet më të larta për zbatimin e këtyre planeve.

Sipas ligjit të ri, i jepet e drejta Fondit të Sigurimeve Shëndetësore të kontraktojë edhe me dhënës privat të shërbimeve shëndetësore, bazuar në rregullore të mirëpërcaktuara.

Për vitin 2011, mbështetur në paketën fiskale të miratuar nga parlamenti, filloi aplikimi për herë të parë i TVSH-së për barnat në masën 10%, ndërsa u ul TVSH-ja për materialet mjekësore nga 20% që është në masën 10%. Rimbursimi i TVSH-së për barna që përfshihen në listën e rimbursimit të barnave ashtu edhe për barnat e materialet mjekësore që përdorin spitalet përballohet me shtesën e fondeve të miratuara nga parlamenti në buxhetin e ISKSH-së.

Aktualisht ISKSH-ja është duke punuar për përgatitjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri. Ndër më kryesoret janë, statuti i fondit, paketat e shërbimeve. Edhe për këto akte do të ketë bashkëpunim me institucionet përkatëse dhe ekspertë të Bankës Botërore.

Gjithashtu, në fushën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore përveç sa më sipër janë ndjekur dhe informuar në vazhdimësi për ecurinë e procedurave të marrëveshjeve dypalëshe në fushën e sigurimeve shoqërore për disa vende si Greqia, Hungaria, Belgjika, Gjermania, si dhe janë propozuar fushat e bashkëpunimit. Kanë vazhduar procedurat e zbatimit të marrëveshjes për mbrojtjen sociale midis Turqisë dhe vendit tonë. Është kërkuar bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, dhe ISSH e ISKSH për vazhdimin e negociatave me Hungarinë dhe Belgjikën.

3.2.4 Sektori bujqësor

Programi i Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e sektorit bujqësor, në linjë me objektivin e përgjithshëm të qeverisë shqiptare për të ecur drejt integrimit në BE, është i përmbledhur në Strategjinë Sektoriale të Bujqësisë dhe Ushqimit. Në këtë strategji janë përcaktuar pesë objektiva strategjike:

- Rritja e mbështetjes financiare për fermat dhe biznesin bujqësor dhe agropërpunues;
- Përmirësimi i menaxhimit të ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore;
- Përmirësimi i marketingut të produkteve bujqësore dhe ushqimore;
- Rritja e nivelit të cilësisë së teknologjive, informacionit dhe njohurive të fermerëve dhe agropërpunuesve;
- Cilësi dhe siguri më e mirë e produkteve bujqësore dhe ushqimore.

Për përmbushjen e objektivit të parë qeveria shqiptare ka filluar mbështetjen për sektorin bujqësor që në vitin 2007, vit në të cilin është subvencionuar vetëm një skemë mbështetëse "Mbjelljet e reja" (ku përfshihen, ullishtat, pemëtoret dhe vreshtat). Gjatë vitit 2008 janë zbatuar 11 skema mbështetëse me 2580 aplikime ku përveç mbjelljeve të reja (ku përfshihen, ulliri, pemëtoret dhe vreshtat) janë përfshirë dhe skema të tjera si skemat për mbështetjen e blegtorisë (të imtat dhe prodhimi i qumështit), prodhim i produkteve bio, serat me ngrohje teknike, prodhimi i vajit Extra-Vergine, kultivim fidanësh në fidanishte, ujitje me pika, si dhe nxitja e kreditimit nga bankat e nivelit të dytë për sektorin e bujqësisë nëpërmjet subvencionimit të normës së interesit të kredive. Gjatë vitit 2009 janë zbatuar 16 skema mbështetëse me gjithsej 3536 aplikime. Përveç skemave të vitit 2008 gjatë këtij viti janë shtuar skema të tilla si: luftimi i mizës së ullirit, mbarështimi i kërmillit, si dhe mbarështimi i bletëve. Gjatë vitit 2010 janë zbatuar 11 skema mbështetëse me gjithsej 8045 aplikime. Së fundi në vitin 2011 janë duke u zbatuar 17 skema mbështetëse. Ndërsa për nxitjen e sektorit të agropërpunimit ekziston edhe një skemë për nxitjen e investimeve në teknologjitë prodhuese, nëpërmjet subvencionimit të normës se interesit për kreditë bankare.

Në total gjatë këtyre viteve janë financuar gjithsej 25 000 projekte me një sipërfaqe totale prej 10 049 ha dhe janë disbursuar nga buxheti i shtetit 860 milionë lekë në 2008, 1100 milionë në 2009, 1058 milionë lekë në 2010, 723 milionë lekë në 2011 dhe parashikohet që në 2012 të disbursohen 1100 milionë lekë.

Një nga synimet strategjike në të ardhmen do të jetë nxitja e arroreve. Shqipëria ka avantazhe konkurruese e në disa raste avantazhe absolute në prodhimin e frutave arrore përfshirë këtu edhe shegën. Politikat aktuale dhe skemat mbështetëse përfshijnë të plotë gjithë zinxhirin e vlerave që nga mbjellja e kultivarit të diferencuar për çdo zonë, si dhe grumbullimin, përpunimin dhe eksportin e arroreve dhe shegës. Një studim në nivel kombëtar është ezauruar dhe vlerësohet se nga investimi publik (filluar në

2011 me skemat) dhe privat do të përfitojnë një total prej 42 610 familje fermere dhe se do të krijohen rreth 1 765 vende pune me kohë të plotë ku nga këto: 925 vende pune krijohen në sektorin e prodhimit dhe 840 vende në sektorin e përpunimit.

Lidhur me përmirësimin e marketingut të produkteve bujqësore politikat qeveritare janë përqendruar në plotësimin e zinxhirit të marketingut me objekte të reja marketing. Konkretisht, me fonde të buxhetit të shtetit dhe me fonde të donatorëve të ndryshëm është mundësuar ndërtimi i 8 tregjeve të tregtimit me shumicë dhe pakicë të produkteve bujqësore dhe ushqimore dhe ndërtimi dhe pajisja e 11 thertoreve në të gjithë territorin e vendit. Synimi për të ardhmen është ndërmarrja e një studimi të përgjithshëm për përcaktimin e nevojave për objekte të marketingut në vend.

Sektori i agropërpunimit është një degë e rëndësishme e sektorit bujqësor dhe zë rreth 25% të prodhimit të brendshme të sektorit bujqësor. Gjatë kësaj periudhe ka pasur një zhvillim të vazhdueshëm të këtij sektori, e shoqëruar me një rritje të vazhdueshme të investimeve në këtë degë. Aktualisht kjo degë mbështetet tërësisht në iniciativën private, pasi të gjitha ndërmarrjet shtetërore janë privatizuar. Gjithsesi, edhe pse i është kushtuar një rëndësi e veçante përmirësimit të agropërpunimit nëpërmjet mbështetjes, serish ky sektor vazhdon të jetë pak i zhvilluar. Një situatë e tillë bën të domosdoshme hartimin e politikave të reja për zhvillimin e këtij sektori dhe mbështetjen edhe në të ardhmen e iniciativave private për investime në këtë sektor.

3.2.5 Reforma administrative

I. Reforma funksional- strukturore

Reforma funksional-strukturore, ka si synim kryesor të saj përshtatjen e vazhdueshme të strukturave dhe organikave të institucioneve të administratës publike, me misionin, funksionet, kompetencat dhe aktivitetet që ato duhet të kryejnë. Në këtë këndvështrim, si dhe në zbatim të "Strategjisë ndërsektoriale të reformës në administratën publike (SNRAP) 2009-2013, në kuadër të Strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim" edhe gjatë vitit 2011, me mbështetjen edhe të projektit të financuar nga Bashkimi Europian dhe Qeveria Gjermane, nëpërmjet GTZ, "Mbështetje për Departamentin e Administratës Publike", qeveria shqiptare ka ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme:

- Me synimin e standardizimit të mënyrës së organizimit të strukturave dhe organikave të ministrive të linjës, institucioneve të pavarura, institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit dhe në varësi të ministrave të linjës, është miratuar vendimi nr. 474, datë 16.6.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e standardeve dhe procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike". Në zbatim të afateve të përcaktuara në këtë vendim, përshtatja e strukturave të ministrive të linjës, si dhe institucioneve në varësi të tyre do të përfundojë në fund të vitit 2011. Ndërkohë për institucionet e pavarura, rishikimi i strukturave në përshtatje me kriteret e miratuara në këtë vendim, është përcaktuar një periudhë transitore 2-vjeçare nga hyrja në fuqi e tij.

- Pas miratimit të vendimit të sipërcituar, me synimin e ardhjes në ndihmë të nëpunësve përgjegjës për propozimin e ndërtimit të strukturave dhe organikave në institucionet e ndryshme (ministri linje, institucione në varësi, apo institucione të pavarura), është realizuar edhe përshtatja e një kurrikule trajnimi, i cili vazhdon të organizohet nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike.

Një aktivitet tjetër i rëndësishëm gjatë vitit 2011, ka qenë edhe rishikimi dhe vazhdimi i konsultimeve për draftligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës publike, në të cilin siç edhe është sqaruar më parë përcaktohen:

- parimet e ndërtimit të institucioneve;
- ndarja e funksioneve;
- marrëdhëniet midis institucioneve dhe brenda tyre etj.

II.a. Thellimi dhe zgjerimi i reformës në shërbimin civil

Në mbështetje të programit të shpallur të qeverisë shqiptare, për thellimin dhe zgjerimin e reformës në shërbimin civil, e më gjerë të reformës në menaxhimin e burimeve njerëzore, puna gjatë vitit 2011 është përqendruar në drejtim të forcimit të kapaciteteve të administratës publike. Në këtë kuadër, janë organizuar një sërë trajnimesh nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, por edhe nga Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA).

Gjithashtu, gjatë vitit 2011, Departamenti i Administratës Publike me mbështetjen edhe të projektit të financuar nga Bashkimi Europian dhe Qeveria Gjermane, nëpërmjet GIZ, "Mbështetje për Departamentin e Administratës Publike", ka hartuar edhe tre dokumente të rëndësishme të cilët synojnë rishikimin e:

- sistemit të përshkrimeve të pozicioneve të punës;
- sistemit të vlerësimit të pozicioneve të punës;
- sistemit të vlerësimit të arritjeve vjetore individuale.

Pas miratimit të këtyre tre dokumenteve nga Këshilli i Ministrave, gjatë vitit 2012, synohet shtrirja e procedurave që rrjedhin nga sa më sipër, edhe për pozicione pune dhe institucione të cilat aktualisht nuk përfshihen në fushën e veprimit të shërbimit civil.

Për sa i përket të ardhmes në këtë drejtim, në mbështetje edhe të SNRAP, me mbështetje edhe të SIGMA, në respektim edhe të letrës së politikave për një ligj të ri të shërbimit civil (të hartuar dhe diskutuar gjatë vitit 2010), gjatë vitit 2011 është përgatitur projektligji "Për nëpunësit Civil". Ky projektligj është tashmë në diskutim (botuar edhe në faqen e *web* të Departamentit të Administratës Publike) me të gjitha palët e interesuara. Gjithashtu, synohet që pas diskutimit të tij, dhe pas rishikimit në këndvështrim të të gjitha komenteve nga palët e interesuara, ai të dërgohet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave dhe më pas në Kuvend, brenda vitit 2012.

Sipas këtij projektligji, propozohet:

- Një shtrirje e fushës së veprimit të legjislacionit të shërbimit civil (LSHC), në disa institucione të mëdha qendrore, si dhe në degët e ministrive, institucionet e varësisë dhe komuna etj. Parimet thelbësore të rekrutimit, performancës, karrierës, trajtimit dhe garancive të LSHC, duhet të përhapen sa më shumë në administratën publike. Gjithashtu, konsiderohet si shumë e rëndësishme që kjo shtrirje të bëhet graduale, e lidhur fortësisht me ecurinë e rishikimit funksional dhe strukturor të institucioneve të administratës publike, si dhe duke marrë parasysh veçantitë e kategorive të caktuara të këtyre institucioneve (p.sh. institucionet e vogla në territor, apo komuna e bashki përkundrejt ministrive);
- parashikimi i rekrutimit masiv për pozicionet "Specialist";
- krijimi i kategorisë së "Nëpunësve të Lartë të Shërbimit Civil";
- thelbi i sistemit të shërbimit civil do të mbetet pozicioni, por duke forcuar elementin e karrierës vertikale dhe horizontale, si dhe duke eliminuar faktorët frenues ndaj rritjes së mobilitetit të brendshëm horizontal dhe vertikal.

II.b. Reforma në fushën e pagave

Në lidhje të ngushtë me reformën në shërbimin civil dhe administratën publike në tërësi, gjatë vitit 2011 u realizua edhe reforma në fushën e pagave. Konkretisht, kjo reformë u krye për këtë vit, në drejtimet si më poshtë:

- rritje e ndjeshme dhe në mënyrë të diferencuar e nivelit të pagave për sistemin e arsimit parauniversitar;
- rritje e ndjeshme dhe në mënyrë të diferencuar e nivelit të pagave për sistemin e shëndetësisë;
- rritje e pagave për pjesën tjetër të nëpunësve/punonjësve të administratës publike.

Për vitet në vazhdim, synohet:

- ristrukturimi i plotë i sistemit të pagave për punonjësit mbështetës (punonjësit e sistemit me klasa);
- lidhja e sistemit të vlerësimit dhe kualifikimit të nëpunësve civilë dhe nëpunësve të tjerë të administratës publike, me pagën e tyre, me synimin e vënies në funksionim, të skemës së karrierës horizontale të tyre;
- indeksimi i pagave për pjesën tjetër të punonjësve të administratës publike.

3.3 *Additional reform areas*

Mbi reformat në sektorin e turizmit

Turizmi është një sektor prioritar i ekonomisë dhe eksporteve shqiptare me kontribut 14,7% në PBB dhe 47% të eksporteve. Turizmi kontribuon veçanërisht në punësim, në zhvillimin e disa fushave të ekonomisë dhe në marketingun e vendit në përgjithësi.

Në zbatim edhe të dokumenteve kryesore, si ligji për turizmin dhe strategjia sektoriale e turizmit 2007-2013, konkretisht të cituara më poshtë: nenin 19 i ligjit nr. 9734, datë 14.5.2007 "Për turizmin", të ndryshuar, ku flitet për propozon politika lehtësuese për bizneset (që ministria është në proces hartimi).

Strategjia sektoriale e turizmit, aksioni 5.7.4 "Azhurnimi i sistemit të taksave të turizmit". Shqipëria duhet ta rishikojë sistemin e saj dhe ta rregullojë atë për të plotësuar pozicionin aktual të sektorit të saj të turizmit dhe të nevojave për gjenerimin e të ardhurave. Një rishikim fillestar sugjeron që taksa është shumë e lartë dhe e përqendruar në hotelet (që ekzagjeron artificialisht një faktor të dukshëm në vendimet e turistit për të vizituar vendin) (SST 2007-2013) .

Argumentimet për një TVSH të reduktuar për hotelet dhe restorantet në Shqipëri bazohen në praktikën që po ndjek BE-ja për sistemin e TVSH-së së reduktuar në vendet anëtare të saj.

Prej vitesh hotelet dhe tashmë dhe restorantet në vendet e BE-së në bazë të direktivave të Komisionit Europian kanë mundësinë të jenë subjekt i TVSH-së së reduktuar.

(Direktiva 2006/112/EC dhe 2009/47/EC: mbi sistemin e përbashkët të vlerës së shtuar të taksave, si dhe ndryshimet pasuese).

TVSH-ja në BE për hotelet dhe restorantet:

- 22 nga 27 vendet e BE-së kanë një TVSH të reduktuar;
- 22 nga 27 vendet e BE-së kanë reduktuar TVSH-në për hotelet (më të ulët se 15%);
- 13 prej tyre kanë reduktuar TVSH-në për restorantet

(më të ulët ose baras me 15%).

TVSH-ja NË VENDET FQINJE

Vendet fqinje	Niveli i TVSH në hotele	Niveli TVSH për restorantet	TVSH për agjentët turistikë
Greqia	10	10	
Mali i Zi	7	n/av	TVSH mbi komisionin
Kroacia	10	23	
Bullgaria	7	20	
Sllovenia	8,5	8,5	
Rumania	9	19	
Franca	5,5	5,5	
Spanja	7	7	
Italia	10	10	
Maqedonia	18	18	

Reforma administrative

Për sektorët e punëve publike dhe transportit vlerësojmë si reforma administrative me kontribut në mirëadministrimin e burimeve financiare dhe natyrore masat e mëposhtme:

Transporti rrugor

Gjatë vitit 2011, në fushën e transportit rrugor janë ndërmarrë disa iniciativa ligjore që lidhen me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në pranimin në treg si vijon:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 101, datë 9.2.2011 "Për miratimin e rregullave për lejet e transportit dhe kryerjen e operacioneve të transportit nga transportuesit e huaj, që nuk kanë selinë në Shqipëri (jorezidentë), për mallra dhe udhëtarë", përafron rregulloret (EC) 1072 dhe 1073/2009 (FZ nr. 14, v. 2011).

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 194, datë 9.3.2011 "Për disa shtesa e ndryshime" në vendimin nr. 325, datë 19.2.2008 "Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare të caktuara për këta operatorë", përafron rregulloren (EC) nr. 1071/2009, (FZ nr. 40, v. 2011).

- Ka përfunduar implementimi i sistemit të tahografit digjital; janë miratuar aktet ligjore për miratimin e tipit të tahografit, instalimin dhe inspektimin.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1054, datë 22.12.2010 "Mbi miratimin e rregullores për pajisjet e regjistrimit në transportin rrugor" (FZ nr. 186, datë 28.12.2010), dhe udhëzimi i Ministrit nr. 8, datë 29.4.2011 "Mbi kërkesat teknike dhe standardet e operimit të ofiçinës (qendrës teknike) së autorizuar të tahografit", (FZ nr. 68, v. 2011), që përafrojnë rregulloren 3821/85/EC të BE-së,

Për vitet 2012-2013 është parashikuar hartimi i legjislacionit të ri për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme që konsiston në hartimin e ligjit "Për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme", si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Kjo paketë ligjore e cila do të hartohet në përafrimin me direktivën 2008/68/EC, do të përfshijë rregullat për transportin e mallrave të rrezikshme në fushën e operimit në transportin rrugor dhe hekurudhor, kërkesat për mjetet, kompetencat dhe kushtet për kryerjen e trajnimit të personelit të përfshirë në transport, kompetencat e organeve shtetërore në lidhje me transportin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të mallrave të rrezikshme.

Transporti hekurudhor

Aktualisht, "Hekurudha Shqiptare" sh.a. është një shoqëri anonime me kapital tërësisht shtetëror. Në përputhje me legjislacionin europian të fushës, para dy vjetësh, kjo shoqëri anonime është ndarë në katër njësi biznesi, me llogari të veçanta.

Gjatë vitit 2011 puna është fokusuar në përmirësimin gradual të kuadrit ligjor, në përputhje me legjislacionin europian, si dhe në forcimin institucional. Kështu gjatë këtij viti është hartuar dhe miratuar rregullorja "Për licencimin e transportuesve hekurudhorë", e cila do të ndikojë drejtpërdrejt në hapjen e tregut në këtë sektor dhe përmirësimin e klimës së biznesit hekurudhor.

Për vitet 2012-2014, në përputhje me dokumentet strategjike sektoriale të miratuar do punohet në drejtimet e mëposhtme:

Reforma ligjore

Ka filluar puna për hartimin e ligjit të ri të hekurudhave, i cili do të jetë në përputhje me të gjitha direktivat e deritanishme të BE-së. Parashikohet ristrukturimi i Hekurudhës Shqiptare, hapja e tregut për operatorët e tjerë, krijimi i organeve rregullatore etj.

Reforma strukturore dhe funksionale

Në bazë të projektligjit të ri të hekurudhave parashikohet që në periudhën 2012-2014, Hekurudha Shqiptare sh.a. do të ndahet në katër ndërmarrje krejtësisht të veçanta. Ndërmarrja e infrastrukturës hekurudhore do të jetë ndërmarrje publike. Dy ndërmarrjet e transportit (e transportit të udhëtarëve dhe e transportit të mallrave) dhe baza e riparimit të mjeteve lëvizëse fillimisht do të jenë shoqëri anonime, pronë shtetërore e më tej mund të privatizohen.

Projektligji, që është në proces, parashikon krijimin e Autoritetit Hekurudhor Shqiptar, i cili do të jetë i pavarur dhe do të përfshijë Entin Rregullator të Tregut, Autoritetin Hekurudhor të Sigurisë dhe Entin Notifikues. Enti i Hetimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore, në përputhje me legjislacionin europian, do të jetë një njësi krejtësisht e pavarur edhe nga Autoriteti Hekurudhor Shqiptar.

Transporti detar

Mbi bazën e Strategjisë së zhvillimit dhe integrimit dhe master planit të Portit të Durrësit gjatë vitit 2011 është dhënë me koncesion terminali i kontejnerëve shoqërisë "Kurum Grup", me të cilën është lidhur kontrata përkatëse më 25 gusht 2011.

Për vitin 2012-2014, nga ana e Autoritetit Portual Durrës do të punohet për privatizimin/dhënien me koncesion të terminaleve të operimit në port.

Për sa i përket porteve të Shëngjinit dhe të Sarandës nga ana e tyre do të punohet për privatizimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të mallrave.

Ujësjellës kanalizime

Për vitin 2012-2014 është parashikuar që të ndërmerren reforma administrative mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 643, datë 14.9.2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve".

- Fillimi i një programi që inkurajon bashkimin e ujësjellës kanalizimeve. Qëllimi strategjik është pakësimi i numrit të ndërmarrjeve të ujësjellësit në vitin 2012-2014 nga 57 ndërmarrje në 40. Ky program përfshin:

a) Hartimin e një Plani zbatimi të detajuar për të arritur qëllimin strategjik;

b) Dhënia e kapitalit "fillestar" për sh.a.-të, që dëshirojnë të bashkohen (në formën e studimeve të fizibilitetit, sisteme informimi gjeografik, sisteme kontabiliteti, automjete etj.

Nëpërmjet rajonalizimit të sh.a ujësjellës kanalizime do të sigurohen:

- instrumentet me të domosdoshme për një menaxhim bashkëkohor;
- tërhiqen më shumë investime kapitale;
- veprohet në përputhje me direktivën kuadër të BE-së për ujin;
- shërbehen edhe banorët të cilët nuk janë në zonat e shërbimit të shoqërive aktuale;
- përfshihen edhe shtresat më të varfra.
- Hartimin e një ligji të ri specifik për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve, i cili do të shërbejë për mirëfunksionimin e sektorit duke përfshirë edhe rajonalizimin.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 20.3.2012
Doli nga shtypi më 22.3.2012

	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 118 lekë